

6657/p

thema

REVISTË E SHOQATES SE FILOZOFËVE
DHE SOCIOLOGJEVE TË KOSOVËS

11-13



11

THE
JOURNAL
OF
THE
ROYAL
ANTHROPOLOGICAL
INSTITUTE

19 12 18

25 16 13

7 11

4 14 10

11 15

12 16

13

thema

EKZEMPLARI I DETYRUESHË

REVISTË E SHOQATËS SË FILOZOFËVE
DHE SOCIOLOGËVE TË KOSOVËS



Thema nr. 11 / 1993

(seria e re)

Baton Shoqata e Filozofëve dhe

Sociologëve të Kosovës

[Numri i parë i Themes doli më 1984]

Këtë numër e përgatiti

Redaksia:

Shkëlzen Maliqi, kryeredaktor

Gani Bobi

Muhamedin Kullashi

Kopërtina dhe disenji: **Maksut Vezgishi**

Lektor dhe korektor: **Mufail Limani**

Adresa e përkohshme e redaksisë:

38.000 Prishtinë / M. Popoviq 22 (ose 27)

Qendra Zejtare (zyra e avok. B. Krasniqi)

tel+fax.: (38-38) 32-993

tel+fax.: (38-38) 35-678

Çmimi

1.500.000 DIN * 75 DEN * 40 LEK

5 DEM * 3,5 USD * 4,5 SFR

ILUSTRIMET

SKULPTURAT E AGIM ÇAVDARBASHËS: 9, 11, 13, 15, 20, 26, 37, 42, 43,
45, 48, 49, 51, 54, 55, 58, 59, 65, 74, 79, 83, 84, 91, 100, 132, 133, 134, 137 (Foto: Afrim Spahiu).

KOPERTINA

AGIM ÇAVDARBASHA (Foto Afrim Spahiu)

GJENDJA POSTMODERNE:

Hans Hollein, Argjendaria e Schullinit në Wienë - 112; Robert Gober, Instalim - 113; Le Corbusier, Unité d'Habitation, Marsejë (1947-52) - 117; M. Graves: (1) Public Service Building, Portland (1981-83) - 124, 127; (2) Aneksi i shtëpisë Benecerref, Princeton (1969) - 126; (3) Humana - 125, 127; Peter Eisenman, Izometria e shtëpisë popullore (1969-70) - 126; Johnson/Burgee, Ndërtesa e kompanisë AT&T, New York (1978-1983) - 121; Rënimi i objektit të banimit të M. Yamasakit në St. Louis, Missouri, maj 1972 - 119.

SEZONI TEATROR:

Luan Daka dhe Afrim Kasapolli (Teki Dervishi: Oda në Hamburg) - 144; Luan Jaha dhe Arben Kastrati (Teki Dervishi: Kufiri me atdhe) foto R. Slivova - 145; Drita Krasniqi dhe Veton Osmani ("Venedikasja") foto M. Mjeku - 147; Ilire Vinca (Molieri: Borgjezi fisnik) foto R. Slivova - 148; Enver Petrovci dhe Dibran Tahiri (Dostojevski: Vajda: Idioti) foto Naser Halili - 148.

Seria e re e 'Themës'

New Series of 'Thema'

IDENTITETI / KOMBI / KONFRONTIMET

IDENTITY / NATION / CONFRONTATIONS

7 Gani Bobi:

Në vorbullën e botës jetësore të shqiptarëve sot

15 Jyrgen Habermas:

Shtetësia dhe identiteti nacional

29 Rexhep Ismajli:

Shqiptarët dhe Evropa Juglindore (aspekte të identitetit)

39 Shkëlzen Maliqi:

Vetënjohja në joviolençë
(Ndërtimi i identitetit shqiptar kundrejt serbëve)

47 Peter Sloterdijk:

Profecia në gjuhën gjermane

53 Isuf Berisha:

Identiteti dhe konfrontimi: shqiptarët dhe serbët

57 Gazmend Zajmi:

Policentrizmi subjektor i kombit shqiptar në Ballkan

63 Anton Kolë Berishaj:

Malesorët dhe malazezët - nga destruksioni deri të sjelljet simbiotike

Gani Bobi: 7

Into the Whirl of Albanian World-of-Living Today

Jyrgen Habermas: 15

Citizenship and National Identity

Rexhep Ismajli: 29

Albanians and South-Eastern Europe (Aspects of Identity)

Shkëlzen Maliqi: 39

Self-Understanding in Non-Violence

(The Construction of Albanian Identity in Opposition to Serbs)

Peter Sloterdijk: 47

Prophecy in German Language

Isuf Berisha: 53

Identity and Confrontation: Albanians and Serbs

Gazmend Zajmi: 57

Multi-centre Subjectivity of Albanian Nation in Balkans

Anton Kola Berishaj: 63

Montenegro Albanian Highlanders (Malesoret) and Montenegrins - from Destructive to Symbiotic Behaviour

VËSHTRIME

VIEWS

73 Claude Lefort:

Kufijt e sundimit totalitar

76 Muhamedin Kullashi:

Demokracia dhe totalitarizmi

87 Hivzi Islami:

Realiteti etniko-demografik i Kosovës dhe aspiratat serbe

97 Rexhep Murtez Shala:

Premisa mbi kategori zhanri në romanet 'Oh' dhe 'Zanoret e humbura'

Claude Lefort: 73

The Limits of Totalitarian Power

Muhamedin Kullashi: 76

Democracy and Totalitarianism

Hivzi Islami: 87

Ethno-Demographic Reality in Kosovo and Serbian Aspirations

Rexhep Murtez Shala: 97

The Premises about Category Genre on the Novels 'Oh' and 'Zanoret e humbura' (Lost Vowels)

GJENDJA POSTMODERNE

THE CONDITION OF POSTMODERNITY

111 Edgar Morin:

Identiteti kulturor evropian

115 Astrit Salihu:

Postmoderna - fundi i iluzioneve të mëdha

124 Michael Graves:

Arkitektura postmoderne (intervistë)

131 Arben Xhaferi:

Në dimensionin e skulptorit : Agim Çavdarbasha

Edgar Morin: 111

European Cultural Identity

Astrit Salihu: 115

Postmodernism - The End of Big Illusions

Michael Graves: 124

Postmodernism in Architecture (interview)

Arben Xhaferi: 131

In the demension of the sculptor: Agim Çavdarbasha

KATALOGU

THE CATALOGUE

135 Ali Podrimja:

Për kë shkruajmë?

139 Ymer Jaka:

Shpërnguljet e shqiptarëve

141 Gjyljeta Mushkolaj:

Thomas Paine, doktrimar i të drejtave të njeriut

143 Haqif Mulliqi:

Sezoni teatror 1992-1993 në skenat e Prishtinës

149 Mufail Limani:

Tri novela të Kasëm Trebeshinës

151 Teuta Arifi:

Të gjitha idetë e kulturës

153 Ylber Hysa:

Shqiptarët dhe Megali Idea greke

Ali Podrimja: 135

For Whom do We Write?

Ymer Jaka: 139

Emigrations of Albanians

Gjyljeta Mushkolaj: 141

Thomas Paine, Developer of the First Doctrine of Human Rights

Haqif Mulliqi: 143

1992-1993 Albanian Theater Season in Prishtina

Mufail Limani: 149

Three Novels by Kasëm Tërbeshtina

Teuta Arifi: 151

All Ideas About Culture

Ylber Hysa: 153

Albanians and Greak's Megali Idea.

SERIA E RE E THEMËS

Pas një ndërprerjeje disavjetëshe që dukej e pakapërcyeshme, me këtë numër Thema po vazhdon së dali. Këtë do të mund ta quanim edhe rifillim, meqë kjo seri e Themës nxiret vetëm në gjuhën shqipe, me disenj krejtësisht të ri dhe, çka është më e rëndësishmja, prej këtij numri, me botimin e shkrimeve profesionale për letërsinë, artet, arkitekturën dhe dijet e ndryshme antropologjike e shoqërore, i drejtohem një opinioni shumë më të gjërë lexues, që ka interes për fushat teorike.

Në kushtet që i kemi sot në Kosovë, është sukses edhe vetë nxjerrja e një reviste. Madje, kjo mund të paraqitet edhe si ngarkesë. P.sh., mund të na imponohet roli i një misioni ekskluziv e të lartë i zërit të vetëm në tokën dhe në kohën e shkretuar. Por, ne kjo nuk na bën përshtypje. Nuk ngarkohemi me ndonjë mision të posaçëm dhe nuk udhëhiqemi nga deklaratime të mëdha programore e as premtime të mëdha. Jemi një grup intelektualësh që po i kalon të dyzetat dhe nuk ka më iluzione për realitetin, për pandehjen se ai mund të ndryshohet me kthesa revolucionare dhe se jemi në gjendje të vendosim shtylla të këtij apo të atij programi.

NEW SERIES OF THEMA

After a few years break, which seemed to be insuperable, by this issue Thema is coming to continue its appearance. Being published only in Albanian, redesigned and, more important, from this number addressed to a much larger number of readers interested in theoretical fields, including essays and papers on literature, arts, architecture and different social and anthropological sciences, this issue could be called a new start.

Under the conditions we are living in Kosova, even publishing a review is a success. Moreover, it could present an overcharge. For example, it could be expected from us to fulfill the exclusive and high mission of the unique voice in the devastated land and time. But we will not be impressed by that. We will not take on us any special mission and we will not be oriented by big program declarations or promises. We are a group of intellectuals going over forties, when there is no more place for illusions on reality. We do not have illusions that it could be changed by revolutionary breaks, or even by building up pillars for this or that program. Our aim is modest: to publish finally a

Nr. inv. 6657/p
304/2000



Qëllimi ynë është modest: të nxiret më në fund një revistë korrente, që mbështetet në kriteret teorike, prezenton frymën e kohës dhe flet me kohën, mbahet me forcën që kemi, rrah problemet e vërteta, kap shqetësimet e njëmendta, merret me rishqyrtimin e mashtrimeve dhe të humbjeve historike, ose "historike", nuk i romantizon e as nuk i hyjnizon gjërat, ballafaqohet me kundërthëniet, çelet e nuk mbyllet ndaj botës dhe përvojave të të tjerëve, njëqind herë pyet e kërkon para se të japë përgjigje.

Natyrisht, edhe kjo që u tha tingëllon si program që në esencë nuk është aspak modest. Por, me një shtruarje të këtillë të tij, ne dëshirojmë të sugjerojmë idenë se ai është i hapur dhe ka formën e plastelinës, të materies që nuk ka formë definitive dhe i jipet çdo shikimi, projektimi dhe modelimi... Ne jemi pjesëtarë në botërat që po thyhen, dëshmojmë për rënien e miteve dhe të riteve, të idoleve, të adeteve, të mënyrës së jetës dhe të të menduarit, të zhbërjes brenda nate të botëkuptimitve e të botërave false. Por, jemi edhe aq të rinj, sa që këtu mund të mëshërohet vetë dysia e Feniksit: i lashtë sa malet e me aq shumë gjethë të njoma të padjallëzisë.

current review grounded on theoretical criteria, presenting the spirit of the time and speaking with the time, created by our own forces, treating the real problems, reaching the true worries, reconsidering the historical or "historical" deceptions and losts, not romanticizing and divinizing the things, confronting with the contradictions, opening and not closing us from the world and the experiences of the others, ten times asking and searching before giving an answer.



Naturally, all of this sounds as a program in essence not at all modest. But, by developing it in that way, we want to suggest the idea that it is open and has the form of plasteline, a material which has no definite form and which is offered to every look, projection and modelation. We are parts of the refracting worlds, we witness the fall of the myths and rites, idols, customs, the way of life and manner of thinking, we test instant dissolution of false viewpoints and worlds. Still, we are so young that we could here incarnate the ambiguity of Phoenix ourselves: as old as the mountains and covered by so much fresh leaves of innocence.

E
TH M
A

IDENTITETI
KOMBI
KONFRONTIMET

THEMA • THEMA
ESSE IS LIKE Ø ARCHITECTURE
TEATER
ART



GANI BOBI GANI BOBI GANI BOBI GANI BOBI	
	NË VOR- BULLËN E BOTËS JETËSORE TË SHQIPTARËVE SOT

I. Supozimet e fillimit

I.1. Mungesa e racionalizimit

Me përmbysjen e sistemit shoqëror* nën të cilin jetuan shqiptarët për gati një gjysëm shekulli u shemb edhe karakteri shoqëror i prodhuar nga ai sistem: është shformuar modeli i identitetit individual e kolektiv; është shthurur sistemi i vlerave; janë shfytëruar simbolet e legjitimitetit; nuk funksionon më kodi i komunikimit.

Botën jetësore të shqiptarëve sot e shquan mungesa e racionalizimit të:

1. riprodhimit kulturor (nuk ka marrëdhënie reflektive e dalluese ndaj traditës dhe trashëgimisë kulturore);
2. integritetit social (nuk janë formuar ende simbolet e identitetit kolektiv; s'është përbrendësuar kultura civile; mungon orientimi i mjaftueshëm nga normat universale); dhe
3. socializimit (nuk i kushtohet kujdes i duhur individualizimit).

I.2. Dy rrjedha të botës jetësore shqiptare

Kur rendi i ri shoqëror nuk ngulitet në botën jetësore, atëherë përparësitë që ka ai nuk mund të shfrytëzohen në mënyrë optimale. Për më tepër, rrezikohen edhe më shumë interesat ekzistuese; ngulitet në skajshmëri entropia morale e qytetare; masat e ndërmarra për të tejkaluar situatën e krijuar, veçse prodhojnë vështirësi të reja.

Së këndejmi, bota jetësore e shqiptarëve sot ka të ngjarë me atë të pacientëve të Minkowskit, përkatësisht t'i kujton përgjigjet e tyre në një pyetje të rëndomtë që u bëhet: "Ku jeni?" Njëri nga ta, i paralizuari, në vend se të përgjigjet në këtë pyetje, tregon shtratin në të cilin ishte i shtrirë, kurse tjetri, skizofreni, zë të thotë: "E di ku jam, por nuk e ndjej veten se jam aty". (Interpretimi profesional: "pacienti i parë është kufizuar në kontaktin momental me hapësirën, pa e zhvilluar kohësisht atë, kurse i dyti e ka humbur kontaktin jetësor me realitetin dhe më kot përpiqet ta kompensojë humbjen përmes dijes abstrakte

A është e mundshme të flasësh sot për

botën jetësore të shqiptarëve jashtë këtyre dy rrjedhave që shpien (e para) në një *Këtu fiks*, afektivisht të stërngarkuar me provincializëm e historicizëm dhe (e dyta) në një *Gjithkund-e-kurrkund* të paidentifikueshëm e ku ndjehemi përherë të huaj? A ka dhe rrjedhë të tretë?

II. Akulturimi antagonist

II.1. Vorbulla e ndryshimeve

Për të hulumtuar çështjet e shtruara më duket mjaft operativ nocioni *akulturim antagonist*, ashtu siç e kanë përsëhkuar, analizuar e përkufizuar Devereuxa (Deveroja) dhe Loebi (Lobi). Është fjala për një proces bazë të ndryshimeve sociokulturore që është i pashmangshëm dhe i domosdoshëm në një situatë krize të shumëfishtë (politike, ekonomike, kombëtare etj.), çfarë është kjo e shqiptarëve sot dhe e cila tregon, jo vetëm rrezikimin e thellë të intereseve ekzistues e shterpësinë e madhe të mënyrave të përshtatjes në situatën e re, por dhe shfaqjen e një rrethi të mbyllur.

Në një vorbull të këtillë shqiptarët kanë zënë të ndjehen të pafuqishëm dhe për aq sa po shtohet vetëdija për këtë, paradoksalisht për aq po rritet pafuqia e tyre. Të jetuarit me një pasiguri të madhe dhe nën një kërcënim difuz e të paparashikueshëm, por me gjasa ekstreme të masakrit e të tragjizmit, është bërë bazë e mirë për shfaqjen dhe manifestimin e të gjitha tipeve të akulturimit antagonist. Shprehje të tij nuk janë vetëm izolimi mbrojtës dhe përvetësimi i mjeteve të reja për të realizuar qëllimet e vjetra, por para së gjithash janë:

1) regresioni; 2) diferencim; dhe 3) mohimi rrugët më kryesore të realizimit të një akulturimi të tillë (disociativ) që ka zënë ta shquajë botën jetësore të shqiptarëve sot.

II.2. Rruga e regresionit

Rruga e regresionit duket më e shkurta dhe më e lehta, meqë kthimi në modelet e sjelljeve dhe në sistemin e vlerave që kanë mbizotëruar para situatës së krizës krijon aparençën e daljes nga ajo. Është kjo rruga për të cilën vendoset më së shpejti, por e cila shpie zakonisht nëpër ato fushadjerra

të traditës ku më kot derdhet energji për të ringjallur forma dhe përmbajtje të tejkaluara si mbështetje të sigurta.

Ky kthim mbrapa, përnga mekanizmi i brendshëm dhe fizionomia e tij, i përngjan një refleksi të kushtëzuar që ka në bazë frikën nga një rrezik real, rreziku i humbjes së identitetit sociokulturor për shkak të përmbysjes së një sistemi shoqëror dhe të shfityrimit të një karakteri shoqëror që është formuar nga ai sistem për gati një gjysmë shekulli, si dhe nga situata pushtuese në të cilën përpëlitet gati gjysma e popullit shqiptar. Nuk është fjala vetëm për atë lloj frike që përmban në vete funksionin mbrojtës, që paralajmëron rrezikun dhe krijon mundësi që të ndërmerren masa për t'u mbrojtur nga ai, as dhe vetëm për tjetrin lloj të frikës që ka rolin e katarzës kur evitohet me sukses rreziku, ose kur arrihet qëllimi kundër tij, por kemi të bëjmë kryesisht me frikën që në mënyrë të theksuar ngërthen në vete, siç do të thoshte Neumanni (Nojmani), *elementin neurotik* dhe *veprimin destruktiv*, që të bëjnë të paaftë për t'u shmangur nga rreziku, apo për të luftuar kundër tij.

Rrjedhojë e një frike të tillë është identifikimi afektiv me ato modele sjelljesh e vlerash që kanë ekzistuar para sistemit shoqëror ("komunizmit") që e ka kushtëzuar krizën dhe, sidomos, me ato sjellje e vlera që kanë qenë të gjykuara nga ai sistem. Ky lloj identifikimi nuk po lejon të shihen qartë e të kuptohen në thelb proceset sociokulturore që po ndodhin në mënyrë që të krijohen premisat bazë për tejkalimin e gjendjes ekzistuese, por po zgjerohen mundësitë për sjellje abuzive e veprime destruktive. Sjelljet e veprimet kaçakçe-komitçe-hajdutçe me të cilat po "luftohen" padrejtësitë shoqërore, sidomos përtej kufirit, mund të shpjegohen në dritën e kësaj që u tha, e që, veç tjerash, kanë për *shkak-pasojë* frustrimin, konfuzionin në sistemin e vlarave dhe mungesën e kontrollit social.

II.3. Degradimi sociokulturor

Degradimi sociokulturor i kushtëzuar nga humbja e sigurisë që ofronte rendi shoqëror tashmë i përmbysur dhe nga pamundësia e shfrytëzimit të favoreve të ren-



dit të ri që s'është ngulitur ende në botën jetësore, si dhe, në krye të radhës, nga paaftësia për të parë e për të kuptuar procesin që shpie kah një degradim i tillë, po manifestohet me shqetësime të mëdha e me konflikte të ashpra, me një shkallë të ngritur të patologjisë sociale e akulturative.

Në veçanti, frika nga humbja e prestigjit sociokulturor pas një përmbysjeje të tillë i ka çekuilibruar ato figura letrare, artistike e shkencore që ishin dekor i sistemit. Shndërrimi i furishëm i tyre nga komunistët e përbetuar në antikomunistë të çartur, nga internacionalistët e vetëshpallur në atdhetarë të përvuajtur, e kështu ngjashëm, paraqet një përpjekje groteske për të konsoliduar në një kontekst të ri



privilegjet dhe prestigjin që kishin. Në këto përpjekje mbeten krejtësisht të pandryshuara mentaliteti autoritar, ngurtësia intelektuale, të menduarit impulsiv, paaftësia për t'u ballafaquar me të vërtetën dhe për të debatuar me argumente. Kemi të bëjmë me atë tip të akulturimit antagonist që realizohet nga shtrembërimi (keqpërdorimi) i mjetit ose i qëllimit. Ajo që është anatemuar dje, glorifikohet sot dhe *vice versa*.

E gjithë kjo është shpeshherë në funksion të nxitjes së pasioneve primitive, të regresionit shoqëror e ideologjik, të thellimit dhe të shumëfishimit të paragjykimëve, të riaktualizimit të padrejtësive historike dhe të vajtimit të tyre, që mjegullojnë edhe më shumë çështjet thelbësore të shoqërisë e të



kulturës shqiptare dhe vështirësojnë edhe më tepër zgjidhjen pozitive të tyre. Ideja e kombëtares në këtë kontekst u përngjan ideve fikse paranoide. Diskursi për kombin, apo në emër të kombit dhe të identifikimit me fatin e tij, bëhet gjithnjë e më i kufizuar dhe gjithnjë e më banal. Forcimi i lidhjeve me bashkëkombasit merr kahe të dobësimit dhe të shképutjes së lidhjeve me të tjerët. Me një fjalë, interesat kombëtare thelbësisht rrezikohen në emër të mbrojtjes së tyre.

II.4. Diferencimi

Diferencimi nga prodhimi sociokulturor që është arritur gjatë sundimit të komunizmit nuk është marrëdhënie refleksive ndaj atij

prodhimi sa është në thelb shprehje e urrejtjes, mllëfit e resentmentit, para së gjithash e frikës së prodhuar nga përmbysja e stuhishme e tij. Kjo frikë, urrejtje e resentment njëherë përqëndrohen mbi individë e grupe të caktuara që denoncohen si bartës kryesorë të përgjegjësisë për gjendjen në të cilën ka rënë populli, për t'u shpërndarë pastaj mbi të gjithë atë që është arritur gjatë "sundimit të kuq".

Identifikimi, përkatësisht arritja e ndjenjës së përkatësisë ndaj vetëm atyre të mbërrimeve që paraqesin një kundërtip polar me të arriturat nën atë sundim nuk mund të jetë shumë frytdhënës, meqë një identifikim i tillë është bërë mbi baza afektive. Fryt i tij mund të jenë krijimet poetike më të shpeshta të mllëfit e të protestës me ritme e ngjyra të gjalla, me imazhe të pasura që bëjnë të mundshëm shpërthimin e energjive të pavetëdijshme, e që zbulojnë kacafytjen e autorëve me vetveten, përpjekjet për t'u liruar nga ajo "pjesë e kalbur e qenies" së tyre. Pa e vënë në këtë kontekst, po e kujtoj me këtë rast vjershën e Ali Podrimjes *Në mes butakëve*:

*Lumi unë
hap e mbyll derën
me një flutur të zezë
Nuk i besoja gjyshit
as babait
Por ç'porosi
t'i lë Petritit
Në mes butakëve
e mutakëve
digjem
duke lu qfruar Fundit*

Mbase vepra të pëlqyera mund të arrihen edhe në fusha të tjera të artit, mirëpo në rrafshin mendor e intelektual nuk mund të arrihet shumë "në mes butakëve dhe mutakëve". Ajo që më së shpeshti po bëhet është "kritika" e fenomeneve dhe e dukurive të sistemit të rrënuar duke përdorur strukturën e mjeteve të tij. Kështu, bie fjala, Fishta, Konica, Koliqi, Camaj etj., të anatemuar dje, glorifikohen sot. Ngjarjet dhe personalitetet kulturore e historike që detyrimisht janë falsifikuar e janë vënë në harresë për arsye të njohura, nxirren nga harresa dhe falsifikohen përsëri për arsye

që dihen e që mund të supozohen. Shkrimet për ngjarjet dhe personalitetet e proskribuara deri më dje, janë në të shumtën të palexueshme për njeriun e arsyeshëm.

III. Formacionet reaktive

III.1. Sublimim i rremë

Shkallëzimi i akulturimit disociativ nuk vërehet vetëm në marrëdhëniet me rendin e mëparshëm sociokulturor dhe sistemin e vlerave të tij, por dhe në marrëdhënie me situatën pushtuese në të cilën përpëlitet sot gati gjysma e popullit shqiptar. Formacionet reaktive si *sublimim i rremë i negativizmit shoqëror* e shquajnë këtë situatë.


Para se të kujtohen disa nga këto formacione, le të vërehet kalimthi suaza që bëri të mundshme shfaqjen dhe manifestimin e tyre.

III.2. Konkretësia e pavërtetë: modeli i regresionit serb

Që në shpërthimet e para të krizës jugosllave në Kosovë, kur u kërkuan në të njëjtën kohë (1) ndërrimi i udhëheqjes së saj dhe (2) pavarësimi nga Serbia dhe kur këto kërkesa u shtypën me dhunë, u pa se ish federata jugosllave nuk ishte në gjendje ta ndërmernte hapin vendimtar drejt demokratizimit dhe decentralizimit të njëkohësishëm të shoqërisë dhe për tejkalimin e sovranitetit absolut të njërës njësi (Serbisë) në dobi të vendosjes së sovranitetit relativ të të gjithave.

Në vend se të përfillëshin nevojat dhe aspiratat potenciale për ndryshime pozitive që do të arrinin rrafshë psikosociale shumë më cilësore të jetesës, del në suprinë *lëvizja serbe* për rikonstruktimin e Jugosllavisë në *një shtet unik dhe të pandashëm*. Shteti në të cilin do të jetonin të gjithë serbët në të, nuk mund të funksiononte ndryshe, pos si *serbizëm i zgjeruar*; nuk mund të sillte përmbajtje tjera, pos *urrejtjes dhe fatkeqësive*; ëndërra të tjera, pos *ëndërrave për forcë* (të krijuar në dëm të lirive vetanake dhe të lirisë së të tjerëve); suazë tjetër, pos *shtetit komb*; dhe fund tjetër, pos *luftës*.

Lëvizja e tillë u quajt "ndodhje e popullit serb". Sugjestioneve të saj iu nënshtrua me



një gatishmëri të rrallë gati e tërë inteligjencia serbe, anipse tiparet dalluese (si: nacionalizmi agresiv i ushqyer nga mllëfi dhe urrejtja e së kaluarës, identifikimi cezarian në prijësin, institucionizmi i frikës përmes propagandës, terrorit policor e ushtarak, sanksioneve arbitrare, etj.) e denonconin që në start si një lëvizje historikisht e psikologjikisht shumë regressive.

Nuk ishte vështirë të supozohej se viktima e parë më e padhimbshme e "ndodhjes së popullit serb" mund të ishin shqiptarët si shtetas më të padëshirueshëm dhe më të pambrojtur. Si jo sllavë, ata fare lehtë mund të shpallehin fajtorë për katandisjen politike, ekonomike e kombëtare të Jugosllavisë. Me "ekspansionin biologjik" të tyre, "kundërrevolucionin", "separatizmin", etj. mund të ndërtohej pa vështirësi të mëdha "konkretësia e pavërtetë" (Neumann) për t'i bërë të *ligjshme* dhunën dhe terrorin policor e ushtarak ndaj shqiptarëve, që, së bashku me manipulimin psikologjik, bëhen mjete efikase për të arritur homogenizimin kombëtar të serbëve e malazezëve në rrafshë gjithnjë e më të ulëta të regresionit, për të rindërtuar mitin mbi veten, për të kënaqur ndjenjat e një superioriteti të rremë, i cili i bën gjithnjë e më të paafte ata për të parë bestialitetin e tyre në sjelljet dhe veprimet e veta.

III.3. Kundërvënia-përshtatja e shqiptarëve në situatën eksplozive

Suazën e tillë pushtuese me një fjalë e shquan sundimi serb i reduktuar në një *dhunë-hard* dhe *reagimi-adaptimi* i njëkohësishëm i shqiptarëve si kontestim i tij. Kontestimi i pushtuesit duke iu kundërvënë dhe, në të njëjtën kohë, duke iu përshtatur atij, flet për mënyrën e të jetuarit me një kundërthënie shpërthyesë, ku veprojnë njëherazi dëshira për pavarësi dhe frika nga ajo.

Shprehje të saj, përkatësisht si formacion reaktiv i përpunuar ndaj veprimeve luftënxitëse, dhunës dhe bestialitetit të pushtuesit, duhet parë orientimin paqësor të shqiptarëve dhe durimin deri në vetësljim të tyre që ka për shtytës kryesor frikën nga pasojat e konfrontimit të hapët me një forcë të madhe shkatërrimtare që e njohin.

Aktet e krimit e të dhunës kanë për manifestim të kundërtën e qëllimeve për të cilat bëhen: varrimi i viktimave shndërrohet në manifestim popullor ku marrin pjesë edhe me qindra mijë përcjellës për të demonstruar qëndresën e popullit; përpunohen zakonet tradicionale për të qenë të kundërta me ato të pushtuesit; pajtohen gjaqet kur nxiten përçarjet dhe rivalitetet; organizohen nëpër shtëpi private e hapësira të tjera veprimtaritë arsimore, shkencore e kulturore kur ndalohen ato nëpër institucionet përkatëse, e kështu ngjashëm.

Këto e formacione të tjera reaktive që shprehin negativizmin shoqëror në formë të pseudosublimuar, e që janë me interes shkencor të hulumtohen në botën jetësore të shqiptarëve, nëse kanë arritur të ruajnë sadopak drejtpeshimin psikoafektiv të popullit dhe të përfitojnë simpatinë e një pjese të madhe të opinionit botëror, nuk kanë arritur dhe të fshijnë gjurmët e dhunës dhe të agresionit mbi shqiptarët; t'i flakin urrejtjen dhe zemërimin që ndryjnë thellë në vetë ata. Autorë si Sartri një situatë të tillë do ta quanin eksplodive. Nuk është vështirë të supozohet, prandaj, se çfarë mund të ndodhë kur shqiptarët një ditë do t'i frikësohen me shumë jetës nën pushtuesin se sa vdekjes kundër tij.

Në rrafshin më të ngushtë kulturor kjo situatë paraqet rrezikun e sterkeqjes së mundësive krijuese e risimtare për shkak të mungesës së mjeteve materiale, për arsye se nuk ka strukturë organizuese dhe nga se mungon suaza formale dhe institucionale e të shprehurit. Kur përkrye kësaj është edhe glorifikimi i përmbajtjeve dhe praktikave të tejkaluara, atëherë kanosja e *sklerozës kulturore* është reale.

IV. Orientimet vlerore

IV.1. Iracionaliteti i botës jetësore


Sa është (i)racionale bota jetësore e shqiptarëve do të mund të shihej më përafër nga analiza e vlerave të tyre. Është kjo punë që i takon një hulumtimi të themeltë empirik, e që do të ndriçonte, jo vetëm botën jetësore të këtij populli, por edhe sistemin shoqëror të tij, përkatësisht do të bënte të

mudshme dhënien e një diagnoze më të saktë për të.

Pa dashur që të zëvendësohet mungesa e një studimi të tillë me disa konstatime paraprake, mund të thuhet se ekziston një orientim vleror mjaft heteronom, e edhe me qëndrime kontradiktore, që vërehen në rrafshin e ndryshme të veprimit shoqëror të shqiptarëve. Posaçërisht bie në sy orientimi vleror shumë egalitar, njerëzor dhe liri-dashës në rrafshin verbal dhe shumë autoritativ, agresiv e edhe fare mospërfillës në rrafshin praktik. Vlerat e mbështetura në reciprocitet dhe ekuivalencë me të cilat do të mund të rregulloheshin marrëdhëniet midis njerëzve në mënyrë racionale nuk funksionojnë sa duhet, kurse vlerat e mbështetura në participim me të cilat rregullohen marrëdhëniet e individëve ndaj bashkësisë shoqërore, simboleve kolektive, veprimeve, aspiratave dhe qëllimeve të saj, kanë rrudhur mjaft vetëdijen për vete ndër shqiptarët për shkak të identifikimit të pamjaftueshëm, apo edhe jo kreativ e submisiv me to.

IV.2. Piramida e përmbysur

Le të kujtohen në këtë rast piramidat që ilustrojnë:



(Barierat midis sferave të veçanta janë më shumë të theksuara)

për të pasur një përfytyrim më të qartë se si individ mund të realizohet dhe mund të asgjësohet nëpër sfera të ndryshme të jetës kolektive. Kur vetëdija për vete është e

zhvilluar Uni është në krye dhe të gjitha fushat e jetës kolektive i shërbejnë zhvillimit të tij e anasjelltas. Midis këtyre fushave, në aspektin funksional, ekziston "një rrymim i lehtë" nga njëra sferë në tjetrën. Ndërkaq, kur vetëdija për veten është e shtypur Uni është në fund dhe i humbur në ndonjërin nga sferat e jetës kolektive. Midis këtyre sferave ekzistojnë bariera të theksuara aq shumë sa përjashtojnë praninë e njëra-tjetrës.


IV.3. Qëllimet dhe parimet

Dy qëllimet kryesore të njëkohësishme që sot ia kanë vënë vetes shqiptarët: (1) ndërtimin e një shoqërie demokratike e pluraliste; dhe (2) pavarësimin nga sundimi serb; kërkojnë identifikimin veprues me dy tipe vlerash që mbështeten mbi baza e parime të ndryshme me vlerat e reciprocitetit dhe të participimit. Pa një identifikim racional me të parat, më kot flasim për demokratizimin dhe pluralizmin dhe pa një identifikim të vërtetë me të dytat, më kot synohet pavarësia.

Bazat e ndryshme mbi të cilat mbështeten (*racionale* - vlerat e ndërsjella; *emocionale* - vlerat participuese) dhe parimet e ndryshme sipas të cilave realizohen (*reciprociteti* - të parat dhe *participimi* - të dytat) lënë mundësi që me ngritjen e motivimit për njërin tip, të zbritet apo të zhduket fare motivimi për tipin tjetër të vlerave. Sidomos ekzistojnë mundësi të mëdha të manipulimit me vlerat participuese, të cilat shpesh shndërrohen në mjet të dobësimit të vetëdijes për vete e kundër lirive, të drejtave dhe interesave individuale. Më këtë nuk desha të them se vetëdija për veten nuk mund të zhvillohet përmes identifikimit me vlerat participuese, as dhe të pojoj se interesat individuale nuk mund të realizohen duke i realizuar interesat kolektive, por të theksoj me fjalë të tjera atë që Supeku e thoshte shprehimisht: "procesi i ekspansionit të ndjenjave sociale mund të jetë shkak si i dobësimit ashtu edhe i forcimit të vetëdijes për vete të individit".

IV.3. Realizmi i interesave të vërteta

Ngritja e motivimit për vlera participuese është kusht i domosdoshëm për realizimin e qëllimeve që ia kanë vënë vetes shqip-



tarët. Pa një identifikim të vërtetë me interesat e vërteta (të mundshme) të popullit më kot flasim për realizimin e tyre. Si janë përkufizuar "interesat e vërteta" të popullit mund të shihet nga programet politike, nga hulumtimi i opinionit publik dhe veçmas nga mendimet e grupeve shoqërore dhe individëve që janë me ndikim të madh në një bashkësi të caktuar.

Mirëpo, kur "interesat e vërteta" nuk përkufizohen qartë; kur nuk bëhet dallimi midis qëllimeve të drejtpërdrejta programatike politike dhe qëllimeve të largëta; kur nuk dallohen proceset reale shoqërore nga ato joreale, proceset e vetëdijshme nga ato të pavetëdijshme; kur përzehet imazhi real me imazhin ideal të popullit, e kështu disi, atëherë duhet të jemi të sigurt se është krijuar një marrëdhënie shumë josimetrike midis vlerave participuese dhe vlerave të ndërsjella dhe se të parat janë vënë në funksion të dobësimit të vetëdijes për vete dhe të krijimit të një *mentaliteti të pavetëdijshëm ideologjik*, që i përgjigjet psikozës së tipit halucinant. Ky lloj mentaliteti ka dhe fishin tjetër të vetin - *hipokrizinë*, ose *çmendinë morale*, kur individët apo grupet e caktuara janë të vetëdijshëm se idetë e pikëpamjet që shfaqin dhe veprimet që ndërmarrin nuk çojnë drejt re-

alizimit të "interesave të vërteta kombëtare", të cilat hiqen se i mbrojnë, por drejt përfitimeve të ndryshme personale.

V. Përfundimi

Në vend të përfundimit po përsëris atë që thashë në fillim të këtij shkrimi: realizmi i qëllimeve që ia kanë vënë shqiptarët vetes - ndërtimi i shoqërisë demokratike e pluraliste dhe pavarësimi nga sundimi serb, kërkon një marrëdhënie shumë më refleksive e dalluese ndaj traditës e trashëgimisë kulturore; rikrijimin e simboleve të identitetit kolektiv; identifikimin e vërtetë me vlerat që determinojnë veprimet për realizimin e interesave të veçanta e të përbashkëta; përbrendësimin e kulturës civile; orientimin nga normat universale dhe zgjerimin e vetëdijes për vete. Me fjalë të tjera, bota jetësore duhet të bëhet shumë më racionale në mënyrë që të bëhet racional e efikas sistemi shoqëror i ngulitur në të. A jemi në gjendje ta bëjmë këtë punë?!

* Pjesë nga kjo ese janë botuar në "Bujkun" e 21 e 22 tetorit, 1992, me titull *Rrjedhat e identitetit kulturor të shqiptarëve sot*, prej nga janë botuar pastaj edhe në disa revista e gazeta që dalin në gjuhën shqipe në Kosovë e gjetiu.

1. Bernard Waldenfels: *U mrežama zivotnog svijeta*, Sarajevo 1991, 216 e tutje.

2. Georges Devereux: *Komplementaristička etnopsihološka analiza*, Zagreb 1990, 300-344.

3. Franz Neumann: Frika dhe politika, *Thema* nr. 10/1988, 125-155.

4. Khs.: F.Fanon: *Të mallkuartit e botës*, Prishtinë 1984, 200-204

5. Georges Devereux: *vepra e cituar*, 341.

6. Më gjëresisht në: Gani Bobi, *Eveil des ethnies e des regions: le cas du Kosovo*, kumesë e paraqitur në simpoziumin mbi temën "Le droits des citoyens face au droits des peuples", organizuar nga I.C.E. në Ecole Normale Supérieure, Paris, më 12 dhjetor 1992.

7. Rrjedhimisht nga kjo, që nga viti 1981 e deri më tash, u vranë nga policia qindra demonstrues paqësorë shqiptarë (dhjetra sish ishin fëmijë), shumica u qëlluan në shpinë në kje e sipër; u vranë shumë më tepër shqiptarë në dhe nga APJ; pjesa dërmuese e popullatës u rrah, u maltretua dhe u "trajtua" nga policia dhe ushtria; u shpërndanë me dhunë Parlamenti dhe Qeveria e Kosovës; shqiptarët nxirren nga administrata shtetërore, gjyqet e policia; drejtuesit e ekonomisë dhe të institucioneve të ndryshme në të gjitha nivelet zhvendësohen me serbë e malazezë pa marrë parasysh kualifikimet përkatëse për vendet e tilla të punës; pjesa dërmuese e mjekëve dhe e personelit mjekësor shqiptar dëbohen nga puna; mbyllen shkollat dhe universiteti në gjuhën shqipe; për shkak të përkatësisë etnike afro 150 mijë shqiptarë dëbohen nga vendet e tyre të punës; serbët e malazezët armatosen frontalisht; nga presionet e llojllojsime rreth 500 mijë shqiptarë braktisin shtëpitë e tyre dhe kërkojnë strehim në shtete të ndryshme të Europës dhe jashtë saj. (Të dhënat mbështetën kryesisht në burimet e KMDLNJ dhe BSP të Kosovës).

8. Në disa fshatra të Rrafshit të Dukagjinit më ka rënë të shohi në të pame gra me shami e vasha me fllonga ngjyrë liri. Kur e pyeta një vendas se pse nuk i kanë vënë të zeza ato, m'u përgjigj: "Për t'u dalluar nga serbët, ata mbajnë zi".

9. Krahason parathënieën e Sartrit në: Fanon, *Të mallkuartit e botës*, Prishtinë 1984, 5-27.

10. Khs.: Grup autorësh: *Vrjednost i društveni sistem*, Zagreb 1977, 299; Rudi Supek: *Zanat sociologa*, Zagreb 1983, 256.

11. *Po aty*, 229.

12. Rudi Supek: *vep. e cituar*, 255 e 256.


13. Për këtë kam bërë fjalë diçka më shumë në "Rilindjen" e 17 marsit, 1990, fq. 10.

Gani Bobi

Into the Whirl of Albanian World-of-Living Today

In this writing the author ascertains that with the overthrowing of the social system under which Albanians lived for almost a half century the character of society produced from this system is destroyed too. The model of individual identity is deformed; the system of values is debauched; the legitimating symbols are disfigured; the code of communication ceases to function any more. The Albanian World-of-Living is characterized today by the absence of rationalization in cultural reproduction, in social integration and in socialization.

In the realization of the aims that Albanians have put themselves as a task (the building of a democratic and pluralist society and the gaining of independence from Serbian rule) they need to reflect their cultural tradition and inheritance. These aims demand also the reestablishment of the symbols of collective identity; real identification with values which make possible the realization of particular and common interests; admission of civil culture; orientation towards universal rules and extension of self-consciousness. The author concludes that Albanian World-of-Living must become much more rational in order to make more rational and efficacious their social system too.



JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS
JYRGEN HABERMAS

SHTETËSIA DHE IDENTITETI NACIONAL

Deri në mesin e viteve të tetëdhjeta dukej se historia gjithnjë do të kalojë në gjendje të pastër "post-historike". Ky tregues paraqiste atë aluzion të Arnold Gelenit për atë ndjenjë të çuditshme se çdo gjë ndërrohet, por asgjë s'na shkon përdore. *Rien ne va plus* - asgjë befasuese në të vërtetë nuk guxonte të ndodhte më. Nën zilen e qelqtë të detyrimeve të sistemit duket se të gjitha mundësitë janë shterur, të gjitha alternativat janë ngrirë, kurse të gjitha opcionet ende të hapura - janë bërë të parëndësishme. Mirëpo, ky disponim në ndërkohë ka ndërruar. Historia përsëri është aktivizuar, ajo përshpejtohet,

madje edhe ulërinë. Problemet e reja i shtyjnë perspektivat e vjetra. Çka është edhe më e rëndësishme, ato probleme, madje, i ndajnë perspektivat e së ardhmes në bazë të të cilave rish-tazi mund t'i hetojmë veprimet alternative.

Tri lëvizje historike të historisë moderne, e cila është bërë shumë mobile, përkasin marrëdhëniet e shtetësisë dhe të identitetit nacional: 1) Bashkimi i Gjermanive, çlirimi i shteteve të Evropës së Mesme - Lindore nga tutela sovjetike, si dhe konfliktet nacionale që po shpërthejnë në tërë Evropën Lindore, i japin një aktualitet të papritshëm çështjes së ardhmërisë së

shteteve nacionale.2) Rritja e bashkësisë evropiane të shteteve përmes njësmi të monedhës, që hyn në fuqi në vitin 1993, hedh dritë të re në marrëdhënien midis shtetit nacional dhe demokracisë: proceset demokratike që zhvillohen në suaza të shteteve nacionale ngecin pa shpresë prapa integritimit ekonomik, i cili bartet në nivelin mbinacional.3) Migrimet e mëdha të popullateve nga regjionet e varfëra të Lindjes dhe Jugut me të cilat gjatë viteve të ardhme në masë të madhe Evropa Perëndimore do të konfrontohet, i japin çështjes së azilantit peshë të re dhe urgjencë. Në këtë mënyrë ashpërsohet konflikti midis primeve universale të shtetit demokratik-juridik nga njëra anë, si dhe kërkesave partikulariste për integritetin e mënyrës hetuese të të jetuarit, nga ana tjetër.

Këto tri tema paraqesin bazën për shpjegimin konceptual të disa qëndrimeve normative nga të cilat mundemi më mirë ta kuptojmë marrëdhënien komplekse të shtetësisë dhe identitetit nacional.¹⁾

I. E kaluara dhe e ardhmja e shtetit nacional

Ngjarjet në Gjermani, si edhe në vendet evrolindore, tërësisht e kanë transformuar diskutimin i cili për një kohë të gjatë udhëhiqej në Gjermani lidhur me rrugën deri te "shtetet postnacionale"²⁾. Kështu, për shembull, shumë intelektualë tërheqnin vërejtjen për deficitin demokratik që paraqitet gjatë procesit të bashkimit, i cili zhvillohet në nivelin administrativ dhe ekonomik pa pjesëmarrjen e shtetasit; sot u duket se i janë ekspozuar qortimit të "arrogancës-asaj postnacionales". Kontraverza e tillë lidhur me mënyrën dhe tempon e bashkimit shtetëror nuk ushqehet vetëm me disponimin e kundërt, të palëve të acaruar, ajo mund të shpjegohet edhe në bazë të koncepteve të paqarta. Njëra palë qasjen e pesë shteteve të reja ndaj Republikës Federale Gjermane e kupton si rikthim të unitetit të sërishëm të shtetit nacional, ndarjen para katër dekeniesh, nga kjo perspektivë kombi prezantohet si tërësi parapolitike e një bashkësie historike e lidhur me fatin. Pala tjetër, megjithatë, bashkimin shtetëror e kupton si rivendosi të sërishme të demokracisë dhe të shtetit juridik në teritorin në të cilin që nga viti 1933 në këtë apo në atë mënyrë të drejtat e qytetarëve kanë qenë të mohuara; nga kjo perspektivë Republika e vjetër Federale, njësoj si edhe e reja, ishte komb i shtetasëve. Kështu nocioni i kombit shtetëror me përdorimin gjuhësor republikanesh i humb pikërisht këto konotime popullore parapolitike, të cilat në Evropën moderne bartnin domethënie përcjellëse të shprehjes shtati nacional. Heqja e

kufizimeve semantike rreth shtetësisë dhe identitetit nacional paraqet pasojën e faktit se forma klasike e shtetit nacional në kohën e sotme ndodhet në procesin e shpërbërjes. Për këtë na mëson analiza e lindjes së saj gjatë modernizimit të hershëm.

Forma paramoderne e *perandorisë* që bashkonte shumë popuj dhe e cila edhe më tutje jetonte në pamjen e mbretërisë së vjetër romake të kombësisë gjermane ose së paku në formën e mbretërisë ruse dhe turke, në periudhën e re evropiane nuk ishte në gjendje të stabilizohej.³⁾ Krahas kësaj, nga zona e qyteteve të Evropës së Mesme ka rrjedhur diçka tjetër - struktura federative e formimit të shteteve. Kështu, para se gjithash në Zvicër, u formua *federata*, e cila ishte mjaft e fuqishme që t'i zbuste tensionet etnike në suaza të një lidhjeje multikulturale të shtetasit. Megjithatë, sa i përket sistemit shtetëror evropian, vetëm *shteti territorial* që qeveriste nga një qendër, ka fituar fuqi që për një kohë të gjatë të krijojë struktura shtetëformuese. Ky është shtet për shembull Portugalia, Spanja, Franca, Anglia dhe Suedia që para se gjithash ka lindur nga mbretëritë dhe vetëm më vonë në suaza të demokratizimit në ngjashmëri të modelit francez është shpërndërruar në *shtet nacional*. Ky formacion shtetëror ofroi kushte trasuese nën të cilat sistemi ekonomik kapitalist ishte në gjendje të përhapej nëpër krejt botën. Shteti nacional në të vërtetë përfaqësonte infrastrukturen e administratës disiplinore juridiko-shtetërore dhe ka ofruar garancion për ruajtjen e hapësirës së veprimit individual dhe kolektiv të liruar nga influenca e shtetit. Kjo formë e shtetit, që neve para se gjithash na intereson këtu, ka krijuar bazë për homogjenitetin kulturor dhe etnik në bazë të të cilit që nga fundi i shekullit tetëmbëdhjetë ka arritur ta imponojë demokratizimi i shtetit vërtetë me çmimin e shtypjes dhe të mënjanimit të pakicave kombëtare. Shteti nacional dhe demokracia, si dy binjak kanë dalur nga revolucioni francez. Megjithatë qytetërisht mbetet nën hijen e nacionalizmit. Kjo vetëdije nacionale paraqet fenomen modern specifik të integritimit kulturor. Vetëdija politike e përkatësisë nacionale rrjedh nga dinamika, e cila popullatën ka mundur ta përfshijë vetëm atëherë kur ajo përmes procesit të modernizimit ekonomik dhe shoqëror e zhvendoste nga lidhjet sociale klasore, pra, kur ajo njëkohësisht u modernizua dhe u specifikua. Nacionalizmi është formacion i vetëdijes e cila supozon të pranuarit e legjendave kulturore, të filtrur përmes historiografisë si dhe përmes refleksionit. Por, njëkohësisht, ai nacionalizëm përhapet përmes kanaleve të medimeve moderne të komunikimit masiv. Me këtë rast të dyjat nacionalizmit i dhanë karak-

teristika artificiale, por të konstituar në një mënyrë të caktuar, e bënë nacionalizmin vetëpërvetë viktime të lehtë të keqpërdorimeve manipuluese nga ana e elitës politike. Megjithatë vetë historia e lindjes së shtetit nacional pasqyrohet në historinë e nocionit të "kombit".⁴ Tek romakët nocioni *natio* shenjon hyjneshën e lindjes dhe të zënafiles. "Kombi" sikurse edhe nocionet *gens* dhe *populus*, përkundër nocionit *civitas*, ka të bëjë me grupet popullore (shpesh me "të egrat", "barbarët", ose me popujt "paganë", të cilat ende nuk janë të organizuara si bashkësi politike. Kombet në pajtim me këtë përdorim gjuhësor klasik të bashkësisë të lidhur me origjinën, të cilat gjeografikisht janë të integruara përmes vendbanimeve dhe fqinjësisë si dhe qytetësisht përmes gjuhës së përbashkët, por ato ende nuk janë të integruara politikisht përmes ndonjë forme shtetërore të organizimit. Ky kuptim i kombit është ruajtur pothuaj gjatë tërës mesjetës, gjithnjë deri te fillimi i kohës së re. Madje edhe Kanti konstaton: "Ai grumbull, i cili në bazë të origjinës së përbashkët konsiderohet i bashkuar në tërësi qytetare, quhet komb (gens)". Megjithkëtë, qysh nga mesi i shekullit të tetëmbëdhjetë nocionet "komb" dhe "popull shtetëror" ngërthehen. Kështu në pajtim me Sieys-in dhe revolucionin francez "kombi" bëhet madje edhe burim i sovranitetit shtetëror. Tash e tutje çdo komb do të duhej të kishte të drejtë për vetëpërcaktim politik. Në shekullin e nëntëmbëdhjetë përfaqësuesëve konservativë të shkollës historike gjermane u dukej se principi i nacionales do të duhej ta kishte të njëjtën rëndësi si edhe "princi i revolucionit".

Me këtë domethënia e nocionit "komb" nga madhësia e vet parapolitike u transformua në karakteristike e cila është konstituive për identitetin politik të qytetarit të ndonjë bashkësie demokratike. Kah fundi i shekullit të nëntëmbëdhjetë marrëdhënia e kushtëzimit midis identitetit nacional dhe shtetësisë mundet madje edhe të përmbysset. Kështu, thënia famoze e Ernest Renan-it "L'existence d'une nation est... un plébiscite de tous les jours" ndodhet në kontekstin i cili është i orientuar kundër nacionalizmit. Kërkesën e mbretërisë gjermane për Elzasin pas vitit 1871, Renan-i mund të hudhë, duke u mbështetur në nacionalitetin francez të popullatës vetëm për atë shkak, m'u pse "kombin" e kupton si komb të shtetasit, por jo edhe si bashkësi të lidhur me prejardhjen. Kombi i shtetasëve identitetin e vet nuk e gjen në karakteristikat e përbashkëta etnokulturore, por në përvojën e qytetarëve, që aktivisht i shfrytëzon të drejtat e veta demokratike të bashkëpunimit dhe të komunikimit. Këtu komponenta republikane e shtetësisë krejtësisht është e çliruar nga fuzhnjeja e ndonjë bashkësie parapolitike e cila

është integruar përmes origjinës traditës të përbashkët dhe gjuhës së njëjtë. Nëse krejt çështja shikohet nga ky prizëm, atëherë faza e parë e shkrirjes së vetëdijes nacionale me mbikëqyrjen republikaneske e kishte vetëm funksionin e katalizatorit.

Nacionalizmi i ndërmjetësuar me vetëdijen historike dhe romantiken pre shkencërisht dhe literarisht e themeloi identitetin kolektiv, i cili ishte funksional për rolin e shtetasit që u formua në revolucionin francez. Në të vërtetë, në rrënzë të vetëdijes nacionale karakteristikat askriptive të zanafiles u shndërruan në rezultate të barabarta dhe aq të shumta të përvetësimit me vetëdije të traditës. Nga nacionalizmi i lindur u zhvillua nacionalizmi i krijuar, forma e frymës e cila u konstitua në bazë të forcave vetanake. Ai ishte në gjendje që ta shtronte kërkesën për identifikimin me funksionin, e cila në masë të madhe kërkon angazhim personalgjithnjë deri te vetëlijimi: detyrimi i përgjithshëm ushtarak paraqiste vetëm anën tjetër të të drejtave qytetare. Me këtë gatishmëri për të luftuar dhe për të vdekur për atdhe u dëshmuar në masë të barabartë si vetëdije nacionale po aq edhe mbikëqyrje republikaneske. Prej këtu është e qartë marrëdhënia komplementare mbi të cilën nacionalizmi dhe republikanizmi burimisht qëndrojnë: njëri është bërë bartës i lindjes së tjetrit.

Megjithkëtë kjo lidhje socio-psikologjike nuk paraqet njëkohësisht lidhje konceptuale. Me që pavarësinë nacionale dhe vetëverifikimin kolektiv karshi kombeve të tjera mund ta kuptojë si një trajtë tjetër, në të vërtetë trajtë kolektive të lirisë, e cila bie ndesh me genuionin e lirisë së shtetasit në brendi, të kuptuarit modern të asaj lirie republikaneske sërish mund të nxirret nga kthetrat e vetëdijes nacionale mbi lirinë, prej nga si të kuptuar edhe ka rrjedhur. Shteti nacional vetëm gjatë kapërcimit nëpër faza të caktuara ka krijuar lidhje të ngushtë midis nocioneve "ethnos" dhe "demos".⁵ Kështu shtetësia në pajtim me konceptin e vet moti është e pavarur nga identiteti nacional

Koncepcioni i shtetësisë zhvillohet nga nocioni i Rusos mbi vetëpërcaktimin. "Pavarësia e popujve" para së gjithash kuptohej si kufizim ose si të drejtuarit ndaj suveranitetit të sunduesit, që fillon në kontratën e bërë midis popullit dhe pavarësisë. Përkundër kësaj Ruso dhe Kanti sovranitetin e popujve nuk e kuptonin si transfer të sundimit prej së larti poshtë ose së paku si ndarje të pushtetit midis të dy palëve. Për më tepër për ta sovraniteti i popujve paraqet transformimin e pushtetit në vetëlegjislacion. Këtu në vend të federatës historike, marrëveshjes mbi sundimin, paraqitet marrëveshja shoqërore si model abstrakt për mënyrën e konstituimit të

sundimit e cila legjitimohet ende vetëm si zbatim i vetëlegjislacionit demokratik. Në atë mënyrë sundimi politik e humb karakterin e forcës së natyrshme: në suaza të pushtetit shtetëror *auctoritas* do të duhej të zhdukeshin gjurmët *violentia*. Në pajtim me këtë bindje "vetëm vullneti harmonik dhe i bashkuar i të gjithëve, nëse secili për të gjithë dhe të gjithë për gjithësecilin në të vërtetë konkludojnë të njëjtën... mund të jetë legjislativ" (Kanti).

Me këtë rast nuk mendohet pa marrëdhënien substanciale të mëtejme të ndonjë vullneti popullor, i cili i falenderohet për unitetin e vet ndonjë homogjeniteti pararendës të prejardhjes ose të mënyrës së të jetuarit. Koncenzusi, kohë pas kohe i gjedhur dhe i fituar në ndonjë asociacion të njerëzve të lirë dhe të barabartë, fillon tekembrëmja vetëm në unitetin e *qëndrimit* të konsenzualizuar. Ai qëndrim i formësimit demokratik të mendimit dhe marrjes së vendimit formësohet në kushtetutë juridikeshtetërore. Në suaza të ndonjë shoqërie pluraliste kushtetuta në atë mënyrë e shpreh koncenzusin formal. Shtetasit dëshirojnë, në të vërtetë, ta rregullojnë jetën e vet të përbashkët në harmoni me principet me të cilat, me që në masë të njëjtë shprehin interesat për gjithësecilin në veçanti, mund të pajtohen me arsye të plotë të gjithë individët. Një asociacion i tillë është i strukturuar përmes njohjes reciproke në suaza të të cilit gjithësecili llogarit se do të respektohet nga të gjithë të tjerët si i lirë dhe njeri i barabart me ta. Secili duhet të përjetojë njohje të trefishtë: duhet t'i ofrohet mbrojtje e njëjtë dhe respektim i njëjtë në integritetin e tij si individuum i përfaqësueshëm, si një pjeshtar i ndonjë grupi etnik ose kulturor si dhe si qytetar, do të thotë si anëtar i bashkësisë politike. Ideja e këtyre bashkësisë politike të vetëpërcaktuar në kushtetutë dhe përgjithësisht në sistemet politike të Evropës Perëndimore dhe të Shteteve të Bashkuara të Amerikës në mënyrë të shumfishtë e ka arritur formësimin e vet juridik.

Gjithsesi, "shtetësia", "citoyennete" ose "citizenship" përgjatë një periudhe të gjatë në suaza të gjuhës së juristëve është përdorur në kuptimin e përkatësisë ndaj ndonjë shteti ose të ndonjë nacionaliteti; vetëm para disa kohësh domethënia e këtij nocioni u zgjerua në kuptimin e statusit të shtetasit, i cili është i përshkruar me anë të të drejtave qytetare.⁶ Me *shtetësi* rregullohet përkatësia e personit ndaj një populli shtetëror ekzistenca e të cilit është e pranuar me të drejta ndërkombëtare. Pavarësisht nga rregullimi i brendshëm i pushtetit shtetëror, ky definicion i përkatësisë së bashku me përcaktimin territorial të juridikcionit shtetëror shërben për kufizimin social të shtetit. Në pajtim me vetëkuptueshmërinë e shtetit juridik demokra-

tik si asociacion i qytetarëve të lirë e të barabartë, shtetësia është e lidhur me principin e vullnetit të mirë. Karakteristikat e rëndomta askriptive të vendbanimit të detyruar dhe të lindjes (*jus soli* dhe *jus sanguinis*) nuk paraqesin kurrfarë baze të nënshtërimit të parevokueshëm ndaj pushtetit sovran shtetëror. Ato shërbejnë ende vetëm si kritere administrative të përshkrimit të miratimeve implicite të caktuara me të cilat korenspondon e drejta për shpërngulje, ose së paku e drejta që të heqim dorë nga shtetësia.⁷

Sot gjithsesi shprehjet "shtetësi", "citoyenneté" ose "Citizenship" nuk përdoren vetëm si shenjë e statusit që përmbajtësisht është definuar me anë të të drejtave dhe detyrave të shtetasit. Në të vërtetë kushtetuta e Republikës Federale Gjermane nuk e përmend shprehimisht atë status të shtetasit sikurse që është rasti me të drejtat aktive qytetare të Zvicrës⁸. Megjithkëtë, e drejta është dogmatike, bazuar në nenin 33 f. 1 e Kushtetutës, bashkësinë e të drejtave dhe të detyrave, veçanërisht të drejtave themelore të individit, ia dhuroi një status të tërësishtëm të kuptuar njësoj⁹. Në suaza të kuptimit republikanesk posaqërisht i jepet rëndësi problemit të vetëorganizimit shoqëror, kurse e drejta politike për pjesëmarrje në fitim si dhe e drejta e komunikimit paraqesin thelbin e shtetasit. Kështu R. Grauwert këto të drejta i kupton si "institucion juridik përmes së cilit ndonjë shtetas në mënyrë bashkëvepruese futet në lidhjen konkrete prodhuese të shtetit"¹⁰. Statusi i shtetasit veçanërisht fikson të drejtat demokratike me të cilat ndividi refleksivisht mund të shërbehet që ta ndryshojë pozitën e vet juridike materiale.

Në suaza të filozofisë juridike bëhen diskutime midis dy interpretimeve të kundërta të asaj të drejte aktive të shtetasit. Kështu në traditën liberale të së drejtës natyrore, që rrjedh nga Loku, u formësua të kuptuarit individualistinstrumentalistik, kurse në traditën republikaneske të shkencës shtetërore, që i bashkangjitet Aristoteli, u formësua të kuptuarit etikkomunarishtik të funksionit të shtetasit. Në njërin rast shtetësia koncipohet në pajtim me modelin e përkatësisë ndaj organizatës e cila themelon ndonjë pozitë juridike, ndërkaq ajo në rastin e dytë koncipohet në pajtim me modelin e përkatësisë të ndonjë vetëpërcaktimi të bashkësisë kulturore-etike. Sipas njërit interpretim individualitetet mbesin jashta shtetit, kurse lidhur me riprodhimin e tij ofrojnë për shembull me votimin e vet dhe pagimin e tatimeve-kontributeve të caktuara në mënyrë që për kundërvlerë të fitojnë shërbime organizative. Në pajtim me interpretimin e dytë në bashkësinë politike qytetarët janë të integruar si pjesë në ndonjë tërësi, në atë mënyrë që iden-

titetin personal dhe social mund ta formësojnë vetëm në ndërlidhje të horizontit të përbashkët oral dhe të institucioneve politike të pranuar. Sipas interpretimit liberal shtetasit në esencë nuk dallojnë shumë nga personat privatë të cilët, të vendosur përkundrejt aparatit shtetëror, prokurojnë rëndësinë e interesave të veta parapolitike; sipas interpretimit republikanesk shtetësia aktualizohet vetëm në praktiken kolektive të vetëpërcaktimit. Charles Taylor këto dy konceptione konkuruese të shtetasit i përshkruan në këtë mënyrë: One (model) focuses mainly on individual rights and equal treatment, as well as to influence the effective decisionmakers... These institutions have an entirely instrumental significance... No value is put on participation in rule for its own sake... The other model, by contrast, defines participation in selfrule as of the essence of freedom, as part of what must be secured. This is... an essential component of citizen capacity... Full participation in selfrule is seen as being able, at least part of the time, to have some part in the forming of a ruling consensus, with which one can identify along with others. To rule and be ruled in turn means that at least some of the time the governors can be "us" and not always "them."¹¹


Edhe pse modeli i tërësishëm i ndonjë bashkësie, në të cilin shtetasit janë të inkuorporuar në pikëpamje të shumfishtë që nuk i përshtatet politikës moderne, ai edhe përkundër modelit organizativ, në pajtim me të cilin individët janë të izoluar përkundrejt aparatit shtetëror dhe me të cilin janë të lidhur vetëm përmes marrëdhënies së specifikuar funksionale të përkatësisë posedon përparësi të caktuar: ai model në të vërtetë sqaron se autonomia politike paraqet vetëqëllimin të cilin askush nuk mund ta peshojë seriozisht vetëm për vete ashtu që si person privat ta përcjellë interesin e vet personal, por vetëm të gjithë së bashku përmes përvojës së përbashkët intersubjektive. Statusi juridik i shtetasit konstituohet përmes rrjetit të marrëdhënieve egalitariste të njohjes reciproke. Në atë status juridik secilit i ndahet perspektiva e pjesëmarrësit, e shprehur në vetën e parë shumës dhe jo vetëm perspektiva e vëzhguesit ose të akterit i cili orientohet vetëm në suksesin përkatës personal.

Megjithatë, marrëdhëniet e huazuara juridike të njohjes nuk riprodhohen vetëvetiu, për to është e nevojshme përpjekja kooperuese e përvojës qytetare për të cilën kurrkush nuk mund të detyrohet përmes normave juridike. E drejta moderne e detyrimit për shkaqe të arsyeshme nuk futet në motivet dhe bindjet e adresatit të tyre. Kështu për shembull e drejta juridike për shfrytëzimin aktiv të të drejtave demokratike në

vetëvete përmbante diçka totalitare. Për këtë shkak statusi i konstituuar juridik i shtetasit mbetet i orientuar në atë që krijimin e vet has në prapavijën e përshtatshme të motivit dhe bindjes së qytetarit që juridikisht nuk mund të ofrohen, pranë së cilës qytetarët orientohen në të mirën e përbashkët. Modeli republikanesk i shtetësisë përkujton në atë se institucionet e huazuara kushtetuesejuridike të lirisë kanë vetëm asi vlerë që ua japin popullatat të mësura në liritë politike dhe të orientuara në nëperspektiven e përvojës vetëpërcaktuese. Kështu funksioni i institucionalizuar juridik i shtetasit duhet të jetë i rrënjësor në kontekstin e kulturës politike të lirë. Për këtë shkak komunitaristët rreshtohen në atë se shtetasin duhet "Patriotikisht" të identifikohet me mënyrën e vet të jetuarit. Edhe vetë Taylor-i postulon vetëdijen e përbashkët, e cila del nga identifikimi me legendat e pranuar vetëdijshëm të bashkësisë së vet kulturore-etnike: "The issue is, can our patriotism survive the marginalization of participatory selfrule? As we have seen, a patriotism is a common identification with a historical community founded on certain values... But it must be one whose core values incorporate freedom".¹²

Por duket se kjo i kundërvihet tezës sonë se midis republikanizmit dhe nacionalizmit ekziston vetëm lidhje kontigente historike, por jo edhe lidhja konceptuale. Megjithatë, nëse mendimet e Taylor-it analizohen më për së afërmi, nga to del vetëm shprehja se qëndrimet themelore univerzaliste të shtetit juridik demokratik kërkojnë njëfarë bazamenti kulturor-politik. Kështu, principet kushtetuese, në suaza të ndonjë praktike shoqërore mund të marrin ndonjë formë dhe të bëhen fuqi lëvizëse e projektit të kuptueshëm dinamik për krijimin e asociacioneve të njerëzve të lirë e të barabartë vetëm atëherë kur në atë mënyrë ata situohen në kontekstin historik të ndonjë kombi të shtetasit; që të lëshohen në lidhje me motivet dhe bindjet e qytetarëve.

Kështu shembujt e bashkësive multikulturale, siç janë Zvicra dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dëshmojnë se disa kultura politike, në suaza të të cilave mund të rrënjosen qëndrimet themelore të kushtetutës, në asnjë rast nuk duhet të mbështeten në prejardhjen etnike, gjuhësore dhe kulturore, që do të ishin të përbashkëta për të gjithë shtetasit. Kultura politike liberale paraqet vetëm emërues të përbashkët të patriotizmit kushtetues, i cili njëkohësisht e hollon mendimin për shumështrësimin dhe integritetin e koegzistimeve të ndryshme të mënyrës së të jetuarit të ndonjë bashkësie multikulturale. Edhe në ndonjë lidhje të ardhme evropiane të shteteve duhet që të njejtat parime



juridike të interpretohen nga perspektiva e traditave të ndryshme nacionale, historive të ndryshme nacionale. Traditen vetiake, krahas kësaj, gjithnjë duhet përvetësuar në bazë të shikimit të gjërave që janë relativizuar përmes perspektivave të të tjerëve, në atë mënyrë që atë e fusin në kulturën kushtetutare evropere-dimore të përbashkët mbinacionale. Krijimi partikularist i llojit të tillë në asnjë mënyrë nuk do të duhej ta zvogëlonte domethënien universaliste të sovranitetit popullor dhe të drejtave të njeriut. Pranë kësaj mbetet shtetësia demokratike, s'është e thënë të rrënjohet në identitetin nacional të ndonjë populli, ajo, megjithatë, pa marrë parasysh shumështrësimin e mënyrave të ndryshme të të jetuarit kulturor, kërkon socializimin e të gjithë shtetasëve në një kulturë politike të përbashkët.

II Shteti nacional dhe demokracia në evropën e bashkuar

Ardhmëria politike e Bashkësisë evropiane hedh dritë, nga një prizëm tjetër, në marrëdhënien midis shtetësisë dhe identitetit nacional. Siç dihet, koncepti i shtetësisë, të cilin e zhvilloi Aristoteli, burimisht ishte i modeluar në pajtim me madhësinë e qyteteve ose të qyteteve-shtete. Evoluimi i popullatave në kombe, që krijojnë shtetet e veta, është bërë në shenjë të nacionalizmit, i cili, duket, përpqej që idetë republikane t'i sillte në pajtim me masën e shteteve territoriale moderne. Ndërkaq, në ndërlidhje me format politike të shteteve të tilla nacionale, zhvilloheshin trende moderne ekonomike. Krahas kësaj, sikurse edhe vetë institucionet

shtetërore burokratike, edhe ekonomia kapitaliste zhvilloi domethënien personale sistemore. Në të mirat e tregut, kapitalin, dhe në fuqinë punëtore dominon logjika personale, e pavarur nga qëllimi i vetë subjektëve. Krahas pushtetit administrativ, ashtu siç është rrënjësor në burokracinë shtetërore, edhe paraaja u bë medium i heshtur i integritit shoqëror i cili me sukses vepron mbi vetë pjesëmarrësit. Ky integritet sistemor i bëhet konkurrent integritit social, i cili zhvillohet me ndihmën e vlerave, normave, dhe mirëkuptimeve, me ndihmën e vetëdijes së vetë akterëve. Megjithatë, vetë integriteti politik, që zhvillohet rrugës së shtetësisë demokratike, krijon njërin nga aspektet e atij integriteti të përgjithshëm social. Për këtë arsye, midis kapitalizmit dhe demokracisë mbretëron një tension i caktuar, i cili në teoritë liberale shpesh lihej anash.

Në shembullin e shteteve në zhvillim shihet se në asnjë rast nuk ekziston ndonjë ndërlidhje lineare midis zhvillimit të shtetit juridik demokratik dhe modernizimit kapitalist. Barabar me këtë nuk u lind përmenjëherë as kompromisi social-shtetëror që në ndërlidhje të demokracive perëndimore u fut qysh nga mbarimi i luftës së dytë botërore. Vetë zhvillimi i Bashkësisë evropiane e nxjerr në shesh atë tension midis demokracisë dhe kapitalizmit, por në një mënyrë tjetër. Ky tension shprehet në thyerjen vertikale midis integritit sistemor të ekonomisë dhe qeverisjes, e cila është arritur në nivelin mbinacional, si dhe integritit politik që është aplikuar vetëm në nivel të shtetit nacional. Mu për këtë, forma teknokratike e Bashkësisë evropiane vetëm sa e shton dyshimin që edhe ashtu ekziston lidhur me ato pritje normative, të cilat janë të ndërlidhura me rolin e shtetasit demokrat. Mos këto pritje, madje edhe përbrenda kufijve të shtetit nacional, me të madhe kanë paraqitur një iluzion të caktuar? Simbioza momentale e krijuar midis republikanizmit dhe nacionalizmit mos e fsheh jo vetëm faktin se koncepti i shtetasit në rastin më të mirë vlen për mardhënie mbikomplekse të një shoqërie të rregulluar dhe etikisht homogjene, e cila ende është e integruar mbi bazën e traditës dhe dokeve?

Sot nga "Bashkësia Ekonomike Evropiane" është krijuar "Bashkësia Evropiane", e cila ka sheshuar vullnetin e vet politik për krijimin e "Unionit Evropian". Sa i përket një krijese të këtillë politike me 320 milion banorë, shembull për këtë, nëse nuk merret parasysh India, paraqesin vetëm Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithsesi SHBA-të krijojnë një bashkësi multikulturale, që është bashkuar me rrugë të njejtë të kultures politike dhe (tash për tash) me rrugën e vetëm dhe vetëm një gjuhe,

kurse, përkundër kësaj Unioni Evropian paraqet shtet nacional shumëgjuhësh. Ai union, natyrisht nëse krijohet, dhe për të cilin mund të shpresojmë, do të duhej të ishte më i ngjashëm me ndonjë lidhje shtetesh se sa me federatë të disa shteteve pjesërisht sovraane, dhe gjithsesi do të duhej t'i ruante disa karakteristika të "Shtetësisë Evropiane" të Gaulleovit. Shtetet e deritashme nacionale, në kuadër të një Evrope të tillë, do të duhej edhe më tutje të dispononin me forcën që do të ishte në gjendje t'i formësonte disa struktura të caktuara.

Në të vërtetë, në rrugën me pengesa deri te Unioni i Evropës, shtetet nacionale paraqesin problem më të vogël sa u përket kërkesave të tyre të pacenueshme për sovranitet, por problem më të madh paraqet fakti që deri tash, përbrenda kufijve të tyre, proceset demokratike funksionojnë vetëm pjesërisht. Thënë shkurt, opinioni politik deri sot është i shpërpjestuar në aspektin nacional-shtetëror. Përbri kësaj, na imponohet pyetja lidhur me atë se a mundet vërtet të ekzistojnë shtetësia evropiane - me këtë nuk mendoj vetëm në mundësitë e veprimit politik kolektiv, që dalin jashta kufijve shtetëror, por gjithashtu edhe në "obligimet lidhur me të mirat e përbashkëta evropiane"¹³. Qysh më 1974 Raymond Aron në këtë pyetje dha përgjegje të bindshme negative. Së shpejti në nivelin mbinacional të qeverisjes, me ndihmën e mjeteve juridike administrative, do të organizohet tregu i brendshëm evropian shumë i gjërë, kurse edhe më tutje nga perspektiva e opinionit politik shtetet pjesëmarrëse mezi do të guxojnë ta vërejnë parlamentin e Evropës të armatosur me kompetenca të varfëra. Deri sot gjeneza e të drejtave politike të shtetasit nuk i tejkalon suazat e shtetit nacional.

Me rastin e marrjes së vendimeve, gjyqi i Evropës mbështet parimin "Pesë liritë e tregut të përbashkët", prandaj qarkullimi i lirë i mallit, lëvizja e lirë e punëpranimit, e drejta për formimin e ndërmarrjeve nga ndërmarrësit, liria e qarkullimit të veprimtarive shërbyese si dhe liria e qarkullimit të parasë të gjitha këto interpretohen si bazë e të drejtës së individit. Kjo në të vërtetë është në përputhje me kompetencat e Këshillit Ministror dhe të Komisionit të Lartë, që i kanë fituar në bazë të nenit 3 të Traktatit të Romës. Megjithatë, këto kompetenca mund të shpjegohen në bazë të qëllimit të nënvizuar në nenin 9. "Themelin e Bashkësisë e paraqet unioni doganor, i cili përfshinë qarkullimin e tërësishëm të mallit". Ky synim do të realizohej me unionin e parasë dhe me formimin e bankës qendrore autonome. Shkalla e re e ndërlidhjeve ekonomike duket se kërkon nevojën e vazhdueshme për koordinim edhe në fushat e tjera

politike, si për shembull, në atë ekologjike, tati-
more, arsimore, në fushën e politikës sociale e
të tjera. Mirëpo, kjo nevojë për rregullim do të
duhej, në radhë të parë, të harmonizohej me
kriterin e racionalitetit ekonoik, me ç'rast duhet
të merret parasysh edhe sigurimi i barabart i
marrëdhënieve konkurente. Këto detyra deri
tash i kryenin ato organizata evropiane, që
ishin të ngulfatura në rrjetin e ngushtë admin-
istrativ. Funksionet e elitës tash janë të reja, në
të vërtetë bazuar në formën e tyre, ende respek-
tojnë lidhjet me qeveritë dhe institucionet e ven-
deve prej nga ato rrjedhin, megjithatë, ato njëk-
ohësisht e kanë mbijetuar kontekstin e vet na-
cional. Nëpunësit që punën e vet e kryejnë si
profesionistë, përbëjnë burokracinë e cila është
shkëputur nga proceset demokratike.

Me këtë për qytetarët gjithnjë e më shumë rritet
humnera midis situatës në të cilën pa
pjesëmarrjen e vet janë të goditur me këto
masa; dhe situatës në të cilën ata marrin pjesë
përprururjen e atyre masave. Kësisoj numri
gjithnjë e më i madh i masave që merren në
nivelin mbinacional, i godet gjithnjë e më
shumë qytetarët dhe atë në tregues të shumtë
të jetës së tyre. Meqë deri sot roli i shtetasit
ishte i institucionalizuar vetëm në suaza të
shtetit nacional, qytetarët nuk disponojnë
mundësi efektive që vendimet evropiane t'i
bëjnë temë të veten dhe as të ndikojnë në to. M.
R. Lepsius në mënyrë lapidare ka konstatuar:
"Mendimi i lirë evropian nuk ekziston"¹⁴.
Megjithatë, ky disparitet mos paraqet vetëm një
mosbarazpeshë kalimtare, e cila mund të elimi-
nohet me anë të parlamentarizmit të ekspertok-
racisë brukselleske? Ose në ato burokraci, që
veprojnë në pajtim me kriteret e racionalitetit
ekonomik, mos edhe më qartë theksohet zhvil-
limi, i cili edhe përbrenda shteteve ekziston
qysh moti dhe gjithsesi i pandashëm në vepër -
gjegjësisht pavarësimi i imperativave ekonomik,
mandej përkrahja e politikës që përmbajtësisht
e zbeh statusin e qytetarit dhe e demanton
kërkesën republikaneske?

T.M. Marshalli¹⁵ ka hulumtuar në shembullin e
Anglisë ekspansionin e të drejtave dhe të de-
tyrimeve të qytetarit lidhur me modernizimin
kapitalist. Ndarja e Marshallit konsiston në të
drejtën e qytetarit në "civil", "political" dhe "so-
cial rights", në pajtim me klasifikimin e njohur
juridik. Në pajtim me këtë e drejta liberale e
mbrojtjes mbron subjektin juridik privat për
shkak të kundërrhyrjes së ligjshme të shtetit në
sferën e lirive dhe të pronësisë, e drejta për
pjesëmarrje politike i mundëson qytetarit aktiv
pjesëmarrje në procesin demokratik mbi for-
mësimin e opinionit dhe të vullnetit, e drejta e
bashkëpunimit social në dobi të klientit,
mirëqenies sociale të shtetit, siguron të ardhura
minimale dhe siguri sociale. Marshalli mbron

tezën se statusi i qytetarit në shoqërinë mod-
erne është zgjeruar dhe sforcuar suksesivisht.
Kështu pikësëpari të drejtat demokratike i kanë
plotësuar të drejtat negative të lirisë, pastaj të
drejtat sociale të të dy llojeve klasike kanë
plotësuar të drejtat themelore të individit dhe
këto ashtu që shtresat gjithnjë e më të mëdha
të popullatës gradualisht i fitojnë të drejtat e
veta për pjesëmarrje. Megjithatë, edhe po të
shmangeshim nga detajet historike, ky sugjes-
tion i zhvillimit, i cili në parim rrjedh linearisht,
përputhet vetëm me atë që socialogët për-
gjithësisht e quajnë "inkluzion". Në shoqërinë e
cila gjithnjë e më shumë diferencohet funksion-
alisht, numri gjithnjë e më i madh i personave
fiton të drejta gjithnjë e më të mëdha bazuar në
qasjen dhe pjesëmarrjen në nënsisteme gjithnjë
e më të shumta qoftë po të kemi të bëjmë me
tregjet, rendet, apo vendet e punës ose edhe me
shërbimet, gjyqet, ushtrinë, shkollat, spitalet,
teatrot, muzetë, integritet politik, mjete poli-
tike të komunikimit, partitë, institucionet
vetëqeverisëse apo parlamentet. Me këtë indi-
vidi i shumëfishohet mundësia për pjesëmarrje
nëpër organizata, i zgjerohet hapësira e op-
cioneve të tija. Këtë pamje të përparimit linear
gjithsesi ia atribuojmë përshkrimi i cili mbetet
neutral edhe përkundër rritjes dhe humbjes së
autonomisë. Ajo është e verbër edhe përkundër
shfrytëzimit aktiv të statusit të shtetasit, me
ndihmën e të cilit individ mund të ndikojë në
ndryshimin demokratik të statusit të vet.
Fundja, vetëm të drejtat e pjesëmarrjes politike
ndërtohen reflesivisht në vetëvete për sa i
përket pozitës juridike të ndonjë shtetasi. Në të
kundërtën e kësaj, e drejta negative e lirisë dhe
e drejta sociale e pjesëmarrjes në fitim, mund të
shpërndahen në mënyrë paternaliste. Shteti ju-
ridik dhe social në parim janë të mundshëm
edhe pa demokracinë. Edhe atje ku ekzistojnë,
si edhe në "shtetin demokratik dhe juridik so-
cial", në kushtetutë janë të institucionalizuara
të tri kategoritë e së drejtës, e drejta e mbrojtjes
dhe e drejta e pjesëmarrjes në fitim mund të
krahasohen me fytyrën e zotit Janus.

Të drejtat liberale, të cilat shikuar historikisht
janë kristalizuar lidhur me statusin shoqëror të
pronarit privat, mundet të kuptohen nga poz-
icioni funksional si institucionalizimi sistemit
ekonomik në të cilin zotëron tregu, ndërkaq nga
pozicioni normativ ato garantojnë liritë indi-
viduale. E drejta sociale nga pozicioni funk-
sional do të thotë instalimin e burokracisë së
mirëqenies shoqërore, kurse nga pozicioni nor-
mativ garanton nevojat kompenzuese të
pjesëmarrjes juridike në pasurinë shoqërore.
Gjithësesi, sikurse liritë individuale edhe
siguria sociale, mund të konsiderohet bazë ju-
ridike e atyre shoqërive të pavarura, që do të
mundësojë shfrytëzimin efektiv të të drejtave

politike. Megjithatë, më parë kemi të bëjmë me ndërlidhje empirike, se sa me ndërlidhje të domosdoshme konceptuale. Sepse e drejta në lirinë dhe pjesëmarrjen në fitimin në masë të njejtë mundëson pengimin privatist të rolit të shtetasit; i cili me këtë reduktohet në një marrëdhënie të ndonjë klienti karshi administratave të cilat apriori kujdesen për klientët duke ua ofruar shërbimet e veta.

Sindromi i privatizimit të shtetasit si dhe kryerja e roleve të tij në suaza që del nga interesi i klientit, bëhet gjithnjë e më real në atë masë sa ekonomia dhe shteti, të cilat me të njejtat të drejta institucionalizohen, zhvillojnë domethënie sistimore personale dhe me këtë ua imponojnë shtetasëve role periferike të bashkëvepruesëve të thjeshtë në organizim. Kështu në sistemet ekonomike dhe administrative mbizotëron tendenca që këto sisteme të mbyllen ndaj rrethit të vet dhe t'u nënshtrohen vetëm imperativeve personale të parasë dhe fuqisë. Për këtë shkak ata thejnë modelin e "bashkësisë", e cila me ndihmën e përvojës së përbashkët të shtetasëve vetë urdhëron. Kështu duket përfytyrimi themelor republikanesk i integritetit të vetëdijshëm politik të bashkësisë së njerëzve të lirë dhe të barabartë duke marrë parasysh relacionet moderne që dominojnë në atë bashkësi ashikare konkrete dhe të thjeshta, veçanërisht në atë rast kur mendohet në kombin, gjegjësisht, posaqërisht në ndonjë bashkësi etnike homogjene e lidhur për fatin, e cila ende ruhet si e tillë përmes traditave të përbashkëta.

Për fat, e drejta paraqet asi mediumi, i cili lejon përfytyrim thelbor abstrakt mbi autonominë qytetare. Sot suverniteti qytetar i popujve mbështetet në qëndrime të cilat juridikisht janë të institucionalizuara si dhe në proceset jofor-male që mundësojnë të drejta themelore të individit, përmes të cilave arrihet deri te formësimi i opinionit dhe i vullnetit publik, që në masë të madhe ose të vogël është diskurziv.

Mandej nisem nga ngatërrimi i formave të ndryshme të komunikimit, të cilat në esencë duhet të jenë asisoi të organizuar që në vetëvete ta kenë supozimin që administratën qytetare ta lidhin me premisat racionale, mandej në këtë mënyrë njëkohësisht nga pozicioni social dhe ekologjik ta diciplinojnë edhe sistemin ekonomik, por me kusht që të mos prekin në këtë rast në logjikën e tij personale. Kjo megjithatë paraqet modelin e *politikës deliberative*. Në kesi modeli nuk fillohet nga subjekti i madh i ndonjë tërësie të përbashkët, por nga diskursi anonim i vijëzuar. Me këtë, qëndrimeve demokratike dhe infrastrukturës së realitetit politik, i cili merr energjinë e vet nga burimet spontane, u mveshet barra kryesore e pritjeve normative. Sot turma qytetare të drejtat e veta politike për

bashkëveprim mund t'i shfrytëzojë në kuptim të integritetit dhe nën ndikimin e rrjedhave jofor-male të komunikimit publik, i cili nuk mund të organizohet në plotësinë e vet, aq më shumë kur ajo rrjedhë e komunikimit publik në esencë mbështetet në kulturën e politikës liberale dhe egalitare. Njëkohësisht konsultime në korporimet që sjellin vendime do të duhej të ishin dorëlira sa i përket temës, orientimit të vlerave, kontributeve dhe programeve që dalin nga realiteti politik, por i cili nuk është i pajisur me instrumentin e forcës. Vetëm kur do të arrihej një bashkëpunim i tillë midis institucionalizimit të formësimit të opinionit publik dhe vullnetit në anën tjetër, shtetësia edhe sot do të mund të kishte rëndësi edhe më të madhe se sa agregacioni i interesave individuale parapolitike dhe kënaqja pasive e të drejtave të ndara paternaliste.

Me këtë model këtu, fatkeqësisht, nuk mund të merrem më shumë¹⁶. Megjithkëtë sa i përket vlerësimit të shansave të shtetësisë së ardhshme evropiane mundem, në bazë të historisë së institucionalizimit të të drejtave të shtetasit në suaza të shtetit nacional, ta hetoj ndonjë mbështetje empirike. Skema, në bazë të së cilës të drejtat e shtetasit paraqiten kryesisht si rezultat i luftës klasore, ashikare është e ngushtë¹⁷. Këtij zhvillimi deri te statusi i plotë i shtetasit i kanë ndihmuar edhe lëvizjet sociale të llojit të dytë, para së gjithash migrimet dhe luftërat. Krahas kësaj, faktorët që mundësojnë të shëndrruarit e marrëdhënieve të reja inkluzive në marrëdhënie juridike, ndikojnë edhe në mobilimin politik të qytetarëve dhe njëkohësisht, me këtë, edhe në aktivizimin e të drejtave ekzistuese të shtetasit¹⁸. Sa i përket ardhmërisë evropiane, të bazuar në arritjet e këtilla ose të ngjashme, është e mundur që ekstrapolirohet pritja e kujdesshme optimiste e cila apriori nuk është e gjykuar për rezignim.

Tregu i përbashkët i Evropës do të cysë mobilitet më të madh horizontal dhe do t'i shumëfishojë kontaktet midis pjesëtarëve të nacionaliteteve të ndryshme. Imigrimi nga Evropa e Lindjes dhe nga vendet e varfëra të Botës së Tretë, do të theksojë mbi të gjitha shumështrësimin multikultural të shoqërisë. Kjo gjithsesi do të nxisë tension social. Por këto tensione do të mund, nëse avansohen kualitativisht, të sillnin mobilizimin politik që do të mund t'u jepte shtytje lëvizjeve sociale endogeme që kanë lindur në suaza të shtetit nacional (siç janë për shembull lëvizjet paqëndashëse, ekologjike dhe feministe). Kjo gjithsesi do të sforcojë relevancën botërore të temave publike. Njëkohësisht rritet presioni i temave për të cilat ekziston vetëm zgjidhja e koordinuar evropiane. Në suaza të këtyre kushteve është i mundshëm zhvillimi i ndërlidhjeve të komunikimit publik gjërë e gjatë

Evropës, e cila nga ana e vet ofron kontekst të volitshëm si për lindjen e korporimeve parlamentare të regjioneve të reja në rritje, po ashtu edhe për parlamentin e Evropës, të pajisur me autorizime të gjëra.

Politika e Bashkësisë Evropiane në shtetet, që deri sot janë anëtare të saj, nuk ka paraqitur lëndë të kundërthënies që do të kishin konsekuencë legjitimuese. Opinionet nacionale ende janë të ndara sa i përket kulturës. Ato në të vërtetë rrenjësohen në kontekstin në të cilin çështjet politike fitojnë domethënien e vet bazuar në prapavinë në të cilën e krijojnë historitë nacionale përkatëse veti. Megjithatë, në të ardhmen do të mund të krijohej një kulturë politike e përbashkët nga kulturat e ndryshme nacionale. Kështu do të mund të vihej deri te një diferencim midis një kulture të përbashkët politike nga njëra anë; si dhe të traditave nacionale në art dhe letërsi, historiografi, filozofi e të tjera, nga ana tjetër, pra, traditat janë të përdëgëzuara që nga faza e hershme e modernes. Kësisoj elitës së kulturës dhe masmedive do t'u takojë një rol shumë i rëndësishëm. Gjithashtu do të paraqitet nevoja për ngjalljen e patriotizmit kushtetues evropian të ndryshëm nga ai amerikan, i cili do të krijohej nga interpretimet impregnuuese nacionalhistorike të ndryshme të të njëjtit parim juridik univerzalist. Pikërisht Zvicra është shembull për këtë që një mirëkuptim i përbashkët politikokulturor mund të zhvillohet në bazë të orientimeve kulturore të nacionaliteteve të ndryshme.

Për këtë shkak shumë më pak na nevojitet vetëverifikimi i burimit të përbashkët të shekullit mesjetar evropian, nga vetëdija e re politike që i përgjigjet rolit të Evropës në botën e shekullit 21. Deri sot historia botërore me lindjen dhe zhdukjen e perandorive ka mundur vetëm një debutim. Njësoj kjo vlen edhe për mbretëritë e botës së vjetër, si dhe për shtetet moderne: Portugalinë, Spanjën, Anglinë, Francën dhe Rusinë. Sot, si përjashtim nga ky rregull, i jepet tjetër shansë Evropës si tërësi. Gjithësesi, ajo këtë shansë nuk do të mund ta shfrytëzojë heshturazi me forcën e politikës së vet të vjetër, por vetëm me ndihmën e premisave të ndërruara të mirëkuptimit joimperialist dhe të nxënies nga kulturat e tjera.

III. Migrimi dhe shovinizmi i mirëqenies.

Një diskutim.

Diagnoza e bërë nga Hannah Arendt se në të vërtetë njerëzit e mbetur pa atdhe, si dhe të papërmirësueshmit e të ikurit, do të paraqesin signaturën e këtij shekulli, është vërtetuar në

përmasa të tmerrshme. "Displaced persons" që e kanë lënë pas vetes lufta e dytë botërore mu në mes të Evropës, tashmë moti e kanë zëvendësuar azilantët dhe emigrantët të cilët nga jugu dhe lindja vërshojnë në Evropën e pasur dhe paqëndrueshme. Batica e valëve të reja migruese nuk mund të përfshihet me kampet e vjetra për të ikurit. Statistikantët llogarisin për vitet e ardhshme deri në tridhjetë milionë të shpërngulur vetëm nga Evropa Lindore. Ky problem ende mund të zgjidhet vetëm me politikën e përbashkët të shteteve të goditura nga kjo. Me këtë rast përsëritet dialektika e cila në një masë më të vogël ka ndodhur gjatë procesit të bashkimit të Gjermanive. Dyndjet transnacionale të qytetarëve veprojnë ngjashëm me sanksionet, që e shtynë Evropën Perëndimore të marrin përgjegjësinë që u ka takuar me dështimin e socializmit shtetëror. Ose do të bëjnë përpjekje eminente në mënyrë që kushtet e jetesës të përmirësohen shpejt në vendet e varfëra të Evropës së Mesme dhe Lindore, ose azilantët dhe të shpërngulurit do të vërshojnë.

Ekspertët bëjnë diskutime të ashpra lidhur me kufijt e aftësive absorbuese të sistemit ekonomik. Megjithatë, gatishmëria për integrim politik të azilantëve varet në masë të madhe nga ajo se në çfarë shkalle popullata vendase i merr seriozisht problemet sociale dhe ekonomike si pasojë e kësaj shpërnguljeje. Kështu në tërë Evropën është rritur numri i reagimeve mbrojtëse të djathtëve radikaliste ndaj depërtimit të të huajëve. Shtresat e deprivuara relativisht vetëm sapo të rrezikuara me rënien sociale, qoftë pse tashmë ndodhen në grupet e skajshmeve çanërisht identifikohen qartë me epërsinë ideologjike të koelktivitetit të vet, prandaj mohojnë çdo gjë që për ta është e huaj. Kjo megjithatë paraqet anën tjetër të mirëqenies shoveniste kudo në rritje. Në këtë mënyrë problemi i azilantëve përsëri e qet në shesh acarimin latent midis shtetësisë dhe identitetit nacional.

Njëri nga shembujt për këtë është disponimi nationalist dhe kundërpolak në shtetet e reja gjermane. Atje statusi i porsaarrirë i qytetarit të Republikës Federale Gjermane lidhet me mundësitë që së shpejti kufiri i mirëqenies, që mbretëron në Republikën Federale, të zhvendoset në Odër dhe Nisë. Shtetësinë e vet të shumica prej tyre e pranojnë me njëfarë kënaqësie etnocentrike se me ta më nuk veprohet sikurse me gjermanët e rendit të dytë. Me këtë rast harrojnë se karakteri liridashës i të drejtave të shtetasit del nga përmbajtja universale e të drejtave njerëzore. Që në nenin 4 të Kushtetutës Revolucionare të vitit 1793, në të cilin bëhet fjalë mbi "statusin e qytetarëve", çdo të huaji të pjekur, i cili një vit ka qëndruar vazh-

dimisht i shpërngulur në Francë, në mënyrë konsekuente i janë garantuar jo vetëm të drejtat e shtetësisë, por edhe të drejtat aktive të shtetasit. Në Republikën Federale sikurse edhe në shumicën e sistemeve juridike të perëndimit pozita juridike e të huajt, të të huajëve që kanë mbetur pa atdhe dhe pa shtetësi, megjithatë u është përshtatur statusi i shtetasit. Me që arkitektonika e kushtetutës ka qenë e përcaktuar me idenë e të drejtave njerëzore, të gjithë banuesit gëzojnë me kushtetutë mbrojtjen e garantuar. Të huajtë disponojnë me të njejtin status të detyrimeve, statusi juridik dhe status pune sikurse edhe popullata vendase; edhe nga pikëpamja e statusit ekonomik, me disa përjashtime të rralla, të huajtë gëzojnë tretman të njejtë. Një numër i madh ligjesh që janë neutrale ndaj përkatësisë nacionale e relativizojnë domethënien e njëmendët së paku të shtetësisë pasive.

Megjithatë, komponenta e shtetësisë që përfshinë të drejtat njerëzore, është sforcuar edhe me të drejtat mbinacionale, veçanërisht me të drejtat qytetare evropiane, madje edhe nga pikëpamja e bërthamës së mundësisë së veprimit politik. Rreth kësaj vlen të përkujtohet shprehja e vlershme e nxjerrur në vendimin e miratuar të gjyqit kushtetues federal të 31 tetorit të vitit 1990. Në atë sqarim në të vërtetë e drejta zgjedhore për të huajtë, me rastin e zgjedhjeve lokale dhe komunale, pra, e drejta zgjedhore komunale për të huaj, konsiderohet e kundërt me përcaktimet kushtetutese, por në atë sqarim pranohet parimi i cili është paraqitur nga ana e propozuesëve: "Prapa këtij të kuptuari qartë qëndron bindja, që në harmoni me idenë demokratike, posaqërisht me të menduarit liridashës që është e përfshirë në te; të vendoset një kongruencë midis poseduesit të të drejtave politike demokratike dhe atyre që përgjatë një periudhe të gjatë i përulëshin pushtetit të caktuar shtetëror. Kjo është e vërtetë në rrjedhën e vet..."¹⁹

Me këtë tendencë dëshirohet që të vërtetohet vetëm kjo se në bazë të përmbajtjes normative të shtetësisë, e cila me të madhe është shmanhur nga identiteti nacional, nuk mund të përfitojë kurrfarë pikëpamjesh me të cilat do të mund të udhëhiqej kurrfarë politike restriktive ose penguese ndaj azilantëve ose së paku përgjithësisht, duke marrë parasysh të drejtën për të fituar të drejtat qytetare. Megjithatë çështje e hapur mbetet edhe më tutje se a bashkësia evropiane sot, duke pritur migrim të madh, a mundet dhe a duhet të udhëheqë asi politike të njejtë liberale ndaj migrantëve dhe të huajëve, ashtu siç aso kohe vepronin jakubinët. *Diskutimi moraloteorik* përkatës sillt rreth nocionit "special duties", të atyre detyrave të veçanta që

ndodhen në suaza të kufijve social të ndonjë bashkësie. Madje edhe vetë shteti krijon bashkësinë konkrete juridike, e cila shtetasëve ua imponon detyrimet e veçanta. Kështu, azilantët dhe emigrantët, pjestarë të shteteve evropiane, ballafaqohen përgjithësisht me problemin se a mund të vërtetohen në radhë të parë me detyrimet e veçanta që kanë të bëjnë me shtetasin, kundrejt detyrimeve univerzale që i tejkalojnë kufijt shtetëror. Do të dëshiroja që këtë diskutim ta përmbledhja në pesë pika:

(a) *Detyrimet e veçanta* i kanë personat e caktuar kundrejt personave të tjerë të caktuar, që u janë të "afërt" si pjestarë, pra si anëtarë të familjes vetiake, si shokë dhe fqinjë, si bashkëqytetarë në "suaza" të bashkësisë politike ose të kombit. Prindërit kanë detyrimet të veçanta ndaj fëmijëve të vet - dhe e kundërta; përfaqësitë konzulare në botën e jashtme janë të vetëdijshme për detyrimet e veçanta ndaj shtetasëve të vet, të cilëve u duhet mbrojtje-kurse këta megjithatë ndaj institucioneve dhe ligjit të vendit të vet. Krahës kësaj mendojmë, para së gjithash, në detyrat pozitive që janë aq të papërcaktuara sepse kërkojnë shërbime të caktuara dhe solidaritet, mund dhe kujdes, masa e të cilave nuk mund të precizohet krejtësisht. Nuk mundet nga të gjithë në çdo kohë të kërkohej ndihmë. Detyrimet e veçanta që dalin nga përkatësia ndaj bashkësive të caktuara mund të kuptohen si përshtime sociale dhe specifikime profesioniste të atyre detyrimeve vetiu të papërcaktuara.

Nga pikëpamja utilitariste është bërë përpjekje që detyrimet e veçanta të themelohen në dobi të ndërmjetvetshme, të cilën e përfitojnë pjestarët e ndonjë bashkësie mes vete nga veprimet reciproke. Gjithashtu, edhe popujt dhe shtetet i kupton si të tilla "mutual benefit societies"²⁰. Në pajtim me këtë model çdo pjestar mund të presë se fitimin që e nxjerr nga marrëdhëniet e shkëmbimit me anëtarët e tjerë, është proporcional me veprimet që ai vetë i fut në interakcionin e vet me pjestarët e tjerë. Në bazë të kësaj mund të arsyetohet reciprociteti i detyrimeve të veçanta dhe i të drejtave, në pajtim me të cilin ndalohet për shembull zvogëlimi i privilegjit të punëtorit në punë të përkohshme. Megjithkëtë, në suaza të këtij modeli nuk mund të themelohen kurrfarë detyrash ndaj pjestarëve të bashkësisë që mund të ofrojnë vetëm ndihmë të vogël (invalidët, të sëmurët, pleqtë) apo së paku ndaj atyre që u duhet ndihmë, për shembull të huajt i cili kërkon azil. Etnocentrizmi instrumental i dobive të pritura dhe të ndërmjetvetshme do t'u propozonte aso politike migruese në suaza të së cilës të huajëve do t'u lejohet vendosja vetëm atëherë kur ekziston shansi i arsyeshëm që ata të mos e ngarko-


■ H A B E R M A S ■

jnë bilancin ekzistues midis veprimit dhe kërkesës.

(b) Ky rezultat konstraintitiv flet në dobi të asaj se baza utilitariste dobësohet dhe atë në dobi të modelit në pajtim me të cilin detyrat e veçanta nuk interpretohen në bazë të dobisë reciproke të shkëmbimit të veprimit midis pjestarëve të ndonjë kolektiviteti, por në bazë të veprimit të koordinuar të ndarjes morale të punës, që do të organizohej prej një qendre ²¹. Në të vërtetë, detyrat e veçanta nuk oshillojnë në masë të njëjtë sikurse edhe distanca sociale, ashtu që edhe kërkesat e atyre që na janë afër vazhdimisht të kishin prioritet ndaj kërkesave të atyre që na janë më të largët. Ky intucion bazohet vetëm në rrethin e ngushtë të familjes dhe fqinjësisë. Kjo, megjithatë, mund të na mashtrojë aq sa të gjithë personat e anës tjetër na janë të njohur në masë të njëjtë të afrisë ose të largësisë. Këta "të huajë" i vendosim në kategorinë "ata të tjerët", pa marrë parasysh se a i përkasin ata kombit të vet dhe a janë qytetarë tonë apo jo. Detyrimet e veçanta ndaj "atyre të tjerëve" në rend të parë nuk dalin nga përkatësia ndaj ndonjë bashkësie konkrete. Ato për më tepër dalin nga koordinimi i veprimeve abstrakte të institucioneve juridike, të cilat një rrethi të caktuar njerëzish ose agjenturash ua imponojnë detyrime të caktuara, në mënyrë që detyrat pozitive që në rastet e tjera mbesin të papërcaktuara, t'i specifikojnë profesionalisht dhe në

mënyrë sociale, si dhe t'i bëjnë të detyrueshëm. Në pajtim me të kuptuarit e kësillë të detyrimeve të veçanta nga ndërmjetësimi institucional del imponimi i përgjegjësve adresatëve të caktuar që veprojnë në pajtim me ndarjen morale të punës. Në suaza të një rregullimi të kësillë juridik të ndarjes morale të punës. Në suaza të një rregullimi të kësillë juridik kanë vetëm atë funksion-shpërndarjen e përgjegjësisë. Kjo nuk do të thotë që detyrimet tona përfundojnë në ata kufij. Për më tepër pushtet nacionale duhet të përkujdesen edhe për plotësimin e detyrimeve pozitive që shtetasit i kanë ndaj personave që nuk i përkasin bashkësisë së tyre, si për shembull azilantët. Me këtë gjithësesi nuk është ofruar ende përgjegjëje në pyetjet se me çfarë detyrimesh kemi të bëjmë.

(c) Nga pikëpamja morale jemi të obliguar që këtë problem ta shqyrtojmë objektivisht, pra, që të mos e shqyrtojmë njëanshëm nga perspektiva e banuesit të ndonjë regjioni që e karakterizon mirëqenia, por gjithësesi edhe nga perspektiva e ndonjë migranti që atje e kërkon shpëtimin vet, do të mund të thoshim: jeta e lirë e denjë për njeriun dhe jo vetëm azili politik. J.Rawls-iç është e diktur, ka propozuar eksperiment mendor të ndonjë pragjendje në pajtim me të cilën të gjithë njerëzit përkatës nuk disponojnë dije mbi atë se në çfarë bashkësie janë lindur dhe me çfarë pozicionesh në atë bashkësi kanë



disponuar. Varësisht nga problemi ynë rezultati i verifikimit moral i ndërmarrur në bazë të shoqërisë botërore është i dukshëm: "Behind the 'evil of ingorance; in considering possible restrictions off freedom, one adopts the perspective of the one who would be most disadvantaged by the restrictions, in this case the perspective of the alien who wants to immigrate. In the original position, then, one would insist that the right to migrate be included in the system of basic liberties for the same reasons one would insist that the right to religious freedom would be included: it might prove essential to one's plan of life"²². Kufizimet legjitime të të drejtës migruese do të mund të themeloheshin atëherë kur do të merrej parasysh pikëpamja konkurruese. Kështu, për shembull, kërkesa që të shmangemi nga konfliktet sociale dhe ngarkesat me përmasa më të mëdha, që do të rrezikonin rendin publik dhe fuqinë ekonomike të ripërtitjes së shoqërisë. Mandej, në bazë të pikëpamjes e cila do të theksonte gjenezën, gjuhën dhe arsimin ose madje edhe pranimin e "përkatesisë ndaj bashkësisë kulturore", siç është rasti i statusit të gjermanit-nuk do të mund të themelonte ndonjë status të privilegjuar me rastin e shpërnguljes ose të fitimit të të drejtës së shtetasit.

(d) Në të kundërtën e kësaj komunitaristët tregojnë në rrethanat që janë harruar në suaza të principeve individualiste të përmendura: kufinjt social të bashkësisë politike nuk posedojnë vetëm kuptim funksional sikurse sugjerohet në modelin e rregullimit juridik të ndarjes morale të punës. Ato për më tepër rregullojnë edhe përkatesinë e ndonjë bashkësie historike të lidhur me fatin si dhe me ndonjë mënyrë politike të të jetuarit, i cili është konstituiv për vetë identitetin e shtetasit: "Citizenship is an answer to the question 'Who am I' and 'What should I do?' when posed in the public sphere."²³ Përkatesia ndaj ndonjë bashkësie politike themelon detyrë të veçanta prapa të cilave ndodhet identifikimi atdhetdashës. Ky lloj i lojalitetit e kapërcen kuptimin e të vlejturit të drejtave juridike ndërmjetësuese institucionale: "Each member recognizes a loyalty to the community expressed in a willingness to sacrifice personal gain to advance its interests"²⁴. Dyshimi përkundrejt shqyrtimit të theksuar moral e juridik të problemit bazohet në atë konceptcion komunitarist të shtetasit që tashmë e njohim. Ky konceptcion megjithatë nuk është i përshtatshëm për mardhëniet që mbretërojnë në shoqëritë komplekse, por ai megjithatë thekson një komponentë etika e cila nuk guxon të harrohet. Edhe shteti modern paraqet formë politike të të ekzistuarit e cila nuk shkrihet në formën abstrakte të ndonjë institucionalizimi të prin-

cipeve të përgjithshme juridike. Mënyra e të jetuarit krijon kontekst politik-kulturor në të cilin duhet të implementohen bazat universaliste të qëndrimeve të kushtetutës, sepse vetëm ajo popullatë që është *mësuar* me lirinë mund t'i mbajë në jetë institucionel liridashës. Për këtë shkak M. Walzer konsideron se e drejta migruese kufirin e vet e gjen në të drejtat e ndonjë bashkësie politike që ta ruajë integritetin e mënyrës së vet të të jetuarit. Sipas të të kuptuarit të tij e drejta e shtetasit për vetëpërcaktim në vetëvete përfshinë edhe vetëverifikimin e mënyrës përkatese vetiake të të jetuarit.

(e) Megjithkëtë ky argument lejon dy interpretime të kundërta: në suaza të interpretimit komunitarist ky argument do të duhej që të drejtën liberale për migrim t'ia impononte kufizimet normative plotësuese. Kështu kufizimeve funksionale që dalin nga kushtet repredukuese të sistemit administrativ dhe ekonomik u bashkohen kufizimet që sigurojnë substancialitetin etnik-kulturor të mënyrës përkatese të të jetuarit. Me këtë ky argument fiton domethënie *partikulariste* në pajtim me të cilin shtetësia në të vërtetë nuk është e ngatërruar me identitetin nacional, por ajo është e ndërthurur me karakteristika të caktuara historike të identitetit kulturor. Kështu H.R. van Gunstern krejtësisht në frymën e H. Arend-it formulon kushtin vijues të ndarjes së shtetësisë në ndonjë bashkësi demokratike: "The prospective citizen must be capable and willing to be a member of this particular historical community, its past and future, its forms of life and institutions within which its members think and act. In a community that values autonomy and judgement of its members, this is obviously not a requirement of pure conformity. But it is a requirement of knowledge of the language and the culture and acknowledgement of those institutions that foster the reproduction of citizens who are capable of autonomous and responsible judgement."²⁶

Megjithatë, kompetencat e kërkuara që "si qytetar i kësaj bashkësie të veçantë politike (this particular polity) vepron", duhet të kuptohet në mënyrë krejtësisht tjetër, në të vërtetë në kuptimin universalist, dhe atë menjëherë kur vetë bashkësia politike implementon qëndrimet themelore universale të kushtetutës. Identiteti i bashkësisë politike, në të cilin nuk guxon të preket as me migrimin, para së gjithash varet nga principet juridike që janë themeluar në kulturën politike, e jo në ndonjë mënyrë të veçantë etnike-kulturore të të jetuarit përgjithësisht. Për këtë shkak, nga shtetasit e rinj duhet të pritët që t'i pranojnë kulturat politike të atdheut të tyre të ri, por krahas kësaj nuk s'është e thënë ta ta lëshojnë formën kulturore të të jetuarit të

vendit prej nga rrjedhin. *Akulturimi politik* i kërkuar nuk përfshinë tërësinë e socializmit të tyre. Për më tepër me mënyrën e re të importuar të të jetuarit migrantët mund t'i zgjeronë ose së paku t'i shumëfishojnë ato perspektiva, në baza të cilave në të vërtetë, rendi i ri politik duhet të interpretohet: "People live in communities with bond and bounds, but these may be of different kind. In a liberal society, the bond and bounds should be compatible with liberal principles. Open immigration would change the character of the community, but it would not leave the community without any character."²⁷

Në bazë të diskutimeve që i përcollëm prej pikës (a) deri te pika (e), gradualisht është formuar rezultati normativ, në të vërtetë, që shtetet evropiane do të duhej të pajtoheshin me politikën liberale migruese. Ato nuk do të guxonin të mbylleshin prapa mirëqenies shoveniste përkundrejt vërshimit të migrantëve dhe azilantëve. Gjithsesi që e drejta demokratike për vetëpërcaktim kyç edhe të drejtat për ruajtjen e kulturës së vet politike, e cila paraqet kontekstin konkret të të drejtave të shtetasit, po kjo e drejtë demokratike nuk e përfshinë edhe të drejtën për vetëverifikim të mënyrës kulturore të privilegjuar të të jetuarit. Në suaza të kushtetutës së ndonjë shteti juridik demokratik, mënyrat e shumëllojshme të të jetuarit mund të koegzistojnë njësoj.

Më në fund, vetëm ajo shtetësi demokratike e cila nuk mbyllet në mënyrë partikulare mund të rregullojë rrugën drejt statusit të *qytetarit botëror*, i cili qysh sot e fiton famën e vet në komunikimin politik në tërë botën. Lufta në Vietnam, ndërrimet revolucionare në Evropën Lindore dhe të Mesme, si dhe lufta në Gjirin Persik paraqesin para së gjithash *ngjarje politike* botërore në kuptimin strikt të këtij nocioni. Këto ngjarje megjithatë opinionit ubikvitet njëkohësisht i janë prezentuar me anë të medimeve masive elektronike. Kështu sa i përket revolucionit francez, Kanti bazohej në reagimet e opinionit pjesëmarrës. Në atë kohë ai diferencoi fenomenin e opinionit botëror, i cili vetëm tash në suaza të komunikimit qytetar-botëror të lidhjeve - bëhet realitet politik. Madje edhe superfuqitë botërore duhet të llogarisin në protestat që do të mund t'i përfshinin pjesë të mëdha të botës. Fundi i fundit, opoletniteti i gjendjes natyrore që ende vazhdon midis shteteve belicistike që tashmë e kanë humbur sovranitetin e vet, porsa ka filluar. Gjendja e qytetarisë botërore nuk paraqet më kurrfarë fantomi të thjeshtë, edhe pse ende jemi larg tij. Shtetësia dhe qytetaria botërore paraqesin kontinuitetin i cili megjithatë duket në gjurmët e veta.

(Për. nga serbok. R.M.SH.)

1. I falenderohem Ingi Maus-it dhe Klaus Günther-it për këshillat kritike dhe cyjet.
2. P. Glotz, *Der Irrweg des Nationalstaates*, Stuttgart, 1990
3. Lidhur me sa vijon shih M.R. Lepsius, "Der europäische Nationalstaat" në: I njejt autor, *Ideen und Institutionen*, Opladen, 1990, f.256-258
4. Shih art. "Nation" në: *Historisches Wörterbuch der Philosophie*, 6.f. 406-414
5. M. R. Lepsius, "Ethnos und Demos", në: Lepsius (1990) f. 247-255
6. Lidhur me sa vijon R. Grawert, "Staatsangehörigkeit und Staatsbürgerschaft" *Der Staat*, 23 1984, f. 179-204
7. P.H. Schuck, R. M. Smith, *Citizenship without Consent*, New Have, 1985 kapit.1. Gjithsesi ndarja e kuptimit normativ të shtetësisë nga karakteristikat askriptive të burimit, nuk është aplikuar gjithkund me konsekuencë. Kështu për shembull në nenin 116 të kushtetutës paraqitet i ashtuquajti gjermani statutar, i cili sipas masës së pranimit të vërtetuar objektiv të përkatësisë ndaj bashkësisë kulturore, i takon popullit gjerman, mirëpo, s'është shtetas gjerman, ai në këtë mënyrë është i privilegjuar me rastin e migrimit, që sot, në të vërtetë, kundërshtohen varësisht nga politika e pikasur në kushtetutë.
8. R.Winzeler, *Die Politischen Rechte des Aktivbürgers nach schweizerischem Bundesrecht*, Bern, 1983
9. K. Hesse, *Grundzüge des Verfassungsrechts*, Heidelberg, 1990, f.113: (të drejtat themelore të individit) si të drejta subjektive përcaktojnë dhe garantojnë gjendjen e individit në themelet e saj, si elementet (objektive) themelore të rendit juridik-shtetror dhe demokratik, ato e vendosin në këtë rregullim, i cili megjithatë nga ana e vet mund të bëhet real vetëm me anën e aktualizimit të atyre të drejtave. Statusi kushtetutur-juridik i individit, i cili është themeluar dhe huazuar me anë të të drejtave të tij themelore, të shënuara në kushtetutë, paraqet statusin juridik material, do të thotë të statusit konkret të përmbajtjes së caktuar, me të cilin as individit dhe as pushteti shtetëror, nuk mund të disponojnë përfundësisht. Ky status kushtetutur-juridik krijon bërthamën e statusit të përgjithshëm të shtetasit, i cili është përcaktuar si me të drejtat themelore të individit... po aq me ligjet.
10. R. Grawert, "Staatsolk und Staatsangehörigkeit", në: *Handbuch des Staatsrechts*, bot. J. Isensee dhe P. Kirchhof, Heidelberg, 1987, f. 684-686
11. Ch. Taylor, "The Liberal-Communitarian Debate", në: N. Rosenblum (bot) *Liberalism and the Moral Life*, Cambr. Mass. 1989 st. 178-179
12. Taylor - 1989, f. 178.
13. P. Kiehlmannsegg, "Ohne historisches Vorbild" (FAZ 07 dhjetor 1990)
14. M. R. Lepsius, "Die Europäische Gemeinschaft" artik. i shkruar me rastin e 20 ditëve të sociologëve gjermanë, Frankfurt am Main, 1990
15. T. H. Marshall, *Citizenship and Social Class*, Cambridge, 1950
16. J. Habermas, "Volkssouveränität als Verfahren" në: i njejt. aut., *Die Moderne e-ein unvollendetes Projekt*, Leipzig, 1990, f. 180-182
17. B. S. Turner, *Citizenship and Capitalism*, London, 1986
18. EuGRZ, 1990, f. 443
19. R. Goodin, "What is so special about our Fellow Countrymen?" *Ethics*, 98, 1988, f. 663-689
21. H. Shue, "Mediating Duties", *Ethics* 98, 1988, f. 687-704
22. J. H. Carens, "Aliens and Citizens: The Case for Open Borders", *Rev. of Politics*, 49, 1987, f. 258
23. H. R. Van Gunsteren, "Admission to Citizenship", *Ethics*, 98, 1988, f. 752
24. D. Miller, "The Ethical Significance of Nationality", *Ethics*, 98, 1988, f. 648
25. M. Walzer, *Spheres of Justice*, N. Y. 1983, f. 31-63
26. Van Gunsteren (1988) f. 736
27. Carens (1987), f. 271



REXHEP ISMAJLI
REXHEP ISMAJLI
REXHEP ISMAJLI
REXHEP ISMAJLI
REXHEP ISMAJLI
REXHEP ISMAJLI

SHQIPTARËT DHE EVROPA JUGLINDORE

aspekte të identitetit

Shqyrtimi ngushtësisht logjisti i çështjes së identitetit do të na shpinte shumë larg dhe mbase edhe të na bënte të heqim dorë të flasim për të lidhur me temën e parashtruar. Edhe *shqiptarët*, edhe *Evropa Juglindore* janë koncepte relative dhe të gjera, lidhen me realitete të ndryshme hapësinore, historike, sociale, psikologjike dhe me gjykime vlerësie, prandaj edhe të ndryshueshme. Më në fund, derisa termi i parë është i rendit etnik, i dyti mund të interpretohet dysishëm: si i rendit etnik dhe si i rendit thjesht gjeografik.

Bertrand Russell, duke u përpjekur të thoshte diçka lidhur me identitetin e në raport me etnicitetin përfundon: "Si do ta përkufizoja frëngun? Mund ta përkufizojmë si dikend që i ka të gjitha tiparet të cilat i ka shumica e frëngjve. Por dhe po të provojmë që të gjitha tiparet t'i kufizojmë vetëm në ato që me asgjë nuk shpiten të gjithpërfshirja e tipareve, jemi të detyruar të pranojmë se shumica e frëngjve në këtë kuptim nuk është tipike. Ky përkufizim, për rrjedhojë, nënkupton se tipar qenësor i frëngut tipik është se ai nuk është tipik.

Kjo nuk është kundërti logjike, sepse assesi nuk është e domosdoshme të ekzistojë frëngu tipik..."

Devreux, duke mos e parë identitetin etnik si përgjithësim induktiv mbi bazë të dhënash, as si gjedhe ideale, po si mjet veçimi, etiketimi, nxjerr përfundimin se identiteti etnik del vetëm në konfrontim me të tjerët, për dallim nga të tjerët, pra mund të përkufizohet negativisht. Sepse sipas tij, identiteti etnik nuk ka të bëjë me aftësinë, predispozitën për të qenë i tillë, po thjesht është një pasojë pasive; individ bëhet, hynë në, e nxë personalitetin, identitetin e caktuar etnik. Kemi të bëjmë pra me një diçka si etiketim që duhet të vlejë për të gjithë. Natyrisht se këtu nuk kemi të bëjmë as me qëndrimin autoetnografik, as me çështjen e deklarimit, po me një varg kompleks rrethanash dhe faktorësh të parë jashtë gjykimeve të vlerësive.

Meqenëse së paku për një pjesë kemi të bëjmë me madhësi të rendit të etiketimeve, meqenëse këto etiketime në hapësirë, në kohë dhe në bashkësi sociale mund të priten ndër vete me etiketime të tjera

(shqiptar në perandorinë otomane, shqiptar në Jugosllavi, shqiptar në Shqipëri; indoevropian, ilir, arbër, shqiptar; arbër, arbëresh, shqiptar i Shqipërisë, kosovar etj.), këtu do të mjaftohemi që me *shqiptar* ta kuptojmë grupin etnik që për gjuhë amtare ka shqipen.

Kontekstin për vendosjen e çështjes shqiptare do ta quaj *Evropë Juglindore*, jo vetëm për shkak të zhvendosjes së theksit nga togfjalëshi "fuqi baroti", i pashmangshëm kur bëhet fjalë për Ballkanin dhe implikimet e tij aktuale, po edhe nga aspekti i këmbënguljes në elementin *Evropë*, për shkak të implikimeve të ndryshme për këtë kontinent me të gjitha synimet dhe projektimet e mundshme, për të shquar më në fund në përmasat e nevojshme ashpërsinë e çështjes në momentin kur kjo Evropë po mëton bashkimin, duke përfshirë edhe Greqinë si një prej shteteve të Juglindjes së saj.

Termin *Ballkan* dua ta evitoj edhe për disa arsye: gjeografikisht nuk është më i saktë se "Evropa Juglindore"; nga aspekti i shteteve që do të hynin në një tërësi të tillë është njësoj fluktuant, sidomos tani që po ndryshon shpejt harta shtetërore; nga aspekti i referencave socio-etnologjike poashtu jo shumë i qartë; ndërsa nga aspekti i projekteve ideologjike krejtësisht mjegullues : në vazhden e evropocentrizmit të shekullit të kaluar dhe të fillimit të këtij shekulli, "Ballkani" u përcaktua si hapësirë identitetesh të paqarta, si hapësirë mbi të cilën duan aplikuar kritere krejtësisht të veçanta, të cilat do të duhej të markonin qartësisht dallimin midis asaj që quhet Evropë dhe pjesës tjetër të padenjë për këtë emër. Të duket sikur këtu fshihet tendenca për përligjjen e qëndrimeve tashmë të kaluara ndaj hapësirave të konsideruara "të pacivilizuara", por të cilat "duan prurë në progres, kultivuar dhe rentabilizuar".

Qëndrime të këtilla ndaj tjetrit dhe tjetërsisë më duket se kanë bërë të mundur të hapej rruga e shpërnjohjes së identiteteve bartëse të subjektësisë politike mbrenda kësaj hapësire, me të cilat në fakt do të duheshin ndërtuar raporte jo vetëm përmbrenda, po edhe në kuadrin e gjerë evropian.

Pikërisht imponimi i raporteve në bazë të injorimeve të tilla të mbështetura madje shtjellimisht në interesat e fuqive të atëherëshme në aspektin politik, strategjik dhe ndëretnik në "Ballkan" ka qenë jo më shumë se mbyllje sysh para realiteteve dhe perpetuim i problemeve që kanë lindur pas rrënimit të perandorive të mëdha të Austro-Hungarisë dhe të Turqisë.

Në fillim të shekullit po ndodhte një proces shkolonizimi, ndërsa rindarjet arbitrare jo vetëm që nuk sollën zgjidhje me perspektivë stabilizimi, po e komplikuan edhe më tej situatën. Për shqiptarët sidomos, raporti i vjetër kolonial u zëvendësua me një raport të ri kolonial në mbi gjysmën e hapësirës etnike.

Posaçërisht jofatlume që krijimi i shtetit të Jugosllavisë - shtet i sllavëve të jugut, vështirë të asimilueshëm midis tyre. Madje as të gjithë *sllavët e jugut* nuk u përfshinë në të, dhe as vetëm sllavët e jugut hynë në të (jashtë mbetën bullgarët, mbrenda hynë shqiptarët pa përligjjen e identitetit të tyre).

I ndërtuar sipas gjedhes së shtetit-komb, ky shtet i "sllavëve" nuk arriti as të impononte serbët si bartës të identitetit jugosllavist, ideologji e krijuar nga kroatët, as të çlirohej nga pretendimi për të asimiluar dhe zhdukur shqiptarët. I projektuar si shtet-komb, përmes emërimit të tillë ai vetëm sa uzurpoi të drejtën mbi domenin ku shtriheshin popuj të tjerë dhe i ashpërsoi edhe më shumë kontradiktat midis popujve.

Kontradikta midis konceptit të shtetit të qëndrësuar nacional të mbështetur në kategorinë identitare hipernacionale të jugosllavizmit dhe realitetit shumënacional nuk kish si të përfundonte pos me ashpërsimin e mëtejshëm të marrëdhënieve. Derisa realiteti shumënacional mund të ishte pretekst për t'i mbajtur shqiptarët në këtë shtet, identiteti i tij hipernacional separat sllav i vinte ata në pozitë të trupit të huaj.

Midis dy luftimeve botërore ky shtet arriti vetëm deri aty sa ta meritonte epitetin "burg i popujve". Pas Luftës II, ndarja në blloqe, shkaktar i luftës së ftohtë, me ngritjen e luftës për pushtet në rrafshin e qëllimit kryesor, sado që të maskuara, konfliktet vetëm sa u thellaun, deri në shak-

llën madje që edhe ata që përfshiheshin në identitetin jugosllav *për definitionem* të merrnin distancat e nevojshme ndaj tij. Kështu, pa gjetur zgjidhje për fatet e "popujve sllavë", ky shtet i bëri shqiptarët viktimë të përhershme të konceptioneve pushtuese të serbëve, nga të cilat nuk ishin të kursyer as të tjerët.

Le të kthehemi te elementet që mund të saktësojnë identitetin.

2. Një nga popujt më të lashtë të tërë Evropës, banorë të të njëjtave vise të Juglindjes së saj qysh nga Antikiteti i hershëm, shqiptarët përbëjnë gjithashtu një nga origjinalitetet e kësaj Evrope. Pasardhës të ilirëve, ata përbëjnë një degë në vete të popujve indoevropianë, mu si grekët dhe armenasit.

Ndryshe nga romanët, gjermanikët, sllavët, që, në procesin e tyre etnolitik të transformimit në italianë, spanjollë, gjermanë, danezë, serbë, rusë apo maqedonas, kanë pasur nevojë të emancipoheshin nga ideologjitë *pan*, si panromanizëm, pangjermanizëm, pansllavizëm (jugosllavizmi del vetëm një variant i degraduar i tij), shqiptarët kanë pasur një proces etnolitik njëherësh më kompleks - për shkak të sundimeve të perandorive të mëdha në trojet e tyre, më të kundërthënshëm - për shkak të prerjes së kulturave perëndimore e lindore në vetë trupin e tyre etnik, dhe më të qartë qoftë me veçantinë ekstreme të gjuhës së tyre, qoftë me origjinalitetin e receptimit të ndajshtrësive kulturore të ardhura nga jashtë.

Një gjuhë e njëjtë, në të cilën pasqyrohen në mënyrë të saktë cilësia, intensiteti dhe koha e ndikimeve të rëndësishme mesdhetare paraindovropiane, greke - të lashta, bizantine dhe të reja, latine të kohëve klasike e më vonë, romane - italiane, dalmate, rumune, frënge dhe spanjollë, sllave të vjetra e pastaj bullgare e serbe, turke dhe orientale; një kulturë e ndryshme nga fqinjët; tri konfesionet e shumë sekte, që domethënë një tolerancë e lartë fetare; një histori plot rezistencë, që ua bëri të mundshme mbijetesën; përvoja të përkohshme dhe parciale të një shteti të veçantë; një diasporë shumë e përhapur në kohë dhe në hapësirë; një kulturë, në të


cilën bashkëjetojnë shtresa autoktone iliro-ballkanike me elementet e adstratit nga Lindja dhe Perëndimi; një kulturë popullore shumë e lashtë e përkrahur nga krishtërimi që nga fillimet dhe një tenacitet individualist, i shquajnë shqiptarët nga rrethi i tyre i pandërmjetshëm, por në të njëjtën kohë i afrojnë me Jugun e Evropës dhe sidomos me Basenin Mesdhetar.

Izolimi i Shqipërisë komunsite i 5 de-cenieve të fundit, në një anë, dhe izolimi kolonialisht sllav dhe komunist njëherësh i shqiptarëve të ish-Jugosllavisë, nga ana tjetër, kanë rrezikuar ta pengonin këtë popull të vogël qysh në qenien e tij dhe prej fillimeve evropiane dhe mesdhetar të merrte pjesë sipas potencialeve të tij në proceset e mëdha të kontinentit në këtë shekull. Dhe kjo do të ishte e kundërta e tendencave thelbësisht perëndimore që shpërthyen me shumë herë në historinë e këtij populli, sidomos në kohën e Skënderbeut dhe më vonë në kohën e Lëvizjes Kombëtare të Rilindjes.

Për atë që i njeh rrethanat e emancipimit të Stambollit nga integrizmi islamik dhe të kyçjes së Turqisë moderne në rrjedhat evropiane, që e njeh kontributin thelbësor të shqiptarëve në këtë proces - faktin se ata kanë luajtur një rol me rëndësi të madhe në rrjedhat kulturore evropiane atje, degradimi i shqiptarëve përmes largimit të imponuar nga Evropa në këtë shekull mund të jetë vetëm i vajtueshëm. Megjithatë, në jetën e tij shpirtërore ky popull ka ditur të gjejë rrugë për ta marginalizuar këtë largim duke e markuar qartë si të huaj, politik, të imponuar dhe aksidental.

3. Para se t'i saktësojmë arsyet e këtij degradimi, do të duhej ta përcaktonim hapësirën e vërtetë të Evropës Juglindore, përkatësisht ballkanike, të shqiptarëve. Siç e ka shënuar me saktësi para sa vitesh gjeografi frëng Michel Roux, Shqipëria aktuale, trojet etnike kompakte shqiptare të ish-Jugosllavisë dhe Çamëria paraqesin hapësirën e identitetit etnik dhe kombëtar të shqiptarëve në aspektin historik e aktual. Kjo është pikërisht hapësira e historisë së tyre mbi dymijëvjeçare, e kulturës, e infrastrukturës, e tërë strukturës sociale, e qendrave urbane, e komu-

Drejtimet kryesore të komunikimeve dhe hapësira e integrimi shqiptare, Islami&Ismajli



- xxxxxx Kufiri i pakalueshëm në sh.20
 oooo Kufiri që po bëhet i pakalueshëm, 1993
 ◄► Drejtimet e komunikimeve historikisht të rëndësishme
 — Lidhjet midis qyteteve
 - - - Kufiri i Kosovës ndaj Serbisë e Malit të Zi
 Zona e integrimi shqiptare në sh.19

nikimeve, e lufrave për çlirim dhe e raporteve të shumanshme ndaj popujve fqinj.

Lëvizja më e madhe kombëtare shqiptare, ajo e Rilindjes, pat arritur kulmin me Lidhjen e Prizrenit, qëllimi i së cilës ishte çlirimi nga robëria osmane dhe krijimi i shtetit kombëtar në hapësirat e tij etnike. Kjo Lidhje, e organizuar në të gjitha rrafshet dhe në tërësinë e hapësirës së përmendur, shquante orientimin e vet të qartë perëndimor dhe laik. Me sloganin "feja e shqypetarit është shqypetarija", Lidhja kish arritur të ngrinte në këmbë tërë popullin në një luftë të përhershme për çlirim nga Turqia prej vitit 1878 e deri më 1912. Në tërësinë e kësaj hapësire, me orientimin e vet perëndimor, kjo lëvizje ka qenë dhe vazhdon të jetë pikë kruciale për definimin e mëtejme të identitetit dhe për zhvillimet e ardhme të kombit.

Adriatiku Verior, Italia, i gjithë Baseni Mesdhetar, Atika dhe ujdhesat greke, Bizanti/Stambolli, paraqesin hapësirën e shpërnguljeve të gjera të shqiptarëve nëpër shekuj, rezultat i të cilave është krijimi i një diaspore historike gjithnjë të gjallë : në Itali të Jugut, në Greqi, në Turqi, në Siri, në Egjipt, etj. Kjo diasporë ndryshon sipas kohës së migrimit, sipas shkakut të migrimit, sipas orientimit vleror që i ka prirë dhe sipas fatit përfundimtar. Për shembull, arbëreshët e Italisë kanë mërguar për të mos e pranuar okupimin turk (fjala është për gati një të tretën e popullatës), ndërsa shpërngulja në Turqi në fund të sh. XIX dhe në sh. XX u bë me detyrim nga shteti jugosllav që pretendonte të dealibanizonte trojet e pushtuara pas lufrave ballkanike. Për pasojë, ekziston një ndryshim i madh në sjelljen e këtyre dy diasporeve : e para ka arritur ta ruajë identitetin edhe pas pesë shekujsh, ndërsa e dyta shumë shpejt iu shtrua procesit të asimilimit. Natyrisht, rolin e vet këtu e kanë luajtur edhe faktorë të tjerë, si feja, statusi social, në kohën e ikjes, apo natyra dhe raportet socio-politike në mesin e arritjes.

Me Rilindjen kombëtare dhe me kthimin përfundimtar drejt Perëndimit, u krijua një tjetër hapësirë shumë e rëndësishme e shpërnguljeve shqiptare - hapësira e veprimtarive ekonomike në Evropën

Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara. Kjo diasporë karakterizohet me ruajtjen e lidhjeve me hapësirën e identitetit kombëtar dhe prandaj ajo aty luan një rol parësor jo vetëm në jetën ekonomike, po edhe në rrafshin social, politik, kulturor.

4. E tërë Evropa Juglindore paraqet një hapësirë gati të natyrshme për shqiptarët, edhe jashtë kufijve të identitetit etnik, qoftë për shkak se ishte fare e njohur dhe e arritshme gjatë pesë shekujve të sundimit otoman, qoftë për shkak se, pas krijimit të shteteve të reja, jashtë Shqipërisë mbeti më shumë se gjysma e shqiptarëve.

Pikërisht për shkak të fatit të popullit shqiptar në sh. XX situata në "Ballkan" bëhet jashtëzakonisht e komplikuar: shtetet kombëtare të sllavëve të jugut dhe ai grek, duke pasë okupuar terriore shqiptare, duhej të merrnin mbi vete edhe problemet e kësaj popullate, që domethënë se edhe raportet ndaj shtetit shqiptar t'i rregullonin sipas kërkesave të saj.

Greqia reagoi me mjete krejtësisht represive, duke i detyruar shqiptarët myslimanë të shpërnguleshin në Turqi dhe në Shqipëri nga njëra anë, dhe duke asimiluar ortodoksët, nga tjetra. Në këtë mënyrë ajo arriti të krijonte një prerje totale midis shqiptarëve të shtetit kombëtar dhe atyre të diasporës në Atikë dhe në ujdhesa, duke reduktuar kështu në pamundësi jo vetëm organizimin si entitet i veçantë, po edhe mbijetesën në kuadër të atij identiteti. Kjo prerje pati për pasojë fundin e rrugëve shekullore të veprimtarive ekonomike e tregtare për regionet e afërta, varfërimin dhe riorientimin e detyrueshëm të qendrave urbane, ashtu si edhe të aktiviteteve ekonomike të popullit. Për më tepër, për shkak të tragjediave nga ndarjet e familjeve, ka pasur frustrim enorm.

Të gjitha këto e ushqyen edhe më shumë ksenofobizmin në Greqi dhe shtuan vështirësi të reja në procesin e demokratizimit të këtij shteti dhe në të njëjtën kohë shtuan pakënaqësinë e shqiptarëve. Ekzistenca e një minoriteti grek në Shqipërinë e Jugut e komplikon edhe më shumë situatën në të dy anët.

5. Me dimensionet e saj, me territorin, me historinë dhe me peshën e përgjithshme,

popullsia shqiptare e mbetur në kufijt e ish-Jugosllavisë, në fakt paraqet problemin më të madh jo vetëm për shqiptarët, por edhe për Ballkanin. Me rreth tre milionë banorë, gjysma e popullit shqiptar, duke pasë qenë një nga epiqendrat e lëvizjes për çlirim, me potencialet e veta ekonomike, kulturore, sociale, demografike maksimalisht të funksionalizueshme vetëm në vazhdimësinë normale të hapësirës së identitetit etnik, ajo paraqet një barrë shumë të madhe për secilin prej shteteve të Evropës Juglindore që do të donte ta asimilonte/ta integronte duke i ofruar kompensim për ato që i humbet me ndarje.

Jugosllavia e Versajës, krijimi i së cilës po dëshmohej të ketë qenë gabim, pat provuar ta zgjidhte këtë problem përmes represionit që arrinte përmasat e gjenocidit.

Gjatë Luftës së Dytë, ashtu si edhe maqedonasit, të cilët nuk njiheshin si komb nga shteti serbo-kroato-sloven, shqiptarët e kishin konstituuar Kosovën si njësi politiko-territoriale të veçantë nga Serbia. Pas gjendjes ushtarake të vendosur nga Jugosllavia më 1945 që gjetur një "zgjidhje", sipas së

cilës, duke u nisur nga vullneti politik i deklaruar i Kosovës, sado që i nxjerrë me detyrim, Kosova mbetej në Jugosllavinë federative në kuadër të Serbisë federale.

Pas kësaj fillon vargu i masave represive në të gjitha fushat e jetës, duke përfshirë edhe shpërnguljet e detyrueshme për në Turqi të mbi 400.000 shqiptarëve.

Pas vitit 1966 fillon periudha e një zhvillimi më të çlirshëm nacional, kulturor e tjetër të shqiptarëve në Jugosllavi. Këtë shans shqiptarët e shfrytëzuan për një integrim më të madh mbrenda vetë Kosovës dhe përreth saj, duke e bërë atë në njëfarë mënyrë bartëse të veprimtarisë dhe të identitetit shqiptar mbrenda federatës shumëk-

ombëshe dhe duke i dhënë kështu kësaj popullate mundësinë që përmes federatës të hynte në marrëdhëniet ndërkombëtare, pra edhe në ato me shtetin shqiptar, duke e nxjerrë kështu lakuriq absurdin e ndarjes së një populli. Kushtetuta e vitit 1974, duke sanksionuar gjendjen e raporteve politike të krijuara ndërkohë, e përkufizonte Kosovën, Krahinë Autonome Socialiste, si një prej tetë njësive bashkëthemeluese të federatës me të gjitha instancat e veta shtetërore të pavarura nga Serbia.

Shteti federativ jugosllav, i nyjtuar në tetë njësi pat provuar të gjente zgjidhje për t'i mbajtur shqiptarët gjithë duke marrë mbi vete barrën e eksponimit edhe të interesave

të tyre dhe duke u ofruar pjesërisht njëfarë kompensimi për humbjen e shkaktuar nga ndarja. Por, meqenëse hegjemonizmi serb kish pushuar së vepëruar asnjëherë, situata u komplikua me interesat e popujve të tjerë sllavë të jugut, nga një anë, dhe me sistemin komunist të dirigjuar nga Beogradi, nga tjetra. Për t'i kënaqur dëshirat e Beogradit, njësitë e tjera të federatës ishin të gatshme ta ndihmonin atë në rregullimin e hesapeve me shqiptarët.

Kjo ambivalencë në raportet e ndërsjella ishte gabimi më i madh.

Këtu shtrohet një problem i dyfishtë : raportet e shqiptarëve me serbët, maqedonasit e malaziasit, nga një anë, dhe raportet me popujt e tjerë sllavë, nga tjetra. Emancipimi i popujve të veçantë sllavë nga identiteti hipernacional jugosllavist (në aspektin ideologjik, procesi i distancimit nga hegjemonizmi serb) shënonte fillimin e procesit të shpërbërjes së shtetit të krijuar mbi një identitet theksimisht ideologjik, pa mbështetje në raportet sociale, etnike e të tjera, dhe në thelb lakuriq imperialiste, por gjithashtu nxirte në dritë të plotë gabimin e bërë ndaj shqiptarëve. Slovenët, kroatët, boshnjakët, duhej të ngarkoheshin me



problemet e shqiptarëve në dy rrafshë : në rrafshin federal, drejtpërsëdrejti, dhe në rrafshin e raporteve me serbët, ndërmjetshëm. Shqiptarët, nga ana tjetër, përveç problemeve lidhur me popujt pandërmjetshëm fqinj, duhej të merreshin edhe me problemet e raporteve midis popujve sllavë. Për më tepër, koalicioni jugosllav ua kish bërë të mundshme maqedonasve dhe malaziasve t'i zgjeronte shtetet e tyre në dëm të shqiptarëve, përkatësisht t'i ndanin ata sërish dhe të krijonin tensione të reja në kuadër të shteteve të Maqedonisë, të Serbisë dhe të Malit të Zi. Në vend se të shumëfishohen problemet me tragjedi të reja që dalin nga çintegrimi i ri i shqiptarëve, është më mirë të kërkohen zgjidhje konsistente dhe kështu të ndihmohen edhe të tjerët për t'u përqëndruar në problemet e veta.

6. Të kthehemi tani te një aspekt tjetër i çështjes. Ndarja e shqiptarëve me kufirin më të pakalueshëm në Evropë nuk ka qenë vetëm shkak i tragjedive të panumërta personale e familjare, por ajo ka qenë gjithashtu shkak themelor i degradimit të këtij populli shtatëmillionësh.

Me lëvizjen kombëtare të sh. XIX konstitui i kombit shqiptar u bë në tërësinë e territorit të tij etnik dhe mbi bazë të identitetit kompleks etnik të ndryshëm nga fqinjët. Kjo tërësi nuk ishte vetëm çështje e vullnetit dhe e dëshirës, po në radhë të parë hapësirë në të cilën ishin zhvilluar procese të gjata transformimesh historiko-sociale dhe etniko-kombëtare sipas potencialeve vetanake ekonomike, kulturore, politike e të tjera, në raport me rrethin e pandërmjetshëm dhe me kuadrin më të gjerë evropiano-mesdhetar. Ajo ishte, pra, rezultati i këtyre zhvillimeve shekullore, ndërsa ndryshimi që iu imponua patjetër do të impononte zhvillime të dhunshme, të cilat çënojnë drejtpërsëdrejti identitetin etnik.

Për ta ilustruar këtë po marr vetëm një shembull. Rrugët e komunikimit nga Durrësi, Shkodra e Vlora, përkatësisht nga Mesdheu e Adriatiku, drejt Athinës, Selanikut, Bizantit/Stambollit, Odesës, Sofjes, Naissit/Nishit, Ragusës/Rushës/Dubrovnikut, kalonin nëpër Janinë, Konicë, Korçë, Pogradec, Lichnid/Ohër, Herakle/Manastir, Dibër, Tetovë, Scupi/

Shkup, Theranda/Prizren, Gjakovë, Ulpi-ana/Prishtinë, Pejë, Plavë, Berzim-inium/Podgoricë, e Ulcinium/Ulqin. Këto qendra tradicionale urbane shërbenin si pikënisje për zhvillimet ekonomike të rretheve të tyre, por njëkohësisht edhe si lidhje të shqiptarëve ndaj Perëndimit e Lindjes. Ato ishin krijuar si rezultat i nevojave dhe mundësive hapësinore, ekonomike, demografike, e të tjera, të këtij populli me shekuj, por ishin krijuar pikërisht kështu në skaje të hapësirës etnike për shkak të komunikimeve me rrethin. Natyrisht, është kjo pozitë në kapërcyell botërash dhe komunikimesh elementi që është reflektuar edhe në identitetin kështu kompleks, prandaj jo ekskluzivist, shqiptar. Është e qartë se ndarjet e mëvona arbitrare nuk kishin mundësi të krijonin bazë të pranueshme për zëvendësim të këtij identiteti me ndonjë identitet të ri, sidomos jo nëse ai është për vete i paqartë dhe jokonsistent.

Kufiri i sanksionuar nga Traktati i Versajës e ndryshoi tërësisht funksionin e këtyre qendrave dhe i çrregulloi raportet ekonomiko-tregtare, hapësinore, sociale, politike, demografike dhe identitare në tërë hapësirën në të dy anët e kufirit. Duke ua hequr rolin që kishin luajtur në integrimet shqiptare, nga një anë, dhe atë të lidhjeve ndërkombëtare, nga tjetra, këto qendra u zbritën në qytete lokale me funksione fare të kufizuara. Kështu Manastiri, Struga, Dibra, Gostivari, Tetova, Shkupi, Prizreni, Gjakova, Peja, Ulqini, duke mbetur në anën jugosllave të kufirit, duke humbur prapavijën në Shqipëri dhe komunikimet e krijuara me shekuj, bien gradualisht në aspektin ekonomik, kulturor e demografik, ose nisin të humbasin tiparet e tyre kombëtare. Riorientimi i tyre nga lindja ose veriu maqedonas, serb, malazias, që i refuzonin sakohë që mbeteshin në cilësinë shqiptare, nuk mund të jepte sukses. Nga ana tjetër, e gjithë Shqipëria e Veriut, malore dhe e pasur me blegtori e minerale, mbetet pa qendra urbane e tregtare. Të njëjtin fat e pësuan qytetet tradicionalisht të rëndësishme të Shqipërisë si Shkodra e Korça, rrethi normal i të cilave mbeti përtej kufirit të pakalueshëm. Reperkusionet e këtij degjenerimi dhe riorientimi të qyteteve dhe jo vetëm të tyre, ndjehen gjithashtu në

zvogëlimin e rolit të porteve të Durrësit e të Vlorës dhe në izolimin përfundimtar të Shqipërisë. Kjo do të thotë se ato reпреkusione ndjehen drejtpërsëdrejti në disfunktionimin e një hapësire që kish krijuar identitetin e vet pikërisht përmes këtyre komunikimeve, prandaj edhe në disfunktionimin e Ballkanit si pjesë e Evropës dhe në theksimin e mëtejme të vatrës së tij serioze të krizës potenciale. Zëvendësimi i përkohshëm përmes transversales Lubjanë-Zagreb-Beograd-Shkup-Selanik pas krijimit të Jugosllavisë i kishte marrë parasysh vetëm pjesërisht interesat globale, e kish orientuar komunikimin vetëm drejt Lindjes, përkatësisht nga Veriu. Një pjesë kyçe e Jugut të Evropës Juglindore ishte përjashtuar nga ky komunikim, e me këtë edhe Perëndimi i Evropës Jugore. Me krijimin e tri kufijve të rinj aspak lehtësues për komunikim dhe me situatën e luftës, kjo transversale u bë krejtësisht e bllokuar, e me këtë praktikisht e tërë Evropa Juglindore.

Në aspektin shpirtëror, politik e kulturor, populli shqiptar edhe ashtu ende me vështirësi të mëdha në ndërtimin e shoqërisë moderne, që dëmtuar edhe më shumë me këtë ndarje. Prej atëherë ai kurrë nuk ka arritur ta shfrytëzojë potencialin e vet njerëzor. Në fakt gjysma e këtij populli për 8 dekadat e fundit ka qenë vënë nën presionin e përhershëm të kërkimit të rrugëve për çlirim nga pozita koloniale dhe më shumë herë madje edhe të kërkimit të rrugës për të mbetur gjallë. Vetëm mund të merren me mend shkalla e frustrimit të kësaj popullate dhe rreziku që paraqet ai për zhvillimet e ardhshme sociale.

Nga ana tjetër, pikërisht edhe për këtë shkak, Shqipëria është bllokuar në rrugët e saj të zhvillimit normal sipas potencialeve të veta. Po jap një shembull. Zhvillimi i përgjithshëm drejt vlerave dhe demokracisë perëndimore i shënuar me Lëvizjen kombëtare të sh. XIX, i projektuar dhe i implementuar në tërësinë e hapësirës kombëtare dhe në sajë të funksionimit të saj si të tillë, pas krijimit të shtetit shqiptar, qoftë edhe ashtu të gjymtuar, pat nxitur ngjarje vërtet demokratike. Qysh më 1924 shqiptarët patën arritur të krijonin një lëvizje dhe një shtet demokratik, por ato nuk patën

mundësi të mbaheshin jo vetëm për shkak të problemeve të mbrendshme që duheshin zgjidhur në këtë kapërcim, po edhe për shkak të ndërhyrjes direkte të shtetit serbo-kroato-sllloven/Monarkisë Jugosllave. Shqipëria që bërë e varur nga Jugosllavia me vetë faktin se gjysma e popullit shqiptar ndodhej nën sundimin e këtij shteti. Fati i kësaj gjysme jo vetëm që ishte barrë e rëndë për zhvillimet e mëtejme të asaj demokracie të re në këtë shoqëri me shumë probleme moszhvillimi, por ai edhe përdorej drejtpërsëdrejti nga fqinjët me rrjedha dhe probleme të tjera zhvillimi për pengimin e saj.

Kështu e zvogëluar dhe e rrethuar me kufij të pakalueshëm, e ndarë dhe e izoluar nga funksioni i saj shekullor i lidhjes midis Perëndimit dhe Lindjes së Jugut Evropian e më gjerë, Shqipëria bëhet copë e vogël e arritjes përfundimtare, prandaj joatraktive dhe e pafuqishme për t'u kujdesur jo vetëm për fatin e gjysmës së mbetur jashtë, po as edhe për integrimet më radikale të domoshmë të vetëvetes. Izolimi dhe vetizolimi komunist vetëm ia zu frymën në mënyrë plotësuese kësaj krijese përgjysmë, në fakt ai ishte zhvillim konsequent i rrjedhave të logjikës së jashtme. Zhvillimi i jashtëzakonshëm i Evropës jomesdhetare dhe rrëgjimi i funksioneve ekonomike e tregëtare të Detit të Zi, humbja e pavarësisë së tij, thjesht e kishin favorizuar transversalen tjetër.

Me këtë është rrezikuar një aspekt i rëndësishëm i identitetit shqiptar.

7. As Shqipëria, as Serbia nuk kanë shansa për të ndërtuar shoqëri të vërtetë demokratike sakohë që të mos zgjidhet problemi i Kosovës dhe i shqiptarëve në ish-Jugosllavi. Absurdi po bëhet lakuriq fare pas krijimit të shteteve nacionale në trollin e federatës.

Natyrisht, gjithëçka komplikohet me implikimet e çështjes shqiptare në çështjen e maqedonasve dhe të shtetit gjysmë të njohur të Maqedonisë. Kjo do të thotë se çështja shqiptare e prek gati pandërmjetshëm Bullgarinë. Njëherësh kjo e nxjerr në shesh edhe më shumë absurdin e ndarjes së shqiptarëve : për të siguruar ekzistencën e shtetit të Maqedonisë duhet të krijohet



edhe një kufi i pakalueshëm midis shqiptarëve dhe të çintegrohet edhe ajo që ish integruar në një shkallë 50 vitet e fundit.

Pesha e Kosovës në kuadër të tërësisë së potencialeve ekonomike, strategjike e të tjera të shqiptarëve, zhvillimet kulturore dhe të vetëdijes, çështjet e identitetit, kontaktet dhe kushtëzimet e ndërsjella të lëvizjeve demokratike në të dy anët e kufirit, diaspora e rëndësishme në Evropë dhe në SHBA, kontaktet intensive shqiptaro-shqiptare poashtu përmes Evropës, që po mëton të bashkohet duke e ruajtur identitetin e popujve, çështjen e Kosovës e shtrojnë si imperativ të ekzistencës së kombit dhe si një nga çështjet kyçe për zhvillimet në Evropën Juglindore. Për shkencën që merret me raportet midis popujve, kulturave dhe gjuhëve të Evropës Juglindore, për ballkanologjinë, tashmë është thënë se do t'ishte një proçkë pa shqipen dhe raportin e saj : mund të thuhet analogjikisht se paqja në Evropën Juglindore do të mbetet vetëm ëndërr pa zgjidhjen e çështjes shqiptare.

8. Burimet më të rëndësishme të frustrimeve shqiptare nga të dy anët e kufirit kanë qenë dhe vazhdojnë të jenë kufijt e padrejtë dhe me këtë përpjekje për t'ua mohuar një identitet duke ua imponuar njëherësh tjetrin. Këta kufij ua kanë bërë të pamundshme t'i zhvillojnë potencialet e veta, në një anë, dhe i kanë involvuar në mënyrë të palejueshme shtetet poashtu të pazhvilluara të Evropës Juglindore në fatet

e këtij populli. Ky involvim arrin shkallën që kërcënon vetë ekzistencën e këtij populli. Duke qenë shtete eksponente të vetëm interesave të popujve të veçantë, duke qenë poashtu të paafta për çfarëdo integrimesh qytetare, ato janë bërë robër të apetiteve pushtuese, prandaj edhe energjitë e veta i derdhin në kërkim të rrugës për të mbajtur këtë gjendje përmes shtypjes së shqiptarëve, përkatësisht për të ruajtur domenet e pushtimit.

Megjithë shkallën e lartë të tolerancës ndaj tjetrit dhe tjetërsisë, të krijuar si nevojë të mbrendshme në saje të bashkëjetesës së më shumë konfesioneve dhe të hapjes ndaj kulturave të tjera dhe të ndryshme, përkundër fqinjve me identitet që mbështetet në përjashtimin e tjetërsisë - fetare, kulturore, etnike, shqiptarët nuk mund ta pranojnë më tej këtë ndarje, sepse kjo do të ishte vetëvrasje. Nëntëdhjetë vjet ndarjeje të tillë me të gjitha pasojat e gjenocidit në pjesën e kombit të mbetur jashtë shtetit shqiptar dhe të izolimit të imponuar kështu të Shqipërisë, të rrënimit sistematik të identitetit të një populli, janë kohë mjaft e gjatë përvojash tejet të idhëta për të dëshmuar se rruga e tillë e ndarjes nuk sjell suksese as për të tjerët përreth.

Dalja nga identiteti i krijuar me shekuj do ta prekte qenësishëm raportin ndaj etnikumeve përreth. Përmasat janë të atilla, sa edhe po të ishte e mundshme kjo, do të kërkonte nga identiteti që do të hynte në këto raporte poashtu ta ndryshojë natyrën

e vet. Në integritet të tjera, për shembull, në një Ballkan, kjo do të ishte e mundshme, por atëherë edhe serbët e maqedonasit do ta humbisnin pjesërisht identitetin e vet, poaq sa shqiptarët, dhe me kusht madje që të ndërtoheshin raporte të tilla demokratike të cilat do ta siguronin mundësinë e ruajtjes së plotë të identitetit të atyre që nuk do ta donin ndryshimin. Në horizont diçka e tillë nuk ekziston.

Është koha e fundit të mendohet seriozisht për një zgjidhje të re paqësore të fatit të këtij populli dhe me këtë të shumicës së burimeve të konfliktit në Evropën Juglindore. Hegjemonia e popujve 8-10 milionësh serb, grek apo bullgar mbi 7 milion shqiptarë as është e pranueshme as e mundshme. Tash që dështoi definitivisht hegjemonizmi pansllavist me të gjitha nusproduktet jugosllaviste, komuniste, etj., tash që Evropa Lindore dhe Baseni i Detit të Zi po i kthehen definitivisht rrugës së bashkëpunimit me Perëndimin, në të cilin bashkëpunim bota shqiptare e ka rolin dhe poz-

itën mijëra vjeçare të lidhjes, ka ardhur koha që shteti shqiptar, në përmasat e kombit eksponent i të cilit është, ta luajë rolin e vet të rëndësishëm në shndërrimin e Ballkanit nga "fuqia e barotit" në zonë të paqes e të bashkëpunimit, në çlirimin e Ballkanit nga lakmitë e vogla luftënxitëse, po edhe në integritet e vërteta evropiane. Me pozitën e tyre shqiptarët janë çelës jo pa rëndësi në dy drejtime të këtyre integriteteve : veri/jug i Ballkanit dhe Lindje/Perëndim i Evropës Jugore. Duke qenë më e qartë, çështja shqiptare është njëherësh më lehtë e zgjidhshme dhe me efekte më kuptimplote për proceset në Evropë.

Përgjegjësitë për vonesat, për paaftësinë mbrojtëse dhe për mungesat e tjera në ndërtimin e shoqërisë së integruar moderne, për aq përse kanë dorë vetë, duhet ti marrin shqiptarët. A do t'i marrë Evropa përgjegjësitë për imponimet e veta?

Shtator 1992

Rexhep Ismajli:

Albanians and South-Eastern Europe (Aspects of Identity)

Respecting the fact that ethnic identity is a question of classification, this issue is discussed on the ground of the parameters which might help the definition of the Albanian identity in South-Eastern Europe in contrast to the other ethnic identities. Rejecting "Balkan" as a high ideological denomination grounded on the projections of the powers from the beginning of the century, therefore one of the sources of quarrels and disputes during the yet unfinished process of decolonization of that part of Europe, in order to give an explanation on the actual possible conflicts, cultural, historic, religious, linguistic and geographic parameters have been precized. The space of ethnical identity and integrations, of the deliberated migrations, and the space of work, together with the value orientations, of the Albanians, are discussed.

By the arbitrary delimitation of the Albanian ethnic space at the beginning of the century with almost impassable borders, not only the communication be-

tween the two parts of the Albanian people has been cut off, but also the communication West-East in the whole Southern Europe. Cities and market centres created during centuries in order to facilitate this communication were left without their background, while the Albanian state isolated to a definite small end. On the other hand, the Albanian population remained in former Yugoslavia was put under impossible conditions of a Slavic national state.

Threats for dissolution of the many centuries built identity under those conditions, on the one hand, and the impossibility to take over the interests of the Albanian population remained under such a Slavic national state, on the other hand, hinder every real democratizing process of both Albania and Serbia/Yugoslavia.

Being one of the key identities of the South-Eastern Europe, Albanians are also a key for communication and stability in the Balkans and Southern Europe. The solution of the Albanian question in former Yugoslavia, being clearly delimited, will help to the definitive calming down of the main conflict area in Europe.

VETËNJOHJA NË JOVIOLENCË



Ndërtimi i identitetit shqiptar
kundrejt serbëve



SHKËLZEN MALIQI
SHKËLZEN MALIQI
SHKËLZEN MALIQI
SHKËLZEN MALIQI
SHKËLZEN MALIQI
SHKËLZEN MALIQI



1. Marëdhëniet ndëretnike në Kosovë viteve të fundit kanë rënë në shkallën më të ulët, praktikisht në shkallën zero të komunikimit. Distanca mes serbëve dhe shqiptarëve sot është e plotë dhe ata jetojnë të ndarë, të parët si pakicë e privilegjuar e cila me ndihmën e policisë dhe të ushtrisë qeverisë dhe sundon Kosovën, ndërkaq shqiptarët, edhe pse shumicë e popullsisë (raporti është pothuajse 9 : 1 në favor të tyre), u janë nënshtruar represionit të fortë dhe marginalizimit të plotë në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike. Në Kosovë ndërtohet sistemi i cili ka të gjitha cilësitë e apartheidit dhe të segregacionit nacional: serbët nuk janë kënaqur vetëm me suprimimin e autonomisë së mëparshme dhe marrjen e krejt pushtetit në adminis-

tratë, në ekonomi dhe në institucionet kulturore, por kanë uzurpuar edhe të gjitha objektet publike dhe institucionet qytetare, duke mos dashur që t'i ndajnë me shqiptarët. Kështu "serbe" janë bërë edhe hotelet dhe restorantet, hallat sportive dhe stadiumet, i gjithë sistemi i shkollimit të mesëm, të gjitha objektet universitare, konviktet e nxënësve dhe të studentëve, bibliotekat me leximore, qendrat kulturore, të gjitha sallat publike, pushmoret sindikale, pishinat etj., etj.

Raporti i sotëm mes shqiptarëve dhe serbëve do të mund të cilësohej si raport i *urejtjes së hapur* i cili ende nuk është shndërruar deri në fund në gjendje lufte, ndonëse shkalla e militarizimit të tyre është shumë e madhe dhe pothuajse çdo ditë ka incidente të armatosura në të cilat viktimat janë qytetarët e kombësisë shqiptare, por ka pasur edhe disa raste të viktimave në mesin e policëve dhe ushtarakëve serb, që zakonisht kanë ndodhur në

rrethanat jo shumë të qarta. Kjo gjendje *as e luftës e as e paqës* përcilet edhe me një disponim të përgjithshëm fatalistik se distanca është bërë e pakthyeshme dhe se është i paevitueshëm konflikti definitiv ndëretnik.

2. Për militarizimin e çështjes së Kosovës përgjegjës është regjimi i sotëm serb, i cili nuk e fsheh se qëllimi i tij është jo vetëm aneksioni por edhe ndryshimi i strukturës etnike të Kosovës. Në Serbi, përndryshe, mendohet se Kosova është tokë e shenjtë serbe dhe se serbët kanë të drejtë t'i përdorin të gjitha mjetet për të kthyer popullsinë e saj në shumicë serbe: kolonizimin masiv të Kosovës me serbë, zvogëlimin e dhunshëm të natalitetit të shqiptarëve, dëbimin e të ashtuquajturëve "shqiptarë emigrantë" dhe të

shqiptarëve jolojalë, dëbimin masiv të shqiptarëve nga puna në mënyrë që të nxitet eksodi ekonomik i tyre, vendosjen e një administrate të përherëshme ushtarake në Kosovë etj. Dhe nëse këto masa nuk do të jepnin rezultate të shpejta, si dhe në rast të ndonjë çrregullimi të madh botëror, regjimi serb e kishte planifikuar edhe mjetin e fundit, ndezjen e luftës serbo-shqiptare që do të zhvillohej sipas skenarit tashmë të njohur të luftërave në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë, ku përmes masakrave dhe dëbimeve masive të popullsisë do të realizohej pasttrimi etnik i Kosovës nga shqiptarët. Një politikë e tillë luftënxitëse dhe gjenocide e ka pasur dhe ende e ka edhe përkrahjen e pjesë më të madhe të opozitës në Serbi.

Shumë tregues flasin mbi atë se në fazën e parë të shkatërrimit të Jugosllavisë, në pranverë të vitit 1990, regjimi serb kishte planifikuar nxitjen e trazirave luftarake në Kosovë, dhe kjo është dashur të shërbejë si shkas për hapjen dhe militarizimin e çështjes serbe në Jugosllavi, në mënyrë që më vonë të fillojë edhe lufta në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Masakrat pa shkas në disa vendbanime (Malisheva, shkurt 1990), helmimi masiv i 7.000 nxënësve shqiptar (mars 1990), rrethimi natën dhe sulmet e armatosura në disa fshatra shqiptare (tërë 1990) me shumë arsye janë vlerësuar si tentime për nxitje të një kryengritjeje masive shqiptare, e cila pastaj do të shfrytëzohej si *casus belli* dhe shkas për bombardimin e vendbanimeve shqiptare dhe reprezalje masive si shtytëse të ekzodit shqiptar.

3. Për serbët krejtësisht papritur shqiptarët e kanë zgjedhur strategjinë e rezistencës të jodhunshme. Kjo rezistencë nga njëra anë në dukje e ka lehtësuar aneksimin e Kosovës,

por nga ana tjetër topiti ambicjet agresive të strategjive luftarak serb. Mirëpo, *gandizmi* shqiptar nuk e ka befasuar vetëm kreun militaristik serb, por edhe vetë shqiptarët, të cilët asnjëherë para kësaj veten nuk e kanë paramenduar në një rol të tillë. Në traditën e tyre dhe në stereotipin të deriatëhershëm dominant të vetënjohjes të identitetit nacional, shqiptarët asnjëherë në planë të parë nuk i kanë vendosur vllarat çfarë janë jodhuna, durimi, mospërgjigja ndaj goditjeve dhe fyerjeve, fljimi i dinjitetit kombëtar për hirë të ekonomizimit të substancës kombëtare dhe të ngjashme. Përkundrazi, në vetënjohjen dhe vetëvlerësimin e tyre shqiptarët kishin vllarat tjera: nderin malësor dhe etikën e të ashtuquajturës fytyrë e pastër, të faqebardhësisë, e cila nënkupton vllencën, trimërinë, mosnënshtrimin, gatishmerinë e fljimit për liri kombëtare dhe idealet kombëtare, deklamimet e tipit "të gjithë do ta japim jetën për liri dhe pavarësi" e të ngjashme. Galeria e heronjëve të preferuar kombëtar në programet shkollore, në librat e historisë, në filmat, në renditjen e portreteve nëpër muret e odave shqiptare ishte e mbushur përplot me luftëtarë, heronjë të rezistencës dhe të luftimeve çlirimtare (Gjergj Kastrioti - Skënderbeu, Bajram Curri, Azem Bejta, Shote Galica, Mic Sokoli etj.).

Deri në fund të vitit 1989, kur mbizotëronte dëshprimi më i madh për shkak të aneksimit të dhunshëm të Kosovës, disponimi dominant i shqiptarëve ishte hakmarrës: pritej vetëm momenti i mobilizimit maksimal për kushtimin e kryengritjes të armatosur masive. Disa agjitor politik, të cilët më vonë patën rol të theksuar në formimin e partive politike shqiptare, ishin të mendimit se kryengritja është e paevi-

tueshme, pa marrë parasysh numrin e madh të viktimave. "Do ti humbim 50.000 ose 100.000 veta, por më në fund do të jemi të lirë!", thonin ata. E kur i pyesnim çka nëse do të ketë më shumë viktima e qëllimi nuk realizohet ata nuk donin të përgjigjeshin, sepse pyetjen e konsideronin si provokim!

Mirëpo në kalim prej dimrit në pranverë të vitit 1990 ndodhi një ndryshim i shpejt dhe radikal. Luftarakët brenda natës dolën nga moda. Eshtë interesante se para kësaj kthese, e edhe pas saj, nuk ka patur as diskutime të mëdha teorike, as fushatë të organizuar propagandistike për strategjinë e joviolencës, e as ndonjë figurë politike e cila do ta merrte rolin e Gandit shqiptar. Dr. Ibrahim Rugova, si lideri më me ndikim i shqiptarëve, erdhi më vonë, kur koncepti i joviolencës në vetëdijen kolektive spontanisht ishte i formësuar. Strategjia e joviolencës pra u imponua disi vetvetiu si përgjigje më e mirë, më pragmatike dhe më efikase ndaj planeve agresive serbe.

4. Një pjesë e përgjegjes ndaj sprovave luftarake dhe hakmarrëse para të cilave ishin gjetur shqiptarët kishte ardhur nga jashtë: vala e ndryshimeve demokratike që e rrënoi dominionin bolshevik evropolindor kishte zgjuar shpresat se çelësi për zgjidhjen e problemit të Kosovës dhe të çështjes nacionale shqiptare është *demokracia*. Formula dukej tejte e thjeshtë: pluara-lizmi, tregu, zgjedhjet e lira, parlamenti shumëpartiak dhe institucionet demokratike, si kërkesa imperative të postkomunizmit, për herë të parë e lejonin hapësirën për deklaram të lirë të shqiptarëve, për vendosjen e pushtetit të magjorancës demokratike në Kosovë. Nuk është e nevojshme të luftohet, mjafton që të ngriten dy gishtat, shënja e viktoriale,

për të ditur se të gjithë shqiptarët, e ata përbejnë pothuajse 90%-shin e popullatës kosovare, janë për Kosovë të pavarur. E kur ky deklarim aq i thjesht njëherë ndodhi, dhe u dëshmuua si njëmendësi e plotë e qëllimit, atëherë edhe realizimi i idealit, i Kosovës sovraane, dukej krejt i prekshëm, diku pranë.

Mirëpo, sekretin e kthesës së papritur më parë ndoshta duhet kërkuar në procesin e ndërtimit të identitetit kundrejt tjetrit, në këtë rast kundrejt kombit rival dhe armiqësor. Padrejtësisht të fajësuar dhe të paraqitur si monstume, përkatësisht nga aspekti politik si komb kundërrevolucionarësh, separatistësh, iredentistësh etj., e nga pikëpamja morale si shovinista shpirtngusht, mujshar dhe njerëz që fqinjëve të vetë serb ua helmojnë pusët dhe të ngjashme, shqiptarët, nga kjo pozitë dhjetëvjetëshe sistemore të të shtypurve, të të fyerve dhe të të gojëkyqurve e zhvilluan prirjen ndaj, nga njëra anë, kërkitimit dhe dëshmimit të përhershëm të alibit kolektiv dhe, nga ana tjetër, të distancimit të vazhdueshëm nga shpifësit: *ruana zot që të kemi diç të përbashkët me popullin që aq shumë gënjen dhe shpif!* Shqiptarët, pra, po vetëafirmoheshin nëpërmjet theksimit të dallimit nga serbët, duke u dëshmuar para tyre dhe kundër tyre. Artikulimin politik të një vetënjohjeje të tillë së pari e demonstruan minatorët e "Trepçës", në nëntor të vitit 1988, kur e nisën marshin protestues prej Stari Tërgut deri në Prishtinë dhe anasjelltas (afro 80 km). Përveç kërkesave të artikuluara dhe të njohura politike, minatorët me sjelljet e veta dhe kuptimin e protestës jepnin edhe një përgjegje implicite mitingjeve të mëdha para-rëndëse serbe të cilat anemba-në Serbisë i kishte organizuar Milosheviqi

luftëdashës, dhe në të cilat për shqiptarët thuhej se janë armiq kryesor të serbëve, se janë bisha shoviniste, vrasës, shtëpidjegës, helmues, dhunues të serbeve, përdhosës të varrezave dhe të objekteve të shenjta serbe, se janë një popull primitiv dhe violent që me paramendim përdorë edhe natalitetin e lartë për t'i shqiptarizuar dhe rrëmbyer tokat e shenjta serbe. Milosheviqi me këto mitingje e filloi luftën verbale ndëretnike në Jugosllavi dhe deri në fund e ndezi nacionalizmin dhe shovinizmin serb.

Minatorët e "Trepçës" (e ata i vurrën në lëvizje edhe qindra mijëra qytetarë tjerë, të cilët nëpër acar dhe borë përsërisnin veprën madhore të tyre kështu që ditë e natë rrugët kryesore të Kosovës ishin të mbushura me kolona të gjata të protestuesve), në të gjitha elementet e veprimit të tyre përpjekshin të dëshmonin se shqiptarët nuk janë të atillë çfarë i prezentojnë serbët dhe se, *çka është më e rëndësishme, shqiptarët janë të ndryshëm dhe më të mirë se serbët*. Për dallim nga demonstratat e mëparshme, ato të 1968-shit dhe 1981-shit, gjatë tërë manifestimeve pesëditëshe (17-22 tetor), ku morrën pjesë afro 400.000 veta, nuk ka pasur asnjë eksces, asnjë akt violent e shkatërrues, asnjë xham të thyer. Për të frenuar furinë e shtytjeve të brendshme shkatërruese dhe për të penguar shpërthimin e urrejtjes, të hidhërimit dhe të mllëfit të masave, duhej të ishte i pranishëm një motivacion tejet i fortë, një vetëkontroll kolosale. Dhe ky vetëkontroll fanatik i minatorëve dhe i rreshtave të panumërta të demonstruesve në të vërtetë edhe përmbante porosinë atyre tjerëve: në nuk jemi të atillë çfarë na prezentoni, ne nuk dhunojmë dhe nuk vrasim, por në mënyrë dinjitoze e shpre-

him vullnetin tonë politik, i cili është i ndryshëm nga vullneti juaj. Minatorët, për më tepër, kishin kujdes që me asnjë gjest dhe parullë të mos e ofendojnë kombin serb. Në vendtubimin kryesor të demonstratave, në Prishtinë, madje është dëgjuar edhe parulla "Rroftë populli trim serb!", me domethënie të qartë se duhet bërë dallimin midis regjimit dhe popullit serb. Megjithatë, kurora e porosisë implicite të protestës ishte kjo: ne nuk shërbehemi me gënjeshtër dhe shpifje, nuk mbjellim helm e urrejtje, duke kërkuar që popujt tjerë të shpërngulen ose shfarosen, siç kishte ndodh kjo në mitingjet serbe ku brohoritej: "Vdekje shqiptarëve", "Duam armë për hakmarrjen e Kosovës", "Shqiptarët jashtë!" e të ngjashme. Më në fund, kishte një simbolikë cinike në faktin se këto demonstrata të nëntorit të shqiptarëve ishin mbase demonstrata të fundit projugosllave dhe protitosiste në ish Jugosllavi. Flamujt shqiptar u lidhën nyje me flamujt jugosllav. Shqiptarët bartnin portretet e Titos dhe i brohoritinin Kushtetutës së vitit 1974, kundër së cilës ishin rebeluar më 1981-shin. Propaganda serbe për këto gjeste thoshte se janë pjesë e dyftyrësisë së shqiptarëve, se Titoja është maskë për antiserbizimin e tyre. Mirëpo, edhe pse kjo mburoja ideologjike vërtetë ishte maskë, nuk mund të mohohet edhe fakti se aty është shprehur lojaliteti ndaj një shteti dhe ndaj një projekti, përmes të cilit shqiptarët për herë të parë në këto treva janë trajtuar si të barabartë. Mirëpo, ngjarjet e nëntorit njëkohësisht paraqesin edhe këngën e mjellmës të titizmit sepse pas disa muajve, në mars të vitit 1989, titizmi shqiptar në Kosovë u shtyp me tankse dhe me vetë këtë fakt, meqë shqiptarët kishin pozitë

konstitutive dhe të drejtën e vetos në federatën jugosllave, u rrënuar jo vetëm koncepti titist i Jugosllavisë por edhe vetë Jugosllavia.

Paraqitja e vetes kundruall tjerëve dhe kundruall përfytyrimit që të tjerët kanë për ne, si dhe ndërtimi i identitetit nacional në këtë kundruallësi, ka marrë trajtën definitive në pranverë të vitit 1990, kur shqiptarët me strategjinë e joviolençës rrumbullaksuan vetënjohjen dhe vetëpërcjetimin si

mbi kroatët dhe boshnjakët-muslimanët, u shfrytëzuan si pre-tekst dhe si arsytim për kri-met më monstruoz ndaj tyre, për maltretimet dhe torturat e papara, për politikën e shfa-rosjes të popujve fqinjë.

5. Kosova kështu është shndërruar në një udhëkryq të çuditshëm të vetënjohjeve të konfrontuara nacionale: kur shqiptarët i ngritën dy gishtat, serbët e ngritën edhe të tretin; nëse të parët e zgjodhën demokracinë si udhërrëfyes dhe

sisht mbante etiketën e prapambeturisë dhe të primitivizmit: u çrrënjës gjakmarrja. Në fushatën që ka zgjatur disa muaj u pajtuan rreth dy një gjaje dhe nga ngujimi u liruan rreth njëzetmijë veta. Natyrisht, aksioni i pajtimit të gjajeve u realizua në kushtet e rrezikut të luftës dhe të mobilizimit, madje në saje të kushtimit tradicional. Porosia ishte: është absurde të vritemi mes veti derisa jemi të ballafaquar me hasmin e egër që do të na shfarosë! Mirëpo, në të njëjtën kohë - dhe kjo ishte një poentë madhështore - ky kushtim i pajtimit brenda kombit nuk u shndërrua në thirrje për hakmarrje kolektive. Përkundrazi, shqiptarët sikur donin të dëshmonin se definitivisht po lironen nga (jo)logjika e vrrullit të gjakut dhe shpagimit, dhe se duan të civilizohen deri në fund, se historikisht janë rreshtuar drejtë vlerave më të avancuara të civilizimit perëndimor, dhe se definitivisht dhe pakthyeshëm po deklarohen se janë evropianë...

Në drejtim të kundërt zhvillohet vetënjohja dhe vetëdëshmimi i serbëve. I majmur në Kosovë, shovinizmi serb do të egërsohet në Kroaci dhe Bosnjë, duke përfunduar me hakmarrje kolektive dhe përsëritje të kasaphanës etnike të Luftës së Dytë Botërore në Kroaci dhe Bosnjë-Hercegovinë. Në Kosovë as në kohët e luftërave të mëdha dhe kur shqiptarët ishin në pushtet nuk ka pasur as për së afërmi këso krimesh masive, këso kasaphanesh dhe këso etjesh për hakmarrje kolektive, çfarë kanë bërë serbët ndaj vëllazërve të tyre të deridjeshëm sllavojugor, e që shashtisën botën. Bestialiteti dhe barbarizmi i papërshtatshëm i luftës së sotme ballkanike me pastrimin etnik të territoreve, me masakrat dhe kampet e përqendrimit, me dëbimin dhe nxitjen e shpërn-



good boys (djelmosha të mirë), përkatësisht të kombit të mirë, paqëndashës dhe demokratik, kundruall serbëve si bad boys (djelmosha të këqij), përkatësisht popullit luftënxitës dhe jodemokratik. Ato që propaganda serbe vite me radhë ua kishte mveshur shqiptarëve tashti dilte ashikare si projektim i vetëvetës në tjetrin dhe në gjithë ato qortime të panumërta të shqiptarëve zubloheshin vetëm dëshirat dhe qëllimet e këqija e hegjemoniste të serbit. Viktima dhe dhunuesi nga projekcionet e shovinistit serb në realitet i kanë ndërruar rolet. Paragjykimet mbi shqiptarët, sikurse edhe ato

qëllim, këta të dytët kuptuan se vendosja e demokracisë është baraz me humbjen definitive të Kosovës; derisa shqiptarët vendosën që të shkëputen nga tradicionalizmi, folklorizmi, hakmarrja dhe paragjykimet e tjera të trashëguara, serbët përkundrazi u zhytën në mite, në ringjallje të militarizmit anakronik serb, në thirrje për hakmarrje të Kosovës, të betejave të humbura historike...

Në momentin më të vështirë, kur luftën e kishin në prag të derës, shqiptarët gjetën forcë për të aktivizuar mekanizmat e rishqyrtimit të një pjese të traditës së hidhur, që përgjithë-

guljes të miliona vetave të nacionalitetit tjetër "të gabueshëm" e që janë pasojë e agresionit serb dhe të grabitjes të paskurpullt të armatës së mëparshme federale, me gjithë armatimin shumë të fuqishëm që ka qenë pronë e përbashët - e gjithë kjo popullin serb më në fund e solli në mospajtim të plotë me botën e civilizuar. Serbët sot gjenden para leqitjes së plotë nga bashkësia ndërkombëtare. Është shpallur bllokada e Serbisë dhe janë ndër-

serb para pak kohe kishte shkruar: "Shqiptarët janë populli politikisht më i pjekur në Jugosllavi. Pajtohem me tezën e filozofit dhe shkrimtarit sloven Slavoj Zhizhek se shqiptarët nga Kosova janë një popull evropian që cilësohet me durim, i cili në pikëpamje politike shërbehet me metoda gandiane, që insiston në dialog dhe e hedh posht dhunën"

6. Natyrisht, me këtë skicë nuk përfundon tregimi, këtu i



marrë sanksionet nga më të rreptat në marrëdhëniet ndërkombëtare.

Për vetëdëshmimin e shqiptarëve sanksionet kundër Serbisë paraqesin një satisfakcion të madh moral që arsyeton fljimin e kodit të mëparshëm të vetëvlerësimit të tyre. U vërtetua alibi i shqiptarëve se padrejtësisht kishin qenë të akuzuar për barbarizëm, por edhe se kolektivisht janë rreshtuar në mënyrë të mbarë, duke u treguar se janë shumë më të mirë dhe më të civilizuar se persekutuesit e tyre. Mirënjohjet më të çmueshme vinin mu nga serbët e urtë dhe vërtetëdashës. Një shkrimtar

shtruar në një mënyrë paksa përrallore, mbi vetënjohjen dhe identitetin e ri shqiptar. Vetënjohja e shqiptarëve, vendimi i tyre kolektiv dhe betimi më i lartë kombëtar sot shprehet kështu: ne duam të jemi komb i lirë në Kosovën e pavarur. Nuk duam më asgjë të përbashët me serbët dhe Serbinë. Shqiptarët, prandaj, shpallën Republikën e Kosovës, e mbajtën referendumin e pavarësisë, i mbajtën edhe zgjedhjet për parlamentin shumëpartiak. Dhe këtu, meqë kemi të bëjmë me një strukturë të veprimit dhe të shpjegimit përrallor, duhet të vendoset ajo pjesë e përrallës kur ndëshkohet keq-

bërësi dhe shpërblehët trimi i drejtë dhe i pafajshëm.

Mirëpo, në realitet (jo vetëm pse politika është kurvë), për zgjidhjen e drejtë të çështjes së Kosovës mungon gjykuesi i saj i drejtë. Evropa, që ne e kemi idealizuar, as në Kosovë e as në shumë raste të ngjashme të padrejtësive historike, nuk mund ta luajë rolin e gjykuesit të drejtë, sepse detyrohet që ta fsheh jo vetëm të kaluarën por edhe të sotmen e saj kriminele. Ajo nuk pranon që të hapen çështjet e revidimit të kufijve dhe angazhohet që problemi i Kosovës të zgjidhet vetëm brenda kornizave të sigurimit të të drejtave të njeriut dhe të garantimit të të drejtave nacionale përmes rivendosjes së autonomisë së Kosovës brenda Serbisë. Disa shtete me ndikim të bashkësisë evropiane "logjikojnë" kështu: nëse Koso-vës i pranohet e drejta për vetëvendosje dhe shpëputja përmes plebishitit, pse një e drejtë e tillë të mos u jipet edhe korsikanëve, skotlandezëve, katalonëve, flamanëve, bretonëve dhe popujve të tjerë në Evropë të cilët nuk kanë shtetet e tyre ose, në rastin më të mirë, gëzojnë vetëm autonomi të kufizuar?

Gjendja në Kosovë sot është e padurueshme, një gjendje as e luftës e as e paqes ose, më saktësisht, *më shumë e luftës se e paqes*. Problemi i Kosovës gjithsesi duhet të zgjidhet me biseda dhe negociata, dhe kjo sa më parë, sepse mund të vijë deri te shpërthimi dhe masakra, si dhe deri te lufta e re ballkanike. Mirëpo, insistimi i Evropës dhe instancave të tjera ndërkombëtare me ndikim që shqiptarët e Kosovës edhe më tej të jetojnë nën juridiksionin serb do të mund të krijonte atë situatë të pashpresë e dëshpruese sikur kur gjyqi i divorcit bashkëshortëve, që e urrejnë njeri tjetrin pa masë, ua shqipton aktgjykimin se edhe më tej duhet të jetojnë

në bashkësi dhe ta ndajnë banesën e njejtë. Aktgjykimi i Evropës ndaj shqiptarëve që kërkojnë divorcin shprehet me cinizëm: po ju do e keni këndin e juaj autonom në atë banesën e përbashkët ku mund të veçoheni dhe të derdhni një lum lotesh!

Ndërkaq, ka edhe këshilltarë që thonë: gjërat duhet të shikohen në dritën e institucioneve demokratike që këtu doemos do të krijohen. Në Kosovë do të vendoset një rend i ri, një sistem tjetër me raporte krejtësisht të reja. Shqiptarët dhe serbët do të mund të jetojnë në tolerancë.

Por, këta dashamirë nuk po e shohin realitetin se problemi i Kosovës konsiston në mosbesim të ndërsjell dhe refuzim të vazhdimit të jetës në një bashkësi, gjë që edhe për shumë kohë e pamundëson krijimin e këtyre institucioneve të premtuara demokratike. Serbia assesi nuk është e gatshme të heq gjendjen e jashtzakonshme dhe masat drakonike që i kufizojnë të drejtat qytetare të shqiptarëve derisa ata nuk e deklarojnë lojalitetin ndaj shtetit serb. Ndërkaq, shqiptarët assesi nuk duan të bisedojnë për një bashkëjetesë të re me serbët, pa lejin e sërishëm të punës së Kuvendit dhe të Qeverisë së Kosovës, me ato ingerenca shtetërore që këto organe të vetëadministrimit i kishin para suspendimit të tyre të dhunshëm, dhe, edhe më tepër, duke i respektuar pakësku vendimet të cilat këto organe i kanë aprovuar pas shpërndarjes së tyre në mbledhjet sekrete që janë mbajtur në Kosovë (Kuvendi i Kaçanikut) apo gjatë punës në ekzil. Dijalogu serioz shqiptaro-serb do të mund të zhvillohej vetëm rreth vetëvendosjes së Kosovës, pra rreth modalitetëve të pavarësimit të Kosovës, dhe vetëm pas kësaj edhe për lidhjet politike, ekonomike,

kulturore e të tjera, të cilat Kosova do ti kishte me Serbinë.

Nëse shqiptarët e Kosovës padyshim janë komb e jo minoritet, atëherë nuk mund të mohohet e drejta e tyre për vetëvendosje, pos me dhunë. Por nga ky konstantim poashtu del edhe konkludimi i prerë mbi realizimin e identitetit shqiptar në rrethanat e konfrontimit total me serbët: vetënjohja e shqiptarëve në joviolençë funksionalisht varet nga afirmimi i shqiptarëve të Kosovës si popull sovran.

7. A mund të ketë, megjithatë, zgjidhje me marrëveshje të çështjes së Kosovës?


Nga ana serbe, prej qarqeve opozitare demokratike, në disa raste është përmendur mundësia e *marrëveshjes historike* shqiptaro-serbe. Para shpërthimit të luftës në Bosnjë, në verë të vitit 1991, Organizata Muslimane-Boshnjake kishte inicuar një marrëveshje të tillë historike mes boshnjakëve dhe serbëve. Mirëpo, ky projekt, siç dihet, dështoi për shkak se shumica dërmuese e popullit boshnjak nuk i besonte Serbisë së Milosheviqit, përveç arsyeve tjera edhe për shkak të mënyrës se si ajo vepronte në "zgjidhjen e çështjes së Kosovës". Nëse boshnjakët para vetes kishin rastin e shkëljes drastike të të drejtave të shqiptarëve, për shqiptarët një marrëveshje e tillë duket edhe më e largët dhe e paarrtshme. Prandaj ata si parakusht për fillimin e zgjidhjes së çështjes së Kosovës dhe të arritjes së çfarëdo marrëveshjeje parashohin vendosjen e demokracisë në Kosovë dhe suspendimin e të gjitha masave të dhunës të cilat regjimi i Milosheviqit këtu i ka aplikuar viteve të fundit.

I vetmi instrument i pranueshëm për zgjidhjen e problemit të Kosovës është vendosja urgjente e institucioneve demokratike. Një pajtim parimor rreth këtij

konkludimi sigurisht se do të ishte i aprovueshëm për demokratët e njëmendtë të të dy kombeve. Mirëpo, në këtë instancë paraqitet çështja e kornizës së demokratizimit të Kosovës: a do të ndodh kjo në suazat e demokratizimit të Serbisë, apo si proces i pavarur kosovar. Për demokratët serbë kjo kornizë duhet të jetë Parlamenti i Serbisë, për demokratët shqiptarë Parlamenti i Kosovës. Ndërkaq, Parlamenti serb e suspendoi më 1990 atë të Kosovës mu nga frika se zgjedhjet e lira në Kosovë do të vendosnin pushtetin legal magjoritar të shqiptarëve, si hap të parë drejt secesionit.

Kontesti shqiptaro-serb esencialisht varet nga kjo nyje e pazgjidhshme e kornizës demokratike. Në qarqet serbe thuhet se korniza e marrëveshjes duhet të jetë Serbia si shtet civil që garanton edhe të drejtat kolektive për pjesëtarët e kombeve që jetojnë në Serbi si pakicë (rreth 1/3 të popullsisë). Thuhet se Serbia nuk duhet të jetë shtet nacional serb, por shtet i të gjithë qytetarëve të saj.

Mirëpo, shteti i sotëm serb me të gjitha institucionet kyçe të tij është i preokupuar aq me çështjen serbe sa që edhe shkatërrimi i Jugosllavisë në të shumtën lidhet me dëshirën që kjo çështje të zgjidhet ndryshe, përkatësisht që të krijohet shteti serb nacional në të cilin do të ishin të bashkuar nëse jo të gjithë serbët, atëherë numri sa më i madh i mundshëm i tyre. Protagonistët e këtij optionsi dominant madje thonë se nuk ka shumë rëndësi se a do të quhet ky shtet (i ashtuquajtur "Jugosllavi e cunguar") Serbi apo ndryshe, me rëndësi është që aty të mblidhen sa më shumë serbë dhe terriore serbe. Momentalisht, këtë shtet e përbëjnë dy republika të ish Jugosllavisë, Serbia dhe Mali i Zi, por nuk hiqet dorë



nga projekti që këtij shteti t'i bashakangjiten edhe "krajinat serbe" të Kroacisë dhe e ashtuquajtura Republikë Serbe e Bosnjë-Hercegovinës.

Një ofertë e tillë që marrëveshja historike të bëhet në suazat e kësaj Serbie të zgjeruar, e cila gjoja do të ishte një shtet qytetarësh, aspak nuk është tërheqëse për palën tjetër. Edhe nëse problemin do të shikonim globalisht, në suazat e procesit unik që po zhvillohet në vendet ish-socialiste, është krejtësisht iluzore të pritet se diku në truallin e ish-Jugosllavisë do të nga-dhnjejë opioni i shteti qytetar. E tërë Evropa Lindore e sëmurë është dhe e kapluar nga një epidemi e pandalshme e krijimit të shteteve nacionale. Shteti qytetar, pa institucionet përkatëse qytetare dhe pa marrëdhënie përkatëse ekonomike, është vetëm fjalë boshe. Kështu, Kushtetuta aktuale e Serbisë deklaroi shtetin e qytetarëve të saj, por të gjitha instrumentet e saj kanë për

qëllim jo vetëm dominimin e plotë të kombit serb por edhe segregacionin dhe aparthejdin në Kosovë.

Për zgjidhjen e çështjes serbe në ish Jugosllavi është duke u aplikuar ideja e ndarjes etnike, e definimit të territoreve etnike. Kështu është vepruar në Vojvodinë dhe Kroaci, kështu tash po veprohet edhe në Bosnjë-Hercegovinë dhe gjithkund ku serbët kanë një komunitet të konsiderueshëm banorësh. Por në dritën e këtij parimi të ndarjes etnike, të cilin po e preferojnë serbët, kontesti shqiptaro-serb merr një trajtë të befaseshme: ai paraqitet si kontest ndër më të lehtët në regjionin eksploziv ballkanik. Kjo rrjedh nga fakti se ndarja etnike e serbëve nga shqiptarët parimisht dhe territorialisht mund të realizohet shumë më lehtë se ndarja e serbëve nga kroatët dhe boshnjakët (muslimanët). Në Kosovë, Serbinë Jugore dhe Malin e Zi shqiptarët përbëjnë shumicë kompakte, mbi dy të tretat e popullsisë.

Në Kosovë shumica shqiptare mbanë në "rrethim" një përqindje të vogël të serbëve nga numri i përgjithshëm i tyre që jetojnë në gadishullin e Ballkanit (vetëm rreth 1,5 %). Nga ana tjetër, shqiptarët e Kosovës përbëjnë rreth 38 % nga popullsia e përgjithshme shqiptare në Ballkan (me shqiptarët e Maqedonisë ata përbëjnë rreth 50% të popullsisë!) kështu që pretendimet serbe që Kosova të trajtohet si territor etnik serb detyrimisht krijojnë një anomali të paqëndrueshme; që 1,5 % e serbëve të Ballkanit të mbajnë nën okupim dhe sundim kolonial 38% të shqiptarëve të Ballkanit! Çështja etnike serbe nuk zgjidhet në Kosovë (1,5 % shi mund të konsiderohet irrelevant në krahasim me 35 % e serbëve jashtë Serbisë) ndërkaj çështja shqiptare nuk mund të zgjidhet pa zgjidhjen e Kosovës. Ndërkaj, nëse Kosova do të amputohej nga Serbia, humbja etnike serbe, të shprehur në mënyrë paksa

të vrazhdë, do të numronte vetëm 1,5 %, gjë që nuk mund të krahasohet me 38 %-shin (përkatësisht rreth 50 %-shit) të shqiptarëve që jetojnë jasht shtetit amë, të trajtuar si "minoritet".

Mirëpo, aspiratat shqiptare për pavarësi nuk i pengon ndonjë shtet qytetarësh por shumica serbe në atë shtet, ku shqiptarët konsiderohen jo vetëm si pakicë por edhe si mish i huaj në territorin serb. Siç dihet, qëllimet e deklaruara shtetërore të Serbisë ndaj Kosovës janë rivendosja e gjendjes çfarë ka qenë para Luftës së Dytë Botërore dhe ndryshimi i strukturës etnike të popullsisë së Kosovës në favor të serbëve përmes dëbimit të një numri të madh të "emigrantëve shqiptarë" (përmendet një numër i trilluar i 300.000 emigrantëve të cilët goja janë vendosur në Kosovë gjatë okupacionit italian të periudhës 1941-1943) dhe kolonizimit masiv të serbëve.

Pothuajse të gjitha analizat objektive japin përfundimin se këto qëllime gjenocide të Serbisë ndaj shqiptarëve nuk janë deri në fund të realizueshme. Për realizimin e tyre duhen mjete të mëdha financiare, të cilat Serbia sot nuk i ka e as

nuk mund t'i krijojë shpejtë meqë është para bankrotit dhe kolapsit të sistemit ekonomik. Pas fushatës së ashpër botërore kundër politikës së pastrimit etnik në Bosnjë, nuk vijnë në konsiderim as planet për shfarosjen masive dhe asimilimin e shqiptarëve, sepse me këto do të provokohej ashpërsimi i izolimit edhe ashtu shumë të repte ndërkombëtar të Serbisë.

Nga ana shqiptare situata është shumë më e qartë. Opioni i tyre është dalja nga Serbia e atutë kryesore që i kanë janë angazhimi për paqe dhe demokraci. Ata janë të gatshëm të hyjnë në të gjitha negociatat vetëm si subjekt i pavarur, përkatësisht si komb i cili bashkëvendos, e jo si pakicë për fatin e të cilit vendosin të tjerët. Përveç një përqindjeje të vogël të të shpërngulurëve ekonomik në territorin e ish Jugosllavisë, shqiptarët në 95 % të territoreve që i banojnë përmbajnë një magjorancë kompakte e së paku dy të tretave të popullsisë. Pra, ata askund nuk janë pakicë, por gjithkund-shumicë.

8. Çështja e Kosovës në kornizën e saj të vërtetë është-çështje e dekolonizimit. Nëse demokracia mbështetet në

parimin e vendosjes së shumicës dhe në të drejtën e vetëvendosjes kombëtare, atëherë me çdo vendosje të sistemit demokratik në Kosovë popullësia shumicë e saj doemos do ta kërkojë dekolonizimin dhe vetëvendosjen, meqë të drejtat e kësaj shumice janë mohuar me dhunë dhe meqë prej 1981-shit intensivisht, por edhe historikisht, që nga 1912-shi, kur Serbia e okupoj Kosovën, por dhe në Jugosllavinë e parë dhe të dytë, kjo shumicë nuk ka pasur pothuajse asnjë përvojë pozitive mbi mundësitë e bashkëjetesës qytetare me serbët.

Shqiptarët, në një mënyrë, të gjitha rrugët i çojnë drejt secesionit. Sot, për arsye se për asgjë nuk pyeten dhe tmerresisht maltretohen nga terrori më i egër policor dhe administrativ, që i ka vënë në një gjendje pasigurie të plotë ekzistenciale, dhe të një shantazhi të paparë shtetëror; ndërsa, në të ardhmen, për arsye të përvojave negative të jetës me serbët, ata gjithnjë do të përcaktohen për vetëvendosje dhe pavarësi të Kosovës.

10-14 gusht 1992

Shkëlzen Maliqi:

Self-Understanding in Non-Violence


The Construction of Albanian Identity in Opposition to Serbs

The forced annexation of Kosova in 1989-90 opened the door to a militarization of the "Serb Question", with the aim of destroying Yugoslavia and creating a Greater Serbia. An armed rebellion of Albanians was expected, and

an Albanian-Serb war. However, the Albanians unexpectedly opted for non-violent resistance. Their traditional self-understanding as a highland and warlike nation underwent a sudden change. In contrast to the violent Serbs, they adopted non-violence; i.e. political, democratic and civilized means of resistance. This did not mean that they lowered their aspirations. On the contrary, these radicalized, leading to the proclamation of Kosova as an in-

dependent republic. The Albanians' self-understanding in non-violence is thus functionally linked to their self-determination as a sovereign people. Whether Kosova sovereignty can be achieved without violence and purely by democratic means is another matter. In his conclusion, the author considers the (non)possibility of a historic agreement between Albanians and Serbs. The Kosova Question is posited as one of decolonizing Kosova.

PROFECIA NË GJUHËN GJERMANE



PETER SLOTERDIJK
PETER SLOTERDIJK
PETER SLOTERDIJK
PETER SLOTERDIJK
PETER SLOTERDIJK
PETER SLOTERDIJK



Sekush pati thënë njëherë se si kombi s'është karrocë nga e cila do të mund të zbritej në kthesën tjetër, nëse s'ka ëndje për vozitje më. Kështu është edhe sot: sado janë modernizuar mjetet e qarkullimit; tash do të ishte më mirë të thuhet se si kombi është tren-ekspres që sulet viseve për të cilat askush me ndonjë siguri s'mund të thotë se atjepari ka fare binarë. Moderimi i krahasimit sjell edhe atë përparësi që ai tash mund ta përshkruajë edhe frikën që përhapet midis pasagjerëve të atij treni, kur dihet se në lokomotivë qëmoti s'është askush. Pyesim, pra, ç'është sot kombi? ku me fjalën "sot" mendohet në epokën e sistemeve aqefale, në të cilën gradualisht lirohemi nga fantazma mbi navigacionin nga një qendër. Se si do të përgjigjem në këtë pyetje jepet të parandihet nga ajo grishje e të vdekurve në citatet e kapitujve të mëparëm dhe në bazë të ekskursit në folkloriken. Do të them se kombi është gurgullimë zërash, zëzëllimë dhe informacion në veshët dhe trupat e banorëve. Mendoni, Ju lutem, se hyrët në sallë ku ndanë tryezave rrinë e bisedojnë dy-tre mijë njerëz; përpikuni t'ia paraqisni vetes atë ushtimë e tingëlime; hapëroni në atë tepih fërshëllime, ku mezi se shquhen zërat e veçantë; ndijeni atë lëmsh tingujsh të një shoqërie, plotësisht të përshkruar

me veten e vetë dhe shprehjen e jetës së vetë. E tash zmadhoheni atë pamje tingullore deri në përmasa gjigante, vërejani veshin murmurimës simultane të dyzet, gjashtëdhjetë apo tetëdhjetë milion zërash gjermanë, shfaqjani vetes këtë detonacion kombëtar, atë oshëtimë historike nëpër një territor, shtrëngatën e frikshme të gjuhës kombëtare, që me qindra vjetë andej shtrihet e rrokulliset. Duket se popujt do të duhej të ndërtonin satelite jo vetëm optike por edhe akustike, që, në mbremje, pranë raporteve për motin, të emetoheshin dhe incizimet satelitore të toneve simultane nacionale. Dhe sikur që spiralet e reve mbi Evropë, të cilat gadi për çdo mbremje i shikojmë në ekrane, rëndom nuk ndërpriten në kufijt e shteteve, po aq vështirë do të ishte që nga tepihu shumë i madh tingullor i kontinentit tonë të veçohet dhe filtrohet toni i mëvetësishëm gjerman, asisoji që të dëgjohet vetëm ai.


Duke u futur në lojë me akustikën politike, fantazia jonë e dëgjimit mbërrinë te kufijt e vetë. Kombi si shushurimë e oshëtimë zërash mbi një copë tokë, mbetet i padëgjuar, i patingull (Ungeräusch). Arsyeja për këtë qëndron në vetë natyrën e sendit; në natyrën e gjuhës. Sepse gjuha kombëtare është po aq shkrim sa edhe zë, madje ndoshta është më parë bibliotekë

sesa që është oshëtimë, më parë shtypshkronjë sesa kuvend. Do të doja, andaj, ta zgjeroj definicionin e të them që gjermanët, sikur dhe popujt tjerë janë në të vërtetë një bibliotekë neurologjike; në sistemet nervore gjermane, në ndërthurjet e sinapsës gjermane (sinapsa- vend ku bashkohen neuronet-vër. e përk.) është i shënuar i gjithëdijshmi (Reallexikon) i historisë gjermane. Andaj biblioteka gjermane nuk gjendet në Frankfurt, ajo as që është gjëkundi, sepse biblioteka e gjithëdijshme jemi ne të regjistruarit e gjallë në bibliografinë mezo-evropiane. E ne s'jemi askund, zukasim, lumnohemi, mobil jemi, ne jemi një bashki librese ke... Padyshim që është vështirë të besohet se dikush e di se si do të mund të përdorej ajo bibliotekë në mënyrë inteligjente. Ende jetojmë sikur analfabetët; s'po e citojmë boll vetëveten. Shuma e informatave gjermane është e shënuar me sisteme të ndryshme të shkrimit, në mediat e shënimit, në trupin e vetë dhe të huaj; duhet vetëm ta shfletojmë veten, ose përmes fjalëve-priresë t'i grishim programet historike, që para neve, në neve, nëpërmjet nesh të shfaqet teksti gjerman, saktësisht ashtu siç ka qenë i shënuar, me shkronja gotike e latine, me shkrim dore, në kujtimet e stacioneve trupore, madje edhe në vetë ujin mineral të trupit, po pati diç të këtillë. Kuptojeni këtë fjalëpërfjalshëm-kur para katër javësh gjermanët kalonin tej Murit, skena zhvillohej krejt brenda bibliotekës neurologjike gjermane-në atë vend me program që koduar mundësia e lotëve, sllogani "prapë bashkë" përcakton në skenarin psikosomatik të pasluftës lotët dhe gazin-fjala-priresë, fjala e të kaluarit ka rënë: pjesën e mbetur të tekstit e cituam nga vetë vetja-në gjurmim për tekstin e mirëfilltë për kapitullin tjetër gjerman, rreth të cilit vëjnë bast mençuria dhe marrëzia. *Nulla dies sine linea.*

Në kapitullin e mëparëm citova tekste nga biblioteka ime private, ashtu që ndoshta shpërkëndyeshëm i prezentova si zëra, sado që ata për neve s'ishin kurrëfarë objekte të dëgjimit, por shënime nga kohët e errëta të drejtuara njerëzve që ishin aq mendjelehtë që atëbotë të ishin gjermanë, dhe aq lakmitarë që në këtë botë të sjellin akoma gjermanë të rinj; mbase kanë menduar se ajo lojë kromozomesh, inicialesh dhe zërash në Mezo Evropë duhet edhe pas luftës doemos të vazhdohet. Citatet e mia dokumentojnë për Gjermaninë si komb të nxitur, bindur dhe të shkruar dhe këto citate pjesërisht akoma e kërkojnë atë të cilit i janë të drejtuara. Shikoni, zonja e zotërinj, këtu ngapak po luaj postierin kombëtar, që u tregua me atë që kombi në rend të parë është një adresë. Posta që na ndërlidh-e shpërndarësit e saj janë shkrimtarët-punon me ngadalë; sikur që pamë,

dorëzimet me vonesa dyzetvjeçare më parë janë rregull sesa përjashtime. Me këtë edhe tërë ajo kërdi e postës së pasluftës, me gjithë ata grumbuj të postët, mezi të lexueshme, të adresuar midis brezeve, bollëku i tekstit pëshpëritës psiko-historik nga jeta e mëhershme, e cila nuk munda të shpëtojë. Për një komb, ndërkaq, është më mirë që bile ndonjëherë t'i dorëzohen letrat, në të cilat formulohet premtimi i lindjes së tij, sesa që ato kurrë të mos mbërrijnë.

Fëmijë të kombit të nxitur-bindur dhe të shkruar qëmoti vetë shkruajnë e flasin, por pasi posta kombëtare zvarritë me dërgesa dhe sillet me neglizhencë, ende duket ngapak sikur të folurit tonë historikisht vie nga asgjëkundi. Jemi këtu sikur kemi pikur nga qielli. Fillohet me frazat elementare, përpjekjet janë që sa më shumë të mbetemi pranë asaj që vetë e dime, nuk tprohet dhe s'thuhet fjalë të tepërta. Gjër-



manishtja e pasluftës kësisoji bëhet gjuhë e konstatimit të të dhënave dhe gjuhë e demantimit. Gjermanishtja në truallin e vet bëhet gjuhë e huaj, duke qenë se nuk kemi arësye për të besuar në asnjërën fjalë, po s'që ajo e vërtetuar me të dhëna ose me ashiqarësi. Fjalja gjermane, u bë e plumbtë; gjuha gjermane u desh t'i rreket punës, sikur ai veterani i kthyer nga lufta të cilin e ka lënë guximi për të folur. Gjuha na ishte e lodhur nga gënjimi dhe dalldisja; nuk munda t'i bëjë ballë asaj që juristët ta detyrojnë ta thotë atë që ata duan dhe që politikanët brenda saj të kalojnë nga fjalët në vepra. Ishte ashtu sikur gjuha rri e pikëlluar dhe e rezignuar para detyrës së çeljes së botës. Baza për këtë pikëllim dhe për këtë vetëkontrollë vullnetare të zërave ishte, për emocionin, qyshkur e qartë, edhe atëherë,



madje, kur kjo gjendje vështirë se mund të arësyetohej decidivisht. Në gjuhën e pasluftës më nuk mund të bëhej asnjë fjali me vend me futurin; në gjermanisht asgjë më nuk mund të premtuhej, gjermanishtja si gjuhë e profecisë që e dëmtuar rëndë dhe në forcën e saj të paralajmërimit të ardhmërisë e rrënuar posikur edhe qytetet gjermane. Por mëkëmbja e saj zgjati më shumë. Asnjëri këtë nuk e kuptoi aq mirë sikur Peter Handke i ri, kur viteve të gjashtëdhjeta zuri të paraqitej për fjalë me copëzat e tij gjuhësore. Më lejoni që nga biblioteka ime private t'ua citoj disa fjali të Handkes, që me precizitet tregojnë se si atëbotë, pak para fundit të vjetëve të fjalive të plumbta, në gjermanishte vihej në provë futuri profetik.

abcd

Po edhe të konvertuarit do të ndihen sikur janë konvertuar.

E ata që janë fortësuar në shtyllat prej kripe do të rrinë sikur janë fortësuar në shtyllat prej kripe.

Dhe ata të djegur vetëtme kanë për të rënë sikur t'i kish djegur vetëtma.

E të mallkuarit të përgjojnë posikur ata që janë të mallkuar.

Dhe të ngurësuarit do të rrinë sikur janë të ngurësuar.

E të ftuarit do të vijnë sikur të ishin të ftuar.

Dhe të marrurit do të rrinë sikur të ishin të marrur.

E ata të vvarë rrefeje do të rrinë sikur të vvarë nga rrufeja.

Dhe ata të zënë gjumi do të vejnë sikur në gjum.

E ata të porositur e të pa marrë do të rrinë sikur të ishin të porositur e të pa marrë.

Dhe ata të shkëmbyer do të ndihen sikur janë të shkëmbyer.

E ata të pasqyruar do të shohin veten si në pasqyrë.

Dhe të thyerit do të ndihen të thyer.

E ata që t përplu dheu do të jenë sikur t përplu dheu.

A është Handke autor apolitik? S'e njoh asnjë që problemin e gjermanishtes si një gjuhë të vdekur profetike në aq shumë mënyra dhe me aq larushi ta ketë përcjellur sikur si austriak, i cili me maskën e shkrimtarit introvert, të largët për politikë, zbaton eksperiment gjuhësor-ontologjik; që sërishmi ta zbulojë funksionin e futurit në gjuhën gjermane, dhe atë me precizitet sa më të madh që është e mundur, dhe me aq patetike për sa është e pashmangshme. Nga pika zero e profetizmit, Handke shkallë-shkallë nga tautologjia, u kurajua për qëndrim përmba-

jtësor rreth të përnjëmendësisë së haptë. Deo-
mos që kjo duhet të fillonte kështu:

- c
Pendat do të jenë të lehta si pendë.
b
Vrerit i hidhur do të jetë si vrer.
a
Gëlqerja e bardhë do të jetë si gëlqere.
d
Tlyent i butë do të jetë si tlyen.
c
Mendimet do të jenë të shpejta si mendim.
b
Qtmja do të jetë e hollë si qime.
a
Vdekja do të jetë monotone si vdekja.
d
Të vdekurit do të jenë të zbehtë si i vdekurit.
c
Të dergjurve do u jetë keq si me vdekë.
b
Korbi do të jetë zi si korbi.
a
Dërrasa do të jetë e rrafshhtë si dërrasë.
d
Lëkura do të jetë e hollë si lëkurë.
c
Gishtit do të jetë një gisht i trashë.
b
Flijet do të jenë të shkëlqyeshme si fije.
a
Guri do të jetë i fortë si guri.


abcd

Secila ditë do të jetë si çdo tjetër.

Handke tekstin e tij e quajti *Profica*-e qysh tjetër? Sepse në atë kohë çdokënd që do të fliste përpara, do ta merrnim për hajgarexhi. Në Gjermani-sikur që tha Benn-mendimtarët që gjuhësisht nuk janë të arrirë për botëkuptimin e vetë i quajnë falltorë. E mbasi është kështu, mendonin fëmijë e pasluftës, atëherë t'i mënjanojmë nga gjuha jonë krejt ato që kanë të bëjnë me këqyrjen-parashikimin, profetizimin. U bëmë brez pa premtime. Më sakt, brez i cili i premtoi vetes se nuk do t'i premtojë tepër vetes. Po çka do të ishte kjo tepër? Sa pak mund t'i premtohet vetes? Deri ku mund të shkohet në përpjekje që të jihet gjallë e që vetes asgjë nga ajo jetë të mos i premtohet?

Ai që i përkiste brezit pa premtime u desh që me kohë të vijë deri te përvoja se si jeta

njerëzore pa premtime është e pamundur. Më 1968 u pa eksplozioni i premtimeve të reja, të egra, të pasakta, politike dhe pseudopolitike. Sërishmi t'i premtohet vetes diçka-po si bëhet kjo punë? Për ne, konflikti midis pafuqisë për të premtuar dhe pashmangshmërisë së premtimit, patjetër u desh të bëhet midisi-qendra e gjuhës gjermane, dhe jo vetëm gjuhës, por edhe sendit gjerman, kauzës gjermane. Të jesh gjerman do të thotë të mos jesh i sigurtë se çka mund botës dhe vetëvetes t'i premtohet. Mendoj se kjo pasiguri më nuk mund të ndahet nga roli gjerman në botë. Sepse për ne s'ka gjë më të sigurtë sesa ajo që më nuk ka mision botëror gjerman.-Pikërisht për shkak se e kemi këtë të qartë, kthjellët si loti, nga kjo del një mision kritik kundër misioneve. Ai e njeh pashmangshmërinë që te bartësit e fuqishëm të misioneve, politike ashtu sikur edhe religjioze, të provokohet një rishqyrtim radikal i asaj se si duhet të premtohet, e si jo, dhe ç'është për t'u premtuar e ç'nuk është. Të shtrohet sot çështja botërore do të thotë të fillohet kritika e misioneve dhe e të zgjedhurve të tyre. Gjermanishtja, ja , u bë gjuha e parë në botë në të cilën premtimet dhe pritjet qofshin ato të shenjta apo profane, nuk mundet që thjesht të barten e të përfolen. Ajo nuk mundet në përmasa planetare ta propagojë *way of life*, as gjerman, as amerikan, as rus, e të mos bëhet propagandë e të keqes. Ajo as mbretërve nimfatik të ekonomisë, nuk guxon pa kufizime t'ua marrë sjalën prej goje. Ai që dëshiron që në gjermanisht të premtojë diçka, duhet që më radikalisht të mendojë për atë *Çka dhe Si në të ardhmen* e të të folurit të vetë, sesa cilido kudo tjetër. Gjithësesi, madje edhe gjat luftës, Gjermania, si komb i nxitur-bindur, nuk qe krej e shkëputur nga rrymimi i premtimeve profane moralistike dhe poetike në të cilat ndodh vetëndërmjetësimi i njerëzimit; duket se edhe citatat e mia thanë diç rreth kësaj. Pyes atëherë çka do të thotë sot, duke u nisur nga skepsa gjermane, nga gravitacioni neoprofetik i gjendjeve shpirtërore gjermane, të përgjohet shushurima e gjuhëve të panumërta në Tokë, në të cilat premtimet e jetës ende janë bartur-të qëndrueshme ose të paqëndrueshme, të mençura ose të turbullta, banale dhe të zvetënuara? Me premtime njerëzimi organizon pavendosmërinë e vetë. Si përshtatet gjuha jonë, e cila tani u bë e vëmendshme, në bisedën planetare të popujve? Çka do të thotë sot aplikimi i futurit si funksion legjitim i gjuhës gjermane, në mënyrë më të re e të mençur? Si mund të mësohemi të japim premtime më të mira-të atilla që do të mund të plotësohen edhe pa vetëshkatërrimin e folësit? A mundemi së shpejti të themi gjëra ende aq të reja e të mençura, aq vetëvetishëm kumbuese,



sikur që Wily Brandt i shqiptoi në mbremje të 9. Nëntorit para bashkisë së Schönenbergut: "Muri do të bie dhe Berlioni do të jetojë". Kjo i takon shembujve të parë të futurit pa fraza pas Luftës së dytë botërore, e qysh tash këto fjali nuk mund të shqiten nga biblioteka dëgjimore nacionale. Pasi Handke në ushtrimet e tij të të profecuarit shkroi: Secila ditë do të jetë si çdo tjetër, atëherë aty duhet të shtohet: Kjo ditë nuk do të jetë aso çfarë kanë qenë të gjitha tjerat. Nga kjo ditë qytetarët e RFGJ-së kanë gjasa që një ditë të jetojnë ndanë një shteti fqinj më simpatik, më normal dhe kooperativ në të cilin flitet gjermanishtja-pse jo ndanë një Austrie prusiane? Kjo do të ishte më shumë sesa që mund të shpresohet, e më pak kërkohet; do të mund të dilte që kjo sërish është pjesë e ndonjë premtimi ogurzi i cili në llogarinë e vetë do ta fuste edhe shkatërrimin e Evropës, në thurjen e një fantazie gjermanomadhe. Kështu po i afrohem përfundimit. S'ka më kohë që sakt të depërtojmë dhe të përgjojmë korin nacional të të vdekurve, nuk kemi mjaft hapësirë për veçimin e zërave kryesorë nga zëzëllima gjermane e zërave. Më duhet të profitoj nga ndonjë tjetër rast për ta shtruar mendimin që kombet janë po aq persona paramitologjik sa edhe politiko-juridik. Ato kanë zanafillën territoriale, me vërjen e lidhjeve me vendet ku janë varrosur të parët; zënë fill në mënyrë psiko-akustike, me ndërlihdjen e veshit të brendshëm me hipnozën e gjuhës amnore; psiko-historike, me misionet fascinante dhe problem-delegacionet të "bijave dhe bijëve të vendit". Nuk ka mjaft kohë as ta ndreq përshtypjen se jam i shurdhër për zërat e femrave dhe se zërat e së kaluarës i kam dëgjuar vetëm si kor burrash gjerman. S'mbeti

kohë as për të shestuar rreth shënimit enigmatik të Rose Ausländer: "Ta këndosh këngën domethënë të lindesh dhe patrembur të këndosh lindjen për lindje". Po prapë nuk mendoj që më këtë ndërhyrje të shkurtër në zëzëllimën kombëtare të zërave ta lë pa përmendur një pjesë të fjalimit që para disa vjetësh u mbajt ndanë kësaj foltoreje-sipas meje, fjala është për pjesën më nxitëse-frymëzuese mendore të një fjallmi që edhe vetë është skajshmërisht nxitës e frymëzues. Alexander Kluge rrinte para gjashtë vjetësh në këtë podium dhe e cyste publikun e tij në lëvizje marramendëse mentale. Pyeste si mundem që fare të flas çkado *mbi* Gjermaninë (*über-mbi*) duke qenë se po rri në Gjermani (*auf*), në truallin e saj? Si mund të flitet *mbi* (*über-mbi*) diçka që na bart, na rrethon, mundëson dhe mbilartëson? Kluge atëherë tha:

Qysh në skollastikë me nocionin *sopra* u diskutua për këto.

Christoporus bart Jezuin fëmijë. Jezui fëmijë në krahët e tij bart botën. E ku, atëherë, Christoporus i vendon këmbët e veta, duke qenë se ato duhet t'i mbërrijnë në një dysheme të fortë, përveç nëse Christoporus nuk hip në botë në krahët e Jezuit, e atje atëherë t'i vendojë këmbët në dysheme të fortë? Kuptojeni këtë seriozisht, sepse është domethënia e fjalisë: *cogito quia natus sum*. S'po e them këtë si moto të fesë sime, por vetëm për ta bërë variantën e asaj *cogito ergo sum*, të cilin me gjithë qejf do ta shndërroja në: në gjendje për të menduar jam se mund të mos e përfill atë se jam. Ndihej kësaj është fjalia *cogito quia natus sum* (Mendoj kështu, e jo ndryshe, se kam lin-

dur në një vend të caktuar)... *natus sum* = kombi, -mund të më besoni, me çkado që *natus sum* mund të ketë lidhje ... (*Nachdenken über Deutschland*, 1988, 73/74)

E tash, këtij mëngjesi as që u bë fjalë për diç tjetër veçse për atë "çkado që", që rri midis *natus* dhe kombit, për këtë ndërlidhje midis nacionalitetit dhe natalitetit, për enigmën e shtruar asisoji që kur zëmë të vijnë në botë, mund të vijnë vetëm si "komb". Në këtë kuptim etimologjik dhe filozofik, "kombi" është konstanta e procesit të të ardhurit në botë, e cila akoma meriton përfillje, sado shteti nacional paraqet shpikje moderne të cilit qyshkur i duhet revizioni. Kësisoj të kuptuara, kombet janë instanca politike amënore, ato janë dhe luajnë rolin e prehërit amënor politik, ato janë personazhe të bashkëlindjes. Pse atëherë skenat e 9. Nëntorit ishin aq prekëse? Na preku ajo Diçka berlinase që u sul në botë, ajo Diçka nga e cila buron çdo jetë njerëzore, madje edhe atëherë, ose pikërisht atëherë, kur me forcat e veta nuk mund t'i rikujtohet pikënisja e vetë. Por kur kjo ndodh-kur hapërimi në të lirën vazhdon, kur ajo përsëritet-atëherë efektet tregojnë në drejtim të prejardhjes. Së këndejmi çështjet kombëtare, duke u bërë akute, kanë në vete diçka prekëse ose diçka ngurtësuese, diçka që na shkrinë ose diçka që provokon para-rezistencë, me këto shkojnë lotët dhe dallimi i lotëve, zmbropsja në indiferencë ose kthimi i asaj që kurrë nuk mund të jetë indiferente. Këto janë ato çështjet kur, duke u pyetur, edhe me mendim kthehemi në atë përfshirësen, bartësen, atë që mundëson dhe mbilartëson. Kombi është nocion gjenealogjik; me gjenealogjikë duhet të kuptohet forma mendore që e shpjegon fuqinë e të qenmit të gjërave e rregullimeve në bazë të ndërsjellësisë së prejardhjes. Së këndejmi ai që mendon nacionalitetin e tjet, mendon në fushën magnetike të prejardhjes, të mos themi në shtërngesat e prejardhjes. Andaj nacionalizimi gjithnjë ka qenë madhësi e dykuptimë, në të dy aspekte i rrezikshëm; nga njëra anë si hap përpara i fuqisë territoriale në komplekset botërisht tej pamëse të fuqisë, nga ana tjetër si aspirim i subjektit për ndërlikimin rikthyes me atë nga ç'gjë burojnë. Pikërisht këtu hyn në lojë lokacioni të cilin Gjermania e mësoi në këtë shekull. Duke marrë parasysh përvojën e deritashme, për neve s'ka gjë më ogurzezë sesa që është prehëri amënor nacional, nga këto atdhera thithëse, nga këto nëna-hyni të ofenduara, me gjihtë e tyre alegorikë, flamujt e lotët, dhe nga bijtë e tyre trima, të cilët nënat në fillim i shpiejnë për të bërë vepra të mëdha, për t'i përvjedhur sërish pastaj në varrin plot lagështi dhe premtime, që, prapë, është placente për reinkarnimet heroike

në atdhe, sikundër e dimë nga historia. Neve s'na duhet më pornografi e pasur gjysmëreligjioze kombëtare; prehërat e nënave në të ardhmen do të duhet të kënaqeshin me mbetjen prapa neve dhe të mos vijnë në konsiderim, përveç vizitave të shkurta. Është afer mendësh që rruga e fëmisë së pasluftës në jetë fillon sikur rruga e të gjithë tjerëve: me familjen e vetë politike, kombin; padyshim që për këtë mendohej edhe me "rrjeshtimin e poshtëm" të Martin Walserit, rreth të cilit pati shumë polemika, me ose pa vend. Bashkëlindja në diçka që bart dhe që kërkon që ta bartim tutje, edhe më tej është problemi më i vogël për njerëzit e fiseve, popujve e kombeve, por shtytja për dalje rritet; kjo është ajo gjëja e përbashkët e refugjatëve dhe frymës së lirë, rruga në të lirën doemos kalon kufijtë e kombit. Kështu, problemi kombëtar, shikuar në përmasa botërore, derdhet në çështjen se sa është përverze apo e shëndoshë-mendoj, normativisht-dashuria amënore politike, që kalon në të gjithë ata që kanë lindur më vonë ose, në anën tjetër, nga ata i dhurohet miljeut të tyre të parë, atëdheut të tyre. Nëse uterusit ynë politikë dëshiron në të ardhmen të jetë *a good enough nation*, një komb i mirë, mjaft për jetë në liri, atëherë ajo duhet të jetë në gjendje t'i lërë fëmijët në botë. Qan nëna Gjermani /S'ka më Hansusha./ Këtu fëmija vendoset/mbrapa në shtëpi-por jo, ajo e di që mund të shtegtojë kudo, përveç nëpër shtëpi, jo mbrapa në nënën, në varrin e flohtë gjerman. Kur pra gjermanët do ta ndërprejnë keqpërdorimin e fjalës frymëzënëse të ribashkimit? Kjo është fjala kyçe e neurozës gjermane-këmbana thithëse verbale, që grish e tërheq invalidët e identitetit për vetësakrifikim për një tërësi të mbifuqishme e dehëse. Ta dini pra: sërishmi të shihemi (*widesehen*) më mirë është sesa të jehet sërish së bashku -(wiedervereinigen), miqësia midis dy vetash është më e mirë nga shkrirja në një.

E prapë, është e vërtetë, ka arsye për t'u pyetur: kur kanë qenë gjermanët më pak neveritës sesa që janë sot? Kur kanë tërhequr kureshtjen e botës me lajme të mira, siç bëjnë kohëve të fundit? Kur, lajmet gjermane, posaçërisht rreth çështjeve ekologjike, kanë qenë për vetëvërtetshmerinë planetare, aq të dobishme, sikur sot? Dhe, më në fund, që sa kohë shkuan qëkur njerëzit në Mezo Evropë mund ta kenë ndenjëse se inteligjenca, e kuptuar në mënyrë afatgjate, është ajo e vetmja që ndoshta nuk mund të nënshtrohet?

Nga serbokroatishtja : M.Limani

Ky shkrim është kapitull nga libri "Profecla në gjermanishtë". I nxjerr nga përmbledhja e botuar në "Dedje novine", 1991, me titull "Tetovirani zivot".

IDENTITETI DHE KONFRONTIMI: SHQIPTARËT DHE SERBËT



ISUF BERISHA
ISUF BERISHA
ISUF BERISHA
ISUF BERISHA
ISUF BERISHA

1. Kriza aktuale jugosllave mund të definohet si konfrontim i Serbisë me komunitetet etnike të ish Jugosllavisë, në përpjekje për realizimin e projektit "të gjithë serbët në një shtet". Në raport me shqiptarët, sllovenët, kroatët dhe muslimanët-boshnjakët, ky konfrontim ka arritur intenzitetin më të lartë, që do të thotë se është ndërprerë çdo lloj i komunikimit që ka për qëllim rregullimin dhe ndërtimin e marrëdhënieve reciproke, përpos atij me forcë-dhunë. Konflikti i armatosur me sllovenët tashmë ka përfunduar, por komunikimi ende nuk është përtërirë. Komunikimi me maqedonët është reduktuar mjaft, por nuk është ndërprerë plotësisht, ndërsa në raport me malazezët elementet e konfrontimit koekzistojnë me ato të bashkëpunimit.

Më poshtë do të preket reflektimi i këtyre konfrontimeve në ristrukturimin e sistemeve të vlerave të komuniteteve etnike. Para së gjithash, do të shihen, nga ky aspekt, marrëdhëniet shqiptare-serbe, pa harruar me këtë rast se dinamika e zhvillimeve në komunitetin shqiptar, brenda pjesës më të madhe të tij, që shtrihet në Kosovë dhe në Serbinë jugore, është rezultat i këtij konfrontimi me Serbinë, ndërsa këto zhvillime brenda komunitetit serb varen edhe nga konfrontimet me komunitetet tjera et-

nike. Në të vërtetë, në mesin e konfrontimeve të përmendura të intenzitetit më të lartë, veçohen marrëdhëniet shqiptare-serbe, me faktin se shqiptarët dhunës që po ushtrohet mbi ta nuk lu përgjigjën me dhunë, por u përcaktuan për rezistencë paqësore. Prandaj, me sa duket, në këtë rast kemi edhe dallimin më të madh në mes të orientimeve vlerore me të cilat komunitetet etnike në ish Jugosllavi kanë hyrë në konfrontim.

II. Projekti "të gjithë serbët në një shtet" nuk është vetëm projekt i shtetit kombëtar. Ai është edhe (ose para së gjithash) projekt i ekspansionit të Serbisë në të gjitha ato terri-tore, të cilat, ku duke u thirrur në parimin etnik e ku edhe më shumë në mbështetje të argumentit historik, u shpallën toka serbe. Do të ishte e pasaktë nëse thuhet se ky projekt është projekt i dominimit. Ky është projekt i pastrimit etnik të terri-toreve të shpallura serbe.

Për realizimin e një projekti të këtillë anticivilizues, ishte i nevojshëm një ristrukturim politik dhe kulturor i Serbisë. Për homogjenizimin e serbëve, për mobilizimin e lëvizjes po-



pulliste-nacionaliste që do ta realizonte këtë projekt, ishte e nevojshme të mobilizohej historia dhe tradita. Prandaj u ftuan të vdekurit¹, u afirmuan ngjarje e periudha historike, norma të traditës e mentalitete të së kalurës, që do të mund të instrumentalizoheshin. Kjo natyrisht nënkuptonte nxjerrjen e tyre nga konteksti historik dhe social. Siç nënkuptonte, po ashtu, edhe rivlerësimin negativ të personaliteteve e ngjarjeve historike, si dhe vlerave që nuk ishin të përshtatshme për këtë instrumentalizim.

Projekti i Serbisë së madhe u ndërtua mbi çështjen e Kosovës. E këtui, në Kosovë, filloi edhe realizimi i tij. Prandaj ri-aktivizimi i mitit serb mbi Kosovën ishte hapi i parë i ri-definimit politik e shpirtëror të Serbisë. Kosova u shpall "djep i Serbisë" (?!), "zemër e Serbisë" (?!), "shpirt i Serbisë" (!!) dhe, mbi të gjitha dhe pra së gjithash "tokë e shenjtë e serbe"(?!)

Bashkë me kategoritë iracionale, në rrafshin e politikës, do të rehabilitohen autorët e mendimit politik që kishin projektuar ekspansionin e Serbisë. Nga ana tjetër, autorët që kishin pasur qëndrim kritik ndaj konceptimeve serbomëdha do të diskualifikohen "teorikisht" dhe do të anatemojnë "kombëtarisht". Shembull ilustrativ për këtë është rasti i socialdemokracisë serbe, e cila dha mbase kritikën më radikale në traditën e mendimit politik serb të apetiteve ekspansioniste të Serbisë. Për ata që donin t'i hynin realizimit të projektit "të gjithë serbët në një shtet", posaçërisht e pakëndhsme ishte figura e Dimitrije Tucoviqit, i cili kishte bërë një kritikë të pamëshirshme të aspiratave të Serbisë për pushtimin e Kosovës dhe daljen në bregdetin shqiptar². Qasja e tij korrekte dhe parimore ndaj çështjes shqiptare nuk është arritur kurrë më vonë nga autorët serbë. Diskualifikimi i veprës së tij si akombëtare-antikombëtare duket se ishte i domosdoshëm. Gjithnjë në këtë rrjedhë, kemi edhe reabilitimin e lëvizjes çetike³, karshi marginalizimit dhe terrorizimit të opozitës së vërtetë⁴.

Në planin kulturor mund të flitet për folklorizim e ritradicionalizim të fuqishëm. Pateitika historike dhe epika popullore kanë shtyrë temat bashkëkohore e vlerat universale. Sistemi vleror i epikës popullore, i cili glorifikon bashkësinë e mbyllur e të vetëmjaftueshme, është bërë orientim vleror dominant i Serbisë së sotme. Prandaj, mbyllja e Serbisë në vetë dhe konfrontimi me bashkësinë ndërkombëtare nuk është diçka akcidentale, por në logjikën e modelitorientimit të zgjedhur vleror.

Në përgjithësi, mund të flitet për një frymë të mosdurimit, ekskluzivitetit. Kjo po shprehet, pos tjerash edhe si ksenofobi, që është themel i teorive



të shumta mbi komplotin ndërkombëtar kundër Serbisë, të cilat janë bërë konstantë e opinionit zyrtar e publik serb. E projektuar në të kalurën, kjo formë ka çuar në heqjen dorë nga ato momente të identifikimit që ishin të përbashkëta me të tjerët. Kështu, fjala vjen, alfabeti cirilik është shpallur alfabet kombëtar dhe zyrtar serb, ndërsa ai latinik është shtyrë nga përdorimi publik. Nga ana tjetër, feja ortodokse shpallet dimesnion esencial, ose i vetëm i identitetit kombëtar serb. Lidhur me këtë, kemi riafirmimin dhe promovimin agresiv të ideologjisë së Kishës ortodokse serbe. Brenda saj riaktivizohen anate-mat për turqët dhe islamin si e keqe mitike, dhe shfrytëzohen tash për perceptimin e shqiptarëve si armiq të përjetshëm të serbëve, si "antinjerëz" të cilët për zot të vetin kanë *Të keqen*! Prandaj, në prizmen e kësaj logjike manikeje, ku Tjetri (shqiptari)

është mi-shërim i së keqes metafizike, për konfrontimin serb-shqiptar mund të thuhet edhe: "Kjo është luftë e njerëzve dhe të Jonjerëzve"! ⁶ Për politikën e ndërtuar mbi frymë të këtillë, është e kuptueshme vendosja e apartheidit në Kosovë (njerëzit ndahen nga antinjerëzit), siç është poashtu e kuptueshme që shqiptarët të përjashtohen ng puna, apo të vriten për shkak se janë shqiptarë (antinjerëz)! ⁷

III. Me projektin e Serbisë së madhe, për sa i përket Kosovës, synohet: (1) likuidimi i autonomisë së saj; (2) rivendosja e sistemit kolonial dhe (3) ndryshimi radikal me dhunë i strukturës etnike të popullsisë⁸. Shqiptarët këtij projekti iu përgjigjën me projekt të çlirimit kombëtar. Standardet e demokracisë perëndimore, si dhe proceset e perspektivat e integritetit evropian, si kontekst që aspiratet e Serbisë i nxjerrin anakrone e anticivi-



lizuese, bëhen model aspirativ i shqiptarëve. Shi për këtë, edhe çështja e realizimit të së drejtës për vetvendosje, çështja e çlirimit nga pushteti kolonial serb, shihet si çështje e demokracisë. Si rrjedhojë kemi edhe përcaktimin për rezistencë paqësore dhe zgjidhje politike të çështjes së Kosovës. Përvetësimi, nga ana e shqiptarëve, i një projekti të këtillë të çlirimit, i la pa mbështetje integrimi, pa kontekst funksional orientimet vlerore që ishin inkompatibile me të.

Këtu, para së gjithash, duhet përmendur tradicionalizmin, përndryshe mjaft të pranishëm në kulturën shqiptare, ose sjelljet dhe normat tradicionale ende të ruajtura në fshatin shqiptar, ku jetojnë shumica e popullatës së Kosovës. Për më tepër, ky projekt mobilizoi edhe aksione për të hequr dorë nga sjelljet në bazë të normave tradicionale. Me 1990, rinia kosovare organizoi një fushatë

për faljen e gjaqeve. Afro një mijë familje hoqën dorë nga hakmarrja, që sanksionohet me Kanunin e Lekë Dukagjinit, kod juridik dhe moral tradicional shqiptar. Nga ana tjetër, sjellje karakteristike e shqiptarëve sot është solidariteti. Në bazë të solidaritetit kombëtar, që nuk ekziston vetëm në nivel të organizuar nga shoqatat bëmirëse dhe Qeveria e Kosovës, por që, para së gjithash, si sjellje, si kualitet i përshkon marrëdhëniet e përditshme të njerëzve, janë zbutur pasojat e përjashtimit nga puna, nga ana e autoriteteve serbe, të mbi 100 mijë shqiptarëve, prej nga 160 mijë sa ishin të punësuar në sektorin shoqëror-shtetëror. Në bazë të këtij solidariteti, pas përjashtimit të profesorëve dhe asistentëve shqiptarë nga Universiteti i Prishtinës dhe ndalimit të mësimin në gjuhën shqipe, është organizuar një universitet paralel, i cili punon në një 200 shtëpi private dhe

objekte të tjera (kisha, xhami, etj) të Prishtinës. Po në bazë të këtij solidariteti dhe po në këtë mënyrë, pra nëpër shtëpi private dhe fshehurazi, është organizuar mësimi edhe në shkollat e mesme, të cilat u mbyllën nga autoritetet serbe.

IV. Nga sa u tha, shihet se projektet e konfrontimit janë bërë parime rredifinimi të sistemit të vlerave të komuniteteve, përkatësisht të sistemit të identifikimit, i cili përbëhet nga të gjitha ato gjëra me të cilat identifikohet një grup.

Procesi i këtij ridefinimi karakterizohet nga:

1) rivlerësimi i elementeve të sistemit ekzistues të identifikimit, në bazë të asaj se sa mund të instrumentalizohen këto për realizimin e projektit të konfrontimit;

2) rivlerësimi i historisë dhe traditës, ose inspektimi i muzeut të momenteve të identifikimit me qëllim të integritetit të elementeve të përshtatshme në sistemin e rikonstruktuar të identifikimit;

3) përvetësimi eventual i elementeve të reja ose të huaja të identifikimit.

Por, procesi i sipërskicuar i rekonstruktimit të sistemit të identifikimit nuk është karakteristik vetëm për konfrontime të grupeve. Në të vërtetë, raporti me Tjetrin është esencial për ndërtimin e sistemit të identifikimit. Ose, thënë ndryshe, sistemi i identifikimit ndërtohet në raport me Tjetrin. Georges Devereux (Devro) vëren se "identiteti i pastër" etnik mund të zhvillohet vetëm duke u ballafaquar me "të tjerët" dhe duke u dalluar nga atë tjerët, të cilëve-për çfarëdo arsyeje-u atribuohet identiteti "i ndryshëm etnik"⁹. Për më tepër, edhe ato periudha të marrëdhënieve normale ndërmjet grupeve përmbajnë edhe dimensionin e ballafaqimit. Shi për këtë mbase do të mund të

thoshin se me rastin e konfrontimeve intensive të grupeve vetëm fitojnë densitet të theksuar dhe bëhen më të dallueshme proceset dhe mekanizmat e ndërtimit të sistemit të identifikimit, që funksionojnë në periudhat e marrëdhënieve më të qeta. Nëse është kështu, atëherë do të mund të thuhej se grupet i ndërtojnë sistemet e veta të identifikimit në bazë të synimeve të veta. Ose po që se dikush preferon që tërësinë e momenteve të identifikimit ta quajë identitet, atëherë do të mund të thuhej se grupi e definon identitetin e vet me projektet e veta. Identiteti, pra, na del kështu kategori di namike dhe gjithnjë e hapur.

Shënime

1. Më 1989 eshtrat e knjaz Lllazarit, që u mund nga turqët në Betejën e Kosovës më 1389, u shëtitën në të gjitha ato territore që më vonë do të shpallen serbe. Në një manastir në Kosovë, titullari i lartë i Kishës Serbe do t'i drejtohet të vdekurit me këto fjalë: "Dobro dosao kneze(...) Dosao si da izvrsis smotru"(!) ("Mirë se erdhe knjaz (...) Erdhe të bësh rivistën e njësive!") Disa ditë më vonë, Slllobodan Millosheviqi, në megamitingun antishqiptar që u mbajt në Gazimestan (Kosovë) do të shpallë fitoren mbi shqiptarët dhe do të paralajmërojë fillimin e luftës.

2. Dimitrije Tucoviq (1881-1914), një ndër figurat më të spikatura të social-demokracisë serbe në fillim të shekullit

20. Vepra e tij më e rëndësishme është "Srbija i Arbanija: jedan prilog kritici zavojevačke politike srpske burzoazije" (Serbia e Shqipëria, një kontribut për kritikën e politikës pushtuese të borgjezisë serbe).

3. Lëvizje ekstreme nacionaliste, e cila në Luftën e Dytë botërore u rrjeshtua në anën e forcave fashiste dhe bëri krime në masë ndaj popullsisë civile. Partia radikale serbe është sot partia e dytë për nga madhësia në parlamentin e

të ashtuquajturës Jugosllavi dhe mburret publikisht me njësitë e veta paraushtarake.

4. Në përgjithësi, vëzhguesit dhe analizuesit e skenës politike serbe pajtohen se në mes politikës aktuale dhe opozitës nuk ka dallime esenciale, për sa u përket qëllimeve strategjike. Sociologu beogradas Slllobodan Iniq, lidhur me këtë, shkruan: "Në esencë, pushteti dhe opozita në Serbi janë shumë më afër sesa duket. Ato plotësohen në mënyrë nacionaliste, por përjashtohen personalisht. Sikurse që e gjithë kritika e pushtetit ndaj opozitës është pushtetmbajtëse, njashu edhe opozita synon rrëzimin e pushtetit në bazë të politikës së njëjtë nacionaliste. Dallimi është vetëm në ngjyrë, derisa socialistët e Millosheviqit janë bartës të nacionalizmit "të kuq", opozitarët marshojnë me mantelin e nacionalizmit "të zi", tradicional serb." (Borba, 22-23.02.1992).

5. Në një shënim lidhur me një vjershë të Ranko Jovoviqit me titull "Raspece" (Kryqizimi) kushtur Gjorgje Martinoviqit, mund të lexojmë: "U pjesmi je, to se ljudskim srcem vidi, i asocijacija na naseg brata Djordje Martinovica. Onaj kolac, na kojem je, ipak ne samo mucen, nego usmrćen-antihristi, antiljudi (nënvizoi I.B) ljube kao simbol svoga boga-zla, mi Srbi drzimo da je to znak najcudesnijeg javljanja Hristova lika u ovom nehriscanskom vijeku. Na tom kocu Djordje se ponovo rodio u nama." (Cituar sipas START-it, nr.543, 11.11.1989). Rezultatet e hetimeve policore treguan se Gj. Martinoviq kishte lënduar veten, duke u vetkënaqur me një shishe, por propaganda serbe e shpalli atë si viktimë dhunimi nga ana e shqiptarëve.

6. "Ovo je borba ljudi i neljudi"-Parullë nga një miting popullist antishqiptar, i mbajtur në Krallëvë më 22 shtator 19888.

7. Më 1990, autoritetet serbe vendosën që nxënësit serbë të shkojnë në shkollë para dite, kurse ata shqiptarë pas dite. Po kështu, u veçuan serbët nga shqiptarët në konviktet e studentëve në Prishtinë. Ndërsa në pishinën e vetme të kryeqytetit të Kosovës, pasi kjo u bekua nga prifti serb, shqiptarëve u është ndaluar hyrja. Pas de-

mostratave të marsit 1991, të mbajtura në Beograd, me ç'rast u vranë dy veta, një zyrtar i lartë i policisë u arsyetua në Parlamentin e Serbisë se sikur të kishin ndodhur demonstratat të tilla në Kosovë do të vritëshin të paktën 100 veta! Mbi 100 mijë shqiptarë janë përjashtuar deri më tash nga puna për arsye etnike-politike.

8. Serbia e pushtoi Kosovën më 1912, të cilën më parë e kishin çliruar shqiptarët, pas tri vjet kryengritjesh kundër Turqisë (1909-1912). Meqë Konferenca e ambasadorëve në Londër më 1913 i njohu rezultatet e këtij pushtimi, Serbia, pas Luftës së Parë botërore, tash në kuadër të Jugosllavisë, vendosi në Kosovë një sistem të egër kolonial dhe filloi përpjekjet sistematike për ndryshimin me dhunë të strukturës etnike të popullsisë, që do të vazhdojë deri më 1966, me një ndërprerje gjatë Luftës së dytë botërore.

9. Georges Devereux: "Komplementaristicka etnopsihoanaliza", August Cesarec, Zagreb 1990, f.205.

Isuf Berisha:

Identity and Confrontation: Albanians and Serbs

Beginning with a definition of the present Yugoslav crisis as one involving Serbia's confrontations with other ethnic communities in former Yugoslavia with the aim of realizing the project of "All Serbs in the Same State", the author considers the ways in which these confrontations have reflected upon the reconstruction of those ethnic communities' valuesystems. The author concentrates here on Albanian-Serb relations, from which he draws the conclusion that ethnic communities' projects for confrontation have become the principles for redefinition of their identification systems.



GAZMEND
GAZMEND
GAZMEND
GAZMEND

POLICENTRIZMI SUBJEKTOR I KOMBIT SHQIPTAR NË BALLKAN

ZAJMI
ZAJMI
ZAJMI
ZAJMI



Çështja e Kosovës e vështruar si dimension integral i çështjes shqiptare në Ballkan, e sugjeron në mënyrë të natyrshme elaborimin e një prej temave bosht mbi çështjen e Kosovës, që do të mund të përcaktohej si vështrim i relacionit ndërmjet çështjes së Kosovës, përkatësisht Republikës së Kosovës dhe programit kombëtar shqiptar.


Natyrisht se me këtë rast vështrimet e kondensuara mbi programin kombëtar janë kryesisht në funksion të vështrimit të këtij relacioni.

Pyetja eventuale paraprake se a kanë shqiptarët sot program kombëtar apo jo, do t'i gjasonte pyetjes se a kanë britanikët

kushtetutë apo jo. Rreth kësaj pyetjeje të fundit është shënuar se Chesterfieldi (Çesterfild), shtetar dhe shkrimtar anglez (1694-1773), të ketë thënë: "Kushtetuta jonë është mbështetur në vetë ndjenjën e përbashkët (common sense)".

Mosekzistimi i programit kombëtar në një të vetmin dokument programor nuk do të thotë dhe mosekzistim i orientimeve themelore programore kombëtare të përmbajtura në forcat intelektuale, shkencore dhe politike të një vendi, përshkuar me konsensus gjithëkombëtar ose me konsensus dominant në gjiun e kombit.

Natyrisht se bashkë me ekzistimin e konstanteve të caktuara të programit kombëtar



të trashëguara nga lëvizja kombëtare, të cilat vazhdojnë të jenë vertikale ndërmjet historisë dhe bashkëkohësisë, rrethanat bashkëkohore, lëkundjet gjeopolitike në hapësirë, lëvizjet në vetë përmbajtjen e fenomenologjisë nacionale bashkëkohore, shtrojnë gjithëherë nevojën e bashkëkohësimit, begatimit, adaptimit dhe të elaborimit konkret të segmenteve të caktuara të programit kombëtar. Duke mos mohuar pra nevojën e mëtutjeshme të rishqyrtimeve, trajtesave dhe refleksioneve mbi programin kombëtar shqiptar, do thënë se shqiptarët e kanë programin e tyre kombëtar që nga Rilindja Kombëtare që ngërthente në vetë dhe idenë e subjektivitetit sa më të lartë politik të kombit në përputhje me rrethanat, idenë e barazisë kombëtare dhe idenë e bashkimit kombëtar si dhe idenë e vetëvendosjes kombëtare (pa marrë parasysh se a përdorej ky togfjalësh në rrafshin leksikor), dhe idenë e respektit reciprok me kombet e tjera dhe të fqinjësisë së mirë pa pretendime në hapësira të huaja etnike. Ideja e vetëvendosjes kombe-

tare që formuluar posaçërisht në mënyrë ekspresive në vetë aktin e pavarësisë së Shqipërisë.


Çdo gjeneratë e kombit mendon për vetë se jeton në udhëkryqin historik. Aq më pak sot kjo ndjenjë mund të mos jetë prezente, kur këtë udhëkryq historik për fatet e kombit janë duke e sajuar lëkundjet e mëdha gjeopolitike në një pjesë të Ballkanit, duke përfshirë dhe territoret etnike shqiptare; janë duke e sajuar lëvizje të mëdha në jetën politike të kombit. Së këndejmi parimi i vetëvendosjes kombëtare sot është dhe duhet të jetë parimi strumbullar i programit kombëtar shqiptar. Ky parim është njëherësh dhe parim paraprijës demokratik ndaj parimit të bashkimit kombëtar. Por, parimi i vetëvendosjes kombëtare nuk mund të vështrohet në mënyrë të simplifikuar, si ndonjë parim i thjeshtë taktik në funksion të parimit të bashkimit kombëtar. Parimi i vetëvendosjes kombëtare është parim me kuptim të gjërë, i cili vazhdon të vlejë edhe në kushte të kombit të bashkuar dhe të lirë, që ai të vendosë në gjiun e tij

lirisht për të gjitha çështjet kapitale të rendit të tij, për fatet e tij historike si dhe për procese integrative (me brendi të ndryshme) qoftë në Ballkan, qoftë në Evropë. Parimi i vetëvendosjes është parim me vlerë të pashtershme për të gjitha fazat historike të kombit, për të gjitha gjeneratat e tij. Vendimet e një gjenerate të kombit në çështje kapitale të cilat i nxjerr ajo në përputhje me rrethanat dhe horizontet e saj botëkuptimore nuk mund t'i obligojë gjeneratat e ardhshme. Nga kjo rrjedh se parimi i vetëvendosjes, posaçërisht atëherë kur e aktuelizojnë udhëkryqet historike, është parim më i lartë njerëzor dhe kombëtar me substancë vetanake njerëzore dhe kombëtare, qoftë për kombin si tërësi, qoftë për pjesët e tij, varësisht nga konteksti historik dhe gjeopolitik. Së këndejmi, parimi i vetëvendosjes kombëtare paraqitet njëherësh dhe si një një themelore e programit kombëtar, nëpër të cilën përshkohen dy parime të tjera të mëdha të programit kombëtar: parimi i lirisë kombëtare dhe ai i bashkimit kombëtar.

Duke filluar pikërisht nga parimi i vetëvendosjes kombëtare, programi kombëtar do të mund të përmbledhej në shtatë parime themelore:

1. Parimi i vetëvendosjes kombëtare;
2. Parimi i lirisë kombëtare;
3. Parimi i bashkimit kombëtar;
4. Parimi i prosperitetit demokratik të kombit;
5. Parimi i prosperitetit shpirtëror, material dhe ambientel i kombit, me theks të veçantë në arsimin kombëtar;
6. Parimi i solidaritetit kombëtar;
7. Parimi i kultivimit të fqinjësisë së mirë dhe i miqësisë me kombe të tjera, me theks të veçantë në përkrahjen dhe inkuadrimit në proceset integrative në Evropë.

Këtyre shtatë parimeve do të mund t'i bashkoheshin tri qasje themelore metodologjike ndaj çështjes kombëtare, të ndërlidhura organikisht me parimet e përmendura. Këto qasje po i shqiptojmë vetëm në trajtë indikimi:



1. Vështirë se mund të flitet për program kombëtar të kompletuar në të cilin përveç parimeve, vizioneve dhe qëllimeve, nuk do të përfshiheshin dhe rruget, prosedetë bazë me produktive të arritjes së tyre në përputhje me rrethana të kohës dhe drejtimet zhvillimore në të. Gjatë historisë kombëtare, personalitetet e shquara të saj, krahas vizioneve të tyre kombëtare gjithëherë i kanë ndierë dhe koordinatat kohore dhe hapësinore si dhe bërthamën zhvillimore në kryqëzimin e këtyre koordinatave;

2. Vështirë se mund të flitet për program kombëtar parimor të cilitdo komb pa vështrim me të njëjtat kritere etnike dhe të programeve kombëtare të popujve fqinjë. Trojet që dikur në Ballkan kishin shumicë etnike shqiptare dhe kur edhe sot në një mënyrë ose në një tjetër vazhdon të ketë puls shqiptar në to, mund t'i takojnë botës sonë emocionale, i takojnë interesit tonë të themeltë kombëtar dhe ndërkombëtar për ruajtjen dhe kultivimin e komponentës njerëzore, kulturore dhe kombëtare shqiptare në to, por kurrësi nuk mund të jenë lloj i atij resentimenti që do të përfshinte synimin tonë për rikthimin e tyre në hapësirën territoriale kombëtare shqiptare;

3. Vështirë se mund të flitet për program kombëtar bashkëkohor pa perceptim dhe konceptim bashkëkohor dhe të vetë kombit, si dhe të aspekteve bashkëkohore fenomenologjike si të kombit, ashtu dhe të jetës bashkëkohore në përgjithësi, duke përfshirë këtu posaçërisht teknologjitë e reja të komunikimit në shoqëri, shkallët më të avansuara vlerësore bashkëkohore etj.

Fokusuar në këtë kontekst të parimeve dhe qasjeve themelore të programit kombëtar, Republika e Kosovës, përkatësisht funksionimi i lirë i saj, është jo vetëm organikisht e lidhur me programin kombëtar, por sot është edhe pjesë organike e programit kombëtar mbarëshqiptar. Është pjesë e programit kombëtar shqiptar, meqë si e tillë ngritet mbi parimin bazë të programit kombëtar shqiptar, atë të vetëvendosjes.

Është pjesë organike e programit kombëtar, meqë në përputhje si me kushtet reale të kohës, ashtu edhe me vizionet, lidhet organikisht me të gjitha parimet e përmendura të programit kombëtar, duke qenë si e

tillë vlerë më vete dhe jo ndonjë hap taktik i kohës; Republika e Kosovës është vlerë më vete me vetë faktin se rreth një të tretën e kombit shqiptar në Ballkan, dhe rreth dy të tretat e popullit shqiptar nga hapësira e ish-Jugosllavisë i ngrit në subjekt vandimtar politik, i cili vendos vetë për fatet e veta kombëtare dhe politike. Lidhur me Republikën e Kosovës qëndron një botë e tërë sakrificash, rrekjesh të mëdha masive dhe gjakimesh të popullit shqiptar të Kosovës për pavarësi dhe subjektivitet dhe dinjitet të plotë në truallin e tij jetësor, duke mos u mohuar asnjëherë trajta sa më të lartë të barazisë institucionale edhe kolektiviteteve të tjera nacionale në Kosovë. Sikur të mund të arrihej bashkimi kombëtar me anë të një hopi në këtë udhëkryq historik të zhbërjes së Jugosllavisë së mëparshme, kjo do të ishte gjëja më e pëlqyeshme në kuadër të parimeve të programit kombëtar shqiptar. Mirëpo, korja e sotme gjeopolitike në Ballkan është ende e zhbravitur për së tepërmi dhe e strati-fikuar me vija të padrejta të ndarjeve etnike, ndonëse sot shënohen dhe lëkundjet e këtyre vijave. Këto vija mund të lëkunden në dobi parimore të programit kombëtar në mënyrën më efikase nëpërmjet polisubjektivitetit të kombit shqiptar në Ballkan, me kultivim të njëkohëshëm të konvergencës dhe proceseve integrative kombëtare. Historia njih realizime të bashkimit kombëtar edhe me hope, por këto hope gjithëherë kanë pasur pas vetes periudha të gjata të akumulimit të energjisë kombëtare për hope të tilla, ose, kanë qenë thjeshtë produkt i fatit në kuadër të ngjarjeve dhe ndryshimeve të mëdha gjeopolitike në përpjestime kontinentale, në vorbulla të luftërave kontinentale ose pas tyre, të shoqëruara me konferenca ndërkombëtare me vendosje për rikufizime në mes shtetesh dhe popujsh. Së këndejmi, duke i lejuar vetes këtë përcaktim terminologjik, policentrizmi subjektor i kombit shqiptar sot në Ballkan i përcaktuar me Shqipërinë, Republikën e Kosovës, komplementaur me kahe të kantonizimit demokratik (federalizmit) të Maqedonisë, në kuadër të të cilit do të ekzistonte kantoni i shumicës etnike shqiptare në Maqedoni i quajtur si "Pjesë-Maqedonia shqiptare", dhe gjithashtu i komplementuar me status autonomiteti

politik të trojeve të shumicës etnike shqiptare në jug të Serbisë (Preshevë, Bujanoc, Medvegjë) dhe i trojeve me shumicë etnike shqiptare në Mal të Zi, do të ishte dispozitë konkrete programore e kohës në kuadër të programit kombëtar shqiptar, që ndërlidhet me të shtatë parimet e përmendura të programit kombëtar.

Nuk ka asnjë dyshim se Republika e Kosovës, përkatësisht funksionimi i lirë i saj, paraqitet si bosht kurrizor i kësaj dispozite programore mbi policentrizmin subjektor, jo vetëm për shak të masës demografike kombëtare në të, por dhe për shak se entiteti i lirë i saj në mënyrë cytëse dhe pozitive do të ndikonte në subjektivitetin e shqiptarëve në të gjitha trojet etnike të tyre në hapësirën e ish-Jugosllavisë dhe anasjelltas. Funksionimi i lirë i Republikës së Kosovës do të ndikonte pozitivisht dhe në pozitën e shqiptarëve në diasporë, qoftë në hapësirën e ish-Jugosllavisë, qoftë edhe më gjerë.

Në momentin aktual historik rruga e zgjidhjes së çështjes shqiptare në Ballkan, qoftë në aspekt të prosperitetit të gjithë pjesëve të kombit, qoftë në aspekt të integritetit kulturor dhe ekonomik të hapësirës kombëtare, qoftë dhe në aspekt të bashkimit kombëtar me plot kuptimin e fjalës, -çon nëpërmjet të policentrizmit subjektor të kombit shqiptar në Ballkan. Ky policentrizëm nënkupton se kudo ku pjesët e kombit shqiptar gjenden në pozitë të shumicës etnike territoriale në makroproporcione, ngriten në nivel të subjektit politik territorial. Është fjala për një zgjidhje sintetike politike të kohës që shton forcën akomoduese të kombit shqiptar si ndaj rrethanave ndërkombëtare të kohës, ashtu dhe ndaj të gjitha parimeve themelore të programit kombëtar. Këtu qëndrojnë dhe vlerat e raportit konkret ndërmjet Republikës së Kosovës dhe programit kombëtar shqiptar. Policentrizmi subjektor i kombit shqiptar në Ballkan në këtë stad të rrjedhave në Evropë, nuk është faktor i ndarjes kombëtare, por përkundrazi, në kushte të trashëgura të ndarjeve gjeopolitike të kombit, është faktor i ngritjes së subjektivitetit kombëtar, i integriteteve kombëtare dhe i proceseve të bashkimit kombëtar.

Raporti organik ndërmjet Republikës së

Kosovës dhe programit kombëtar do vështruar gjithashtu nga prizmi i prosperitetit demokratik të kombit shqiptar si dhe nga prizmi i parimit të fqinjësisë së mirë dhe miqësisë ndërmjet kombëve në proceset integrative në Evropë, si dy parime që programin kombëtar shqiptar e bëjnë dhe duhet ta bëjnë gjithnjë më të realizuar si program demokratik kombëtar, me vlera të larta njerëzore dhe demokratike.

Nisur nga këto postulate demokratike të programit kombëtar, Republika e Kosovës dhe funksionimi i lirë i saj nuk mund të nëkuptojë çfarëdo lloj republike, të cilës do t'i mjaftonte vetëm pavarësia dhe sovraniteti kundruall subjekteve tjera shtetërore dhe ndërkombëtare.

Në kuadër të programit demokratik kombëtar dhe në raport me të, bëhet fjalë për një Republikë të Kosovës thellësisht demokratike, për republikë të hapur, në veçanti plotësisht të hapur ndaj Shqipërisë, por dhe ndaj Maqedonisë, Serbisë dhe Malit të Zi.


Bëhet fjalë për një Republikë të Kosovës, ku krahas funksionimit të lirë dhe të plotë të hapësirës kulturpre integrative shqiptare, lirshëm funksionon dhe hapësira kulturore për serbët dhe të gjitha nacionalitetet e tjera, sado të jenë demografikisht të mëdha apo më të vogla;

Bëhet fjalë për Republikën e Kosovës ku njëherazi respektohet edhe struktura reale etnike e saj në strukturën e organeve shtetërore, por dhe principi kooparticipativ i të gjitha nacionaliteteve të Kosovës në jetën shtetërore politike dhe publike;

Bëhet fjalë për funksionim të lirë të Republikës së Kosovës në të cilin dëshirohet që Kosova të jetë zonë e demilitarizuar e Ballkanit dhe e Evropës, me garanci ndërkombëtare të pavarësisë së saj;

Bëhet fjalë për Republikë të Kosovës ku në mënyrë skrupulloze do të respektoheshin liritë dhe të drejtat e njeriut, barazia e qytetarëve dhe parimi i sundimit të të drejtës me aspirim të njekohëshëm për prosperitet sa më të lartë shpirtëror dhe material të të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve nacionale të saj.





ANTON KOLË BERISHAJ
ANTON KOLË BERISHAJ
ANTON KOLË BERISHAJ
ANTON KOLË BERISHAJ
ANTON KOLË BERISHAJ
ANTON KOLË BERISHAJ



MAËSORËT
DHE
MALAZEZËT
NGA
DESTRUKSIONI
DERI TE SJELLJET
SIMBIOTIKE

Divergjenca që del nga përmbajtja e nocioneve *destruksion* dhe *simbozë*, manifestohet sidomos në rrafshin e komunikimit ndëretnik. Ato, në të vërtetë, janë moduse të kontaktit të drejtpërdrejtë të dy palëve, që janë të detyruara të jetojnë pranë apo me njëra-tjetrën. Vija kufitare mund të jetë rigjide apo formale, por, si e tillë, është rezultat i raportit të forcave dhe luan rol të dyfishtë: njëkohësisht ndanë dhe bashkon. Sjelljet simbolike, si gjendje komunikimi, manifestohen me spontanitet, tolerance dhe përfillje të përmbajtjeve të ndryshme. Ato nënkuptojnë fqinjësi korrekte. Nëse nuk përmbushen këto kushte, komunikimi ndëretnik perceptohet si destruktiv. Destruksioni, si modus i komunikimit ndëretnik, manifestohet si dhunë që çon kah shkatërrimi. Për nga vrazhdësia, ai oscilon prej formave të imponimit të indentifikimit me modelin, e deri te akulturizimi dhe asimilimi¹.

Modeli i komunikimit ndëretnik, për të cilin do të bëjmë fjalë, i përmbush kriteret e shembullit karakteristik, me veçoritë e të

gjitha formave të sjelljeve në kontaktet ndëretnike. Retrospektiva historike zbulon larmi modusesh që fillojnë me destruktivitet, agresion, pushtim rrënim etj., dhe përcillen me procesin e identifikimit me okupatorin, akulturizimin, asimilimin, shpërnguljen. Me shpresë se ngjarjet në këto vise nuk do të marrin kahje që të më demantojnë, në vitet e fundit hetohet një tendencë e ripërtirjes së periudhave simbiotike në komunikimin ndëretnik malësor-malazez.

Edhe analiza më sipërfaqësore, nga çfarëdo këndvështrimi, do të zbulojë ngjashmëri dhe afërsi në mënyrën e organizimit dhe në stilin e jetës së grupeve etnike fqinje të brezit dinarik. Ky fakt dominon në veprat e shumicës së hulumtuesve të këtij regjioni që shquhet me agonalitet dhe zgrip ekonomic, bujqësi ekstensive, blegtori primitive ekzistencë të rrezikuar nga uria, por edhe nga rrethi tejet agresiv.

Antropogjeografi i njohur jugosllav Jovan Cvijic, edhe pse i ngarkuar me shpjegime dhe qasje tendencioze, që shpesh arrijnë

nivelin e shtrembërimeve shoviniste, sidomos kur flet për kufijtë e paraardhësve të tij, në rastin e brezit dinarik heq dorë nga kombinimet. Duke folur për shqiptarët dhe malazezët, Cvijiqi në të vërtetë dëshiron të flasë mbi banorët e brezit të caktuar gjeografik, duke abstrahuar veçoritë e tyre etnike. *"Në rrafshin e kësaj kulture, jetojnë fiset dhe popujt fizikisht më të fortë dhe etnografikisht më të freskët të Gadishullit Ballkanik. Thelbin e këtij brezi kulturor e përbëjnë bjeshkët e Malit të Zi, të viseve fqinje të Hercegovinës, rajoni i Sjenicës dhe Shqipëria e Veriut... Këto janë fiset më të frytshme dhe më ekspansive, prej të cilave vazhdimisht rrjedhin valë popullzuese, që i vërshtojnë fiset fqinje. Të gjithë janë kryesisht blegtorë. Ata janë të shëndoshë dhe të fuqishëm, kryesisht shumë të gjatë, elegantë, mjaft elastikë, kurrë të trashë, me fytyrë plot shprehje, me mollëza të theksuara, sy shqiptarë: lloji më i bukur i Gadishullit Ballkanik."*¹

Me citatin që pason, padyshim kompletohet portretizimi i banorit ideal, jo vetëm të Gadishullit Ballkanik... *"Edhe më tepër i forcon morali malor me veti ritere, shpesh të zgjedhura me ndjenjë të thellë për bashkësi dhe vetëmohim, që nuk dobësohet as para fljimeve më të shtrenjta."*² Mirëpo, siç shihet, Cvijiqi as kësaj radhe nuk e ka ndërmend të hyjë në prognozatat e pamiradishme rreth përcaktimit eventual të modelit dominues dhe të subjektit të nënshtruar. Përpjekjet e këtilla ose do ta zhgënjenin dhe lëndonin sedrën e ndieshme të shkencëtarit të madh, ose do ta shtynin në shpjegime subjektive, siç ndodhi me shumë spekulatore, bashkëkombës të tij. Pas portretizimeve kaq të qëndisura, vërtet është vështirë që nga tërësia të shpëputet ndonjë pjesë dhe të shndërrohet në viktimitë. Kujt t'i përshkruet vetia e gjunjëzimit dhe kujt e dominimit? Fundja, përveç kërkimesë shkencore, kjo nuk do të zgjidhte asgjë, por megjithatë, vazhdon të jetë preokupim i shkencëtarëve të mirëfilltë³ dhe i atyre që ashtu e quajnë veten. Kjo nyjë, e "zgjidhur" kryesisht sipas origjinës së autorit, edhe sot e gjithë ditën shërben si atu spekulative për mëveshjen e primatit apo mohimin e së drejtës mbi truallin ku jetojnë.

Me analizën e gojëdhënave vërtet të pasura popullore mbi origjinën e përbashkët të disa fiseve shqiptare dhe malazeze, mund të hasim në periudha kohore të komunikimit ndëretnik simbiotik, por jo edhe në formulën e zgjidhjes së sigurt të problemit. Gojëdhënat popullore, që shquhen me përputhshmëri dhe pastërti të pabesueshme nga çfarëdo tendence e përvetësimit dhe e paragjykimit shovinist⁴, dëshmojnë edhe për ekzistimin e proceseve asimiluese, gjë që nuk vihet në dyshim. Diskutabile është vetëm kahja e këtij procesi, si dhe rrethanat në të cilat ka ndodhur! Në të vërtetë, kjo është problematike për atë sa mungon gatishmëria e pranimi të fakteve relevante, që i ofron historia. Sidoqoftë, kjo nuk është temë kryesore e shqyrtimit tonë, prandaj përjashtohet nevoja e grumbullimit të fakteve që çojnë kah sqarimi dhe spastrimi i dilemave.

Komunikimi ndëretnik simbiotik

Faktografia historike e periudhës para-otomane dëshmon për luftëra të shpeshta dhe komunikim tejet destruktiv ndëretnik në këto vise. Është periudhë e adaptimit në fqinjësi me ardhacakët sllavë, që, për ndryshim prej të gjithë agresorëve, nuk kanë karakter kalues. Këta luftojnë për pushtimin e tokave dhe për përforcimin e pushtetit mbi to. Sipërfaqet e kufizuara të tokës pjellor bëhen mollë sherri, që helmon marrëdhëniet fqinjësore, duke shkaktuar situata konfliktoze shekuj me radhë. Baticat dhe zbaticat luftarake krijojnë, megjithatë, një këmbim përvojash, veçorish kulturore, shkathtësisht në ekonomizim, organizim dhe stil të jetës etj. Mirëpo, kjo ende nuk mjaftonte që të bëhet bazë mbi të cilën do ndërtohej komunikimi simbiotik ndëretnik. Kjo ndodhi vetëm me depërtimin e turqve në Ballkan.

Para fantomit aziat, rreziku ishte i përbashkët. Kjo është rrethanë që i përmbyllë dhe i tejkalon konfliktet e rëndomta lokale, duke krijuar nevojën e organizimit të frontit të përbashkët mbrojtës. Si rezultat të aleancës së dhunshme, historia shënon betejat të përgjakshme, që malësorët dhe malazezët zhvillojnë kundër ushtrisë turke.



Më të njohura janë ato të viteve 1612, 1613, 1686, 1687, 1688, 1692 etj⁵.

MALESIA është njëri prej regjioneve të shumta ndër viset shqiptare që mbajnë të njëjtin emër. Është sinonim i visit malor dhe të varfër. Shtrihet në verilindje të Podgoricës, kryeqytetit të Malit të Zi, në komunën e të cilës pjesëmarrja me vendbanime (gjithsej 38) arrinë 25,3%, ndërsa me banorë rreth 10%⁶. *Malësia e Madhe, apo e Mbishkodrës*, për të cilën flitet në këtë punim, shquhet me një të kaluar përplot kryengritje, luftëra, sidomos kundër pushtuesve osmanë dhe malazezë, që shpërblehet me pavarësi dhe vetëadministrim brenda Perandorisë Osmane. Ishte kjo një oazë në botën e pushtuar, ku rueshin me sukses gjuha, religjioni, doket, zakonet, rregullimi gjinor-fisnor dhe kontinuiteti kulturor. Shkëmbi i thatë dinarik ishte aleati më i mirë i banorit të maleve. Ai ishte inkurajues për të, po aq sa ishte dekurajues për pushtuesin i cili, objektivisht, përveç qëllimit për të nënshtruar, nuk kishte ndonjë dobi tjetër. Kjo harmoni e rrallë e qëndrimeve të të dy palëve kundërshtarë, banorit të këtyre maleve i krijonin hapësirë për vetëbesim dhe jomodesti që shpesh shpaguhet me gjak. Iluzioni mbi visin e pamposhtur, sidoos në periudhën e rilindjes kombëtar, malësinin e bën sinonim të guximit, qëndrueshmërisë, vetëmohimit, patriotizmit etj.etj. Të gjitha këto virtyte i ndan me popullatën fqinje, malazeze, që është edhe një fije e re që i

lidh fqinjët aleatë. Mirëpo, së shpejti do të këputen fjet lidhëse dhe sjelljet simbiotike, kryesisht për shkak të ambicieve malazeze që të zgjerojë territorin dhe të konstituohet si shtet, me përkrahjen e Rusisë dhe të Serbisë.

Me ndryshimet që ndodhin në raportin e forcave të fqinjëve aleatë, bëhen kthesa radikale edhe në rrafshin e komunikimit ndëretnik në këtë regjion. Dobësimi gradual i Perandorisë otomane ndikon në ndryshimin e kursit politik të shumë fuqive në Evropën e atëhershme, madje edhe të principatave xhuxhe, siç ishte Mali i Zi. Nga një territor i lidhjeve fisnore, malor dhe i ngushtë, lindin e ushqehen ambicie që të përkrahjet një politikë ekspansioniste. Hapi i parë për t'u realizuar kjo politikë bëhet në drejtim të territoreve shqiptare, nga të cilat tërhiqet Turqia. Kjo është koha kur sjelljet fqinjësore simbiotike shndërrohen në sjellje destruktive. "*Pas luftës çlirimtare të Malit të Zi me Turqinë (1876-1878), kriza lindore në këtë hapësirë nuk u ndal. Ajo u shndërrua në konflikt rreth caktimit të kufirit malazezo-turk në anën e Shqipërisë*"⁷.

Ndonëse popullata e rrafshit të Malësisë përfshihet me procesin e islamizimit shumë më vonë se viset e tjera, përçarja fetare, si dukuri evidente në këto vise, aktualizohet më vonë. Me këtë fakt shpjegohet edhe qëndrimi jokompakt i banorëve të Malësisë ndaj agresorëve. Elementi islam, ndonëse numerikisht më i vogël, refuzonte çfarëdo aleance për luftë kundër Turqisë. Nga ana tjetër, elementi katolik, një kohë të gjatë i inkadruar në levizjet antiosmane, aspiratat grabitqare malazeze nuk i përcëpton si të tilla. Kjo ishte arsyeja që një numër i konsiderueshëm prijësisht fisnorë dhe individë të tjerë me ndikim mashtrohen se lufta kundër Turqisë do të thotë çlirim, e jo pushtim i ri. Një situatë e këtillë, jo e rëndomtë për Malësinë kompakte dhe luftarake, pjesërisht tejkalohet me angazhimin e klerit katolik. "*Priftërinjtë katolikë gjithkund... nëpër katunde dhe qendra trimëronin dhe motivonin latinët që të shkojnë në luftë kundër malazezvetë cilët i quajnë të pafë*".⁸ Duhet theksuar se kjo propagandë demaskuese zhvillohet në

kohën kur ende nuk shihet korniza e shtetit të ri shqiptar.

Ndonëse kompaktësia territoriale mbështetej dhe ruhej nga rregullimi gjinoro-fisnor, që funksionon në frymën e të drejtës zakonore, Malësia si territor nuk pati pretendime të organizohej politikisht. Familja është bazë e fortë e bashkësisë së gjerë e cila ka tendencë të forcimit dhe të pavarësimit aq sa t'i mjaftojë vetëvetes. Mirëpo, ky stil i jetës nuk është në funksion të mbylljes së saj. Përkundrazi, ajo shquhet me çiltëri të nevojshme, për virtytin e mikpritjes dhe të besës. Ajo është në shërbim të vëllazërisë dhe të fisiet, por edhe strehim i mysafirit dhe i nevojtarit. E. Durkheim do ta quante bashkësi të solidaritetit mekanik⁹. Edhe si e atillë, Malësia kishte forcë t'u përballonte sulmeve malazeze, por luftën e humbi jashtë fushëbetejës, në takimet e diplomatëve të fuqive të mëdha. Kështu ndodhi më 22 prill 1880; më 22 mars 1913 (në Konferencën e Ambasadorëve në Londër; më 24 nëntor 1918; pas luftës së II-të botërore etj.¹⁰

Kur komunikimi ndërtnik i fqinjëve të barabartë shndërrohet në raport të palëve të armiqësuar, sjelljet simbiotike shndërrohen në sjellje destruktive. Përforcimin e pushtetit mbi pjesët e dhuruara të Malësisë, aleati i dikurshëm e kryen me fushata të papara dhune dhe terrori. "Paraleisht me pushtimin ushtarak... filon edhe procesi i çarmatimit"⁴, që, sidomos për banorët e këtyre viseve, më tepër është akt i përçmimit dhe i degradimit moral sesa ndonjë preventive politike. Çarmatimin mashkulli malësor e përjeton si rënie në nivel të femrës, sepse arma, jo vetëm që e mbron atë, por e avancojnë në krijërkë të tradicionale, nga prona e prindërve të tij, në pronën e bashkësisë¹¹. Instanca më e lartë dhe më me ndikim në bashkësinë e këtillë, angazhohet për të ndërprerë fushatën e ndjekjeve dhe të burgosjeve, ku çarmatimi shërbente si pretekst. "Lutja e kryetarit të fisit Grudë, Dedë Nika, të cilin ia dorëzon agjytantit kujdestar, Janko Vukotići, që pengjet nga Gruda të lirohen nga burgu i Podgoricës më 18.12.1912."¹² është dëshmi e shkallës së represionit mbi popullatën malësore fqinje. A është marrë parasysh apo jo lutja e



kryetarit të fisit mund të konkludohet nga fushata që pason. "Në shkurt dhe mars të vitit 1913 pushteti malazez ka bërë konvertimin e myslimanëve, e në rajonin e Gjakovës, pjesërisht edhe të katolikëve."¹³ Një gjendje e këtillë merr hov, duke u justifikuar se gjoja është plotësim i kërkesave të vetë banorëve të nënshtruar, që të përkujton disa ngjarje nga lufta e fundit ku gjoja mbrohet liria (psh. në periferi të Dubrovnikut, ku nuk ka popullatë malazeze ose serbea). Manipulimet e ngjashme, në saje të përkrahjes së fuqive të mëdha, marrin përmasa të mëdha prej të cilave, me sugjerimin e Austro-hungarisë, "tmerrohet" edhe vetë Knjazi. Ai reagon që "... të ndërpritet fushata e konvertimit të katolikëve."¹⁴

Duke i mohuar plotësisht, ose duke dhënë premtime se do të ndërpriten fushatat e ndryera që ndërmerr pushteti mbi viset e pushtuara ato zgjatnin aq sa dhanë efekte të konsiderueshme. "Struktura nacionale e popullsisë, për një kohë të shkurtë, pjesërisht ndryshon në këtë territor. Disa mijëra qytetarë turq, myslimanë dhe shqiptarë braktisën vendin."¹⁵ Ndër familjet që përjetuan egzodin para ushtrisë malazeze, ishte edhe familja e autorit të këtyre rreshtave. Kujtimet e evoluara mjaft shpesh nga dëshmitarët refugjatë mbetën të freskëta në kujtesë, si sekuenca nga filmat e tmerrit. Kthimi në vendlindje nga Rrojlloi i Shqipërisë, pas 3-4 viteve kur mbikëqyrjen e kësaj treve e bënë Austro-



hungaria ishte ballafaqim me kolonët destruktivë. Kjo të ngjallë tmerrin dhe asociacionet me luftërat e sotme në Kroaci dhe në Bosnje. Populli thotë-gjaku nuk është ujë.

Malësia enklavë

Specifike e historisë së këtij nënqielli është kahja që *marrin ngjarjet* politike. Malësia shndërrohet në zonë të intresit të fuqive të mëdha. Kjo do të thotë që krerët e fiseve dhe prijësit e tjerë e lëshuan fatin e vet nga dora. Vendimet që merren i tejkalojnë kompetencat e liderëve lokalë. Kjo amortizon ndërsimet dhe mllëfin ndaj fqinjëve, topit ndjenjën e theksuar për hakmarrje. Pakënaqësia dhe revolti mfshehën, ndrydhen ose shprehen si mosdurim ndaj të afërmit, meqë manifestimet publike të rezistencës ndaj pushtetit sanksionohen rëndë. Për veprim politik dhe diplomatik, që janë të vetmet aktivitete të lejueshme dhe të frytshme, mungon kuadri, kështu që barra kryesre bie mbi klerin katolik. Ata marrin përsipër përgatitjet e lëvizjeve patriotike.

Politika e copëtimit të Shqipërisë e godit rëndë edhe Malësinë, historikisht kompakte. Amputimi territorial përcillet me shkëputjen e lidhjeve reciproke farefisnore, fqinjësore, miqësore etj., të cilat janë regulator i sjelljeve të individëve në mes të tyre¹⁶. Ndërprerja e komunikimit me Shkodrën, që ishte qendër dhe sinonim i


qytetërimit, krijon gjendje tronditëse. Ajo duhej të zëvendësohej me Podgoricën, si qendër më e afërt, prej nga një kohë të gjatë rrjedhnin të gjitha të këqijat. Qëndrimi në qendrën e huaj përcillet me frus-trime dhe komplekse të rënda, që pengojnë tejkalimin e ndjenjës së bonjaut. Procesin e integritetit edhe më tepër e vështirëson qëndrimi destruktiv i banorëve të qendrës ndaj sjelljeve, kostumeve, komunikimit të vështirësuar në gjuhën serbe etj. Bilinguizmi, si karakteristikë tradicionale e fqinjëve malazezë, tani shtrohet si kusht i integritetit për shqiptarët. Nëse këtyre rrethanave u shtohet edhe trajtimi special i politikës së zhvillimit të viseve të banuara me shqiptarë, si zona kufitare, atëherë shihet se këtu kemi krijimin e enklavave që mund të shndërrohen në geto.

Përpjekjet që Tuzi, si qendër administrative e komunës, të urbanizohet dhe të modernizohet krahas me qendrat e tjera, aq sa të mund të absorbojë fuqinë punëtore të migrantëve ditorë nga fshatrat malore, pengohen nga pushteti në mënyrë të organizuar. Me dekret, pa farë shpjegimi dhe arsytimi, më 1956, Tuzit i mirret statusi i qendrës administrative-komunale. Me këtë akt hehohet korniza e një politike speciale ndaj popullatës shqiptare në Mal të Zi. Për ndryshim nga politika e represionit, e ndjekjeve dhe e dhunës, që ushtrohet haptas mbi shqiptarët në Kosovë dhe në Maqedoni, këtu kemi politikën e ruajtjes së "status quos." Kjo do të thotë-injorim total i brezit kufitar, ku plot dyzet vjet ruhet struktura e ekonomizimit ekstenziv, stili tradicional i jetës në kooperativat familjare, rendi gignoro-fisnor dhe e drejta zakonore.

Vidak Vajuçiq dhe ithtarët e tjerë të politikës speciale ndaj viseve shqiptare mund të flasim mbi "...proceset relativisht të shpejta të industrializimit dhe të urbanizimit, të cilat kanë bërë ndryshime të mëdha në sferën materiale dhe shpirtërore të jetës¹⁷, por vetëm nëse i mbyllim sytë para fakteve. Mund të duket jo serioze, por është e vërtetë se nga të gjitha këto procese Malësia ka shijuar vetëm tymin dhe kundërmimin e padurueshëm të bërllokut të kryeqytetit, që edhe sot e gjithë ditën shprazet vetëm në vendbanimet shqiptare.

Politika e këtillë njihet alternativën e asimilimit ose të shpërnguljes. E para gjere tani u realizua vetëm pjesërisht, përmes martesave të përziera¹⁸, ndërsa e dyta gati tërësisht. Në Malësi mbetën pleq dhe vajza, që vështirë mund të martohen pas çrregullimit të balancit natyror gjinor me shpërnguljen më intenzive të meshkujve. Numri i të prirurve për integrim gjer në asimilim është pakëz më i vogël, dhe ka ngelur në paralagjet e kryeqytetit, siç është Aeroporti i Vjetër në Koniku. Kjo e fundit, që është lagje rome, myslimane dhe shqiptare, për shkak të strukturës profesionale dhe nacionale, në zhargonin e rrugës quhet-Kongo! Sidoqoftë, banorët e paralagjeve dhe migrantët ditorë ishin bartësit e parë të virusit urban në ambientin malësor. Përpjekjet për integrim në rrjedhat urbane ndoshta mbesin të kota, por me këto fillon shthurja e rendit tradicional, sidomos me shkapërderdhjen e kooperativës familjare. Në fillim për arsye të shfrytëzimit të benificioneve (shtesave të fëmijëve, bursat dhe kreditë për shkollim të fëmijëve, kreditë për ndërtim, konkurimi për banesë etj.), e më vonë sepse kjo u pëlqeu, familjet e mëdha copëtohen në disa të vogla. Kjo dukuri përcillet me copëtimin e pasurisë, që në realitet është imtësim i parcelave të tokës pjellore, që gjithnjë e më pak i përmbushin nevojat e sigurimit të ushqimit.

Deri në vitet '80, kur fillojnë të arrijnë ndihmat e para nga emigrantët shqiptarë, këto ambiente nuk njihnin asnjë gjurmë të bashkësisë së gjere. Këto rrethana, të planifikuara dhe të kurdisura mirë, sjellin eksplodimin demografik të enklavave shqiptare në Mal të Zi. Përmes kampit për refugjatë politikë, që shtetasit e Shqipërisë i pranon që nga viti 1961, në intervalin kohor prej dhjetë vjetëve (1965-1975) ua mësyjnë SHBA-ve, e më pak vendeve të tjera të perëndimit, më tepër se gjysma e banorëve të këtyre viseve. Nga biseda me drejtorin e kampit për refugjatë shqiptarë, në periudhën e përmendur, At-Prenkë Nervashën, (e zhvilluar më 01.01.1990. në Birmingham, Michigan-U.S.A.), mësuam se nëpër kampe italiane kaluan 14.900 shqiptarë nga Mali i Zi. Kusht i pranimit dhe i vendosjes ishte deklarata e rrejshme se janë refugjatë nga Shqipëria. Pasaportat jugosl-



lave (që lëshoheshin shumë lehtë, madje edhe për të mitur pa pëlqimin e prindërve, ose për obliguesit ushtarakë me thirrje në xhep, që për malazezët ishte e pamundur), ose i hudhinin ose i mshehnin. E tërë kjo lojë kundërligjore, bëhej para syve të organeve shtetërore, të cilat mëshilnin sytë, sepse pohon Atë. P.Nervasha, ishte skenari i tyre.

Shikuar nga perspektiva e sotme, kur pas shthurjes së botës socialiste të Lindjes, ndodhin lëvizje të mëdha shoqërore, shifra prej 15.000 njerëzish mund të duket minore. Por, nëse kemi parasysh faktin se këto janë shpërngulje të pastra etnike nga një shtet multinacionaal, në kohën kur Jugosllavia gëzonte frytet e shtetit të privilegjuar, pikërisht në vitet e mirëqenies, dyshimet në natyrshmërinë e procesit, mund të jenë të arsyeshme. Këtë më së miri e dëshmon ambientit vërtet ekologjik, absolutisht i paprekur nga qytetërimi nga i cili ata ikin, por edhe përpjekjet e partisë që kjo dukuri të heshtet. I vetmi shërbim shtetëror që merret me fatin e emigrantëve, si jasht atdheut si kur ktheheshin si vizitorë, është ai i punëve të brendshme. Me trajtimet që u bëjnë emigrantëve, ata, në të vërtetë, janë realizatorë të projekteve fantome të Çubriloviqit, Djordjeviqit Andriqit e shumë urrejtësve të tjerë të shqiptarëve. Arsenali i pasur imetodave represive, gjer te burgosjet e denimet paushalle (rasti i Pjetër Ivezajt, që alarmon opinionin amerikan pas denimit të tij me shtatë vjet



burg, për arsye të pjesëmarrjes në demonstratat paqësore në SHBA, organizuar kundër represionit jugosllav në Kosovë), është në shërbim të politikës që pengon kthimin eventual të tyre.

Historia përsëritet ?

Territori kompakt etnik i shqiptarëve në Mal të Zi, është njëri ndër faktorët e rëndësishëm, që komunikimin ndëretnik në këto vise e bën specifik. Mospërfillja e veçorive etnike, mostoleranca ose përçmimi, ishin realitet, por, për hir të sistemit që insistonte në tejkalimin e tyre, abstenohej nga manifestimet e hapta. Këto e mundësonin kontaktet më të rralla, si dhe kërkesat tejet modeste të popullatës shqiptare. Me arsimin që duhej finalizuar në Kosovë, vetëdijsohet edhe shtresa dominante bujqësoro-blegtore, të cilëve u prijnë shkollarët. Kjo është arsyeja kryesore që, pas përkrahjes së rezervë të masave represive nga qarqet politike malazeze ndaj popullit shqiptarë në Kosovë, hetohet ftohje në komunikimin ndëretnik. Shqiptarët i irtojnë vlerësimet e ngjarjeve, gjykimet euforike dhe histeria kolektive që ushqehet me disponim antishqiptar. Kjo fushatë e gjuajtjes së shtrigave, flizon një numër të konsiderueshëm të puntorëve të arsimit shqip, ndjek dhe burgos individë që janë bartës të afirmimit kombëtar, denoncon funksionar lokal dhe të niveleve më të lart, si shëmbull-preventivë për lokalizimin e

manifestimit të solidarizimit me ngjarjet në Kosovë.

Sidoqoftë, represioni mbi kulturën dhe mbi njerëzit shqiptarë në Mal të Zi, është vetëm kopje e zbehtë, përbri atij në Kosovë dhe në Maqedoni. Nga fakti që janë pakicë, e cila nuk mund të rrëzojë strukturën nacionale të republikës, ose nga afërsia shekullore në ambientin dinarik, politika malazeze, megjithatë, dëshmoi një tolerancë. Ekspe-ditat ndëshkuese më shumë përcilleshin me kërcinime dhe zhurmë, sesa me viktima. U fitua përshtypja se kjo ishte produkt i politikës solidarizuese me politikën afatgjatë erbe, e jo specialitet i kuzhinës malazeze. Këto koncsione joparimore ndaj "vëllaut të madh", që Kosovën dhe shqiptarët i përdorë si bazë për hapjen e procesit të realizimit të projektit memorandumian, edhe kreatorëve të politikës së këtillë koketuese do tu kthehet si bumerang. Prej grushtetit, shembjes së strukturës pushtetmbajtëse dhe inaugurimit të politikës proserbe, në Mal të Zi fillon epoka e përtërirjes së komunikimit ndëretnik simbiotik. Pushteti i ri injekton frymën e presionit mbi poullatën krenare malazeze, që t'i nënshtrohet njëfarë mazohizmi ekstrem, për të hequr dorë nga etnia dhe shtetësia malazeze. Kjo politikë, e proklamuar me pompë dhe fanfare, malazezët dinjitozë i irtton në atë masë sa që kërkojnë aleancë me shqiptarët. Kjo u kurorëzua me themelimin e degës së Partisë Liberale (malazeze), në Tuz, me kontakte konstruktive dhe me ndjekjen e kursit antiserb.

Sa është irtuese politika e presinit serb, dëshmon deklarata e një intelektual malazez, Marko Veshoviqit, dhënë "Borbës", të cilnë e përcjellë "Bujku"-i dt.31.05.1992.v., ku, përveç tjasht thotë: *"... në të vërtetë unë jam malazez, por sa herë që dikush më konsideron serb, me qëllim që të më pështyjë, unë pranoj të bëhem edhe serb..."*

Pozita e palakmueshme e malazezëve bën që ata duke u kthyer nga aleati i vjetër, përpiqen të evitojnë rrezikun e ri, e në të vërtetë evitojnë pjesëmarrjen në skenarin e suprimimit dhe të zhdukjes së një etnikumi me traditë shtetësisë dhe kulturës në brezin dinarik. Dhe jo vetëm kaq. Ata angazhohen që të mos marrin pjesë në

luftërat më të ndyta që mban mend njerëzimi, por shthurja e shtetit të bëhet me marrëveshje, pa gjakderdhje. Qëndrimi dinjitoz në pozita të këtila, një numër intelektualëve e hudhi në radhën e "tradhtarëve", dhe i detyroj që të kërkojnë strehim edhe te shqiptarët. Historia po përsëritet, por a thua sjelljet simbiotike nuk mund të jenë rezultat i fqinjësisë së mirë, i rrezikut të përbashkët?

1) Marta Olivetti Bellardinelli, në veprën me titull "Identifikazione e prolezione", përpjetë të shpjegojë nocionin e identifikimit si modus i komunikimit ndëretnik. Ajo dallon katër tipe të tij, prej të cilëve veçoi atë të identifikimit me agresorin, që, sipas saj, karakterizohet me mekanizmin e nënvetëdijes (inconscla), kështu që individit nuk është në gjendje të njohë rrethanat ku hetohet inferioriteti. Përkundrazi, inferioriteti shpesh shprehet në formë të dinjitetit të theksuar... Identifikimi me agresorin ndikon... në eliminimin e dallimeve që ekzistojnë në mes dy qenieve, grupeve, kulturave. Të bëhesh si agresori... ta humbësh ndjenjën e padrejtësisë, të "ndiheshi mirë" kur je keq, të bëhesh i "huaj", "të shiteshi" si person pa qenë i vetëdijshëm etj. (Cituar sipas: Dr. Lush Gjergji, "Roli i femrës shqiptare në familje dhe në shoqëri", Saraj, 1977, vj.fq.99. Për procesin e akulturizimit bëjnë fjalë edhe Rindise Lingon dhe Herskovitsch. Për procesin e identifikimit, si lloj të mekanizmit mbrojtës, flet edhe Anna Freud-L'lo e mekanizmit di feso martinelli 1967 fq.119 (cit. sipas L Gjergji, vep. e vitit, fq.101)

1) Jovan Cvijik, Sabrana dela, knjiga 4. tom. 1. Beograd, 1987, str. 37

2) IBID

3) Kahreman Ulqini flet për tri periudha të komunikimit ndëretnik që shquhen me simbiozë dhe asimilim të disa fiseve shqiptare. E para prej shek. XI-XV; e dyta prej ardhjes së turqve deri në fund të shek.XVIII; dhe periudha e tretë, prej fillimit të këtij shekulli deri me 1918, kur M.I Zi hyn në Mbretërinë SKS-(Kahreman Ulqini, KULTURA POPULLORE, Nr.1. TIRANË 1983, fq. 121-124).

4) Kahreman Ulqini: "Kultura popullore", nr.1 1983. Tiranë, fq.121

5) Shuko: V. Stojaceviq, Severna Albanija, 124-125; M.Gavriloviq, V.P.III, 360; D. Pavlovic, V.P. 63, 64; P. P. Njegosh, Pisma I, 1830-1837, cjelokupna djela, knj.III- Beograd, 1959, g. 129, 145, 538, 539 etj. P. Popoviq, V.P.139 J. Vučković, Ibid, V. Stojanoviq, Problemi i saradnje etj.

6) Statistički godišnjak opštine Titograd, 1987, g. Izdat od opštinskog Zavoda za drushtveno planiranje.

7) Novak Razhnatoviq, Pokushaj razgraničenja između Crne Gore i Turske; 1880. god. putem kompenzacije za Plav i Gusinje teritorijom alb. plemena Gruda i Hota. "Istorijski zapisi, god. XXIV, 1-2, Tg. 1973, fq.33.

8) Novak Razhnatoviq, vep. e cit. fq.54

9) Shih: J.G.von Hahn; M. Shufflay; B. Djurdjev; J. Erdeljanoviq; F. Nopca; A. Degrand; E. Çabej; S. Pulaha; Rr. Zolzi; K. Ulqini...etj.etj.

10) Shih. dhe krahaso: Sadulla Brestovci, "Marrëdhënjet shqiptare-serbo-malazeze (1830-1878), Prishtinë, 1983. vj. /Ilustrative është ngjarja e 22 prillit të vitit 1880, kurë M i Zi, nuk arrinë të aneksojë Hotin e Grudën edhe përbrim premtimeve të fuqive të mëdha, që dalin nga Memorandumi i 12 prillit 1880, Savas Pasha. Është dashur të bëjë dorëzimin, por malësorët e kundërshtuan. "Ja ku i ka Mali i Zi tokën, vendet, shtëpiat. Të gjitha janë të tija, grabituri, merrni si të dini.(sipas N. Rozhnatoviq, vep. e cit. fq. 61).

4)Dr.B. Babic: "Politika C.G. U novooslobodjen. krajevima 1912-1914" "Obod" Cetine "Pobjeda". Tg. 1984.god. str.208

11) A.R.Redklif-Braun, "Struktura i funkcija u primitivnom drushtvu", "Prosveta", Beograd, 1982. god. fq.51

12) Asrcg, K-1912, f.1.734. (cit. sipas: B. Babiq, vep. cit. fq.175

13) Dr. B.Babiq, cit. djelo, str. 208

14) Ibid

15) Ibid. fq.229

16) A.R.Redklif-Braun, vep. e cit. fq.42

17) Vidak Vujačić, Transformacija porodice, Slovo ljubve, Bgd.1977. v.fq.101

18) Ruzha Petrovici, Etnički meshoviti brakovi u Jugoslaviji, Institut za socioloskiko istraživanja Filozofskog fakulteta u Bgd, 1985, g.str.17

Anton Kola Berishaj:

Montenegro Albainian Highlanders (Malesoret) And Montenegrins-from Destructive To Symbiotic Behaviour

Through a close historical analysis of the position of Albanian Highlanders in Montenegro the author analyses the tensions existing in Yugoslav history between symbiotic behavior-in which spontaneity and tolerance characterise the relations between neighbouring groups manifesting slight differences in cultural practices-and destructive behaviour-in which such differences provide legitimation for acts of oppression, forced assimilation and ethnic genocide. The author examines the historical formation of Montenegrin state antagonism to Malesoret

Muslims as well as to Malesoret Catholics through the late 19-th and early 20-th centuries, and charts the extension of ethnic antagonism into the communist period. His examination of oppression and the resulting "pure ethnic migrations from a multinational country... in the years of Yugoslavia's well being" throws light onto some of the origins of today's practices of ethnic cleansing. In closing the author contrasts the situation of Albanian Highlanders in Montenegro with the more dire situation of Albanians in Kosova and Macedonia, and points out that the shared history of Montenegrins and Malesoret in the area has left traces of symbiotic behaviour which lead some Montenegrins to resist Belgrade's attempt to promote even more racist and genocidal attitudes towards the Albanian minority.

E

TH


M

VËSHTRIME

A

THEMA • THEMA
ESSE IS TIHE ð ARHITEKTURE
TEATER
ART





CLAUDE LEFORT
CLAUDE LEFORT
CLAUDE LEFORT
CLAUDE LEFORT
CLAUDE LEFORT


KUFIJTË E
SUNDIMIT
TOTALITAR



Të gjashtë tekstet e përmbledhura këtu*, janë nxjerrë nga dy libra, *Zbulimi i demokracisë* dhe *Ese mbi politikën*. Më i mësoni u botua në një revistë aty nga fundi i viteve 70, i fundit më 1986. Që prej atëherë, kohërat kanë ndryshuar. Së pari zuri fill në Rusi, nën ndikimin e Gorbaçovit, një politikë reformash, në fillim mjaft e turpshme, që u shoqërua me një orvatje për të vendosur marrëdhënie paqësore me Perëndimin. Më pastaj *glasnost* shënoi fundin e një nemitjeje; debati publik u thellua, fuqia e Partisë u dëmtua, e Udhëheqësia e humbi kontrollin mbi lëvizjen. Më në fund, kjo krizë e autoritetit në Moskë mjaftoi që të shkaktohet, me një shpejtësi të jashtëzakonshme, një shembje e të gjitha kështjellave të komunizmit në Evropën Lindore. Kështu u shpartallua, brenda disa muajsh, një perandori që e shikonin si të gjithëfuqishme, njësoj si edhe ideologjia e cila, sigurisht, nuk mobilizonte qëmoti masat, por të cilën nuk guxonte askush ta kontestojë. Ngjarje kjo që s'ishte parë ndonjëherë më parë në histori, pasi që nuk u shkaktua as nga ndonjë luftë e as nga ndonjë revolucion. Ndryshimi duket të jetë i pakthyeshëm, madje edhe nëse, gjatë këtyre dy viteve të fundit, shpërthyen konflikte të një lloji të ri-të nxitura aty-këtu nga komunistë të vjetër-kahja e të cilave nuk mund të parashikohet.

Ndoshta lexuesit do t'i vijë keq të mos gjejë në këtë vëllim ndonjë jehonë nga ngjarjet më të reja. Mirëpo, kjo nuk i bën këta artikuj joaktuale. Ata artikuj ftonin të rimendohej *politika* (le politique) dhe të rishqyrtohet domethënia e demokracisë. Kjo punë vazhdon të jetë impertive.

Në kohën kur shkruaja, debati politikintelektual në Francë tashmë ishte zhvilluar shumë. Ndikimi i Partisë Komuniste, që kishte qenë aq i madh gjatë decenive mbi tërë të Majtën franceze, ishte në rënie; opinioni u bë i ndieshëm ndaj dëshmimeve të disidentëve sovjetik në Evropën Lindore, ndaj zbulimeve të Solzhenicinit dhe ndaj përpjekjeve të lëvizjes polake *Solidarnoshq*. E megjithatë, refleksioni mbi totalitarizmin nuk kishte ecur fare përpara; dënimi i shtypjes që mbretëronte në vendet komuniste ashtu si ishte formuluar nga intelektualet, në veçanti ata që i quanin filo-



zofë të rinjë, mbështetej mbi vështrimet thjesht morale. Pikëshikimi im ishte pra, fort i rrallë. Unë mbroja mendimin në radhë të parë, se bota nuk ishte një herë e përgjithmonë e ndarë në dy blloqe pse, në vend se të verbërohemi me fuqinë ushtarake të Bashkimit Sovjetik, do të duhej të merret në shqyrtim regjimi totalitar dhe të hetohej se çka përbën forcën e tij e çka përbën dobësinë e tij. Nëntitulli që ia dhash "Zbulimit demokratik" ishte "kufijtë e sundimit totalitar". Kundërthëniet e sistemit komunist paraqesin, sipas meje, në tri aspekte kryesore: pushteti i cili pretendonte të mishërojë popullin dhe të bëhet i gjithëpranishëm në tërë hapësirën e shoqërisë, përmes Partisë, nisi gjithnjë e më tepër të shikohej si *përmbi të gjithët* si pushtet që ka një fuqi despotike; pushteti i cili pretendonte të vepronte në emër të një ligji sovran-ligjit të Historisë-e që tregohej i zhveshur nga çdo respekt, ndaj ligjeve pozitive, nuk arrinte asgjë tjetër veçse të impononte sundimin e frikës, dhe gjithnjë e më shumë shikohej si arbitrar; pushteti i cili pretendonte të mbante njohurinë e qëllimeve të rendit shoqëror dhe të përkufizonte në çdo fushë se ç'duhet të mendojë çdo njeri, me kohë, doemos do të duhej të ndeshej me përvojën që kishin fituar njerëzit, duke u ballafaquar me realitetin, e njëherit që gjithnjë-e më tepër diktohej si i rremë. Unë nuk parashikoja as kur e as në ç'mënyrë këto kundërthënie do të shkaktonin zhdukjen e regjimit. Mirëpo, kisha

bindjen se ai ishte i cenueshëm në një shkallë të lartë. Së dyti, orvatesha të tregojë se liritë individuale, që i përkrahnin me elokuencë në Perëndim intelektualët që më në fund u çliruan nga iluzionet komuniste, ishin të pandashme nga liritë qytetare dhe politike. Këto liri nuk ishin formale; të Drejtat e Njeriut pëbënin kurizimin e demokracisë liberale; zgjerimi i demokracisë që nga fillimi i shekullit XIX kishte ecur krah për krah me fitoren e të drejtave sociale e politike, me zhvillimin e kërkesave që bazoheshin në parimet e Deklaratës së madhe. Pra, ne duhej ta lidhnim idenë e individit me atë të qytetarit dhe me atë të njeriut. Në radhë të tretë, unë e theksoja ndryshimin që kishte të bënte me origjinën e demokracisë moderne. Kjo e kishte shënuar lindjen e një tipi të shoqërisë e cila shképutej nga të gjitha trajtat e mëparshme të organizimit shoqëror. Bashkë me të ishte zhdukur edhe ideja e Kuvendit apo e mbretërisë së kuptuar si një trup të një tërësie të hierarkizuar në mënyrë të natyrshme. Mendoja se ajo që shquante demokracinë moderne ishte fakti se askush, asnjë njeri, asnjë grup, s'do të mund ta përvetësonte pushtetin; gjithashtu edhe se askush nuk mund ta shpallte Ligjin dhe askush nuk mund ta zotëronte dijen e fundit; atë e shquante poashtu fakti se njerëzit e pranonin heshtazi ndarjen shoqërore: ndarjen midis shtetit dhe shoqërisë civile, ndarjen e sferave të aktivitetit (çdonjëra renditej, këtej e tutje, si-


pas kërkimit të vet normave të veta), ndarjen e interesave, të pikëpamjeve, të bindjeve. Nga ky pikëshikim, nocioni i *revolucionit demokratik*, të cilin e futi në përdorim Tocquevill-i (Tekuill), më dukej thelbësor. Demokracia ishte formë e një shoqërie në lëvizje, e cila e kishte lënë pas vete parimin e një legjitimiteti absolut. Te ajo, ekuilibri fitohej brenda vet lëvizjes, stabiliteti brenda jostabilitetit. Jetën shoqërore e cilësonte në papërcaktueshmëri bazë; ajo bartte me vete një etikë dyshimi (të ndryshme nga nihilizmi) e cila e bënte konfliktin të frytshëm, duke e penguar të shndërrohej në luftë për vdekje. Njeherazi e cilësoja aventurën totalitare që ishte vijëzuar në vitet 1920-sa në versionin fashist aq edhe në atë komunist-si kundërrevolucion. Ajo nuk kishte në shenjestër pronën private, as sundimin e borgjezisë apo individualizmin e prodhuar nga shoqëria e masës, por demokracinë si të tillë (argument ky i cili, siç do shihet, më ndante nga Hannah Arendt). Megjithatë, unë theksoja se ky kundërrevolucion i kishte gjetur premisat e veta brenda shoqërisë moderne. Fantazma e popullit një, e një themelimi që e lente anash plotësisht të kaluarën, fantazma e krijimit të një njeriu të ri, e kishte kapluar imagjinatën e njerëzve në kohën e Revolucionit francez, pas shkatërrimit të shoqërisë aristokratike. Në këtë frymë unë i bëra disa artikuj për Terrorin revolucionar. Nuk e paraqitja Robespierin si një paraardhës të Stalinit, por doja t'i veja në pah shenjat e para të një imagjinate karakteristike të modernitetit.

Situata e tanishme tregon se sa është i vështirë kalimi nga sundimi totalitar në demokraci. Komunizmi e ka copëtuar në thellësi, më shumë se ç'mund të merrej me mend, indin shoqëror. Ai la mbrapa vetes, veç rrënimave materiale, frikën, mosbesimin, shprehinë e nënshtrimit, mosnjohjen e Ligjit dhe mospërgjegjësinë individuale. Për më tepër rrënimet, materiale janë shqetësuese: shija për liri nuk fitohet në gjirin e mjerimit. Pamje e çuditshme do të ishte më në fund po të kapërthehej me shikim territori i perandorisë së vjetër; kemi mundur të besojmë se popujt, njëllojë të shtypur, do të ndienin se i takojnë një bashkësie me fat të njëjtë; po, në fakt, nuk

doli ashtu. Kohën e totalitarizmit e zëvendëson koha e copëzimit. Natyrisht, synimet kah pavarësia, kur i takojnë kombeve të nënshtruara një fuqie të huaj, janë legjitime, dhe mund të lidhen me aspirata demokratike. Përkundrazi, është vdekjeprurës nacionalizmi që shoqërohet me ksenofobi dhe me racizëm-e aq më keq, kur është në shërbim të një vullneti të ekspansionit qoftë të shtypjes, qoftë të zhdukjes së pakicave. Si të dyshohet se ky nacionalizëm, në formën e acaruar që ka marrë në Serbi, është një trashëgimi e komunizmit?

Për mua është tejet e rëndësishme që tekstet e mia janë përkthyer në gjuhën shqipe. Simpatia e ime është e madhe ndaj shqiptarëve që kanë përjetuar gjatë dekenieve një shtypje totalitare e që tani gjenden përballë rreziqeve më të mëdha. Kam admirim ndaj atyre që i kanë bërë rezistencë sundimit të komunizmit e që luftojnë për respektimin e të drejtave qytetare e politike. Kam shpresë të kem qenë i kuptuar prej disave. Kur e kam takuar së pari zotëri Muhamedin Kulashin, të cilit i jam mirënjohës për përkthimin që ka bërë, menjëherë kam ndierë, megjithë dallimet midis përvojave tona dhe kulturave të cilave u takonim, se ne flitnim *të njëjtën gjuhë*, se kërkonim njëlloj fjalët e sakta për t'i emërtuar kushtet e një shoqërie të lirive.

* Ky tekst është shkruar për lexuesit shqiptar si parathënie e përkthimit të librit të eseve politik të autorit "Demokracia dhe totalitarizmi", që ende nuk është botuar.





DEMOKRACIA
E
TOTALITARIZMI

MUHAMEDIN
KULLASHI

Titulli i këtij punimi* përmban dy terma që kanë zën rishtas të përdoren gjithnjë e më shpesh në jetën publike të shumicës së vendeve evropiane. Mënyra e përdorimit të tyre brenda diskutimeve e polemikave, në artikuj gazetareskë e publicistikë, në programet e partive të sapoformaura, jo rrallë i nxjerr të zbrazura nga kuptimi, të reduktuara në etiketa ideologjike shterpe, që më tepër e errësojnë realitetin social-politik që duan ta sqarojnë. Por, edhe aty ku përdoren në mënyrë të paqartë, shpesh shqitet bindja se këto dy terma përkufizojnë rrethanat e një horizonti dramatik brenda të cilit u zhvillua jeta shoqërore e politike e individëve dhe e popujve në bashkëkohësi.

Zbërthimi i koncepteve kritike e përmbajtësore që shënojnë këta dy terma kurrsesi nuk është lëvizje në një hapësirë të kristaltë të nocioneve e ideve, ngase ato janë sajuar sa nga një përvojë teorike aq edhe nga ballafaqimi me një realitet kompleks social e politik. Ato, natyrisht, nuk mund të na shpëtojnë nga ndryshimësia e vazhdueshme e realitetit dhe e mendimit por mund të ofrojnë pikëmbështetje për deshi-

frimin e kuptimit të asaj që ka ndodhur dhe asaj që po ndodh.

Claude Leforti¹ (Klod Lefor) mbahet si një nga mendimtarët më të shquar të politikës në këtë shekull. Punimet e tij nga filozofia politike merren si referencë e paevitueshme në të shpjeguarit sidomos të fenomeneve që i "mbulojnë" termat demokraci e totalitarizëm. Natyrisht, vepra e Lefortit nuk na jep të vërteta të gatshme e të pakontestueshme: ajo më tepër na sfidon të mendojmë për problemet kyqe që i përkasin qeniesimit të njerëzve brenda atyre "kornizave", aq të ndryshme njëra nga tjetra, që i emërtojnë termat e përmendur. Subtiliteti dhe thellësia e analizave të tij e bën të vështirë paraqitjen dhe interpretimin e tyre; po sa për ngushëllim e justifikim të përkujtojmë pohimin se çdo interpretim njëfarë dore është varfërim i një mendimi.

Që në fillim na shtrohet obligimi të skicojmë pozicionin teorik nga i cili Leforti i kundron fenomenet politike të kohës sonë. Skicimi i këtij pozicioni kërkon një sqarim të parë të dallimit që ai e bën në të gjitha punimet e veta midis termave *politika* (la

politique) dhe *politikja* (*le politique*). Me të parin shënon veprimtarinë e individëve e të partive politike brenda sferës politike si vend ku sajohet instanca e përgjithshme e pushtetit dhe ku zhvillohen garat politike. Me të dytin emërton "atë lëvizje të dyfishtë të *shfaqjes* së procesit në saje të të cilit renditet e njësohet shoqëria përmes ndarjeve të brendshme të saj si dhe fshehjen e parimit prodhues të konfiguracionit të tërësisë²".

Që të mund ta rimendojë fare politikën Leforti e pa veten të shtrenguar të shkëputet nga pikëshikimi i shkencës në përgjithësi dhe në veçanti nga pikëshikimi i shkencës politike dhe sociologjisë politike. Ai do të kritikojë si interpretimin marksist të fenomenit politik, i cili e vendos këtë në regjistrin e një superstrukture që e ka themelin në nivelin e supozuar real të marrëdhënieve në prodhim, po ashtu edhe atë të politikologëve e sociologëve që "e gjejnë objektin e tyre të njohjes, duke u nisur nga ndërtimi apo nga përcaktimi i faktit politik, të shikuar si fakt i veçantë, i ndryshëm nga faktet e tjera të veçanta (ekonomike, juridike, shkencore etj.)³". Zaten "këta nuk e bëjnë çështje trajtën e shoqërisë brenda së cilës paraqitet dhe del e legjitimuar ndarja e sektorëve të ndryshëm të realitetit⁴".

Leforti kultivon një mendim që refuzon të reduktohet në "gjurmimin e relacioneve të kauzalitetit midis fenomeneve, apo të ligjeve të organizimit dhe të funksionimit të sistemeve e të nënsistemeve sociale⁵". Ai nuk i flak gjykimet vlerësuese ngase subjektin njohës nuk e pandeh si neutral e "objektiv", të shkëputur nga relacionet brenda të cilave është vendosur. Me pozicionin e vet teorik ai tejkalon kufizimin e shkencës politike e sociale i cili i bën këto të paafta të mendojnë "atë që çdo shoqërie i jep statusin e saj prej shoqërie njerëzore: dallimin midis legjitimitetit e jolegjitimitetit, të vërtetës e gënjeshtërs, autenticitetit e mashtrimit, kërkimit të pushtetit ose të interesit privat dhe kërkimit të së mirës së përgjithshme⁶".

Zbërthimi i tipareve të demokracisë e të totalitarizimit Leforti e bën nga një pozicion që ia bën të mundur të hetojë *dallimet midis trajtave të shoqërive*. Por hetimi i dallimeve jo vetëm që nuk e përjashton por

edhe implikon hetimin e lidhjeve që mbajnë ato: kështu bie fjala, sadoqë demokracia e totalitarizmi janë thelbësisht të ndryshme ato dalin ngushtësisht të lidhura, shpejgohen njëri në saje të tjetrit. Në sfondin e totalitarizmit, që mori hov në shekullin XX, Leforti dikton të shqitet një reliev i ri i demokracisë moderne⁷.

Ndryshe nga qasjet e tjera, mjaft të përhapura, të politikologëve e sociologëve, shpjegimin e lindjes së totalitarizmit dhe të demokracisë, Leforti nuk e kërkon në nivelin e historisë empirike, sadoqë këtë nuk e përjashton, por i sheh të lidhur me ndryshime të një rendi simbolik, që i dëshmon veçmas ndryshimi i statusit të pushtetit.

Mëvetësinë e demokracisë moderne, të cilën nuk e redukton as në një *sistem institucionesh* e as në një *trajtë të qeverisjes* (siç e përkufizonin Aristoteli e Montesquieu-a) por e sheh si *trajtë të shoqërisë*, Leforti e vë ne spikamë duke e krahasuar me ndërtimin e sistemit monarkist, nga shembja e të cilit ajo doli.

Ndryshe nga Marxi, për të cilin monarkia paraqitet si institucion superstruktural, funksioni i të cilit buron nga natyra e mënyrës së prodhimit, Leforti përkundrazi mendon se shteti monarkist "në saje të punës së tij të nivelimit e të njësimi të fushës sociale, e ka bërë të mundur zhvillimin e marrëdhënieve të tregut dhe të një mënyre të racionalizimit të aktiviteteve që kushtëzonin hovin e kapitalizmit⁸". Mbretëria feudale paraqitej si një trup, si një unitet substancial, e njëherit si piramidë e hierarkizuar ku vendi dhe funksioni i çdo njeriu ishin fiksuar që më parë dhe mbeteshin të pandryshuara. Parimin e prodhimit dhe të rendit të mbretërisë e përmblihte në trupin e vet mbreti, që shikohej njëherazi si i vdekshëm e i pavdekshëm, si ndërmjetësues midis zotit e njerëzve, si garancë dhe përfaqësues i unitetit të mbretërisë. Pushteti i trupëzuar (incorporé) në personin e mbretit, njëherit bën tru-pëzimin e shoqërisë. Bota feudale del si një totalitet organik⁹.

Përmbysjen e rendit feudal, shthurjen e marrëdhënieve që e sajnin atë, Leforti e definon me termat *çtrupëzim* (desincorporo-

ration) dhe *shpleksje* (desintrication). Çtrupëzimi ka të bëjë me ndryshimin e ndërtimit të shtetit dhe të shoqërisë, ndëkaq shpleksja realizohet midis *sferës së pushtetit, sferës së ligjit dhe sferës së dijes* (në kuptimin më të gjerë: opinionet, besimet, bindjet, pikëpamjet, njohuritë) që më parë ishin të ngjitura. Këtë përmbysje e shquan në veçanti ndryshimi i statusit të pushtetit: pushteti në rendin e ri demokratik del si *vend i zbrazët*: atë s'mund ta mishërojë më asnjë individ, organ e parti, askush s'mund të jetë bashkësubstancial me të¹⁰. Ata që e ushtrojnë pushtetin zënë vend aty vetëm përkohësisht, ngase i nënshtrohen procedurës së zgjedhjes periodike. Ndryshe nga Marxi, Leforti nuk e sheh pushtetin si organ të thjeshtë sundimi, por si "instancë të legjitimitetit dhe të identitetit"¹¹.

Në demokraci pushteti pushon të shfaqë parimin e prodhimit dhe të organizimit të shoqërisë si një *trup unik*, e poashtu ai nuk mban më në vete "virtutet e nxjerra nga një arsye dhe drejtësi transcendentë", sepse *e drejta* dhe *dija* afirmohen si të pavarura përballë shtetit, i nënshtrohen normave të veta specifike. Por raporti midis këtyre tri sferave nuk është ndarje e plotë: pavarësimi nuk përjashton ndërveprimet¹². Për të qenë legjitim pushteti duhet të jetë në pajtim me të drejtën, e parimi i të drejtës në demokraci është jashtë sferës së pushtetit. Mirëpo, kjo ndajre strukturale në tri sfera, që cilëson demokracinë, nuk e garanton në tërësi pavarësinë e tyre: në ç'masë do të jenë të pavarura e drejta dhe dija nga ndërhyrjet e shtetit varet edhe nga vetë veprimtarët në këto sfera.

E drejta në demokraci nuk del si tërësi parimesh të fiksuara njëherë e përgjithmonë, në një kod me origjinë hyjnore apo në një kod tradicional, që dalin si transcendentë në raport ndaj mendimeve dhe vullnetit të njerëzve të një shoqërie e të një epoke. E drejta tashti i shtrohet një procesi të vazhdueshëm të formimit, të varur nga një debat për vetë *themelin* e saj. Dhe pikërisht kjo mungesë e themelit, jo vetëm e të drejtës, por edhe e pushtetit e dijes, përbën veçorinë e tyre thelbësore në demokraci, e cila kështu "çel një histori në të cilin njerëzit i shtrohen sprovës së një


papërcaktueshmërie të fundit"¹³. Shoqëria demokratike sajohet si shoqëri pa trup. Mirëpo, papërcaktueshmëria s'do të thotë patrajtësi, mungesë identiteti, por çeltësi, mosngurëzim, proces i hapur i formësimit. As shteti as populli nuk figurojnë më si *realitete substanciale*. Edhe vetë përfytyrimi për to varet nga një diksurs politik dhe një elaborim sociologjik e historik. Çtrupëzimi hap procesin e sajimit të një trajte të re të shoqërisë, të shoqërisë demokratike: hapet hapësira për mënyra të ndryshme të ekzistimit, të veprimit e të komunikimit, këto bëhen objekt i zgjedhjes së lirë të individit. Kjo është një risi thelbësore që e shquan shoqërinë e re¹⁴.

Shkoqitja e tipareve kyçe të demokracisë, që e vijëzuam shkurtazi, shoqërohet në tekstet e Lefortit me zbrërthimin e kundërthënieve që e kaplojnë shoqërinë e re, tensionet që vazhdimisht rilindin nga ato kundërthënie, si dhe me ndriçimin e *ambiguiteteve* të fenomeneve karakteristike të demokracisë. Ai vë në pah, bie fjala se si afirmimi i veçantisë së individit, shoqërohet me një sundim të *anonimitetit*, afirmimi i dallimit të bindjeve, zakoneve, mendimeve shoqërohet me përhapjen e *uniformitetit*, opinionin publik, si vend i hapur për ballafaqimin e pikëpamjeve të ndryshme e të kundërta shndërrohet në një opinion masiv që imponon kallëpe të njëtrajtshme për të gjithë, heterogjeniteti i shtuar i jetës shoqërore përcillet me sundimin e shoqërisë e të shtetit mbi individët¹⁵.

Vrojtimet e thella për këto ambiguitete, për shkaqet e tyre, trajtat që marrin, rrjedhojat që i prodhojnë na ndihmojnë të kuptojmë përse Leforti nuk e kufizon demokracinë në sistem institucionesh.

Totalitarizmi dhe kampi i përqendrimit

Lindja e totalitarizmit në shekullin XX në Evropë në studimet e Leforit del si *përmbysje e demokracisë*. Kjo vlen jo vetëm për tipin perëndimor të totalitarizmit (nacizmin e fashizmin) që ishte vendosur në vende me traditë të mirëfilltë demokratike por edhe për atë lindor (stalinist) që zuri fill në vendet me traditë tejet të varfër demokratike¹⁶.



Pikërisht vetë natyra e demokracisë-një shoqëri ku themelet e rendit politik e social fshehen, humbja e substancës së shoqërisë, tensionet e vazhdueshme midis instancave të saj të pavarura-bën të mundur "çrregullimin e logjikës demokratike"¹⁷.

Interpretimin e përhapur se totalitarizmi buron nga një mënyrë e prodhimit, Leforti e mohon duke vënë në pah se edhe fashizmi italian edhe nacizmi gjerman u akomoduan mjaft mirë me strukturën e ekonomisë kapitaliste, ndërsa regjimi sovjetik i kishte marrë tiparet e veta karakteristike edhe para periudhës së socializmit të mjeteve të prodhimit dhe të kolektivizimit. Lindjen e totalitarizmit Leforti, para së gjitha, e shpjegon si një *ndryshim politik*, që është ndryshim i natyrës simbolike dhe ka të bëjë me *ndryshimin e statusit të pushtetit*. Por ai nuk i lë anash as faktorët e rrethanat tjera që ndikojnë në paraqitjen e totalitarizmit, veçmas krizën ekonomike, varfërimin dhe shthurjen e shtresave e klasave në një shoqëri që kishte një stabilitet relativ.

Si *tip i ri sundimit* totalitarizmi mbështetet në një tip të ri të partisë politike që del nga një lëvizje masive dhe që e përvetëson

pushtetin në emër të identifikimit me popullin dhe interesat e tij historike. Kjo parti, qoftë në variantin bolshevik apo në variantin nacist, paraqitet si "pronare e një legjitimiteti që e vë përmbi ligjet"¹⁹. Në shumicën e analizave të veta Leforti, megjithatë, do t'i kushtojë kujdes më të madh variantit lindor të totalitarizmit. Në ndërtimin e këtij tipi të totalitarizmit rol të veçantë ka *logjika e identifikimit* midis proletariatit e popullit, partisë e proletariatit, byrosë politike e egokratit (prijësit) me partinë²⁰. Efikasitetin e sundimit të vet, prijësi e partia e mbështetin, veç mekanizmave të tjera, në faktin se arrijnë të imponohen si *mishërues* të revolucionit, që përfytyrohet si përmbysje e gjendjes ku njerëzit janë të shfrytëzuar e të shtypur. Besimi në këtë funksion mishërues të prijësit e të partisë, i shtyn turmat milionshe të lidhen për ta verberishtë.

Partia ndërkaq gradualisht, heq dallimin midis pushtetit politik e pushtetit administrativ, bën trupëzimin e shtetit me shoqërinë duke hequr autonominë e shoqërisë civile, duke e vënë nën kontrollin e vet të plotë të gjitha sferat e veprimtarisë shoqërore e individuale²¹.

Ndryshe nga rendi feudal, totalitarizmi kombinon një model kryekëput artificial-*makinen* me një model organicist të *shoqërisë*. Shoqëria del si një organizëm-makinë e madhe që përmban në vete njësi më të vogla (institucione e ndërmarrje në ekonomi, arsim, shëndetësi, gjyqësi etj) të cilat i nënshtrohen normës së njëtrajtshme të Organizatës së Madhe. Heqja e autonomisë së këtyre sferave dëmton thelbësisht vitalitetin e veprimtarive specifike në to. Homogjenizimi i hapësirës shoqërore, sadoqë maskohet me krijimin e një shumësie mikro-organizatash (institucione e shoqata në fusha të ndryshme të veprimtarisë shoqërore) që vetëm *simulojnë llojshmërinë*, në fakt realizon mohimin e llojshmërisë së mënyrave të jetesës, të mendimeve, sjelljeve, besimeve, bindjeve, dokeve, shijeve. Të gjitha këto i nënshtrohen projektit të kontrollit, të normalizimit e të uniformizimit²².

Këto tipare e bëjnë totalitarizmin të dallohet edhe nga ato tipe të sundimit që rëndom ngatërrohen me të: nga *despotizmi, tirania e diktatura*.

Ky dallim vjen e thellohet edhe më tutje po të merret në shqyrtim edhe një aspekt karakteristik i realitetit të totalitarizmit: kampi i përqendrimit.

Në një literaturë të bollshme (publicistike, sociologjike e artistike) për kampet e përqendrimit në regjimet totalitare, që u krijua në deceniet e fundit, hasim në interpretime të ndryshme të rolit e të funksionit të tyre: disa i shohin si dëshmi të shkallës së represionit në totalitarizëm, disa të tjerë i shpjegojnë edhe me arsye ekonomike-nevoja për shfrytëzimin e forcës së paguar të punës në vendet e pazhvilluara, e disa madje tregojnë mirëkuptim për njërin nga arsyetimet që e ofron vetë ideologjia totalitare: *kampi është vend i edukimit dhe i socializimit* të individëve të paadaptuar (vagabondë, huliganë, kokërrisur etj.) Në shumicën e këtyre teksteve nuk mungojnë përshkrimet e tmerreve që e cilësojnë jetën në kampe. Një pjesë e konsiderueshme e kësaj literature nuk e heton lidhjen e ngushtë midis *natyrës dhe thelbit* të sistemit totalitar dhe ekzistimit të kampeve të përqendrimit në të.

Në ç'mënyrë Leforti e shpjegon lidhmërinë e përmendur? Njëri nga konceptet bazë të ideologjisë totalitare, për të, është koncepti për *popullin si një organizëm e trup unik* "populli-Një". Ndërkaq moment konstitutiv i identitetit të popullit, sipas tij është "armiku", ai i të gjitha ngjyrave. Ai vën në pah se procesi i vendosjes dhe i riprodhimit të sistemit totalitar zhvillohet në mënyrë të pandashme me procesin e ndjekjes së armikut, me procesin e pastrimit të popullit e shoqërisë ("profilaksia sociale") nga elemente të dyshimta e të rrezikshme²³. Ekzistimin e kampeve të përqendrimit në totalitarizëm Leforti nuk e shpjegon thjesht me shkallën e lartë të represionit në këtë regjim. Kampi, për të, shpreh synimin e totalitarizmit për ta përsunduar shoqërinë në mënyrë totale. Organizimi i shoqërisë dhe organizimi i kampeve lidhen ngushtësisht. Me gjithë shkallën e lartë të përsundimit të shoqërisë që arrin regjimi totalitar, duke e nënshtuar gjithë llojshmërinë e grupeve sociale e të individëve, llojshmërinë e projekteve të tyre nën një normë të vetme të sajuar nga kreu i partisë dhe prijësi ("egokrat"), rezistencat aty janë të dukshme. Megjithë mekanizmat që i disponon ky sistem, shoqëria i ikën kontrollit të plotë. Pikërisht për këtë, kampi, me motivet dhe mënyrën e themelimit të vet, me funksionimin e vet, shpreh synimin që të realizohet *sundimi i pakufizuar*²⁴. "Armiku" shkëputet nga relacionet e shumëfishta në shoqëri, relacione këto përmes të cilave njeriu realizon ekzistimin e vet shoqëror, dhe vendoset në një "medium" i cili figuron projektin totalitar për shoqërinë. Në fakt, kampi është për Lefortin shoqëria totalitare e zhvilluar deri në skajshmëri. Kontrolli mbi viktimat dhe vetëkontrolli i viktimave arrijnë aty shkallë të lartë. Njerëzit e shkëputur nga indi social, të desocializuar, në kamp bëhen njerëz abstraktë, numra. Kampi, kështu, del si laborator ku totalitarizmi eksperimenton me mundësitë e veta për ta *fabrikuar shoqërinë*²⁵, e njëherit edhe "njeriun e ri". Prandaj, ndryshe nga interpretimet që kampin e shohin vetëm si tepri të represionit, apo që e shpjegojnë atë me arsye ekonomike ose madje edhe me ato pedagogjike, Leforti gjerësisht zhvillon dhe argumenton tezën e vet se kampi dësh-

mon për projektin e totalitarizmit që të zhbëjë "virtualitetin e raportit social, lidhjen elementare të reciprocitetit", për përpjekjen e tij që çdo njeriu ta bëjë të huaj për tjetrin²⁶. Pushteti totalitar e sheh si armik të rrezikshëm sociabilitetin, spontanitetin, pluralitetin e projekteve individuale e sociale. Procesi i prodhimit dhe i ndjekjes së armikut zhvillohet mbi tërë gjerësinë e hapësirës shoqërore si proces i pandërprerë, ngase ai është kusht i vazhdueshëm për afirmimin e identitetit të sistemit totalitar²⁷.

Dimensioni simbolik i të drejtave të njeriut

Mëvetësia e pikëpamjeve të Lefortit mbi demokracinë e totalitarizmin dhe raportin e tyre shquhet edhe në trajtimet e tij për të drejtat e njeriut.

Në tekstet që i shkroi aty nga fundi i viteve '70 dhe në fillim të viteve '80 Leforti i merr në shqyrtim disa interpretime karakteristike të kësaj çështjeje. Përfaqësuesit e njerit nga interpretimet e përhapura brenda "të majtës" evropiane, në njërën anë, pranonin shkeljen e të drejtave të njeriut në vendet "socialiste", por në anën tjetër refuzonin me ngulmë të problematizojnë natyrën dhe thelbin e regjimeve komuniste. Qëndrimin e tyre ata e arsye-tonin me tezën se të drejtat e njeriut janë të drejta individuale e nuk janë politike. Natyra e shtetit, ndërkaq, dallon nga natyra e individëve, ngase shteti i nënshtrohet ligjeve e shtrëngesave që janë specifike për të²⁸. Ky argumentim haset edhe te kundërshtarët e komunistëve-tek iedologët konservativë jokomunistë. Edhe këta e përkufizojnë politikën me "raporte të pronësisë" dhe me "raporte të forcës" e realizimin e të drejtave të njeriut e bëjnë të varur nga imperativi i ruajtjes së shtetit, pra i nënshtrohen arsyes së shtetit (parimit *raison d'Etat*). Leforti problematizon po ashtu pozicionin i cili reduktohet në mbrojtjen e të drejtave të njeriut "të përpunuar si një religjion i rezistencës kundrejt çdo pushteti", por që refuzon ta mendojë politikën²⁹. Është fjala për pozicionin e intelektualëve që "nuk duan të merren me kurfarë politike".

Përkundër këtyre interpretimeve, Leforti zhvillon dhe argumenton tezën e vet se të drejtat e njeriut kanë karakter thellësisht politik, se janë të lidhura me natyrën dhe thelbin e një sistemi politik dhe të një trajte të shoqërisë, se statusi i tyre ndriçon më së miri karakterin e një sistemi dhe shkallën e qytetërimit në një shoqëri.

Argumenti i kësaj teze mbështetet në konceptet kyçe të Lefortit për demokracinë e totalitarizmin. Shqyrtimi i çështjes të të drejtave të njeriut, pikërisht pse kjo nuk reduktohet në çështje humanitarizmi, hap edhe një pikëvërtetim të trajtës së një shoqërie.

Shpallimin e pikëpamjes së vet Leforti e nis me problematizimin e kritikës së Marxit për të drejtat e njeriut në veprën e njohur polemike "Rreth çështjes ebreje" (1843), ngase e sheh atë si interpretim relevant, edhe për shkak të ndikimit që ka ushtruar në mendimin filozofik e politik, edhe për shkak të mënyrës së instrumentalizimit të tezave të Marxit në praktikën e "socializmit" bashkëkohor.

Të drejtat e njeriut, ashtu si u shtruan nga fundi i shekullit XVIII, për Marxin kanë karakter kryekput ideologjik, ngase duan të justifikojnë e njëherit të mjegullojnë e të mistifikojnë raportet e sundimit dhe të nënshtrimit në shoqërinë e re borgjeze. Sipas tij, ato synojnë t'i japin formë shthurjes së individëve në gjirin e shoqërisë dhe të ndarjes midis shoqërisë së atomizuar civile dhe bashkësisë politike, që s'është tjetër veç një surogat bashkësie. Të drejtat e njeriut për Marxin s'janë veçse të drejta të njeriut egoist, të ndarë nga njeriu tjetër dhe nga kolektiviteti (njeriu i ndarë në dysh-homo duplex-në "borgjez" e në "qytetarë abstrakt")³⁰. Marxi njëherit kritikon konceptin e "natyrës njerëzore" si abstrakte në karakterin e saj universal. Është kurioze se këtë kritikë Marxi, si mendimtar i revolucionit, i lirisë e i barazisë, e ka të përbashkët me ideologët konservativë (Burke, De Bonald, De Maistre).

Leforti do të bëjë një analizë kritike të leksimit dhe të interpretimit të *Deklaratës për të drejtat e njeriut* (1789) nga Marxi, e në veçanti do ti shqyrtojë rrjedhojat që i nxjerr Marxi nga pikëshikimi i vet lidhur me opin-

ionin, lirinë, barazinë, pronësinë e sigurinë. Theksin kryesor në kritikën e interpretimit të Marxit Leforti nuk e vë në pamëshitetjen e vërejtjeve të tij, në inkonskuencën e tyre, në keqinterpretimin e disa neneve të Deklaratës, jo aq në atë që Marxi heton në to por pikërisht në atë që ai injoron dhe nuk heton në to ³¹. Këtë *moshetim* Leforti e shpjegon me kufizimet e disa koncepteve kyçe të Marxit.

As Marxi e as Burke nuk hetuan ngjarjen e re historike që e solli shthurja e sistemit feudal: fenomenin e çtrupëzimit dhe shpleksjen e sferave *pushteti-e drejta-dija*. Ata nuk hetuan një moment të ri, atë që ideja e të drejtave të njeriut mohon: përkufizimin e një pushteti si mbajtës (pronar) të së drejtës, nocionin e një legjitimiteti themeli i të cilit do të ishte jashtë ndikimit të njeriut. Marxi në veçanti injoron funksionin e pranuar të ligjit të shkruar, statusin që e fiton ligji duke u ndarë nga sfera e pushtetit ³². Mirëpo, Leforti pranon se kritika e Marxit për funksionin ideologjik të ligjit dhe të drejtës në maskimin e raporteve të shfrytëzimit E të sundimit nuk është e paqëlluar. Por kjo kritikë del e kufizuar ngase e redukton të drejtën në aspektin e saj ideologjik, duke e flakur dimensionin e ligjit si të tillë, e në veçanti *karakterin simbolik të së drejtës*. Shkakun e këtij kufizimi Leforti e gjen në kufizimet e koncepteve të Marxit për emancipimin politik e emancipimin njerëzor. Vizioni i një shoqërie të çliruar nga çfarëdo shtypje, shfrytëzim e përbuzje të njeriut, vizion ky që e përshkon të tërë veprën e Marxit, nuk përmban në vete asnjë institucion të caktuar si pikëmbështetje për realizimin e të drejtave dhe lirive të njeriut ³³. Duke kritikuar karakterin e kufizuar të *emancipimit politik* që solli shoqëria e re, Marxi synon kapërcimin e tij në saje të *emancipimit njerëzor*, të një shoqërie të lirisë e të barazisë *absolute*. Mirëpo, ai i flak institucionet që do të duhej ta bënë të mundur realizimin e atyre qëllimeve. Kështu ai flak shtetin, sferën e politikës dhe veprimtarinë politike si veprimtarë të *tëhuajsuar*. Për Lefortin, që nuk synon qëllime të tilla absolute, problemi shtrohet në ç'mënyrë shteti të vëhet nën kontrollin e ligjeve, si të aprovohen këto me një proce-

durë demokratike, që nënkupton një parlament shumëpartiak, si të arrihet që pushteti legjitimitetin e vet ta mbështesë në parimet që dalin nga sfera e të drejtës, e cila duhet të jetë e pavarur. Përvoja historike prej më se një shekulli pas Marxit i jep të drejtë Lefortit: të drejtat dhe liritë e njerëzve, të klasave e shtresave të ndryshme, janë respektuar e zhvilluar mu aty ku janë kultivuar të mbërrimet e demokracisë: ndarja e tri pushteteve (ligjvënës, ekzekutiv e gjyqësor), pavarësia e shoqërisë civile nga shteti, pavarësia e individit, liria e opinionit, e bashkimit politik e profesional etj. Kufizimin e kritikës së Marxit e vë në shesh në veçanti lindja e totalitarizmit, që u ndërtua mbi rënojat e të drejtave të njeriut: u pa sheshit se tëhuajësimi i njeriut nuk ngjet për shkak të ndarjes shteti-shoqëria civile dhe ekzistimit të "iluzionit" të drejtave të njeriut, por përkundrazi pse "shteti zotëron parimin e të gjitha formave të socializimit", pse mungon pavarësia e sferës individuale. Pikërisht këto shkaqe bëjnë që njeriu të jetë më i shkëputur nga njeriu tjetër dhe nga kolektiviteti si asnjëherë më parë ³⁴.

Nga kjo që u tha megjithatë nuk shihet qartë përse e drejta nuk mund të reduktohet në funksionin ideologjik, në instrumentalizimin që mund të ndodhë me të në sisteme të ndryshme? Veç provës faktike historike, të nxjerrë nga rrjedha e historisë, në tekstet e Lefortit tezën e përmendur e gjejmë të mbështetur edhe në provën që i takon një *rendi simbolik*.

Dimensionin simbolik të së drejtës Leforti e heton në dy Deklaratat e njohura (atë franceze dhe atë amerikane) për të drejtat e njeriut: aty e drejta del e shtruar në vetë *natyrën e njeriut*, jo më në vullnetin hyjnor të zotit apo në personin e mbretit. Nocioni i të drejtave të njeriut shtron një "vatër të pavarur" nga shteti; përkundrazi, vetë shteti duhet ta mbështesë legjitimitetin e vet në parimet e së drejtës, që janë jashtë kontrollit të tij ³⁵. Nëse shteti e gëlltit pavarësinë e kësaj sfere, atëherë ai shndërron në shtet totalitar.

Mirëpo të drejtat e njeriut, të shpallura në Deklaratat e njohura nuk janë objekt i thjeshtë i tyre: në esencën e të drejtave Leforti dikton kërkesën që të deklarohen.



"Njeriu paraqitet nëpërmjet përfaqësuesve të vet si qenie esenca e të cilit është që të shpallë të drejtat e veta; e pamundur është të ndahet ajo që është shpallur nga vete shpallja ³⁶".

Një aspekt tjetër i dimensionit simbolik të të drejtave të njeriut shqitet në faktin se formulimi i tyre përmban kërkesë për riformulimin e tyre. Të drejtat e fituara mbështesin të drejta të reja. Përtej formulimit të tyre faktik, Leforti heton në to para së gjithash "*të drejtën për të pasur të drejta*". Pikërisht pse të drejtat e njeriut shtrohen si referencë e fundit, çdo legjislacion ekzistues bëhet çështje, e përmes tij edhe shoqëria e rendi shoqëror të cilit i takon ³⁷.

Është mjaft i përhapur edhe interpretimi i cili dallimin midis demokracisë e totalitarizmit e përkufizon si dallim midis një sistemi që funksionon në mbështetje të ligjeve dhe një sistemi që i flak ligjet. Këtë interpretim Leforti e konteston duke vënë në pah, edhe në mbështetje të analizave të Hannah Arendtit (Hana Arent), se totalitarizmi nuk është tirani ngase i referohet një *ligji absolut*, i cili nuk varet nga interpretimi i njerëzve, është jashtë ndikimit të

tyre, sikurse edhe pushteti: në variantin komunist ai ligj absolut del si ligj i Historisë që determinon gjithçka, e në variantin nacist si Ligji i Jetës ³⁸.

Brenda konceptit të Lefortit dallimi i përmendur artikullohet ndryshe: demokracia moderne nuk është thjesht regjim i rregulluar me ligje por regjim i mbështetur në "legjitimitetin e një debati për legjitimen e jolegitimen ³⁹", debat ky që nuk ka garanca të fundit, por është i hapur. Kjo do të thotë se askujt (asnjë individ, grupi shoqëror apo partie politike) nuk i takon vendi i *Gjykatësit të madh*, ngase drejtësia lidhet për një *hapësirë publike*, çdoherë të papërcaktuar, sepse s'është *pronë* e askujt; aty bëhet problematizimi i të drejtës por edhe i vetë rendit shoqëror dhe të çështjeve të veçanta ekonomike, politike e kulturore ⁴⁰.

Gjatë shpalosjes së konceptit të vet Leforti do t'u kundërvihet edhe atyre interpretimeve që të drejtat njerëzore i shohin të realizuara në shoqëritë e sotme demokratike, i shohin si një realitet e një fakticitet i thjeshtë. Krahas përkufizimit të thelbit të totalitarizmit në mohimin e të drejtave të njeriut ai njëherit i shmanget iluzionit komod që ato të drejta t'i shohë si një realitet

të thjesthë në shoqëritë demokratike: "Të drejtat janë parime gjeneratore të demokracisë, por ato parime nuk ekzistojnë si institucione pozitive, inventurën e elementeve të cilave do të mund ta bënim, edhe po të jetë e sigurt se ato i japin frymë institucioneve"⁴¹. Pikërisht pozicioni i tillë ia bën të mundur Lefortit të ketë qëndrim kritik ndaj realitetit ekzistues në fushën e të drejtave të njeriut në shoqëritë ku janë vendosur institucionet demokratike, të vlerësojë shkallën e realizimit dhe të respektimit të të drejtave, trajtat e veçanta të shkëljes e të cënimit të individëve e të grupeve (të pakicave fetare e nacionale por edhe politike, të imigrantëve, të punëtorëve të huaj, femrave, të rinjve etj.)

Pohimi se *institucionet demokratike* nuk janë garancë e mjaftueshme për realizimin e të drejtave shpie te theksimi i rolit të *vetëdijes për të drejtat* dhe të guximit civil të qytetarëve që të luftojnë për mbrojtjen e të drejtave të legalizuara dhe për miratimin e drejtave të reja. DimENSIONI simbolik i të drejtës del në shesh edhe në "faktin se vetëdija për të drejtën nuk shterret në asnjë trajtë të objektivimit juridik"⁴². Aq më tepër që një praktikë e caktuar juridike mund të jetë në shërbim të mbrojtjes së formave të caktuara të shtypjes e të shfrytëzimit. Këtu hapet fusha e kritikës së mënyrave si zbatohen të drejtat e njeriut në një shoqëri demokratike, si sajohen faktikisht ligjet, trajtat që marrin padrejtësitë në funksionimin e sistemit juridik (presionet nga sfera e shtetit, korupcionit etj.).

Leforti kritikon edhe pozicionin e *pozitivizmit juridik* që kërkon të respektohet verberisht çdo ligj që është në fuqi, dhe që këtë kërkesë e shtron si kusht të funksionimit të shtetit juridik. Ajo që ia bën të mundur kritikën është pikëshikimi i dimensionit simbolik të së drejtës: çdo ligj në fuqi nuk është vetiu legjitim, madje edhe nëse ka kaluar përmes një procedure demokratike. Ai çdoherë i shtrohet sprovës së problematizimit nga kriteret që dalin nga "ajo vatrë e pazotërueshme" e të drejtës, e që pyesin: është i drejtë a i padrejtë një ligj i caktuar? Leforti përkujton me këtë rast se madje edhe shteti juridik monarkist nënkuptonte mundësinë e një kundërvënies



ndaj pushtetit (lidhur me pagimin e një taksimi të tepruar apo madje edhe të drejtën në kryengritje kundër një qeverie jolegitime). Ndërkaq shteti demokratik, që është themeluar pikërisht me shpalljen e të drejtave të njeriut dhe me pavarësimin e të drejtës, shkon edhe më larg: ai i shtrohet sprovës së të drejtave të reja (e drejta në grevë, e drejta relative në punë, në sigurim social)⁴³.

Në punimin "Të drejtat e njeriut dhe shteti-providencë" (në veprën *Ese për politikën*, 1986) Leforti, veç tjerash, do të marrë në shqyrtim kritikën që ia bëri Pierre Manent, pas botimit të punimit "Të drejtat e njeriut dhe politika" në librin *Zbulimi demokratik* (1981).

Teza kryesore e Manent-it mund të përmbledhet kështu: është e vërtetë se demokracia ka triumfuar duke vendosur ndarjen midis shoqërisë civile, që del si vend i opinionëve pa pushtet dhe shtetit laik liberal, si vend i pushtetit pa opinionë. Shteti gjithnjë e më tepër forcohet nën firmën e neutralitetit, të ndërmjetësuesit midis interesave të kundërta, ndërsa shoqëria civile dobësohet vazhdimisht, duke u shndërruar në një "teatër të zhurmshëm të

opioneve", pasi opinionet e individëve të veçuar e neutralizojnë njëri tjetrin⁴⁴).

Kufizimet e njëanshmërinë e kësaj teze, që përndryshe ndalet të përshkrimi i disa dukurive nga jeta politike e publike, Leforti e vë në pah duke theksuar se ajo injoron risinë e ndryshimit të statusit të pushtetit: pushteti duhet ta fitojë legjitimitetin e vet në sajë të garave të partive, e këto nënkuptojnë ushtrimin e lirisë së individëve e grupeve, shfaqjen e tyre në skenën publike. Ajo tezë injoron origjinalitetin politik të demokracisë: pushteti është i detyruar ta kërkojë vazhdimisht themelin e vet, sepse ligji e dija nuk janë trupëzuar nën presionin e atij apo të atyre që e ushtrojnë⁴⁵).

Mirëpo, Leforti, në anën tjetër, nuk injoron ekzistimin e shumë dukurive në shoqëritë demokratike që dëshmojnë për reduktimin e dukshëm të të drejtave e lirive të individëve apo të grupeve. Ai i analizon ato hollësisht veçanërisht në punimet e veta të botuara në vitet e tetëdhjeta. Lidhur me këtë ai do të konstatojë në një tekst se reduktimi i të drejtave në shoqëritë demokratike evropiane bëhet pikërisht në emër të zgjerimit të tyre: kërkesat e reja të grupeve e shtresave të ndryshme, partitë e qeveritë i pranojnë, e modifikojnë legjislacionin në pajtim me to, administrata fiton autorizime të reja që shoqërohen me mjete të reja të kontrollit dhe shtrengesa të reja mbi shoqërinë e individin me ndërhyrje në hollësitë e jetës civile e individuale, që e cilësojnë shtetin-providence⁴⁶).

Duke mos i mohuar këto dukuri Leforti njëherit vë në pah se vetë *dispozitivi demokratik* pengon procesin e ekspansionit të shtetit, pengon pleksjen në një organ udhëheqës të instancave: pushteti-e drejta-dija. Në analizat e veta ai provon se, sadoqë kompleksiteti i aparatit shtetëror zgjerohet, sektorët e tij megjithatë i nënshtrohen presioneve të *aktorëve të ndryshëm social* që mbrojnë autonominë e sferës së tyre, normat e kompetencat e veta⁴⁷).

Në analizat e veta Leforti i kushton vëmendje të veçantë lëvizjeve të shumëllojta (ekologjike, feministe, lëvizjeve për të drejta të reja sociale e kulturore), të cilat zhvillojnë ide të reja, trajta të reja të komunikimit, cysin nga format e reja të jetesës.

Në shqyrtimet e tij shqitet kompleksiteti i fushës ku zhvillohet lufta midis kontrollit, normalizimit e shtrengesave, që vijnë qoftë nga ana e shtetit qoftë nga ana e opinionit masiv e kompakt që varfëron mendmin dhe ngulfat frymën krijuese, dhe në anën tjetër të lëvizjeve emancipuese që u kundërvihen. Nga raporti i forcave në çdo shoqëri të veçantë, varet edhe *trajta e asaj shoqërie*, edhe kufijtë e lirisë në të, edhe shkalla e emancipimit të qytetarëve të saj.

Ekskursi ynë nëpër tri veprat e rëndësishme të Lefortit kishte për qëllim të vijëzohet pozicionin teorik, fillin e argumentit të tezave të tij dhe disa nga konceptet kyçe me të cilat ai zbërthen fenomene që i përkasin sa vendeve që janë duke përjetuar shthurjen e totalitarizmit aq edhe vendeve ku institucionet demokratike kanë një traditë mjaft të gjatë. Përkthimi dhe prezentimi i pikëpamjeve të Lefortit është i motivuar nga bindja se ato mund të na ofrojnë njohuri të domosdoshme për deshifrimin edhe të përvojës sonë sociale e politike.

* Teksti është dedikuar si parathënie e një vëllimi të artikujve të zgjedhur të Claude Lefortit që është përkthyer në gjuhën shqipe, por ende nuk është botuar.

SHËNIME:

1. Claude Lefort u lind më 1924. Ligjërroi, deri në vitin 1990, në Ecole des Hautes Etudes en Sciences Sociales, në njerin nga institucionet më të çmuara arsimore të Francës. Veprat kryesore: "La Brèche" (Shpërthimi), në bashkëpunim me Edgar Morin, botoi Fayard, 1968. "Elements d'une critique de la bureaucratie", (Elemente të një kritike të burokracisë), Dros, 1971., "La travail de l'oeuvre. Machiavel" (Puna e veprës. Machiaveli); Gallimard, 1972., "Un homme en trop" (Njeriu i tepërt), Seuil, 1975, "Sur une colonne absente. Ecrits autour de Merleau-Ponty" (Rreth një shtylle. Shkrime për Merleau-Ponty-n), Gallimard, 1978., "Les Formes de l'histoire" (Trajta e historisë), Gallimard, 1978., "L'invention démocratique. Les limites de la domination totalitaire". (Zbulimi demokratik. Kufijtë e sundimit totalitar), Fayard, 1981., "Essais sur le politique" (Ese për politikën), Seuil, 1986.

2. Claude Lefort, "Essais sur le politique", fq. 19-20.

3. Po aty, fq. 20

4. Po aty, fq. 19

5. Po aty, fq. 20.

6. Po aty, fq. 21

7. Po aty, fq. 21

8. Po aty, fq. 26

9. Po aty, fq. 26

10. Po aty, fq. 27

11. Claude Lefort, "L'invention démocratique", fq. 63

12. Lefort, "Essais sur le politique", fq. 27

13. Po aty, fq. 29

14. Po aty, fq. 25

15. Po aty, fq. 25

15. Po aty, fq. 23

17. Po aty, fq. 29

18. Po aty, fq. 21
 19. Po aty, fq. 22.
 20. Po aty, fq. 22
 21. Po aty, fq. 22
 22. Lefort, "L'invention démocratique", fq. 100
 23. Lefort, "Un homme en trop", fq. 52
 24. Po aty, fq. 123
 25. Po aty, fq. 15
 26. Po aty, fq. 118. Analizat e hollësishme të Leforit lidhur me këto çështje në veçanti vejnë në spikamë "rezultatet" e sistemit totalitar në dehumanizimin e njerëzve dhe të marrëdhënieve njerëzore, në prodhimin e frikës, urrejtjes dhe të mosbesimit midis njerëzve, *trajtat më të thella të degradimit të njeriut që janë parë ndonjëherë në historinë e njerëzimit*. Megjithatë, duhet cekur se thellësinë e tëhuajësimit të njeriut në botën totalitare e kanë artikuluar në mënyrë më të fuqishme krijuesit letrarë: Solzhenicini, Kundera, Nadezhda Mandeljshta, Orwell etj.
 27. Po aty, fq. 52
 28. "L'invention démocratique", fq. 49. Edhe një numër i konsiderueshëm i intelektualëve tanë ka dëshmuar mjaft mjeshtëri e vullnet për të heshtur apo për të arsyetuar e mbrojtur natyrën dhe thelbin e regjimit totalitar në Shqipëri, funksionimin dhe rrjedhojat që i ka prodhuar ai në një periudhë prej gjashtë shekulli.
 29. Po aty, fq. 51. Parimi i arsyes së shtetit (*Raison D'Etat*) që pretendonjë të mbajë interesa më të larta (shtetërore a kombëtare) shërben dhe ka shërbyer si justifikim për shkeljen e të drejtave dhe lirive të individëve, grupeve të veçanta apo të tërë një popull. Viteve të fundit, ideologët e nacionalizmit serb e përdorën edhe "arsyen e shtetit serb" jo vetëm për të arsyetuar represionin e shumëfishitë kundër shqiptarëve por edhe për ta mbështetur projektin e shpopulëzimit të Kosovës nga shqiptarët. Daniel Mayer, një veprimtar i shquar i të drejtave të njeriut pat thënë me një rast: "Arsyeja e shtetit përdoret atëherë kur shteti humb arsyen".
 30. Po aty, fq. 52
 31. Po aty, fq. 56
 32. Po aty, fq. 61
 33. Po aty, fq. 61
 34. Po aty, fq. 58
 35. Po aty, fq. 64

36. Po aty, fq. 65
 37. Po aty, fq. 67
 38. "Essais sur le politique" fq. 52
 39. Po aty, fq. 53
 40. Po aty, fq. 55
 41. "L'invention démocratique", fq. 69
 42. Po aty, fq. 69.
 43. Po aty, fq. 67. Paqëndrueshmërinë e pozicionit të pozitivistit juridik që kërkon të respektohet verbërisht çdo ligj që është në fuqi, mund ta ilustrojmë me Ligjin mbi masat e veçanta në Kosovë, që e miratoi Kuvendi i Serbisë. Se një ligj, pavarësisht madje nga procedura me të cilën është miratuar mund të jetë negacioni më i thellë i idesë dhe i frymës së të drejtës, më së miri dëshmon ligji i përmendur. Ky ligj në fakt legalizoi dhe bëri të mundur zbatimin e formave më të egra të shkeljes së të drejtave të njeriut, të diskriminimit, të pabarazisë nacionale.
 44. "Essais sur le politique", fq. 46-47
 45. Po aty, fq. 47
 46. Po aty, fq. 48
 47. Po aty, fq. 49. Të shtojmë në fund se, derisa Hannah Arendt e kupton sistemin totalitar si sistem të mbyllur e të vetëmjaftueshëm kështu që thyerja e tij mund të bëhet vetëm nga jashtë, Leforti do t'i nxjerrë në shesh kundërtënie dhe kufizimet e brendshme të totalitarizmit që do të shkaktojnë rrënimin e tij. Studimet e Leforit nga vitet e '70' dhe '80' për regjimet totalitare në Bashkimin Sovjetik, Hungari e Poloni diktuan në mënyrë lucide plasaritjet që do të zgjerohen dhe që do të shkaktojnë rrënimin e regjimeve totalitare. Lidhur me këtë çështje shquhen në veçanti punimet "Disidentët sovjetikë dhe ne" (1977) "Kryengritja hungareze" (1957), "Një revolucion tjetër" (1977) "Kthimi nga Polonia" (1957), "Të zgjerohen kufijtë e të mundshmes" (1981), të ribotuara më vonë në "L'invention démocratique".

Muhamedin Kullashi

Democracy And Totalitarianism

This article consists of a presentation of the main ideas of the wellknown 20th century political thinker, Claude Lefort. Lefort's theoretical position differs both from marxist and liberal orientation of sociology of politics. The author deals especially with Lefort's writings about the totalitarian phenomenon. Lefort doesn't search for the source of totalitarianism on the level of empirical history (for eg. by changing of system of institutions or by changing the forms of power) but on the level of symbolic order which appears especially in the alternations of the status of power. If, for eg. Marx's explanation of the monarchy is as a superstructural phenomenon which emanates from the manner of the


production in the feudal order, then Lefort describes it as a society of symbolic unity which is expressed by the figure of a Body or a hierarchical pyramid where social functions are not changeable. According to Lefort only with the overthrowing of feudal order, comes the Disembodiment, when the sphere of power remains empty, respectively changeable. State power is not simply an organ of domination as marxists thought, but "the instance of legitimacy and identity", which in democracy should be subordinate to the procedure of periodical elections. Thereupon totalitarianism appears as a new type of reign which differs essentially from despotism, tyranny and dictatorship. Totalitarianism attempts the conquest of the whole society, this can be witnessed by presence of concentration camps found both in fascist and communist systems.

Të gjitha regjimet dhe pushtetet e huaja kishin interes të veçantë që popullin shqiptar, me një shtrirje territorialisht kompakte, ta mbanin të ndarë në njësi të ndryshme territoriale -politike dhe të dezintegruar në të gjitha rrafshet. Me vendimin e Konferencës së Londrës (1913), të konfirmuar edhe nga Konferenca e Versajës (1919) dhe Konferenca e Parisit (1946), Kosova dhe viset e tjera të banuara nga shqiptarët në ish-Jugosllavi, përkundër vullnetit të shqiptarëve, u lanë jashtë shtetit shqiptar, Shqipërisë, dhe në këtë mënyrë u copëtua tërësia etnike shqiptare.

Pas këtij copëtimi, u bë edhe me tragjike ndarja politike-territoriale e hapësirës shqiptare brenda vetë territorit të ish-Jugosllavisë. Politika jugosllave nga territori i pakëputur etnik i ndau shqiptarët në katër njësi territoriale-politike dhe shtetërore: në Kosovë, të cilës iu lejua vetëm një autonomi e kufizuar brenda Serbisë (madje, në pikëpamje juridike-politike, deri në vitin 1963, shumë nën statusin e Vojevodinës), mbetën afër 70% të shqiptarëve (sot rreth 2 milion), ndërsa rreth 30% mbetën jashtë saj; në Maqedoni rreth 25% (aktualisht së paku 800.000 ose rreth 40% në popullsinë e gjithëmbarshme të Maqedonisë), në tri komunat e Serbisë së Jugut (Preshevë, Bujanovc dhe Medvegje), që përbëjnë rreth 4% të shqiptarëve (sot rreth 100.000 veta) dhe në Mal të Zi rreth 2% (sot 50.000 veta). Edhe pas shkatërrimit të Jugosllavisë dhe krijimit të shteteve të reja (1992), bashkësia ndërkombëtare bëri që, duke mospërfillur parimin e vetëvendosjes edhe për shqiptarë, shqiptarët në këtë fazë si duket sërish të mbesin të ndarë, në kornizat e mëparshme. Midis Kosovës dhe Maqedonisë tashmë u vu një kufi artificial, duke i ndarë shqiptarët nga shqiptarët.



Mirëpo, edhe përkundër të gjitha ndarjeve historike dhe bashkëkohore të hapësirës etnike shqiptare, të gjitha pjesët e bashkësisë shqiptare, sa herë që pak mundësonin rrethanat e kohës, merrnin pjesë aktive në të gjitha proceset dhe lëvizjet kombëtare, politike, kulturore dhe ekonomike, pos në një periudhë të ekzistimit të sistemeve të egra komuniste në të dy anët e kufirit, që ishin përçarës dhe copëzues të kombit shqiptar.

Vëllimi, rritja demografike dhe shtrirja territoriale e pakëputur etnike e shqiptarëve ishin dhe mbetën një ndër faktorët më të rëndësishëm të perspektivës sonë kombëtare, të rezistencës ndaj asimilimit dhe të zhdukjes fizike, por edhe të frikësimit të forcave hegjemoniste serbe. Prandaj, të vetëdijshme për këto fakte, të gjitha pushtetet serbe-jugosllave, ndërmorën aksione të pandërprera për sakatosjen e homogjenitetit



REALITETI ETNIK-DEMOGRAFIK I KOSOVËS DHE ASPIRATAT SERBE

HIVZI ISLAMI
HIVZI ISLAMI
HIVZI ISLAMI
HIVZI ISLAMI
HIVZI ISLAMI



etnik të rajoneve të banuara nga shqiptarët, ndërrimin e përbërjes së tyre kombëtare në dëm të shqiptarëve dhe dobësimin e fuqisë vitale demografike të popullit shqiptar.

I. Trojet shqiptare në ish-Jugosllavi, ndonëse shumë të pasura me resurse natyrore dhe potenciale njerëzore, mbetën më të pazhvilluarat në të gjitha aspektet. Prandaj edhe dallimet në karakteristikat dhe zhvillimin demografik midis shqiptarëve sot nuk janë të mëdha. Në rrjedhat e ndryshimeve intensive, vonë e ngadalë, u përfshinë sektorët kyç të riprodhimit dhe të zhvillimit të popullsisë shqiptare: *femra* si faktor kryesor i përtërirjes biologjike, *familja* si suazë vendimtare e lindjes, e amësisë dhe riprodhimit dhe si bartëse e shumë funksioneve shoqërore-ekonomike dhe *fshati* si strukturë dominante në shoqërinë kosovare-shqiptare (rreth 65% të shqiptarëve edhe sot jetojnë në fshat).

Kosova dhe viset e tjera shqiptare deri vonë pas Luftës II Botërore njiheshin si territore rurale-agrare dhe autarkike, në pikëpamje ekonomike dhe demografike, me mbeturina të shumta të strukturave gjysmëfeudale. Si profesion dhe mënyrë dominante e jetës ishte bujqësia ekstensive dhe natyrale, ndërsa analfabetizmi si përcjellës shekullor i shqiptarëve ishte në nivel shumë të lartë, sidomos te popullata femërore. Për këto arsye dhe për shkak të karakterit afatgjatë të proceseve demografike, shqiptarët në ish-Jugosllavi, por edhe populli shqiptar në përgjithësi, sot paraqesin *transiclonin e fundit demografik në Evropë*. Popullsia rurale-agrare të Kosovës dhe të territoreve të tjera shqiptare edhe sot i bie barra kryesore e riprodhimit të popullsisë. Kjo popullatë deri vonë ishte afër gjendjes ku ekuilibri demografik midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish për shkak të mortalitetit të lartë, sidomos të foshnjëve, sikurse ishte rasti me të gjitha popullatat paraindustriale¹.

Lënia pas dore e Kosovës dhe e shqiptarëve në politikën zhvillimore duke filluar nga politika e njëanshme dhe e pavolitshme e investimeve, norma e ulët e punësimit, veçanërisht e femrave e deri të ndryshimet e ngadalshme e të vonshme në sferën e arsimit, të kulturës, të shëndetësisë publike, të infrastrukturës dhe të standardit të ulët jetësor në përgjithësi-ishte një strategji e paramenduar dhe e konceptuar mirë. Në Kosovë p.sh. në strukturën e investimeve, industria ekstraktive (plumbi, zinku, nikli etj.) dhe energjetika (thengjilli) gëlltitnin pjesën dërmuese të investimeve, ndërsa ky tip i industrisë siç dihet, ka efekte të vogla në akumulimin, në të ardhura dhe në punësim (sidomos të femrave), ndërsa kapacitetet përpunuese ishin të

pamjaftueshme për të absorbuar fuqinë e bollshme punëtore, që nxiti emigrimin ekonomik në botën e jashtme para 2-3 dhjetëvjetëshave. Mbi 95% e lëndës së parë të "Trepçës" finalizohet jashtë Kosovës, e kështu ishte situata edhe me energjinë elektrike e cila eksportohej jashtë Kosovës. Strategjia e tillë në tërësi përfaqësonte interesin e Serbisë dhe të Jugosllavisë. *Kosova në planin ekonomik gjithnjë kishte pozitë të një kolonie, ndërsa sot paraqet shembullin më tipik të kolonisë klasike*. Prandaj, pa një vështrim të thellë dhe kritik të një politike të tillë në të gjitha segmentet e jetës shoqërore nuk është as e mundur të kuptohen rrjedhat dhe ndryshimet demografike në Kosovë dhe në trojet e tjera, veçanërisht në lëmin e përtërirjes së popullsisë, në një anë, si dhe strategjia kryesore e politikës jugosllave, e cila kishte për qëllim që problemin e shqiptarëve ta zgjidhë me shpërnguljen e tyre në Turqi dhe me asimilimin, në anën tjetër.

II Niveli aktual i natalitetit (rreth 28 promila) dhe i riprodhimit në përgjithësi të shqiptarët, struktura shumë e re e popullsisë shqiptare (52-53% të popullsisë deri në moshën 19 vjeçare dhe moshë mesatare rreth 24 vjet), që paraqet një dukuri të rrallë edhe në demografinë botërore, si dhe stabiliteti i bashkësive martesore dhe i familjeve flasin për një *popullsi vitale*, me rritje të shpejtë demografike. Pikërisht kjo perspektivë demografike nga fillimi i viteve të 80-ta u bë faktor shumë shqetësues për qarqet politike, shtetërore e shkencore të ish-Jugosllavisë dhe, mbi të gjitha, të Serbisë. Prandaj, në kuadër të fushatës së gjerë kundër Kosovës dhe shqiptarëve, nuk u la pas dore as diskursi ndaj problemeve të tyre demografike. Hetohej se diskursi po zhvillohet në mungesë të plotë të gjykimit racional, duke u injoruar të gjitha qasjet shkencore e humaniste ndaj zhvillimit të popullsisë të një populli. Shumë shpejt doli në shesh qëllimi i vërtetë i këtij diskursi: problemi demografik i shqiptarëve nuk shtrohej për shkak të përmirësimit të cilësisë së lindjes, të riprodhimit e të jetës, humanizimit të raporteve midis gjinive dhe ruajtjes së shëndetit të femrës, por shtrohej për arsye të një frike të paarsyeshme nga shqiptarët dhe shtimi i tyre. *Shqiptarofobia mori hov aq shumë sa që shqiptarët nisën të numërohen se sa do të jenë pas 30 e 100 vjetësh*, se ata do të okupojnë hapësirën serbo-jugosllave dhe do ta rrezikojnë prosperitetin demografik, politik, ekonomik e kombëtar të sllavëve të jugut dhe, përmes faktorit demografik dhe lëvizjes "secesioniste", do ta krijojnë "Shqipërinë e Madhe". Në këtë mënyrë e tërë qasja e shndërruar në një fushatë të paparë kundër popullit shqiptarë në ish-Jugosllavi, *me prapavijë të qartë raciste*, ku

rrafsh qendror i sulmeve u bë nataliteti i shqiptarëve. Shumë udhëheqës shqiptarë komunistë e përkrahnin një politikë të tillë shoveniste.

Institucionet politike e shtetërore të Serbo-Jugosllavisë kërkonin zvogëlimin radikal të natalitetit të shqiptarëve me masat administrative, antisociale dhe anticivilizuese të tipit tashmë të njohur indiano-kinez. *Serbia donte ta përdorte Maqedoninë si territor provues jo vetëm për ta kufizuar rritjen demografike të shqiptarëve, por edhe për ta reduktuar shkollimin shqip dhe perspektivën e përgjithshme të shqiptarëve në Kosovë.* Pushteti maqedon, si në nivel të Republikës ashtu edhe në nivel të komunave, ku dominonin shqiptarët, nxorri disa ligje për të ushtruar presion në sferën e lindjes; kërkohej që familjeve shqiptare që kishin më shumë se dy fëmijë. t'u kufizohej e drejta në shkollim, punësim, mbrojtje shëndetësore të fëmijëve "tepricë" etj. Ky pushtet nxorri edhe ligjin mbi kufizimin e ardhjeve të shqiptarëve në vendbanimet e Maqedonisë. Ai frikësohej se me rritjen natyrore dhe shtimin mekanik, shqiptarët kinse do ta krijojnë "Kosovën e dytë" dhe "Shqipërinë e dytë" në Maqedoni.

Në çdo shoqëri me institucionet e saj nuk është kontestuese që, në mbështetje të njohurive shkencore dhe qasjeve humaniste, të diskutohet çështja e sjelljes dhe e sistemit të tërë të qëndrimeve e të vlerave që kanë të bëjnë me lindjen, martesën dhe familjen, si dhe vlerësimin e drejtë të jetës. Por, në këto duhet të respektohen patjetër parimet themelore të lindjes dhe të riprodhimit si parime të përbashkëta, pa marrë parasysh përkatësinë rajonale, sociale, nacionale, racore dhe fetare, sepse është fjala për një sferë shumë intime të jetës, e cila nuk toleron dhunën, politizimin dhe manipulimin burokratik. I tërë procesi i riprodhimit zhvillohet në mikronivel, që do të thotë se individët, çiftët bashkëshortorë dhe familja janë bartës të tij dhe ata vendosin për numrin e lindjeve dhe intervalin kohor midis lindjeve. *Çdo presion me motivacione të dyshimta në drejtim pro apo contra lindjeve është në kundërshtim të plotë me ndjenjat, vullnetin dhe arsyen e njeriut dhe jep vetëm rezultate kontraktive*².

Eksperiencia e popullatave që e kanë kaluar fazën e plotë të transicionit demografik (rënia e mortalitetit dhe e natalitetit dhe zgjatja e jetës së njeriut), ka treguar se fillimi i rënies së natalitetit nuk paraqitet në tërësinë e popullatës, por në ato pjesë dhe shtresa të të cilat janë krijuar kushtet e ndryshimit të sjelljes riprodhuese. Në territoret e pazhvilluara, sipas

rregullit, barra e riprodhimit shtrihet në popullatën rurale bujqësore dhe të pashkolluar.

III Me ndryshimet sociale-ekonomike, arsimore, shëndetësore, infrastrukture etj., që e përfshinë Kosovën dhe territoret e tjera të banuara nga shqiptarët pas viteve të 60-ta dhe sidomos pas viteve të 70-ta, nisi të zvogëlohet shkalla e natalitetit dhe të diferencohet niveli i tij në pikëpamje rajonale dhe sociale. Hulumtimet e deritanishme demografike treguan se nataliteti është kryesisht çështje sociale-klasore, *nuk është as etnikisht e as knfjesionalisht i determinuar, as i lidhur me veçori ataviste e as me ideologji nacionale apo nacionaliste*, çfarë u mvishte sistemi serbo-jugosllav pandërprerë shqiptarëve. Kërkimet demografike, në bazë të të dhënave të regjistrimit të vitit 1981, edhe në popullatën kosovare këtë e dëshmuar: një femër kosovare (kohorta 45-49 vjet) aktive në jetën ekonomike lindi 3.07 fëmijë, ndërsa ajo e mbajtur 5.49 fëmijë; femra e mbajtur në bujqësi lindi 6.74 fëmijë, kurse femra aktive në profesionet jobujqësore 2.74 fëmijë; femra analfabete dhe pa përgatitje shkollore lindi 7.04 fëmijë, me shkollë të mesme 2.24 dhe me arsim superior 2.18 fëmijë³.

Dallimet në shkallën e natalitetit midis bashkësive të ndryshme kombëtare gjithashtu janë rezultat i nivelit jo të njëjtë të zhvillimit ekonomik, arsimor, kulturor e shëndetësor dhe mbi këtë bazë të krijimit të normave dhe sjelljeve ndaj riprodhimit biosocial, ndërkaq përkatësia etnike paraqitet vetëm si një karakteristikë sociale. Dallimet janë evidente edhe midis pjesëtarëve të nacionalitetit dhe konfessionalitetit të njëjtë, por në territore me shkallë të ndryshme të zhvillimit. Në pesë dhjetëvjetëshat e fundit, p.sh., shkallë më të lartë të natalitetit serbët kishin në Kosovë dhe B e H, malazezët në Mal të Zi (deri vonë edhe në Kosovë), myslimanët në rajonin e Sanxhakut, kroatët në B e H dhe në Kosovë (p.sh., më 1981, 27,5 promila në Kosovë ndaj 15,3 promila në Kroaci) dhe shqiptarët në të gjitha rajonet e ish-Jugosllavisë, me disa dallime të vogla⁴. Në vitin 1981 femrat shqiptare që e kishin përfunduar periudhën e riprodhimit në Kosovë kishin 6,66 fëmijë, në Maqedoni 5,60, në Serbi 5,75 dhe në Mal të Zi (për shkak të shpërnguljeve intensive të të rinjve) 4,43 fëmijë, ndërsa në Slloveni femrat tona kishin lindur 3,07, në Kroaci 3,56 dhe në B e H 4,29 fëmijë. Femrat serbe periudhën e përtërirjes biologjike e kishin përfunduar me lindjen e këtij numri të fëmijëve: në Kosovë 3,42, në B e H 2,81, në Kroaci 2,02, në Vojvodinë 1,87, në Serbi 1,85 dhe në Slloveni 1,98 fëmijë, ndërsa femrat malaziasë kishin lindur gjithsejt: në Kosovë 3,16, në Mal të Zi 2,98, në Maqedoni 2,59, në

Serbi 2,12, në B e H 2,05, në Slloveni 1,98, në Vojvodinë 1,99, dhe në Kroaci më së paku, 1,84 fëmijë⁵. Sipas regjistrimit të vitit 1981, p.sh., në Kosovë 15.101 femër serbe kishte lindur 5 e më tepër fëmijë (prej tyre 10.038 femra madje kishin lindur 6 e më tepër fëmijë) dhe po aq fëmijë lindën më se 1.400 femra malaziasë⁶.

Rol dominant në ndryshimin e regjimit të riprodhimit biologjik ka përfshirja e femrës në të gjitha sferat e jetës materiale dhe shoqërore, përmirësimi i pozitës së gjithëmbarshme të saj në familje dhe shoqëri, mbrojtja shëndetësore e nënave dhe e fëmijëve, zvogëlimi i mortalitetit të foshnjeve etj. *Aktiviteti ekonomik, punësimi dhe arsimimi i femrës krijojnë qëndrime krejtësisht të tjera ndaj funksionit të kohës së punës dhe funksionit të kohës së lirë, duke e reduktuar dukshëm funksionin e saj biologjik.* Pozita socioekonomike, kulturore dhe qeverisëse e femrës shqiptare në Kosovë dhe në ish-Jugosllavi, siç dihet, është shumë e pavoritshme. Në vitin 1981 norma e punësimit të saj në sektorin shoqëror në Kosovë ishte vetëm 15% nga numri i përgjithshëm i shqiptarëve të punësuar, ndërsa në territoret e tjera përgjysmë më e ultë. Ekonomikisht është ende e varur (më 1981 vetëm 7,4% të femrave ishin aktive në jetën ekonomike, ndërsa në fshat 3,9%) dhe jo mjaft e arsimuar (më 1981 në Kosovë 26,3%, ishin analfabete; në fshat 29,2%, kurse te brezat mbi 35 vjet analfabetizmi arrinte madje deri 60%)⁷. Deri në vitin 1990 më se 1/3 e lindjeve të femrave shqiptare të Kosovës realizohej jashtë institucioneve shëndetësore dhe pa ndihmë profesionale, përqindja e të shëruarve para vdekjes ishte vetëm rreth 65%, ndërsa shkalla e mortalitetit të foshnjeve sillej rreth 55 promila, me dominimin e shkaqeve ekzogjene të vdekjes, ndërsa pas përjashtimit të punëtorëve shqiptarë nga entet e shëndetësisë publike, nga spitalet, klinikat dhe ambulancat, në të gjithë këta indikatorë gjendja u keqësua shumë më tepër.


Nëpërmjet angazhimit në procesin e punës, i cili objektivisht kërkon edhe nivel përkatës të arsimit profesional dhe atij të përgjithshëm, femra ka mundësi që t'i shfaqë aspiratat, dëshirat, nevojat, qëllimet dhe interesat e tjera jetësore jashtë familjes dhe suazave lokale. Në këtë mënyrë, ajo bëhet mobile në hapësirë dhe në shkallën shoqërore dhe ndaj martesës e kohës së hyrjes në të dhe ndaj familjes, lindjes së fëmijëve dhe intervalit kohor midis lindjeve, si dhe ndaj jetës dhe vdekjes formon vetëdije dhe qëndrime krejtësisht të tjera. Mbi këtë bazë krijohen supozimet objektive për motivacione dhe vetëdije të re për planifikimin e madhësisë së familjes, për qafimit të kontrollit të lindjes në martesë si "stil" të jetës dhe për natalitet të ulët dhe familje të vogël.

Shkaqet e nivelit të lartë të natalitetit për një kohë të gjatë dhe të rënies së ngadalshme të tij të shqiptarët në ish-Jugosllavi, prandaj, lidhen me dominimin e strukturës rurale dhe agrare, me ndryshimet e ngadalshme e të vonshme në karakteristikat ekonomike, sociale e profesionale të popullsisë dhe në shëndetësinë publike, me nivelin shumë të ulët të shkrim-leximit e të arsimit, veçanërisht të femrave, me mobilitetin e vogël hapësinor e social të popullsisë, me inkudrimin shumë të vogël e të vonë të femrës shqiptare në jetën ekonomike, shoqërore dhe kulturore, me mortalitetin shumë të lartë të foshnjeve e të fëmijëve të vegjël, me funksionin specifik të familjes dhe organizimin e saj social, me nevojën për fëmijë si fuqi ekstensive punëtore në ekonominë natyrale bujqësore dhe si faktor i domosdoshëm i kontinuitetit të familjes e të ekonomisë shtëpiake, të trashëgimit të pasurisë e të familjes dhe si mbajtës të prindërve në pleqëri etj. Nga këto arsye edhe shpjegohen normat dhe pikëpamjet specifike mbi martesën, siç janë hyrja e hershme në të, universaliteti i saj, hyrja përsëri në martesë pas shkurorëzimeve dhe veçanërisht nevoja dhe vetëdija për numër më të madh të pasardhësve.

IV Tashmë më tepër se një shekull historiografia dhe qarqet politike serbe nuk pushojnë të manipulojnë me të vërtetën për Kosovën dhe shqiptarët, veçanërisht për pasqyrën etnike të Kosovës dhe për drejtimet dhe vëllimin e migrimeve të popullsisë. Teza kryesore e institucioneve shkencore dhe politike serbe, që po përsëritet aq shumë kohët e fundit, mund të përmbledhet në faktin se sllavët e jugut prej ardhjes në Ballkan dhe serbët prej formimit si popull kanë dominuar në këtë hapësirë. Ndërkaq, shqiptarët në Ballkanin Qendror, ku shtrihet Kosova dhe viset e tjera etnike shqiptare në ish-Jugosllavi, sipas kësaj teze, kanë ardhur në fund të shek. 17 dhe gjatë tërë shek. 18 dhe atë si "kolonizatorë" dhe "uzurpatorë" në territoret "e shpirtit mesjetar serb". Këto teza të tyre janë krejtësisht pa mbështetje shkencore dhe tendencioze.

Ballkani Qendror gjatë tërë historisë ishte territor dinamik demogjeografik dhe gjeopolitik, me konflikte të shpeshta të brendshme, me dominime të interesave të huaja dhe me lëvizje migruese të popullsisë, etnive dhe konfesionëve të ndryshme. Mirëpo, *popullsia shqiptare me gjithë reduktimet hapësinore, si pasojë e politikave ekspansioniste të perandorive dhe pushtuesve të ndryshëm, do të qëndrojë pandërprerë në territoret etniko-gjeografike të paraardhësve të tyre dhe në të gjitha periudhat do të dominojë.* Për këtë dëshmojnë vetë dokumentet mesjetare serbe, regjistrime kadas-

trale osmane të kohës, raportet e misionarëve e udhëpërshkruesve të ndryshëm, pjesëmarrja masive e shqiptarëve në luftërat e ndryshme të asaj periudhe "kontestuese" dhe para saj për çlirim e pavarësi dhe faktet e tjera shkencore. Ardhja kinse masive e shqiptarëve këto 2-3 shekujt e fundit në Kosovë, kur ajo na qenka "shëndrruar në një vakuum demografik me "ikjen" e serbëve në drejtim të veriut, nuk qëndron. Një imigrim i tillë nuk ka qenë i mundshëm as për arsye thjesht demografike nga se, siç dëshmojnë regjistrimet kadastrale turke (defterët), qysh në shek.XV dhe XVI Shqipëria Veriore kishte vetëm rreth 2.000 shtëpi, ndërsa Sanxhaku i Prizrenit dhe i Dukagjinit, së



bashku kishin rreth 20.000 shtëpi. As për arsye gjeografike kjo tezë nuk qëndron, sepse Shqipëria Veriore, si territor malor, nuk ka mundur të ketë popullsi kaq të madhe për ta popullzuar tërë Kosovën dhe viset rreth saj. Në anën tjetër, deri tash nuk janë gjetur as dokumente të shkruara të kohës që do ta dëshmonin konstatimin e historiografisë serbe se të gjithë serbët kishin ikur drejt veriut dhe Kosova në pikepamje demografike kishte mbetur e zbrazët.⁸

Manipulimet rreth përberjes etnike të Kosovës për shekullin XX edhe më me këmbëngulësi do të vazhdojnë nga partitë fashizoide dhe qarqet

aktuale qeveritare serbe, për qëllime tashmë të njohura. Mirëpo, në bazë të të dhënave të statistikave të të gjitha pushteteve, del se gjatë tërë shek. XX në Kosovë dominonin shqiptarët. Sipas statistikave turke të viteve 1908-1909, Kosova kishte 506.862 banorë. Prej tyre, në kazatë e atëhershme, që shtriheshin në hapësirën e sotme të Kosovës, numri i shqiptarëve ishte 413.970, që përbënte 81.6% në numrin e gjithëmbarshtëm të popullsisë. Ndërsa në të gjitha trojet shqiptare, të cilat më vonë do të hynin, pa vullnetin e tyre, në Mbretërinë Serbo-Kroato-Slllovene (Jugosllavia e vitit 1918) numri i shqiptarëve sipas kësaj statistike ishte 777.152.⁹ Statistika e bërë nga autoritetet ushtarake të Austrisë në kohën e pushtimit (1916), shënon numër më të vogël absolut të popullsisë së përgjithshme të Kosovës dhe të shqiptarëve, që mund të jetë për shkak të dobësive në përfshirje dhe për arsye të shpërnguljeve pas vitit 1912 dhe viktimit nga okupimi serb dhe Luftërat Ballkanike. Por përqindja e shqiptarëve del përafërsisht e njëjtë me atë të statistikës turke. Sipas kësaj statistike austriake, në Kosovë jetonin 460.607 banorë, ndërsa prej tyre shqiptarë ishin 359.458 ose 78.2% të popullsisë së gjithëmbarshtëm të Kosovës.¹⁰

Në periudhën e ekzistimit të Jugosllavisë në vitet 1918 janë bërë dy regjistrime: më 1921 dhe 1931. Në këto dy regjistrime popullsia është regjistruar vetëm sipas përkatësisë gjuhësore dhe fetare, ndërsa përkatësia kombëtare, për shkaqe të politikës unitariste serbomadhe, është injoruar. Në regjistrimin e vitit 1931 vërtet pyetësori është plotësuar edhe me pyetjen mbi përkatësinë kombëtare, por ajo vetëm formalisht është shtruar dhe të dhënat nga kjo pyetje as që janë përpunuar e publikuar. Prandaj, këto dy regjistrime përveç defekteve të natyrës metodologjike, përshkohen edhe me spekulime të shumta rreth numrit të popullsisë joslave veçanërisht të asaj shqiptare. Megjithatë, edhe sipas rezultateve të këtyre regjistrimeve, shqiptarët dominuan në strukturën etnike të Kosovës. Sipas regjistrimit të vitit 1921, në bazë të gjuhës amtare shqipe (ar-nautski, siç e quanin), nga 436.929 banorë sa u evidentuan në Kosovë, 280.440 ose 64.1% ishin shqiptarë. Në tërë territorin e Jugosllavisë së atëhershme, sipas gjuhës amtare, u regjistruan gjithsej 441.740 shqiptarë. Sipas përkatësisë fetare në Kosovë 73% i përkisnin fesë islame, 26% fesë ortodokse dhe më pak se 2% fesë katolike.¹¹ Ndërkaq, sipas regjistrimit të vitit 1931 në Kosovë u shënuan gjithsej 552.064 banorë, kurse prej tyre, sipas gjuhës amtare, u evidentuan 347.213 shqiptarë ose 62.8% nga numri i përgjithshëm i popullsisë. Në tërë Jugosllavinë e atëhershme numri i shqiptarëve, sipas gjuhës

amtare ishte 517.470. Sipas përkatësisë konfesionale, nga numri i përgjithshëm i popullsisë në Kosovë, 72% i takonin fesë myslimane, 26% asaj ortodokse dhe 2% fesë katolike.¹²

Mirëpo numri i vërtetë i shqiptarëve ka qenë shumë më i madh në Kosovë dhe në Jugosllavinë e vitit 1918. Se është fjala për nënvlerësimin e numrit të shqiptarëve tregojnë edhe vlerësimet e dijetarëve shqiptarë të asaj kohe. J. Milaj (1944) numrin e shqiptarëve në Jugosllavinë e viteve të 30-ta e vlerëson midis 700.000 dhe 900.000 veta,¹³ F.S.Noli (1930) në rreth 1 milion,¹⁴ ndërsa famullitarët shqiptarë Don Bisaku, Don Kurti dhe Don Gashi (1930) e vlerësojnë midis 800.000 dhe 1 milion shqiptarë.¹⁵ Për vlerësimin e ulët të bazës demografike të shqiptarëve për gjysmën e parë të këtij shekulli dëshmojnë edhe rezultatet e regjistrimit të vitit 1948, kur, përkundër shpërnguljeve masive në Turqi dhe Shqipëri midis dy luftërave dhe pasojave të drejtpërdrejta (viktimat) dhe të tërthorta (shtyrja e martësive) të Luftës II Botërore, sipas kombësisë në Kosovë u evidentuan 498.242 shqiptarë (68,5%), ndërsa në tërë ish-Jugosllavinë 750.431 shqiptarë. Sipas statistikave zyrtare serbo-jugosllave, regjistrimeve të popullsisë, megjithë manipulimet dhe spekulimet deri në vitin 1971, numri absolut dhe relativ i shqiptarëve në Kosovë, kryesisht në saje të shtimit natyror, vazhdimisht është rritur, kështu që sot arrinë në afër dy milion, ose rreth 90% në popullsinë e gjithëmbarshme të saj.

V Pas vitit 1981, nga qarqet reaksionare serbe dhe instancat politike serbo-jugosllave, doli teza tjetër edhe më absurde, që u përsërit edhe në mitingjet populliste dhe shoviniste serbe, se një numër i madh i shqiptarëve, 300.000 deri 400.000, kanë ardhur nga Shqipëria në Kosovë pas vitit 1941 dhe gjoja në saje të këtij imigrimi shqiptarët paskan krijuar epërsi në strukturën etnike të Kosovës. Faktet flasin krejtësisht ndryshe: sipas regjistrimit të vitit 1981, nga bota e jashtme në Kosovë kanë ardhur 3.331 persona. Prej tyre nga Shqipëria kanë ardhur 1.543 veta, prej të cilëve sot në Kosovë, sipas raporteve të policisë, jetojnë gjithsej 704 veta. Prandaj, teza mbi numrin masiv të emigrantëve shqiptarë është në të vërtetë pjesë e një strategjie hegjemoniste serbe për spastrimin etnik të Kosovës, dëbimin jo vetëm të 300.000-400.000 shqiptarëve, por edhe të pasardhësve të tyre, e kjo praktikisht do të thotë të të gjithë shqiptarëve të Kosovës. Është kjo një ëndërr e kahmotshme e të gjitha regjimeve serbe dhe do të mbetet pa dyshim vetëm aspiratë megalomane dhe hegjemoniste.

Insistimi kaq i madh i qarqeve politike e shken-

core serbe në tezat e përmendura, përkatësisht në "argumentin demografik", ka për qëllim që shqiptarët t'i paraqesë si "kolonizatorë" dhe "ndjekës" të serbëve dhe se vetëm serbët e kanë "të drejtën historike" e në mbështetje të saj edhe "të drejtën aktuale" për të jetuar dhe qeverisur në Kosovë, kurse shqiptarët, si "të ardhur", janë të privuar nga këto të drejta historike dhe aktuale. Kështu mendon edhe regjimi aktual serb. Meqenëse janë bërë edhe qytetarë të padëgjueshëm dhe jolojalë ndaj shtetit serb, sipas qarqeve ekstreme dhe fashizoide serbe, shqiptarët duhet të dëbohen nga Kosova me mjete dhe metoda gjenocide. Politika shtetërore serbe në mars të vitit 1990 doli hap-taz me ligje, projekte dhe programe hegjemoniste, destinimi kryesor i të cilave është ndërrimi i strukturës etnike të Kosovës përmes kolonizimit të serbëve dhe spastrimeve etnike të shqiptarëve.¹⁶

Regjimet, partitë politike dhe institucionet kulturore e shkencore serbe pandërprerë i akuzojnë popujt e tjerë për spastrimet etnike dhe për krimet të cilat vetë i bëjnë. *Ideja për spastrimet etnike nuk është e re dhe nuk i përket askujt tjetër përveç vetë qarqeve serbe.* Pas Luftës serbo-turke (1876-1878), me qëllim të krijimit të shtetit të pastër serb, pushteti serb i shpërnguli me dhunë shqiptarët e nga më se 600 fshatra të rrethit të Prokuples (Toplica, Kosanica, Dobriqi, Pusta Reka), të Vranjës e Leskovcit (Polanica, Jabllanica, Misurica, Veterica, Gërdelica), të Nishit (Nishi me rrethinë) dhe nga qytetet e këtyre rretheve (Prokupla, Kurshumlia, Vranja, Leskovci, Nishi, Piroti, Bella Pallanka). Shqiptarët e shpërngulur me dhunë nga këto troje i lanë të gjitha pronat e patundshme dhe tërë pasurinë tjetër që patën.¹⁷ Vetë J. Cvijik (1865-1927), si shkenctar i regjimit, pohonte se vetëm nga Toplica me rrethinë janë ndjekur më se 30.000 shqiptarë.¹⁸ Shqiptarët e dëbuar, të njohur me emrin muhaxhirë, u vendosën në Kosovë dhe rreth saj, në jug të kufirit serboturk. Deri vonë ka pasur edhe dëshmitarë të gjallë që e mbanin mend këtë terror masiv të regjimit të atëhershëm serb mbi popullatën shqiptarë të vendeve të përmendura.

Pas okupimit të Kosovës nga Serbia, në vitin 1912, pushteti serb nisi t'i vendosë serbët në Kosovë dhe t'i shpërngulë shqiptarët në Turqi dhe Shqipëri. Për këto qëllime veçanërisht u intensifikuan masat e presionit ekonomik, politik, juridik dhe torturat fizike e vrasjet pas krijimit të Jugosllavisë në vitin 1918, kur u zbatua një varg reformash agrare për marrjen e tokës nga shqiptarët dhe ndarjen e saj kolonistëve serbë, kishave dhe manastireve ortodokse, ushtrisë e xhandarmërisë, shkollave dhe ekonomive serbe, komunarëve e çetnikëve. Midis dy luftërave

botërore, sipas vetë burimeve serbe, u bë kolonizimi i më se 11.000 familjeve serbe me rreth 54.000 anëtarë dhe i rreth 12.000 anëtarëve të tjerë si kolonistë të rëndomtë¹⁹. Më shumë kolonistë u sollën në viset kufitare me Shqipërinë, në rajonet homogjene shqiptare, në rrethinën e Gjakovës, të Pejës, të Deçanit, të Istogut, pastaj të Ferizajt, në Podrimë, në Drenicë, në Llap, në Anamoravë etj.

Kjo ishte vala e parë e fuqishme e kolonizimit të Kosovës, që kishte për qëllim jo zgjidhjen e çështjeve agrare dhe suprimimin e marrëdhënieve çifligare, siç e arsyetonte pushteti i atëhershëm, por ndjekjen sa më të shpejtë e më masive të shqiptarëve dhe serbizimin e Kosovës. Vlerësohet se midis dy luftërave botërore me dhunë u shpërngulën në Turqi rreth 250.000 shqiptarë dhe rreth 50.000 të tjerë në Shqipëri²⁰.

Në gjysmën e dytë të viteve të 30-ta ishin hartuar planet dhe elaboratet për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve nga Jugosllavia e atëhershme me mjete më brutale, duke përfshirë edhe djegien e fshatrave shqiptare dhe të kuarteve të qyteleve të tyre. Bartës të këtyre ndërmarrjeve me karakter gjenocidi ishin institucionet kulturore dhe ushtarake serbe dhe individë të njohur të shkencës, kulturës dhe politikës shoveniste serbe, si Vasa Çubrilloviqi (1898-1990)²¹, nobelisti Ivo Andriqi (1892-1975)²², Drazha Mihajloviqi (1893-1946)²³, Stevan Moleviqi²⁴ etj.; shumë para këtyre ideologëve të spastrimeve etnike njihet Ilija Garashanini (1812-1874) me projektin e tij të njohur "Naçertanie", të hartuar në vitin 1846. Valët e shpërnguljes së shqiptarëve parashihej të zhvilloheshin në disa faza gjatë viteve 1939-1944. Mirëpo, ngjarjet që pasuan, para së gjithash vdekja e Atatürkut (1938), i cili me pranimin e popullsisë së fesë myslimane nga shtetet ballkanike (Jugosllavia, Greqia dhe Bullgaria) donte ta forconte Turqinë ushtarakisht, pastaj rënia e Qeverisë së M.Stojadinoviçit (1939), mungesa e mjeteve financiare dhe sidomos shpërthimi i Luftës II Botërore ndikuan që të pengohej shpërngulja e plotë e planifikuar e shqiptarëve.

VI Mirëpo, pas Luftë II Botërore, preokupim kryesor i Serbisë dhe i Jugosllavisë ishte që problemi i shqiptarëve përsëri të zgjidhej me shpërngulje në Turqi dhe me asimilim. Menjëherë pas çlirimit të Beogradit (3.XI.1944), V. Çubrilloviqi, ministër i disa resoreve në Qeverinë e Titos (1892-1980), paraqitet me elaboratin e dytë për shpërnguljen e të gjithë shqiptarëve me zbatimin e forcës ushtarake, por edhe të bashkësive të tjera me prejardhje joslave (gjermanët, hungarezët, rumunët, italianët, turqit) dhe krijimin e shtetit etnikisht të pastër të

sllavëve të jugut²⁵. Përzënia e më se 500.000 gjermanëve pas Luftës II Botërore nga ish-Jugosllavia kaloi pa reagime në botë, duke marrë parasysh komprometimin e Gjermanisë si shtet fashist gjatë kësaj lufte. Ndërsa, në rastin e shqiptarëve, ky elaborat nuk gjeti aplikim menjëherë, sepse rrethanat ishin të tilla, para së gjithash raportet e mira që ekzistonin midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë. Por, pas prishjes së këtyre marrëdhënieve me Shqipërinë (1948), në bazë të një marrëveshjeje të fshehtë të përtërirë jugosllavo-turke menjëherë nisi vala e shpërnguljes masive të shqiptarëve me dhunë në Turqi.

Për shpërnguljen e shqiptarëve, si presione të drejtëpërdrejta ishin krijimi i atmosferës së frikës e të pasigurisë, deklarimi i dhunshëm i shqiptarëve për kombësi turke, aksioni i mbledhjes së armëve, i përcjellur me represione të tmerrshme (rreth 50.000 veta u torturuan) dhe vrasje (109 veta), me arsyetim se shqiptarët po përgatiten për kryengritje të armatosur, ndjekja e inteligjencisë, e punëtorëve arsimorë, inskenimi i grupeve dhe i aksioneve "armiqësore", reduktimi edhe i atyre të drejtave të pakta qytetare e kombëtare të shqiptarëve, siç ishin ndalimi i përdorimit të gjuhës shqipe në jetën publike dhe i simboleve kombëtare, mbyllja e Institutit Albanologjik dhe e shkollave shqipe e deri te maltretimet masive dhe likuidimet e fshehta fizike të njerëzve²⁶.

Deri në fund të viteve të '60-ta, kur edhe u ndërpre shpërngulja në Turqi për shkak të ndërrimit të klimës politike dhe raportit të forcave në ish-Jugosllavi, vlerësohet se nga Kosova dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë u shpërngulën në Turqi rreth 250.000 veta. Mirëpo, nataliteti shumë i lartë, përkundër mortalitetit gjithashtu të lartë, ishte faktor i fuqishëm i kompenzimit demografik të popullatës shqiptare. Duhet theksuar gjithashtu se deri në fund të këtyre viteve ishin rreptësisht të ndaluara kontaktet e bashkatdhetarëve me të afërmit e tyre dhe vendlindjen, sepse pushteti serbo-jugosllav frikësohej se informimi i drejtë për jetën në Turqi mund ta ngadalësonte procesin e shpërnguljes, meqenëse pjesa dërmuese e migrantëve shqiptarë ishte ngulitur në rajonet e varfëra të Turqisë dhe në pjesët po kështu të varfëra të qyteteve të saj. Kontaktet u mundësuan vetëm pas ndryshimeve që u bënë në kreun politik të shtetit jugosllav (1966), decentralizimit të funksioneve të ish-Federatës dhe forcimit të autonomisë së Kosovës (1968; 1974).

Derisa vazhdonte shpërngulja e shqiptarëve në Turqi, në Kosovë pasoi vala e dytë e fuqishme e kolonizimit: shumë serbë dhe malazezë nga

Serbia dhe Mali i Zi vijnë si kuadra me kualifikime të ulta, të mesme ose që dinin vetëm shkrim-lexim dhe me familje. I zunë vendet e punës në organet administrative e shtetërore, në drejtorate, në institucione sociale dhe shërbime komunale, në ente shëndetësore dhe kulturore etj. Të ardhurat ishin kryesisht nga viset e Serbisë së Jugut dhe nga rajoni i Plavës, Gucisë, Titogradit etj., të cilët sot, pas përfundimit të karrierës së punës dhe pasurimit, kthehen në vendlindjet e tyre. Numri i imigrantëve serbo-malazezë prej 1945-1966 arrinë në rreth 50.000 veta.

Nga fundi i viteve të 60-ta, kryesisht për shkak të ngushtimit të perspektivës jetësore, *nisi emigrimi i punëtorëve shqiptarë në vendet e zhvilluara të Evropës*, por një numër i konsiderueshëm i tyre para dhe pas kësaj periudhe kishte emigruar në shumë qytete të ish-Jugosllavisë, kryesisht si punëtorë krahu e një numër edhe si zejtarë kurbëtarë. Migrantët e punës ishin kryesisht të rinj dhe të gjinisë mashkullore. Ky proces vazhdon edhe sot, por në rrethana të presioneve edhe më të mëdha ekonomike dhe politike, që ushtrohen nga pushteti okupues. Numri më i madh i migrantëve ekonomikë sot gjendet në Gjermani, Zvicërr, Austri, Belgjikë, Francë, SHBA, Australi etj. Meqenëse ky emigrim deri tash kishte të shumtën karakter të përkohshëm, nuk rrezikohet riprodhimi normal i popullsisë në rajonet emigruese dhe nuk paraqitet dukuria e moshërimit demografik, si proces tepër negativ për rrjedhat demografike dhe jetën sociale-ekonomike.

Në këtë periudhë, pas vitit 1966, edhe *serbët nisën ta braktisin Kosovën, ndërsa në Kosovë të vijnë shqiptarët nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia e Jugut, por edhe myslimanët nga rajoni i Sanxhakut*. Ardhja e shqiptarëve në Kosovë u bë për shkak të reduktimit të të drejtave kombëtare e qytetare dhe politikës shtypëse maqedono-serbo-malazeze. Pasi Kosova fitoi një shkallë të autonomisë (1968), u hap Universiteti (1970) dhe shumë shkolla të mesme, shqiptarët nga rajonet e përmendura vinin në Kosovë, veçanërisht në Prishtinë dhe në qytetet e tjera për t'u shkolluar. Një numër i madh i tyre, pas kryerjes së shkollave dhe fakulteteve mbetej përgjithmonë në Kosovë, sepse atje nuk mund të punësoheshin, por edhe ndiqeshin nga pushtetet e atjeshme. Kishte mjaft të ardhur në kuadër të migrimeve të martesave. *Hapja e Universitetit të Prishtinës intensifikoi migrimet ndërshtetërore dhe përmes martesave hapi mundësi për një integrim të rajoneve shqiptare në shumë sfera të jetës*. Por nuk ishte i vogël edhe numri i atyre shqiptarëve që vinin drejtpërdrejtë me familje

për të njëjtat arsye. Madje, edhe pas vitit 1981, kur Kosova ishte në gjendje shtetërrëthimi, në Maqedoni dhe në viset e tjera shqiptare situata ishte edhe më e rëndë, prandaj shumë familje e individë, deri sa nuk u rrënuar autonomia e Kosovës (1989), gjenin strehim në Kosovë. Ka pasur shpërngulje edhe në drejtim Kosovë-Maqedoni, por më tepër për shkaqe familjare (martesat). Mund të vlerësohej se prej vitit 1966 e deri më sot nga Maqedonia, Mali i Zi dhe Serbia në Kosovë kanë ardhur rreth 45.000 shqiptarë.

Shpërngulja e serbëve nga Kosova pas vitit 1966 nuk ishte bërë për shkak të presioneve të shqiptarëve mbi ta, siq e paraqiste pushteti serbo-jugosllav komunist pas vitit 1981, por për shkak të humbjes së privilegjeve që gëzonin deri atëherë dhe mostolerimit të barazisë së shqiptarëve me ta, për shkaqe të pasigurisë së atyre serbëve që i përkisnin aparatit shtetëror e policor e që u kishin bërë shumë të këqija shqiptarëve, për arsye të gjendjes shumë më të mirë ekonomike në Serbi dhe fitimeve të mëdha nga shitja e pasurisë së patundshme në Kosovë, si dhe për shkaqe familjare dhe individuale, meqenëse shumica dërmuese ishin të ardhur në Kosovë në kuadër të valës së parë dhe valës së dytë të kolonizimit të Kosovës dhe në mënyra të tjera. Një numër i mirë i serbëve të shpërngulur i përket eporëve ushtarakë. Vlerësohet se, për arsye të përmendura, prej vitit 1966-1981 nga Kosova janë shpërngulur rreth 52.000, ndërsa prej vitit 1981-1988 rreth 20.000 serbë; pjesa dërmuese e të shpërngulurve u ngulit në Serbi, kryesisht në zonën urbane të Beogradit (rreth 40%) dhe të qyteteve të tjera. Por për krejt këtë periudhë, anipse saldoja e migrimeve është negativ, ka edhe ardhje të serbëve brenda migrimeve të martesave dhe stimulimit të rikolonizimit të Kosovës pas vitit 1981²⁷. Pas rrënimit të plotë të autonomisë së Kosovës, më 1989, shpërngulja e serbëve vazhdon me intensitet të dukshëm, por pushteti serb këtë tash nuk e problematizon, sepse shqiptarët më nuk mund t'i fajësojë; po ta pranonte këtë fakt, publikisht do ta pranonte politikën dështuese të tij në Kosovë.

VII .Pas vitit 1981, kur e tërë Jugosllavia u ngrit kundër shqiptarëve dhe kërkesave të tyre të drejta për barazi dhe pavarësi, *pasoi një valë e konsiderueshme e ikjes së shqiptarëve*, kryesisht të rinjve nga presionet e shtetit policor dhe partiak komunist. Këta janë kryesisht të ikurit politikë, ndërsa pas nxjerrjes me dhunë nga puna të rreth 120.000 punëtorëve shqiptarë prej vitit 1990, emigrimi për motive ekzistenciale u intensifikua edhe më tepër. Pasi pëlciti lufta në Slloveni e Kroaci (1991) dhe në BeH (1992) ushtarët shqiptarë, duke mos

dashur të luftojnë në anën e ushtrisë agresore serbo-jugosllave, braktisën këtë ushtri dhe ikën kryesisht në vendet perëndimore. Sot një numër i madh i shqiptarëve kërkon strehim politik në këto vende, veçanërisht të rinjtë, të cilët, nëse kthehen, do t'i ndiqte pushteti ushtarak për t'i rekrutuar në frontet e luftës kundër popujve të pafajshëm. Ndonëse shumë shtete e kushtëzuan hyrjen përmes vizave, megjithatë shumë shqiptarë, me familje dhe si individë, vazhdojnë të emigrojnë në shtetet e tjera evropiane ku mundësohet hyrja dhe përmes tyre ilegalisht hyjnë në vendet që kanë vënë viza. Shumë të rinj shqiptarë, të ndjekur nga autoritetet ushtarake serbe, janë strehuar te të afërmit e tyre në Turqi, Shqipëri e Maqedoni. Më brengosëse është dukuria e shkuarjes së shqiptarëve, sidomos të rinjve, përtej oqeanit: në SHBA, Kanada dhe Australi. Emigrimi i përkohshëm në këto vende po shndërrohet gradualisht në emigrim pa kthim. Vala e re e terrorit me pretekst të kërkimit të armëve është në funksion të drejtpërdrejtë të shpërnguljes së shqiptarëve. Në këtë funksion është edhe pengimi i funksionimit të arsimit shqiptar i të gjitha niveleve nga pushteti okupues.

Vlerësojmë se aktualisht më se 400.000 shqiptarë nga trojet e tyre nga ish-Jugosllavia, kryesisht nga Kosova, punojnë dhe në cilësi (status) të ndryshme qëndrojnë në Gjermani (rreth 120.000), Zvicër (rreth 95.000), Suedi (rreth 35.000), Austri (rreth 23.000), Belgjikë (rreth 8.000), Francë (rreth 5.000), Danimarkë (rreth 5.000), Itali (rreth 4.000), Norvegji (rreth 3.500), Holandë (rreth 2.000), Angli (rreth 2.500), Finlandë (rreth 600), Luksemburg (rreth 200), pastaj në Kroaci (rreth 40.000), Slloveni (rreth 15.000), Shqipëri (rreth 25.000), ndërsa në BeH, ku para luftës vlerësohej se kishte rreth 30.000 shqiptarë, me status të ndryshëm qëndrimi, sot nuk dihet se sa kanë mbetur. Këto vitet e fundit, për arsye tashmë të përmendura, shumë shqiptarë emigruan në SHBA, ku iu bashkuan diasporës së madhe të hershme dhe arritën deri në Alaskë, pastaj në Kanada, Australi e Zelandë të Re. Vlerësohet se sot në vendet perëndimore gjenden rreth 1 milion shqiptarë, ku më së gjysma emigruan këto dy dhjetëvjetëshat e fundit. Bashkëatdhetarët tane nuk po kursejnë asgjë për ta ndihmuar materialisht, moralisht dhe politikisht Kosovën e frustuar e të okupuar.

Në të njëjtën kohë, pra pas vitit 1981, përmes të ashtuquajturit Program Jugosllav për Kosovën, fillon vala e tretë e kolonizimit të Kosovës. Kjo politikë e re kolonizuese është pjesë e programit ekstrem nacional serb, që insiston në sjelljen e serbëve për ta vënë baraspeshën etnike në Kosovë. Ky program që në fillim të realizimit

mbështetej kryesisht në elaboratet dhe projektet ekstreme hegjemoniste të Çubrilloviqit e të tjerëve dhe Memorandumit të Akademisë Serbe të Shkencave dhe të Arteve (1986). Ish-Federata jugosllave dhe republikat e saj ndanin mjete të mëdha për stimulimin e ardhjes sa më masive të serbëve në Kosovë, që përkrahej edhe nga ish-udhëheqja komuniste shqiptare e Kosovës. Privilegjet e serbëve ishin shumë të mëdha: sigurimi i punësimit, i banesave, i trojeve falas, i kredive afatgjate pa kamatë, për të njëjtin vend pune të ardhurat shumë më të mëdha dhe beneficione të tjera. Në vitet e 80-ta filloi ngritja e reparteve industriale në enklavat serbe dhe ndërtimi i objekteve segregacioniste të banimit, ndërsa për shqiptarë ofrohej si ndihmë punësimi në miniera, në industrinë e rëndë dhe në ndërtimtari në Serbi dhe në rajonet e tjera të ish-Jugosllavisë kinse për ta përmirësuar situatën punuese dhe jetësore. Kjo valë e kolonizimit filloi me sjelljen e policëve, të instruktorëve të lartë ushtarakë, të gjykatësve dhe administratorëve për t'i ndjekur e torturuar sa më tepër shqiptarët. Ish-Federata dhe njësitë e saj në këtë mënyrë e stimulonin represionin në Kosovë dhe i realizonin synimet e kahmotshme të politikës hegjemoniste të Serbisë.

Edhe pas shthurjes së ish-Federatës jugosllave, objektivi kryesor i Serbisë mbetën aspiratat shtetomëdha dhe serbizimi i Kosovës. Në këtë drejtim Kuvendi i Serbisë dhe organet partiake të saj në mars të vitit 1990 miratuan edhe platformën politike. Për këto qëllime Serbia, krahas ndjekjes së shqiptarëve po sjellë edhe kolonistë-refugjatë nga Kroacia e BeH, si dhe serbomalazezë nga Shqipëria. Këto programe të Serbisë tërthorazi në fillim e ndihmoi edhe Komesariati i Lartë i OKB-së për refugjatë me seli në Prishtinë. Këta refugjatë serbë pushteti okupues po i vendos në pjesë të ndryshme të Kosovës, kryesisht në Rrafshin e Dukagjinit, më tepër në objektet arsimore, edukative e rekreative të nxënësve dhe në objektet hoteliere e turistike. Numri i këtyre refugjatëve deri tash nuk është i madh. Sipas burimeve serbe ky numër sillet deri 10.000 veta, por ata janë pjesa më militante dhe kryesisht kriminelë të luftës, të cilët pushteti serb po i nxitë e ndërsen çdo ditë kundër shqiptarëve. Kjo bëhet pikërisht në frymën e porosive të elaboratit të V. Çubrilloviqit (1937) për spastrime etnike, në të cilën tekstualisht kërkohej që në Kosovë ku vala e shpërnguljes nuk i përfshinë të gjitha vendbanimet shqiptare, në ato vendbanime duhet "të sillen njerëz pa mirësjellje, të vrazhde e agresive, të cilët me sulmet e tyre do ta detyrojnë pjesën e shqiptarëve që ka mbetur të shpërngulet".

Për kolonizim të tipit klasik Kosova nuk ka


kurrfarë kushtesh, sepse është territor më i dendur i banuar në këtë pjesë të Evropës, sidomos në pikëpamje të dendësisë agrare, me potenciale të mëdha të fuqisë punëtore të papunësuar, me zhvillim të pamjaftueshëm të kapaciteteve përpunuese dhe me një shkallë shumë të ultë të finalizimit të lëndëve të para që i disponon vetë. Në anën tjetër, shkatërrimi i bazës ekonomike të Kosovës, plaçkitja e fondeve dhe e teknologjisë nga pushtetmbajtësit serbë nuk shkon në favor të popullëzimit plotësues. Por qëllimi kryesor i pushtetit okupues mbetet tendenca për ndërrimin e përbërjes kombëtare të Kosovës. Të gjitha rajonet ruralo-agrare të Serbisë tashmë kanë mbetur pa njerëz, por atje pushteti nuk po vendos refugjatë serbë, ndërsa në Kosovë refugjatët e kombësisë myslimane nga BeH nuk po i lejon të vendosen.

Meqenëse për ndërrimin e shpjetë të strukturës kombëtare të popullsisë së Kosovës, kolonizimi përmes programit të përmendur të ish-Jugosllavisë, programit të Serbisë të vitit 1990 dhe sjelljes së refugjatëve serbë nuk dha rezultate inkurajuese, *pushteti policor e militarist serb aktualisht po ushtron një terror sistematik mbi shqiptarët, veçanërisht mbi të rinjtë me qëllim që Kosova të braktiset dhe boshatiset*. Presioni më i madh është duke u bërë në rajonet kufitare me Shqipërinë, në komunat e Pejës, të Gjakovës e të Deçanit, pastaj të Istogut e të Klinës, ndërsa si pretekst po përdoret mbledhja e armëve, të cilat shqiptarët nuk i kanë, sipas skenarëve të aksionit të mbledhjes së armëve në vitet e 50-ta, si dhe ndjekja e rekurteve shqiptarë, numri i të cilëve çdo vit është prej 18.000 deri 20.000. *Me qëllim të pastrimit të qetë etnik, provokimet, dhuna dhe terrori e kanë përfshirë tërë Kosovën e aneksuar dhe të okupuar*.

1. Shih më hollësisht: H. Islami, "Kosova dhe shqiptarët-çështje demografike" Pena, Prishtinë 1990, fq. 89-126.
2. H. Islami, "Demografski problemi Kosova i njihovo tumacenje", në librin "Kosovo-Srbija-Jugoslavia", Ljubljana 1989, fq. 39-46.
3. G. Todorovic, "Dejstvo aktivnosti i obrazovanja zene na njeno radjanje i stav o njemu na području SR Srbije" "Stanovništvo" nr. 1, Centar za demografska istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd 1984/85, fq. 58.
4. "Demografska kretanja i karakteristike stanovništva Jugoslavije prema nacionalnoj pripadnosti", Centar za demografske istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd 1978, fq. 27-31; "Saopštenje Saveznog zavoda za statistiku", nr. 178, Beograd 1983.
5. "Demografski razvoj i populaciona politika SAP Kosovo" (Interneta studija), Centar za demografska istrazivanja, Institut drustvenih nauka, Beograd 1988, fq. 62.
6. "Zene stare 15 i vise godina prema vitalnim, etnickim, obrazovnim i ekonomskim obeležjima u SAP Kosovo", Popis stanovništva, domaćinstava i stanova 1981: "Bilten 47", Pokrajinski zavod za statistiku, Pristina 1984, fq. 24.

7. H. Islami, "Fshati i Kosovës (Kontribut për studimin sociologjik-demografik të evolucionit rural)", Rilindja, Prishtinë 1985, fq. 158-175.
8. H. Islami, "Kosova dhe shqiptarët-çështje demografike", Pena, Prishtinë 1990, fq. 9-34 dhe literatura që shënohet atje.
9. "Shqipëria përpara Konferencës së Paqës", Ble i Parë (Dokumenta zyrtarë të paraqitur nga ana e Dërgatës Shqiptare, qyshë prej 12 Shkurt e deri më 5 Qershor 1919, e të botuam nga ana e Qeverisë së Përkohëshme), Roma 1919, fq. 35-36.
10. Po aty, fq. 37 (plotësuar edhe nga burimet e tjera).
11. "Popis stanovništva u Kraljevini Srba, Hrvata i Slovenca 1921", Drzavna Stamparija, Sarajevo 1924.
12. "Popis stanovništva u Kraljevini Jugoslaviji 1931", Drzavna Stamparija, Sarajevo 1934.
13. J. Milaj, "Raca Shqiptare", Tiranë 1944, fq. 107.
14. F.S. Noli, "Një tragjedi në tri akte: çpaurim, çpërngulje, çfarosje", Liria Kombëtare, nr. 110, Gjenevë, 10 prill 1929; F.S. Noli, "Vepra" 3, Rilindja, Prishtinë 1988, fq. 177-178.
15. "La situation de la minorité en Yougoslavie (Mémoire présenté à la Société des Nations par Don Bisaku, Don Etienne Kurti et Don Lovis Gashi)", Gënëva, le 5 mai 1930; Dokumenti ka tërë anekse si dëshmi për shpërnguljen me dhunë dhe shikombëtarizimin e shqiptarëve nga ana e pushtetit të atëhershëm serb dhe për herë të parë i prezentohej opinionit shqiptar në gazetën "Rilindja" të dt. 31.VII.1990 (në disa vazhdimë) në përkthim të dr. Rexhep Ismajlit.
16. Shih programin me titull cilik: "Program za realizaciju mira, slobode, ravnopravnosti, demokratije i prosperiteta u SAP Kosovë" "Sluzbeni list SR Srbije, br. 15.30, mart 1990, Beograd.
17. S. Uka, "Vendbanimet e Sanxhakut të Nishit të banuara me popullatë shqiptare dhe të përzier në vitet 1877/78" Gjurmime albanologjike-Seria e shkencave historike, XII, Prishtinë 1983, fq. 105-124.
18. J. Cvijic, "Osnove za geografiju i geologiju Makedonije i Stare Srbije", knj. III, Beograd 1911, fq. 166.
19. M. Obradovic, "Agrarna reforma i kolonizacija na Kosovu (1918-1941)", Pristina, 1981, fq. 221-222.
20. H. Bajrami, "Rrethanat shoqërore dhe politike në Kosovë më 1918-1941", Prishtinë 1981, fq. 177; H. Bajrami, "Shpërngulja e shqiptarëve gjatë viteve 1875-1966", "Rilindja", dt. 28.V.1990.
21. Shih: "Iseljavanje Arnauta, Predavanje održano u Srpskom kulturnom klubu od dr Vase Cubrilovica, 7. marta 1937. godine", Vojno-istorijski institut, Arhiv bivše jugoslovenske vojske, br. 2, Fasc. 4, Kutija 69; teksti është i shkruar me alfabet qirilik dhe ka 19 faqe maqine, një hartë në shtojcë, dy tabela, dy grafikona (në original është i nënshkruar me dorë).
22. Shih: B. Krizman, "Elaborat dr Ive Andrica o Albaniji iz 1939. godine", Casopis za suvremenu povijest, II, Zagreb 1977.
23. Shih dokumentin e çetnikëve, të nënshkruar nga vetë D. Mihailloviq: Dokument br. 37 od 20.XII.1941. godine, Arhiv Vojno-istorijskog instituta, Beograd; çetnikët projekte të tilla kishin hartuar edhe para vitit 1941 dhe pas tij.
24. S. Moleviqi ishte një nga ideologët kryesor në Klubin Kulturor Serb për formimin e Serbisë së Madhe dhe zhdukjen fizike të popujve joserbë. Ishte hartues i disa projekteve për këto qëllime.
25. V. Cubrilovic, "Manjinski problem u novoj Jugoslaviji", 3.XI.1944, Beograd; elaborati ka 11 faqe maqine, i shkruar me alfabet cirilik, në shtojcë ka dy tabela dhe një hartë dhe në original është i nënshkruar me dorë (fotokopja e tekstit gendet e autori i këtij shkrimi).
26. H. Hoxha, "Kosovo in Albani u novi Jugoslaviji", në librin Albanci, Cankarjeva založba, Ljubljana 1984, fq. 214-215.
27. Shih më hollësisht: H. Islami, "Demografski problemi Kosova i njihovo tumacenje" në Librin "Kosovo-Srbija-Jugoslavia", Ljubljana 1989 fq. 46-66.

PREMISA MBI KATEGORI
ZHANRI NË ROMANET
"OH"
DHE
"ZANORET E HUMBURA"



REXHEP
MURTEZ
SHALA



1. Formulimi *Premisa mbi kategori zhanri në disa romane tona* nënkupton para së gjithash një numër të caktuar kategorish zhanrore dhe një numër të caktuar romanesh që do t'i analizojmë. Këto janë: *pikëshikimi modelues* dhe *modeli aktansial* në romanet: "Oh" të Anton Pashkut dhe "Zanoret e humbura" të Zejnullah Rrahmanit. Me këtë problem i nuk imponohet plotësisht si teorik-nuk është thjesht studim teorik mbi kategoritë zhanrore, por edhe një analizë teorike mbi aplikimin e kategorive zhanrore, si relacion midis teorisë dhe praktikës letrare; me ç'rast sprovohet validiteti i kategorive zhanrore në tipat e romanit. Problemi i shtruar kështu eliminon keqëkuptimet e rastit dhe pritjen se ndoshta në këtë punim është dashur të ndeshemi me farë pasqyre dhe kronologjie të kategorive zhanrore dhe të romaneve tona në kuptimin e përfshirjes së tyre sa më të plotë. Ky as që ka qenë qëllimi ynë, më tepër kemi synuar disa premisa teorike që dalin me rastin e validitetit të mundshëm të kategorive, natyrisht aq sa na kanë ofruar mundësi për

diçka të këtillë romanet e analizuar në punimin tonë (...)

1.2. Kriteret për kufizimin tonë vetëm në dy kategori zhanrore dhe vetëm në dy romane janë më tepër, më duket, të natyrës objektive: 1. evoluimi zhanror, sinkretizmi i zhanreve, formalizimi i kategorive dhe sidomos "originaliteti" i presu pozuar i çdo veprë letrare e përjashton ose pritet ta përjashtojë përpjekjen teorike ortodokse për përligjjen e strukturës së veprës letrare, e bën hipotetike çdo përpjekje për kanonizim në letërsi, prandaj paraqitet vazhdimisht nevoja për përkufizime dhe ripërkufizime të reja. Todorov sjell shembëll të qartë mbi karakterin hipotetik të zhanrit fantastik¹. Nga kjo perspektivë validiteti i kategorive zhanrore është evident, prandaj është vështirë që nga një aporizëm teorik të përqëndrohemi në kategori zhanrore dhe me rastin e analizës (aplikimit) t'i kërkojmë më çdo kusht në tipat e romaneve; kjo do të përfaqëste shkarje metodologjike, do të dëmtohej dhe keqëkuptohej vepra, sepse nuk do të respektohej modelimi dhe kategoritë baz-

ike të saj. Në hierarhinë e kategorive për nga universalizmi i tyre duket se qëndron dhe është i domosdoshëm *pikëshieimi modelues* pa të cilin nuk mund të mendohet asnjë tip i artit, prandaj as romani; si dhe kategoritë e modelit aktansial dhe relacionet e tij që në shkallë relative i përafrohen këtij universalizmi. Prandaj formulimi *kategorit zhanrore* në punimin tonë ka karakter universal: kuptojmë kategoritë të cilat mëtojnë të vlejné si kategori bazike pothuaj në të gjithë ose në shumicën e arteve; dhe kurse si nuk guxon të ngatërrohet me kuptimin e ngushtë: si kategori që vlejné ose do të vlenin vetëm për tipat e romanit. Natyrisht validiteti dhe specificiteti i këtyre është evident prej zhanri në zhanër: p.sh. dallon pikëshikimi në roman nga pikëshikimi në pikëturë ose film² ose modeli aktansial në dramë nga modeli aktansial në roman apo përrallë³ por një validitet i shkallës më të ulët mund të pritet dhe prej romanit në roman etj. Megjithë këtë validiteti i këtillë nuk e bën plotësisht hipotetik karakterin e tyre, sepse gjithmonë duhet dhe rrëfëhet nga një pikëshikim (ose shumë sish) dhe gjithmonë ekziston një simetri kategorish dhe relacionesh në tekst. 2 Të testuarit e kategorisë dhe syrimi ynë për farë premise teorike me rastin e këtij testimi dhe aplikimi të kategorive në roman, na ka imponuar në radhë të parë zgjedhjen e atyre romaneve për analizë që e kanë të theksuar *origjinalitetin* dhe që mëtojnë të jenë ose që janë nyje ("kthesë") zhanrore në letërsinë tonë. Nga kjo perspektivë tipike janë romanet "Oh" i Anton Pashkut dhe "Zanoret e humbura" i Zejnullah Rrahmanit, që i takojnë prozës sonë me modelim metaforik (figurativ). I pari duket se është roman alegorik-fantastik, kurse i dyti romansimbolik⁴. Validiteti i kategorive zhanrore që i kemi për shqyrtim këtu është evident, si kualitet i ri del të *formalizuarit e kategorisë*...

3. Formulimi ndërkaq *disa kategori zhanri në disa romane tona*, sa do që duket i kundërthënëshëm me praktikën që kemi ndjekur, më bëhet se ka qenë i domosdoshëm për shkak të relativizmit të theksuar në interpretimin e letërsisë dhe formulimeve teorike lidhur me te; si dhe për shkak të kompleksitetit të strukturës së veprës letrare, mplaksjes sidomos të shtresave të strukturës së veprës, për të cilat Benvenist thotë se janë vetëm "operime metodologjike"; prandaj është vështirë të flitet për një kategori, sa do bazike të jetë ajo, pa u interferuar me të tjerat. Këtë e kushtëzon *transformimi* i domosdoshëm i kategorive nëpër shtresa të tekstit etj. Prandaj shpesh jemi ndalur edhe në syzheun, narracionin, kodin e heroit etj. gjatë analizës së pikëshikimit dhe modelit aktansial në romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura".

1.3. Maksimalisht jemi përpjekur t'i reduktojmë përsëritjet rreth problemeve të njohura teorike, aq sa është e mundur të bëhet kjo. Ballafaqimi dhe konfrontimi eventual me ndonjë tezë dhe autor mund të ketë qenë i paevitueshëm dhe i domosdoshëm me rastin e validitetit të kategorive si kushtezim i funksioneve të tyre të reja në roman⁵. Në këtë rast më shumë kemi anuar kah mendimet dhe tezat e Lotmanit lidhur me pikëshikimin se sa nga ato të Uspenskit. Dallimi midis këtyre lidhur me këtë kategori është evident. Uspenski në esencë flet për pikëshikimin e karakterit dhe tipizimet e tij; kurse Lotmani vëmendjen e përqëndron edhe nga pikëshikimi i autorit (romansierit), edhe pse jo shpesh nuk i diferencon këto sa duhet. Lotmani diskuton për disa karakteristika dhe tipa të pikëshikimit⁶: 1. pikëshikimi kolektiv në suaza të tipit kulturor. Nga teksti del se me këtë duhet të kuptohet pikëshikimi si botëkuptim kolektiv i sublimuar përbrenda kulturës tipike (p.sh. në kulturën shqiptare pozicioni ynë kolektiv mbi besën, vdekjen etj.) 2. pikëshikimi i autorit si pozicion i autorit-ashtu siç e hasim edhe të Uspenski pikëshikimin në nivel ideologjik, i kuptuar para së gjithash si moralizim i autorit në tekst; 3. pikëshikimi-e vërteta dhe pikëshikimi-e pavërteta; ky formulim çon gjithsesi kah validiteti i thënies në kuptimin logjik: një pohim mund të jetë i vërtetë ose i pavërtetë etj. 4. pikëshikimi artistik këtë e definojmë si "relacion të sistemit ndaj subjektit të vet" ku me "subjekt të sistemit" nëkupton "vetëdijen e cila është e aftë të krijojë një strukturë të atillë dhe që në harmoni me të rikonstruktohet para përceptimit të tekstit". Me që teksti presupozon njëkohësisht diskursin e karakterit në roman, por edhe krejt strukturën e veprës letrare si diskurs i autorit, atëherë formulimi në fjalë presupozon njëkohësisht pikëshikimin e autorit (romansierit) dhe të karakterit në roman. Që t'i shmangemi kësaj mosmarrëveshjeje në punimin tonë pikëshikimin e autorit e kemi riformuluar si pikëshikim modelues dhe jemi përpjekur ta zgjerojmë atë duke e pranuar si sintezë të idesë tematike dhe të idesë së formës, si intencë e autorit në tekst në të gjithë treguesit e saj. Pikëshikimi modelues në këtë kuptim del kategori bazike që e përcakton strukturën zhanrore, prandaj edhe është në kreun e hierarhisë së kategorive, siç potencon Uspenski, si "problem qendror kompozicional", kurse për rastin tonë-si problem qendror tekstori. Natyrisht nën këtë prizëm, nga pikëshikimi modelues e kemi analizuar në tekst edhe modelin aktansial: kategorit dhe relacionet e të cilit, sipas Greimasit, mëtojnë të zënë vend në nivelin sintaksik të tekstit; kurse në analizën tonë vendin e tyre e kemi parë përgjithësisht në


strukturën e tekstit: si kategori dhe relacione logjike që janë potencial për t'u realizuar dhe transformuar në kategori të reja nëpër nivele të strukturës së tekstit, natyrisht në varshmëri me pikëshikimin modelues në tekst. (...)

11. Në të vërtetë aplikimi i modelit aktansial si një operator në dy romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura" është relativ për shkak të strukturës specifike të romaneve. Shkalla e abstraktimit të modelit aktansial megjithatë është ruajtur nën 1. si imanencë e modelit të kuptuar si kategori dhe relacione logjike të tekstit, si potencial që pret të materializohet në nivele të tjera të tekstit (sipas Gremsit ekskluzivisht në nivelin sintaksik); nën 2. abstraktimin e ka kushtëzuar reduktimi maksimal si ligjësi e prozës moderne: dominimi i sistemit shenjues mbi atë referencial, thjeshtimi i kategorive dhe relacioneve, bifunksionalizimi i tyre, simultanizmi, zgjerimi i fushës asociative, konotimi figurativ etj. ; nën 3. abstraktimin e modelit aktansial e ka ruajtur në të dy romanet dominimi i modelit syzheik mbi atë fabular⁷. Kjo ka kushtëzuar që relacionet midis kategorive të modelit aktansial vetë të paraqiten, të sugjerohen, por jo edhe të zhvillohen deri në fund. Për ilustrim po përmendim konfliktin midis subjektit kundërshtarit-në të dy romanet ka strukturë monolite dhe jo dialogjike, nuk ka ndeshje aktive pikëpamjesh, idesh, konfrontimi është pasiv-jepet përmes një simultanizmi të përfunduar etj. Kjo është karakteristikë për të dy romanet e përmendura këtu.

12. Në të dy romanet kemi nënvizuar një numër të konsiderueshëm modelesh aktansiale. Gremsi tërheq vërejtjen se duhet të bëhet distinktion i qartë midis aktansëve dhe akterëve dhe se zakonisht akterët i gjejmë në suaza të strukturës së diskursit⁸. Nga kjo perspektivë duket vështirë të qëndrojmë një numër kaq i madh modelesh aktansiale që i kemi nënvizuar në këto dy romane. Mirëpo konstatimi i Gremsit duket relativ, sepse: 1. varet çka kuptojmë me diskurs, si e përkufizojmë këtë kategori kur e përdorim në tekst⁹ dhe 2. numri i modelit aktansial varet nga kompleksiteti i strukturës së romanit. Në të dy romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura" montazhi asociativ-refleksiv mbi të cilin modelohet tipi syzheik, imponon montimin e tërësive të pavarura që kanë koherencën e vet logjike, temat, situatat, kodet, konotimet figurative, aktin e shprehjes, procedimin, indicje të tipit fabular. Disa nga këto indicje njëkohësisht janë edhe të diskursit, prandaj në këtë kontekst ne kemi përdorur në punimin tonë kategorinë diskurs. Bie fjala diskursi mbi Djaloshin, bariu babain (në "Zanoret e humbura"); diskursi mbi mizogamin, gjahtarët, Vashën-Heroïn, bariun etj. Ajo që imponohet si kategori bazike perma-

nente, si praelement në të dy rastet është: relacioni midis pushtuesitë pushtuarit (në "Zanoret e humbura") dhe tradhëtia (në romanin "Oh"). Në këtë kontekst secilës tërësi të pavarur i përgjigjet një model fiks aktansial, prandaj edhe ekziston një numër relativisht i madh modelesh aktansiale në këto dy romane. Pavarësia e relacioneve dhe e kategorive të këtyre modeleve është relative, varet nga diskursi dhe hierarchia e diskursit në kuadër të strukturës së romanit. Montazhi asociativ-refleksiv e sforcon këtë dihotomi relacionesh midis modeleve aktansiale: shpesh kategoritë e njërit model ndërrojnë natyrën e vet në modelin tjetër aktansial: paraqitet po ai transformim funksionesh siç ndodhë te akterët përbrenda vetë modelit aktansial (Gremsi). Në këtë kontekst mund të shihet megjithatë njëfarë hierarchie kategorish dhe relacionesh në kuptimin e fiksimit të një modeli kryesor aktansial të cilit i nënshtrohen të tjerët. Mirëpo, koherenca e tekstit, e strukturës së romanit nuk është maksimale, pavarësia e diskursve është e evidente, prandaj edhe kategoritë e modeleve aktansiale që i nënshtrohen modelit kryesor kanë funksione të dyfishta: si *aktans* dhe si *akterë*. Hierarchy midis kategorive si dhe funksionet e tyre provizorisht i kemi dhënë në skemën grafike të modeleve kryesore.

13. Nga analizat e bëra, së paku për këto dy romane, ka indicje që e relativizojnë pak a shumë rregullën e Gremsit se modeli aktansial i përket ekskluzivisht nivelit sintaksik të tekstit. Në 1. është vështirë të vëhet kufi i qartë midis niveleve të tekstit nga se struktura e romanit është strukturë dinamike dhe jo statike.¹⁰ Benvensit në mënyrë eksplicite konstaton se nivelet e tekstit janë vetëm operator¹¹, me këtë nënkuptohet se karakteri hipotetik i niveleve të tekstit është evident, ato i presupozojmë gjatë analizës në mënyrë që më qartë t'i hetojmë kategoritë dhe relacionet e strukturës. Në 2. të kuptuarit e strukturës së tekstit si strukturë dinamike presupozon para së gjithash një interferim koheziv të niveleve të tekstit si dhe një transformim të mundshëm të kategorive dhe relacioneve të strukturës nëpër nivele të saj (të tekstit). Nga analizat e bëra këtu, disa kategori të modelit aktansial i nënshtrohen rigorozisht këtij transformimi, kurse disa të tjera barten (përsëriten si të tilla vazhdimisht). P.sh. 'LB'N në "Zanoret e humbura" në modelin aktansial është aktans subjekt; në bashkësinë semiotike 'LB'N paraqet një model binar midis bashkëtingëlloreve dhe apostrofëve (LBN-APOSTROFET); në modelin retorik është simbol, në modelin e diskursit pranohet si subjekt dhe objekt i diskursit-varësisht a flet apo flitet për të dhe në modelin narrativ paraqet një tip të nar-



ratorit dhe një pozicion të shikimit. Nëse 'LB'N' e shenojmë me X, kurse funksionet e reja me indeks, atëherë transformimi i kategorive bazike duket kështu: nga X në X1, X2, X3, X4 etj. varësisht prej numrit të funksioneve në shtresat e tekstit. Në të gjitha rastet X do të kuptohet si kategori bazike në kuptimin abstrakt të fjalës-si entitet i përhershëm. Funksioni fundamental i 'LB'N' si kategori bazike dó të varet nga shtresa dominuese në strukturën e romanit. Transformimi i këtyre nuk do të thotë se është i domosdoshëm për të gjitha kategoritë dhe relacionet e modelit aktansial. Disa e ruajnë vazhdimisht një funksion strikt dhe një marrëdhënie duke e bartur ose përsëritur vazhdimisht në tekst. P.sh. relacioni kundërshtari-subjekti në modelin aktansial të "Zanoreve të humbura" si relacion midis pushtuesit dhe të pushtuarit si dhe tradhëtia që realizohet në trekëndëshin subjekti-ndihmësi-kundërshtari në romanin "Oh" i nënshtrohen përsëritjes së vazhdueshme si praelement: si relacion midis të mirës dhe të keqes (në rastin e parë) dhe si tradhëti që nga koha mitike e deri në ditët tona; me këtë rast në tekst kemi vetëm ndërrimin e kodeve, gjegjësisht sistemeve shenjuese përbrenda të cilave ato materializohen...Kjo sikur len mundësi që modeli aktansial të kuptohet para

së gjithash si model logjik, si model bazik (arkitektonik) i tekstit kategoritë dhe relacionet e të cilit janë potencial për t'u realizuar nëpër nivele të tekstit dhe atë varësisht nga kompleksiteti i strukturës dhe nga pikëshikimi modelues. Kjo do ta realitivizonte përcaktimin strikt dhe vendin që i jipet modelit aktansial tash për tash vetëm në nivelin sintaksik...

14. Dominimi i nivelit sintaksik në strukturën e romaneve "Oh" dhe "Zanoret e humbura" ka kushtëzuar funksionin narrativ të disa kategorive të modelit aktansial si funksione bazike në tekst. Ekzistojnë këta narratore: 1. Heroi (Ai), 2. Plaku, 3. desidiatët, 4. reporteri, 5. gjahtarët- në romanin "Oh" dhe 1. narratori autorial, 2. 'LB'N' dhe 3. autori i fletoreve A, A, I-në romanin "Zanoret e humbura". Narratori autorial i fletoreve A, A, I është ambivalent: a) është vetë 'LB'N' nëse kemi parasysh kodin artistik: 'LB'N' është krijues që e shkruan të vërtetën mbi identitetin kombëtar, që e shkruan historinë në fletore dhe b) nëse kemi parasysh kodin ideologjik, autori i shënimeve nuk është 'LB'N' por narratori-kronik, historiani që e ka regjistruar historinë kombëtare dhe të cilën 'LB'N' e gjen gjatë kërkimit të identitetit dhe të vërtetës mbi fatin kombëtar të ndarjes së genies. Këto dy kode janë me gjasë të barabarta

në tekst dhe kjo vetëm e ruan ambivalencën e narratorit në fjalë, është koncipuar mbi bazë të modelimit të hapur¹².

Pavarësisht prej këtij specifikimi dhe parcializimi formal, teknik; të gjithë narratorët e përmendur këtu (në të dy romanet) për nga pikëshikimi modelues janë identik, kanë karakteristika të përafërta: i përkasin botës së paraqitur, rrëfejnë në vetën e parë, por edhe në të tretën, komentojnë por edhe janë objektivë. Këta në esencë përmbajnë të tri funksionet narrative, gjegjësisht i përgjigjen karakterizimit që bën F. Shtancël; 1. narratori autorial, 2. narratori i vetës së parë, dhe narratori personal¹³. Heroi (Ai) në romanin "Oh" dhe 'LB'N' në romanin "Zanoret e humbura" janë narratorë që në mënyrë tipike i sintetizojnë këto karakteristika, prandaj edhe e relativizojnë kategorizimin e narratorëve (Shtancël). Në prozat e këtilla me strukturë monolite dhe përgjithësisht në prozën moderne kategorizimi i narratorëve është formal dhe jo intencional. Nga perspektiva e rrëfimit narratorët në romanin "Oh" kanë të njëjtat funksione në tekst: 1. pasiviteti dhe 2. vëzhgimi. Janë konstituentë të situatës-janë të pranishëm, por janë të përjashtuar nga dinamika e ngjarjes; janë pasivë; janë të liruar nga botëkuptimi personal, emocionaliteti etj.; sepse roli i tyre është të vëzhguarit e ngjarjes dhe jo të vepruarit në te. Si konstituentë të fabulës veprojnë vetëm derisa motivohet perspektiva e rrëfimit, derisa bëhet hapja e procesit në sekvencë (Bremont) më tutje veprojnë si konstituentë të syzheut dhe rrëfimit.

Në "Zanoret e humbura" gjithashtu është evidente planëtia e narratorëve, por narratorët nuk i hasim vetëm në rolin e vëzhguesve. 'LB'N' është aktiv dhe rrëfen njëkohësisht për vetëvetën dhe botën që e rrethon në kërkimin e identitetit. Kjo rezulton jo nga farë dinamizimi tipik, por nga shkaku se mpleksja midis fabulës dhe syzheut, njërive fabulare dhe syzheike, shpesh është mjaft e paqartë, nuk dihen ose me vështirësi dallohen kufijt midis tyre për shkak të kuazalitetit të vetëdijes dhe rrëfimit të maskuar, kauzaliteti i "ndërdijes" që e bllokoi emërtimin e njëmend të gjërave. Në këtë roman, si dhe në romanin "Oh" parcializimi i narratorëve është evident, kushtëzohet nga formalizimi maksimal i karakteristikave të tyre dhe imponohet si zgjidhje teknike me këtë motivacion: 1. provizorisht të ruhet ende një motivim minimal objektiv në nivelin fabulativ-kompozicional¹⁴, të imitohet mundësisht lëvizja dhe "karakteret" deri në atë shkallë minimale që i nevojitet romanit për ta ruajtur ende natyrën e vet artistike, përkundër rrezikut që romani të shndërrohet në ese, traktat filozofik, apo përgjithësisht në ndonjë diskurs tjetër-jo letrar; 2. të

mundësohet konstituimi i një kodi dhe i një diskursi në kuadër të të cilit bartet dhe rimaterializohet tradhëtia si kategori e përhershme; 3. theksohet karakteri metaforik (personifikues, simbolik) në modelin retorik: nga kjo perspektivë duket se flet koha, narratorët si personifikues të kohës: e tashmja teknikiste-defetiste (Heroi, gjahtarët); historia-tradita (desidiatët, Plaku¹⁵ etj.); 4. thehet karakteri monolit i rrëfimit, kamufllohet tipi linear syzheik, kjo iluzion ose së paku synohet ky iluzion mbi rrëfimin objektiv dhe ruajtjen ende të botëkuptimit, emocionalitetit (etj.) të narratorëve 5. sigurohet një dialog minimal që është konstituent ekskluzivisht i rrëfimit (në romanin "Oh" dhe pjesërisht në "Zanoret e humbura"); ky tip i dialogut me funksion narrativ ka të përjashtuar nga vetëvetja karakterin dialogjik (konfliktuoz) imponohet struktura relative e dialogut-bisedë¹⁶ subjekti-dëgjuesi në suaza të cilit dominon funksioni fatik: nevoja për rrëfim, vazhdimi i rrëfimit, cytja e tij.

Ky shpalim gradual i rrëfimit përmes dialogut bëhet midis narratorëve: Heroi-Vasha, Vasha-Plaku-Heroi, desidiati-de-sidiati; gjahtari-gjahtari (në romanin "Oh"); 'LB'N'-Specialisti, 'LB'N'-Vera, 'LB'N'-njeriu (në "Zanoret"). Mirëpo kjo gjithsesi është perspektivë monolite e rrëfimit që do të mund t'i mveshej vetëm një narratori. Pavarësisht prej këtij tipi të dialogut me funksion narrativ në këto dy romane ekzistojnë edhe tipa të tjerë të dialogut me funksione të tjera, por analiza rreth tyre do ta kapërcente diskutimin mbi narratorin.

Disa nga premiset e këtilla mbi narratorët në romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura" duket se e favorizojnë relativizimin e Shtancëllit lidhur me kategorizimin e narratorëve përkundër ortodoksizmit shkencor të Butit dhe Markievçit.

Zatën këta autorë edhe përfaqësojnë dy tendencat teorike lidhur me kategorinë narratorë: dhe kategorizimin e tyre: absolutizmi i Butit mbi pavarësinë e plotë të narratorëve në tekst që s'është asgjë tjetër pos një shkencizëm ortodoks dhe relativizim i matur i Shtancëllit që megjithatë nuk shih dallime shumë të mëdha midis narratorëve. Natyrisht diskutimi mbetet i hapur për literaturën teorike, zgjidhja fatlume nuk është aq e thjeshtë, ajo gjithmonë varet nga praktika letrare që shpejt i relativizon kategorimet shkencore sidomos në letërsi. Së paku për romanet "Zanoret e humbura" dhe "Oh", barazimi i funksioneve dhe i mundësive shprehëse të narratorëve është evident. Ky barazim në esencë çon kah formalizimi i kategorisë narrator, ato bëhen kategori formale romaneske dhe jo intencionale. Këto shpjegohen me evoluimet zharrë dhe evoluimet përbrenda vetë zha nrit.

Të dy pozicionet teorike mbi kategorinë narratore arsyetimet e veta i mbështesin pikërisht mbi dy praktika të ndryshme romaneske prandaj edhe rezultatet-premisat teorike duken të tjera: intencionaliteti i narratoreve duket se i përgjigjet modelit realist të romanit, kurse formalizmi i narratoreve i përgjigjet zakonisht modelit modern të romanit. Mbi këtë bazë të dallueshmërisë midis praktikave letrare diskuton edhe Lukaçi, natyrisht me referenca në narracion dhe motivim (modelim), në punim me tezë "Drejt diskutimit mbi natyralizmin dhe formalizmin"; natyralizmit i përgjigjet mo tivim-rastësia, kurse formalizmit jorastësia, gjegjësisht detyrueshmëria (domosdoja) që e imponon abstrakten në formalizëm dhe zhdukjen e jetës¹⁷; kurse për nga tipet e rrëfimit: natyralizmit i përgjigjet të treguarit, kurse formalizmit-përshkrimi¹⁸. Këtë e përmendëm vetëm si shembëll të evoluimit të kategorive zhanrore përbrenda zhanrit. Përndryshe ilustrime ka mjaft: p.sh. dialogu si kategori tramatike e bartur në roman ka pasur vazhdimisht funksione pak a shumë të ndryshme; bie fjala, në romanet e Dostojevskit, sipas, Bahtinit, për shkak të strukturës polifonike, dialogu ka funksion tipik, intencional-dialogjik¹⁹, kurse në prozën moderne, siç e pamë të "Oh" dhe "Zanoret e humbura" dialogu kishte funksion narrativ. Në krahasim me funksionin intencional-dialogjik, ai ka evoluar në dialog formal që e ka braktisur dialogjicitetin nga vetëvetja. Ose polifonizmi si imanencë e romaneve të Dostojevskit është bartur në monolitizmin e prozës moderne, por me modifikim drastik: jo më si kategori intencionale që do të jepte strukturën polifonike të romanit, por si kategori formale që ka gjetur shprehje në shtresën grafike të tekstit, imponohet si organizim grafik i tekstit dhe si "polifonizëm" i rrejshëm; vizualisht teksti duket shumështrësor, sintezë e disa procedimeve dhe strukturave zhanrore, por në esencë i nënshtrohen një monolitizmi të theksuar dhe një redukcionizmi të paevitueshëm si imanencë e prozës moderne.

Rast tipik për këtë paraqet në letërsinë tonë proza e Beqir Musliut "Mbledhësit e përpurit", mandej "Zanoret e humbura", "Oh" etj. Një evolucioni të këtillë prej esencës kah forma, prej intencionale kah formala iu ka nënshtuar edhe kategoria narrator. Prandaj ortodoksizmi scientik i Butit dhe i Markieviçit është i arsyeshëm vetëm në suaza të një tipi apo disa sish, mirëpo jo edhe për krejt zhanrin. Pavarësia që u është atribuar narratoreve me karakteristikat dalluese nga ana e Butit, rrjedh nga përpjekja që të theksohet me çdo kusht objektivja në art, për shkak të teorisë së

mimesisit, pra, në atë periudhë të sforcimit të onticitetit të veprës letrare²⁰ dhe të ashtuquajturës "zhdukje" të autorit, të pranisë së autorit, në emër të pavarësisë gjithnjë e më të madhe të kategorive dhe të mvetësisë së strukturës së veprës letrare. Me këtë rast subjektivja e autorit është bartur dhe mundësisht kamufluar prapa pikëshikimeve të karaktereve dhe narratoreve të cilët iu kanë nënshtuar një modelimi dhe motivimi sa më real. Karakterizimi i tyre ndërkaq është varur nga prania apo mosprania e narratoreve në situatën të cilën e rrëfejnë ose e paraqesin; në esencë atyre u është atribuar një funksion proksemik (loja me distancën) nga është varur edhe gjithdija apo kufizimi i dijes së tyre. Mirëpo të gjitha këto janë ligjësi, karakteristike dhe kategori relative që s'mund të vlejnjë plotësisht as për modelimin realist të ormanit, edhe pse tendenca e pavarësisë së narratoreve lidhet pikërisht me literaturën letrare me modelim realist. Në esencë kategorizimi i narratoreve nga pozicioni ortodoks-scientik i Butit është i varur ngushtësisht nga pikëshikimi "si kategori qendrore kompozicionale" për të cilin flet B.A.Uspenski²¹. Prania apo mosprania e narratoreve në situatën e cila rrëfëhet apo paraqitet i përgjigjet dy tipave themelor të pikëshikimit: a) pikëshikimit të brendshëm (prania) dhe b) pikëshikimit të jashtëm (mosprania). Ky është njëri nga faktorët e kushtëzimit të gjithëdijes apo të kufizimit të dijes së tyre në bazë të modelimit realist. Korenspondimi i këtillë midis narratoreve dhe pikës së shikimit rrjedh për shkak të analizave të bëra nga të dy autorët kryesisht në literaturën letrare mbi këtë modelim. Në këtë kontekst shihet qartë dominimi dhe ruajtja me çdo kusht e karakterit, e tipizimit të tij në të gjithë treguesit e mundshëm që nga të folurit tipik, veshja, morali e deri te mvetësia mundësisht sa më e plotë psiko-fizike e karakterit që, si e tillë, e ka kushtëzuar, natyrisht, situatën narrative dhe mundësitë shprehëse të narratorit. Mirëpo kjo s'është asgjë tjetër pos intencë e romansierit për t'i imituar me përpikëri vetitë psiko-fizike dhe moralin e njeriut të kohës. Çdo shmangie nga motivimi dhe masa reale do të dukej si dobësi artistike etj. Të gjitha vërejtjet që mund t'i bëhen Butit, si vërejtje që dalin para së gjithash dhe ndoshta kryesisht nga kufizimi i zhanrit, duket se nuk vlejnjë plotësisht edhe për Uspenski, sepse Uspenski është më i hapur ndaj perspektivës teorike: ai le udhë për problematizimin e mëtejme rreth pikëshikimit dhe sidomos cek mundësinë e korenspondimit të pikëshikimit me përcudnim-si kategori bazike e formalizmit.

Një lidhje e këtillë hap udhë për evoluimin e kategorive në fjalë prej një modelimi në tjetrin,

mundëson, bie fjala, ristrukturimin e narratorit dhe pikëshikimit edhe në literaturën post-realiste. Zhdukja e karakterit në prozën moderne në esencë e formalizon narratorin dhe pikëshikimin, i bën ato kategori formale që s'janë imanencë më e një lloji zhanror; zhdukja e karakterit prish më tutje iluzionin mbi "zhdukjen" e pranisë së autorit në tekst; teksti modern faktikisht me formalizimin e kategorive e kthen praninë e autorit në tekst si prani e paevitueshme, që s'ka munguar asnjëherë as në romanin më tipik realist. Pyetja shpesh e përsëritur në literaturën teorike: "Kush e rrëfen romanin?" sa do banale që duket, esencialisht ia tërheq vërejtjen lexuesit për praninë e paevitueshme të autorit në tekst sepse vepra është prodhim subjektiv i autorit, pavarësisht prej kalkulimeve teknike romaneske që në esencë janë vetëm manifestime dhe parcializime të "metodës" së autorit. Prania e autorit në tekstin romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura" si proza postrealiste-është esenciale, ajo duhet të shihet në suaza të pikëshikimit modelues. Prandaj edhe pavarësia dhe kushtëzimi i kategorive, në rastin tonë-i narratorit dhe pikëshikimit, në tekst varen ekskluzivisht nga pikëshikimi modelues, i cili dallon nga tipet e pikëshikimit që bën Uspenski. Definimin mbi pikëshikimin që bën Uspenski mund ta pranojmë para së gjithash si botëkuptim, vetëdije dhe pozicion të karakterit prej nga rezultojnë, kushtëzohet edhe perspektiva e rrëfimit. Karakterin hipotetik të pikëshikimit në raport me rrëfimin Llotmani e shpjegon si të paevitueshëm me vetë faktin që "ofrohet mundësia që ai të ndërrohet gjatë rrëfimit"²². Këtë mundësi e ofron pozicioni i autorit në tekst i kuptuar si pikëshikim modelues, në të kundërtën pikëshikimet e karaktereve në rrëfim nuk do të mund të ndërroheshin prej vetëvetiut. Llotmani në të vërtetë diskuton për pikëshikimin e autorit: "relacioni pikëshikimi-teksti është gjithnjë relacioni krijuesi-krijimi. Në suaza të tekstit letrar ky është problem i pozicionit të autorit, heroit lirik etj."²³ Në nivelin më abstrakt pozicionin e autorit e sheh si pikëshikim artistik të cilin e definon si "relacion të sistemit ndaj subjektit të vet" ku me "subjekt të sistemit" nënkupton "vetëdijen e cila është e aftë të krijojë një strukturë të atillë dhe që në harmoni me të rikonstruktohet para perceptimit të tekstit"²⁴. Kjo hap udhë drejt të kuptuarit të drejtë të pranisë së autorit në tekst, sa do që termi pikëshikim artistik është mjaft hipotetik, sepse në suaza të tekstit letrar edhe pikëshikimet e karaktereve synojnë kah artistikja-i nënshtrohen një funksioni dhe relacioni të tillë. Në anën tjetër precizimi i pozicionit të autorit, kategorisë autor dhe tekst nuk është edhe aq adekuat. Te Llotmani ato i hasim edhe

në kuptimin e karakterit dhe të diskursit të tij, prandaj vështirësohet kufiri midis autorialitetit të karakterit -narratorit dhe autorit të veprës, midis veprës dhe thënies (ligjëratës, diskursit etj). Precizimi i mëtejme rreth pikëshikimit të autorit dhe shmangia nga mosmarrëveshjet eventuale rreth autorialitetit të karakterit-narratorit-krijuesit (autorit të veprës) na çon kah pikëshikimi modelues si kategori që gjithsesi sforcon vërejtjen e Llotmanit mbi relacionin pikëshikimi-teksti si relacion krijuesi-krijimi (pa konotime në relacionin karakteri-diskursi). Pikëshikimin modelues mund ta kuptojmë si *intencë të autorit*²⁵ në tekst në të gjithë treguesit e tij. Kjo nënkupton para së gjithash të përcaktuarit e autorit dhe seleksionimin për një strukturë zhanrore apo sintezë zhanresh, teknikash romaneske dhe formash të përvetësuara nga fushat e tjera të dijes ose të realitetit, por të modifikuara në art. Mundësia është gjithmonë e hapur si mundësi për t'u përcaktuar dhe për të seleksionuar, por çdo seleksionim dhe përcaktim i autorit më tutje kufizon mundësinë shprehëse, sepse determinohet nga ligjësitë e formës së zgjedhur²⁶. Pikëshikimi modelues është intencë e autorit për sintetizimin (harmonizimin) e idesë tematike (ose disa sosh) dhe idesë së formës së tekstit. Ideja tematike dhe ideja e formës së tekstit nuk janë një. Ideja e formës²⁷, në esencë është ide mbi strukturën zhanrore. Romancieri krahas idesë tematike duhet ta gjejë edhe formën përmes së cilës duhet ta realizojë idenë tematike. Shkalla e realizimit të idesë tematike varet nga ideja e formës-kushtëzimi është reciprok: çdo ide nuk mund të shprehet përmes çdo forme, por as çdo formë nuk mundëson të shprehurit / realizimin tipik (ideal) të idesë që duam ta paraqesim. Prandaj edhe ekzistojnë (shfaqen) zbrazitë letrare: diskutojmë për vepër të mirë, të keqe, të suksesshme, të pasukseesshme, diskutojmë për vlera etj. Vepra e mirë në këtë kontekst do të duhej ta harmonizonte idenë tematike me idenë e formës, ta arrinte korenspondimin maksimal midis tyre. Kjo është edhe intencë e autorit në tekst-si pikëshikim modelues dhe si prani e autorit që dallon nga prania e autorit në tekst në kuptimin e teorisë klasike e kuptuar si pikëpamje dhe refleks ideologjik i autorit: moralizim, anim ndaj karaktereve pozitive, urrejtje ndaj karaktereve negative etj. Pa u marrur më tutje me këto, pikëshikimin modelues do ta shohim në të dy romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura", por jo në të gjithë treguesit e strukturës zhanrore për shkak të ndërlikueshmërisë së vetë strukturës për ndryshe do të duhej të analizoheshin të gjitha shtresat e saj, e kjo s'është synim i yni në këtë punim.

15. Në romanin "Oh" zbërthimi i pikëshikimit

modelues si sintezë e idesë tematike me atë të formës duket përafërsisht kështu: 1. ideja tematike: uniteti kombëtar gjithmonë ka qenë i penguar dhe i pamundshëm përgjatë historisë e deri në ditët tona për shkak të tradhëtisë. Ideja tematike në esencë është ide mbi tradhëtinë e përhershme në botë si praelement që manifestohet në këta tregues, si: tradhëti kombëtare, tradhëti politike-ekonomike (e kuptuar edhe si tradhëti ndaj një formacioni shoqëror), tradhëti në familje dhe tradhëti në dashuri. Tradhëtia si faktor i përçarjes, dështimit, shkatërrimit. Tradhëtia-uniteti këtu janë vetëm kodifikim i relacionit mitik e keqja-e mira si relacion i të kundërtave-mbështetjet në teorinë mitike ciklike. Ideja tematike në këtë roman do të mund të formulohej edhe si ide mbi dominimin e vazhdueshëm të së keqes në botë. 2. ideja e formës del si ide e medimitit dhe e kërkimit të vetëdijes pesimiste të dëshimive mbi të ekzistuarit e tradhëtisë si praelement dhe si faktor i përçarjes, dështimit, shkatërrimit të unitetit në të gjithë treguesit institucional të shoqërisë. Meditimi i këtillë koncipohet në suaza të karakterit pesimist që nuk beson në perspektivën kombëtare ose së paku që e arsyeton përtacinë e vet intelektuale, dhe realisht pozitën prej robi! Këtë modelim e ka kushtëzuar tradhëtia, intencja e autorit që të ne e paraqes tradhëtinë si praelement, onticiteti i saj realisht është mundësuar vetëm në suaza të një vetëdije të këtillë pesiiste: "uniteti s'është arritur as në të kaluarën, prandaj s'do të arrihet as tash për shkak të tradhëtisë". Çdo pikëshikim tjetër modelues në suaza të kodit të heroti i kundërt me këtë vetëdije pesimiste, s'do ta ruante dhe s'do ta mundësonte motivimin real dhe as idenë tematike të romanit, por do ta ndryshonte atë. P.sh. tradhëtia nuk do të mund ta ruante onticitetin e vet përbrenda vetëdijes optimiste, sepse për vetëdijen optimiste perspektiva kombëtare nuk është e mbyllur dhe as fati i zhvillimit të njëmendët njerëzor; prandaj tradhëtia si praelement nuk do të qëndronte, në një të tashme të afërt ose më të vonë, në një të ardhme sa do të largët ajo do të kapërcehej. Në këtë kontekst autori përcaktohet për vetëdijen pesimiste dhe defetizmin e heroit. Ai, i cili paraqitet si subjekt bazik në modelin kryesor aktansial dhe si narrator kryesor që provizorisht dominon mbi të tjerët. Të përcaktuarit eventual të autorit nga pikëshikimi modelues për subjekt bazik të romanit p.sh. për Vashën ose Plakun, do ta ndryshonte totalisht zgjidhjen e konfliktit në suaza të romanit, por do ta ndryshonte edhe idenë tematike të romanit: nuk do të ishte më dështimi i unitetit për shkak të tradhëtisë, as tradhëtia si praelement në botë ose dominimi i së keqes në mënyrë të vazh-

dueshme; por ideja te-matike do të ishte para së gjithash; ngadhënjimi mbi tradhëtinë, përçarjen, të keqen, qëndresa dhe lufta e vazhdueshme për unitet kombëtar në të gjithë treguesit e shoqërisë.

Të përcaktuarit e autorit për *meditimin* e vetëdijes pesimiste si premisë bazike e formës, i ka hapur rrugë për zbatimin e mëtejme të *paradigmës* si premisë tjetër mbi idenë e formës. Paradigma kohore ka mundësuar paralelizmin e manifestimeve të tradhëtisë nëpër kohë: në kohën mitike-historike/aktuale (të tashme) të ardhme²⁸, ka mundësuar faktikisht karakterin e tradhëtisë si praelement. Nga perspektiva modeluese paradigma e këtillë është mundësuar në suaza të medimitit, i cili presupozon një *segmentim* dhe fluiditet më të madh, gjegjësisht hap udhë për një pandeterminizëm kohor dhe hapësinor, i cili do të vështirësohej në koordinatat e ndonjë forme tjetër joadekuatë. Romani modelohet si *meditim brenda një çasti të vetëm*:²⁹ që nga momenti kur heroi-Ai shtrihet pranë akuariumit (pasi kthehet nga nevojtoresha), e derisa Vasha mbledh plaçkat dhe largohet nga dhoma. Në suaza të një çasti real (provizorisht real) shtrihet një kohë artistike prej miliona vitesh (që nga mitikja e deri te e ardhmja!), pra, thehen ligjet e determinizmit mundësisht real të kohës dhe hapësirës që do t'i atribuoheshin tipit të romanit me modelim realist. *Paradigma* më tutje si premisë e formës duhet të shihet në *simultantizmin* e *kodeve* në suazatë të cilit materializohet parcializimi i tradhëtisë si praelement, ose segmentimi i përsëritjes së vazhdueshme të tradhëtisë. Autori përcaktohet për këtë tregues të tradhëtisë që i përmendëm në pjesën mbi idenë tematike (1). Secilit nga tipet e tradhëtisë i përgjigjet një kod adekuat i cili mundëson përligjen e tij: kodi socio-politik: tradhëtisë politike-ekonomike (pushteti-populli; politikani-populli); kodi historik: tradhëtisë kombëtare në luftërat për pavarësi dhe integritet teritorial dhe kombëtar; kodi familjar: tradhëtisë në familje (baba-biri, e vjetra-e reja, tradite kombëtare/antikombëtarja, univerzalja); dhe kodi dashurisë: mospajtimi në dashuri për shkak të pikëpamjeve të ndryshme jetësore. Indicje tjetër, e formës është synimi i autorit që këtij parcializimi të tradhëtisë dhe secilit kod që e përligj në mënyrë tipike atë parcializim t'i përgjigjet mundësisht një *procedim* adekuat; madje ka tendenca kah krijimi i *diskursit* të veçantë etj. Indicje tjetër e formës është *montazhi asociativ-refleksiv*; *rrëfimi retrospektiv*; *diskontinuiteti* e kështu me radhë. Pa e analizuar në tërësi strukturën zhanrore të këtij romani nuk mund të flitet për projektimin adekuat nëpër shtresat e saj të pikëshikimit modelues si in-

tencë e autorit në tekst. Më tutje këtë do ta shohim vetëm në raport me kategoritë e modelit aktual.

15.2. Në romanin "Zanoret e humbura" zbërthimi i pikëshikimit modelues si sintezë e idesë sëmatike me atë të formës duket përafërsisht kështu: 1. *ideja tematike*: në këtë roman segmentohet në njësi tematike. Megjithatë mund të definohet si lufta për liri në të gjithë treguesit e saj që nga liria kombëtare e deri te ajo individuale; për identitetin individual dhe kombëtar, kërkimi për shkrimin e historisë dhe për të vërtetën kombëtare etj. është e domosdoshme dhe me sakrificë qoftë edhe deri në vetëflijimin. Rruga mbi të vërtetën kombëtare, historinë, shkrimin në rrethana të caktuara socio-politike është tabu-temë, "mollë e ndalueme". Njeriu edhe ashtu përgjatë ekzistencës së vetë ballafaqohet gjithmonë me të keqen, gjithmonë i mungon diçka, por vazhdimisht e kërkon atë që i mungon: 1. në kodin religjioz: njeriu në raport me zotin kërkon lirinë e vet absolute, moshbindjen pavarësinë-Eva e shtyn Adamin ta hajë mollën e ndalueme, ta prishë tabu-temën; njeriu ndodhet midis të mirës dhe të keqes (zoti-njeriu-djalli). Adami tradhëtohet nga Eva dhe synon kah djalli, kah e keqja, bën mëkat, tradhëtohet; 2. në kodin e përrallës: Djaloshi kërkon Vashën që ia ka rrëmbyer Keçani, kërkon dashurinë e vet, pjesën e vet të qenies pa të cilën është i shëmtuar, i përgjysmuar; e tradhëton Bariu etj. S. në kodin social-politik: 'LB'N' e kërkon pjesën tjetër të qenies pa të cilën është i shëmtuar, i përgjysmuar; e tradhëton Bariu etj. S. në kodin socio-politik: 'LB'N' e kërkon pjesën tjetër të qenies, i kërkon zanoret e enrit, lirinë kombëtare në të gjithë treguesit e saj, identitetin kombëtar etj., që i ka humbur nga pushtuesi dhe tradhëtarët. Ideja tematike më tutje mund të formulohet si ndeshje midis relacionit mitik e mira-e keqja që përsëritet si praelement dhe nuk përfundon kurrë; është binaritet i të kundërtëve që nga koha mitike-religjioze, zoti-djalli (njeriu-djalli) e deri në të tashmen: i pushtuari-pushtuesi ('LB'N'-pushtuesi: Specialisti, Vera, etj.).

Në roman ky relacion mbet në barazpeshë-nuk ka zgjidhje në favor të njërit, dualiteti vazhdon. Diskutimi në këtë kontekst do ta kapërcente diskutimin mbi idenë tematike. 2. *Ideja e formës*: është kushtëzuar nga rreziku potencial me rastin e hulumtimit të vërtetës dhe të shkrimit mbi një tabu-temë kombëtare-politike; prandaj autori është orientuar në logjikën dhe modelimin e "ndërdijes". Ky tipizim gjeneral i formës zhanrore nuk guxon të përzihet me tipin zhanror të *përroit të ndërdijes* që i atribuohet para së gjithash prozës së Xhojsit-në kuptimin e *automatizmit* në shkrim ose të *rrëfimit shizof-*

renik si pamundësi për të kontrolluar qoftë edhe në shkallën më minimale logjikën në rrëfim dhe strukturim. Modelimin e ndërdijes dhe, në nivelin narrativ: rrëfimin e ndërdijes, në "Zanoret e humbura" e hasim vetëm në kuptimin e formalizimit të tij dhe jo të intencional, pra, e hasim si teknikë romaneske që kryesisht mundëson situimin dhe rrëfimin aluziv. Me këtë përjashtohet automatizimi dhe shizofrenia e përroit të ndërdijes; autori fushën asociative dhe ndjenjën e ka nën kontroll të plotë; prandaj vetëm formalisht duket rrëfim dhe logjikë e ndërdijes, kurse realisht i nënshtrohet logjikës së vetëdijes. Modelimi dhe rrëfimi i këtijllë para së gjithash duhet të kuptohet si rrëfim dhe modelim që i nënshtrohet logjikës së kamufluar-si logjikë e aluzionit mbi gjërat që nuk i emërton plotësisht, por që paraqiten vetëm deri në atë shkallë dhe në atë tregues që mundësojnë të kuptuarit e aluzionit mbi tabu-temën kombëtare dhe politike. Kjo në esencë është "marrëveshja" e parë e domosdoshme e autorit me lexuesin mbi formën e ofruar³⁰, gjegjësisht kjo është premisa e parë për ta kuptuar drejtë strukturën zhanrore të romanit "Zanoret e humbura".

Premisa tjetër e idesë së formës është sistemi simbolik, i cili më së miri i përgjigjet intencës së autorit mbi aluzionin e gjërave dhe "shqiptimin e idesë"³¹ tematike. Nga analiza e bashkësisë semiotike³² del se sistemi simbolik është i ndërthurur mbi shenjat e kodeve të ndryshme, por që i nënshtrohet gjithmonë një sistemi të njëjtë referencial, dhe që e bartin prej një kodi në tjetrin gjithnjë çiftin binar 'LB'N'- pushtuesi. Ky në esencë është relacioni në modelin aktansial midis subjektit-kundërshtarit që ka mundësuar përsëritjen e vazhdueshme të relacionit mitik e mira-e keqja, por e kodifikuara nëpër kohë. Këtu vetëm po përmendim sa për ilustrim, kodifikimin e këtillë të kësaj përsëritjeje: 1. Kodi linguistik: zanoret-bashkëtingëlloret, apostrofët-bashkëtingëlloret (''-LBN), shenjat antishenjat, ardhmëria-"a", "r", "dh", "sh", "m", "ë", "r", "i" etj. 2. Kodi matematikor: një-dy, vija-pika, një-shtatë, drejtimi-çdrejtimi, 1-2 etj. 3. Kodi procesual-kinestezik-proksemik: largimi-afrimi; bashkimin-darja, ardhja-tërheqja, kërcimi-pengimi, qetësia-shkëputja etj. Natyrisht këtu kodet nuk marrin fund, romani përmban edhe shumë sish; ose sistemi simbolik i romanit ndërtohet mbi shenjat e shumë kodeve të tjera: mitik-historik, religjioz, filozofik moral, socio-politik, biologjik, hapsinor, arkitektorial.

Ndryshimi i kodeve mundëson përsëritje, shqiptimin e përsëritjes së vazhdueshme të relacionit e mira-e keqja, në rastin konkret i pushtuari-pushtuesi, gjegjësisht relacionin e luftës së të kundërtave që vetëm modifikohet nëpër kode,

nëpër shenja të reja simbolike, kurse lexuesi duhet ta shoh këtë përsëritje të së njëjtës. Ndërimi i kodeve paraqet kufi në fushën asociative dhe domosdo kërkon aplikimin e pandeterminizmit të ëndërrës dhe montimin refleksiv-asociativ që i përgjigjet këtij pandeterminizmi dhe kauzaliteti të ëndërrës. Gjegjësisht kjo është ide mbi formën simbolike oniriste, e cila në shikim të parë duket se determinohet nga një alogjizëm i plotë dhe anarki e papërshtatshme shenjash, idesh, relacionesh, situatash, halucinacionesh etj.; por realisht teoria oniriste aty sheh logjikë të plotë, rend, rregull dhe kuptim, me ç'rast hapet mundësia për interpretimin e ëndërrave. Në këtë kuptim forma simbolike oniriste lidhet me të djeshmen, të tashmen dhe të ardhmen e njeriut. Forma e këtillë simbolike në roman ruan intencën e autorit mbi aluzionin mbi tabu-temën: posa të paraqitet rreziku që ideja të dalë në sipërfaqe në suaza të një kodi, afrohet kodi tjetër me shenja të reja që sjellin kualitet dhe përmasa të reja të aluzionit. Kauzaliteti i këtillë mundëson vazhdimisht thellimin e fushës asociative, refleksin dhe sistemin shenjues, imponohet montazhi refleksiv-asociativ, por në këtë roman është me tendencë më të theksuara mekaniciste, sepse kapërcimi prej një kodi në tjetrin ose bartja e çiftit binar i pushtuari-pushtuesi prej një rendi shenjash në tjetrin është shumë më i vrazhdet se sa në romanin "Oh".

Nga perspektiva modeluese dhe intenca e autorit që të ruhet shkalla e aluzionit dhe e kamuflimit, shpesh përvidhet moskonsekuenca dhe rrëfimi sikur anon kah automatizimi dhe shizofrenia si kualitete të rrëfimit të përroit të ndërjes dhe lexuesi shpesh nuk e zë fillin. Pavarësisht prej kësaj analize e mëtejme e shih raportin midis sistemit simbolik dhe sistemit referencial: në këtë roman dominon sistemi i shenjave mbi sistemin referencial, kurse lexuesi për ta kuptuar drejtë romanin dhe ligjësitë e strukturës zhanrore, gjithsesi duhet ta shohë drejtë këtë përkim midis sistemeve në fjalë. Pa e analizuar më tutje pikëshikimin modelues në raport me strukturën zhanrore, mund të thuhet se ideja mbi formën është në esencë formë simbolike dhe modelim simbolik që projektohet në tërë strukturën e romanit. Gjegjësisht nga analiza e pikëshikimit modelues dhe e modelit aktansial si kategori bazike zhanrore mund të konkludohet mjaft bindshëm se romani "Oh" dhe "Zanoret e humbura" i përkasin prozës me modelim metaforik; l.romani "Oh" prozës simbolike. Me gjithë këtë specifikim tipologjik këto dy romane kanë ngjashmëri evidente modeluese që do të dilte fare qartë nga analiza komparative në të gjitha treguesit e strukturës zhanrore (...)

16. Analiza e mëtejme mbi pikëshikimin

modelues do të impononte vëllim dhe specifikim tematik tjetërfare të punimit, ndërkaq ne e kemi pasur parasysh vetëm skicimin e kësaj kategorie, aq sa na nevojitej ta shihnim në raport me modelin aktansial; të cilin e kemi analizuar kryesisht nën këtë prizëm, pra në raport me pikëshikimin modelues si kategori qendrore e tekstit që e përcakton varshmërinë e kategorive të tjera. Kjo varshmëri mund të ilustrohet këtu gjithashtu në mënyrë fragmentare, në rastin e të ashtuquajturit arbitër që e supozon Etjen Surio³³: animi kah njëra zgjidhje kah subjekti apo kah kundërshtari në modelin aktansial; sado që Suroi këtë e kupton si kategori të pavarur që është e prirur ta dhurojë të mirën. Më duket se nga pikëshikimi modelues arbitri nuk mund të ekzistojë si kategori e mvetësishme, sepse mvetësia e saj do të presupozonte relacione të dyfishta: me subjektin dhe me kundërshtarin njëkohësisht. Parimisht arbitri midis Heroit-Vashës (subjekt-kundërshtar) duket i dyfishtë: konflikti zgjidhet në të mirë të Vashës: Vasha ikë dhe e realizon mospajtimin definitiv me Heroin (Ai); por edhe Heroi (Ai) e realizon qëllimin e vet: bindet mbi prezencën e tradhëtisë që e prish unitetin në të gjithë treguesit e shoqërisë, prandaj edhe në dashuri; largimi i Vashës është vetëm një manifestim konkret dhe individual m'u para hundëve të Heroit. Nga ky pozicion i vetëdijes dhe i botëkuptimit të karakterit, secili kanë të drejtë edhe Vasha edhe Heroi, prandaj çdo zgjidhje dhe veprim është në pajtim me moralin e karakterit etj. Sipas kësaj logjike, që secili të ketë të drejtë nga pozicioni i vet, nuk mund të flitet për arbitër dhe as që ka nevojë për te, kur ai vetëvetiu nënkuptohet si determinizëm më abstrakt që del nga koordinatat e karakterit! Arbitrin nuk mund ta shohim dhe definojmë si vullnet të njerit apo të tjetrit, subjektit ose kundërshtarit apo ndonjë kategorie tjetër aktansiale; nuk mund ta pranojmë në suaza të botëkuptimit të karakterit. Arbitrin duhet ta pranojmë vetëm nga perspektiva e pikëshikimit modelues si aplikim (projektim) i pikëshikimit modelues në modelin aktansial. Me këtë rast midis subjektit (heroit) dhe kundërshtarit (Vashës) si arbitër na paraqitet tradhëtia. Pra, është intenca e autorit që nga pikëshikimi modelues ta afrojë tradhëtinë si praelement që përsëritet nëpër kohë, prandaj Vasha duhet ta tradhëtojë patjetër Heroin që të ekzistojë tradhëtia edhe në dashuri. Po të mos afrohej kjo zgjidhje do të ndryshonin relacionet aktansiale dhe shumë tregues të tjerë në romanin "Oh". Prandaj arbitri vetëm provizorisht mund të ruhet si shenjues që mbulon të projektuarit e pikëshikimit modelues në modelin aktansial...

Shembëll tjetër mund të jetë të kërkuarit e arbi-

trit në modelin aktansial në "Zanoret e humbura". Relacioni i kundërshtisë midis subjektit ('LB'N)-kundërshtari (pushtuesit: Specialistit, Verës gjykatësve etj.) më së miri e ilustron karakterin hipotetik të arbitrit në kuptimin siç e sheh Surio. Zgjidhja e këtij konflikti është karakteristike. Nga pikëpamja e Surios zgjidhja ofrohet në favor të subjektit dhe kundërshtarit njëkohësisht: 'LB'N' e kryen misionin e vet: arrijnë ta gjejë të vërtetën mbi identitetin kombëtar, ta shkruajë historinë kombëtare, simbolikisht unitetin e qenies e realizon si elaborim të idesë mbi bashkimin e zanoreve me bashkëtingëlloret për t'u "shqiptuar ideja" (Hamiti), si dhe përhapjen e kësaj ideje përmes veprimit simbolik: hedhjes së fletoreve nga dritarja në turmë. Ky ka qenë qëllimi i 'LB'N' në rrugën e kërkimit të identitetit... Por edhe nga pozicioni i Specialistit gjegjësisht pushtuesit, misioni dhe qëllimi është arritur: është zbuluar 'LB'N' dhe veprimtaria e tij është gjykuar dhe në fund 'LB'N' është ekzekutuar: është hedhur nga dritarja në tokë, është mbytur. Zgjidhja e konfliktit në esencë nuk ka ndodhur, arbitri në kuptimin e Surios këtu ka abstenuar, sepse edhe më tutje e kemi të njëjtin relacion aktansial: kundërshtia midis subjektit ('LB'N) dhe kundërshtarit (pushtuesit-Specialistit etj.) si relacion midis të pushtuarit dhe pushtuesit ekziston edhe në fund të romanit, si edhe në fillim të tij, por natyrisht i manifestuar në etapa dhe shkallë të reja të intenzitetit të këtij konflikti. Ndërkaq arbitri në kuptimin siç e kemi nënkuptuar në suaza të pikësishtimit modelues ekziston, ky është konflikti midis së mirës dhe së keqës si praelement; konflikti midis 'LB'N' dhe Specialistit është vetëm një manifestim i relacionit të këtyllë mitik, por tash në kodin socio-politik e modifikuar si relacion kundërshtie midis të pushtuarit-pushtuesit. Kjo është intencja e autorit në tërë romanin që të na e paraqes këtë përsëritje të konfliktit midis së mirës dhe së keqës. Nga ky pikëshikim modelues prandaj edhe e kemi zgjidhjen neutrale të konfliktit, ose zgjidhjen zero, që në esencë është ruajtje e konfliktit të përhershëm midis të pushtuarit dhe pushtuesit në të gjithë treguesit që nga ndeshja ideologjike e deri të zhdukja fizike. Edhe pas hedhjes (ekzekutimit) së 'LB'N'-së nga dritarja, konflikti midis të pushtuarit dhe pushtuesit vazhdon: edhe më tutje do të pasojë ndeshja e pushtuesit me turmën që i ka idetë e 'LB'N' së dhe fletoret e tij me elaborimin mbi identitetin kombëtar dhe unitetin kombëtar në të gjithë treguesit e mundshëm dhe të domosdoshëm. Arbitrin prandaj mund ta pranojmë vetëm si anim të autorit që kushtëzohet nga intencja e tij modeluese, gjegjësisht nga pikëshikimi

modelues si sintezë e idesë tematike e atë të formës.(...)

Relativiteti i rezultateve të arritura këtu është evident, nga se vështirë mund të besohet në rezultate dhe të vërteta absolute; aq më pak kur është fjala për studimin e letërsisë për shkak të : 1. objektit të saj mjaft fluid; 2. entropisë së metodave dhe instrumentalizmit teorik dhe 3. ndërrimit shpesh radika të shijeve estetike.

(1989)

Ky shkrim përbëhet nga pjesët e një studimi më të gjerë.

1. Cvetan Todorov, "Uvod u fantastičnu književnost", Beograd, 1987.
2. B.A. Uspenski, "Poetika kompozicije. Semiotika ikone", Beograd, 1979.
3. Për modelin aktansial në dramë shih lib. e An Ibersfeld, "Citanje pozorista", Beograd 1982; dhe Etjen Surio, "Dvesta hiljada dramskih situacija", Beograd, 1982. Për "relikt" të modelit aktansial në përrallë shih librin e Vladimir Propp, "Morfologija bajke", Beograd, 1982. Për modelin aktansial, disa kategori të tij në raport me rrëfimin romanesk shih. tekstin e Rolan Bertit, "Uvod u strukturalnu analizu pripovjednog teksta", Republika Zagreb.
4. Çdo tipizim është relativ, por me këtë rast merren për bazë karakteristikat dominuese.
5. Nuk jemi ndalur shumë as në mendimet paraprahe të autorëve tanë që në një mënyrë apo në një tjetër, janë marrë me romanet "Oh" dhe "Zanoret e humbura"; në mënyrë që të mos e orientojmë analizën kah kritika e kritikës dhe receptivitë. Nëse kemi përsëritur me këtë rast diçka që kanë thënë të tjerët para nesh, atëherë ajo le të kuptohet si popullarizim i mendimit të tjetrit dhe më shumë si verifikim i mendimit nga një perspektivë tjetër e analizës.
6. J.M. Lotman, "Struktura umetnickog teksta", Beograd, 1976
7. Dominimi i syzheut mbi fabulën në të dy romanet e analizuara është evident-kushtëzohet nga hierarhia e strukturës zhanrore, sidomos në prozën moderne. Ky dominim imponon defabularizmin e rrejtshëm, duket sikur fabula nuk ekziston. Në këto dy romane fabula nuk zhduket, por i nënshtrohet syzheut. Në hierarkinë midis tyre dominojnë në masë të dukshme njësitë bifunkionale: syzheut dhe njëkohësisht fabulare. Modelimi syzheut për këtë shkak i referohet montazhit asociativ-refleksiv. Në të dy romanet montazhi i këtyllë ka kushtëzuar diskontinuitetin e lëvizjes dhe zhvillimit të ngjarjes: ajo nuk zhvillohet, por paraqitet. Ka imponuar pandeterminizmin e kohës dhe të hapsirës së romaneve. Në "Zanoret e humbura" ky pandeterminizëm ka theksuar oniristesi kauzalitet simbolik, i cili ndryshon nga pandeterminizmi anarkik i prozës së ndërdijes; sepse në "Zanoret e humbura" "rrëfimi i ndërdijshëm" është vetëm zgjidhje teknike romaneske, formë përmes së cilës realizohet logjika dhe vetëdija që s'guxon të thuhet haptas-si vetëdije e maskuar. Në romanin "Oh" montazhi asociativ-refleksiv ka imponuar një shkallë më relative të pandeterminizmit suksesiv dhe simultan. Imponohet si proces i medimit dhe i rrëfimit retrospektiv. Dominimi i modelit syzheut njëkohësisht në të dy romanet aktualizon me të madhe modelin narrativ, respektimin e konvencionalitetit të kohës dhe të hapsirës si kategori romaneske. Në "Zanoret e humbura", ky mosrespektim është shpesh ekstrem, nuk shihen qartë kufijt e simultanitetit. Në romanin "Oh" ky mosrespektim është më i "frenuar", simultanizmi

është më i qartë, montimi është shumë më i hetuar. Në kësaj strukture modeli aktansial është më se i doosdoshëm.

8. Teksti i cituar disa herë në këtë punim.

9. Përkufizimi i *diskursit* është relativ, në fjalorë terminologjik lingvistik dhe në tekste të autorëve të ndryshëm gjejmë përkufizime që dallojnë. Dejvid Kristal i jep disa shpjegime për të që nga përkufizimi i diskursit si pjesë e pandërprerë e gjuhës që është më e madhe se fjalla, njësi biheviortiste: bashkësi ligjëratash, ligjërimit, e deri te çasja semiotike si *universe of discourse* si kategori logjike që përfshin objekte, tema, situata etj. në aktin e shprehjes (të folurit). "Enciklopedijski rečnik moderne lingvistike", Beograd, 1985). Del Hajnz në lib. "Etnografija komunikacije" (Beograd, 1980) ka kapitullin me titull "Dimenzionet e diskursit" dhe e analizon në këta tregues: diskursi-tekstet; diskursi-aktet e shprehjes; diskursi-ndërrimi i kodeve; diskursi-perspektiva stilistike. Relativiteti i kësaj kategorie është edhe më evident me rastin e aplikimit të saj në letërsi, në kuptimin e një diskursi letrar. Nëse ruajmë para së gjithash diskursin në relacion me aktin e shprehjes, si një ligjëratë, atëherë krejt teksti letrar, tërësia e një romani na imponohet si një ligjërimit dhe si një akt i shprehjes para së gjithash i autorit.

10. Për strukturën e tekstit ndër të tjerash shih tek. E J.M. Lotmanit, "Struktura umetnickog teksta", Beograd 1976.

Cvetan Todorov, "Poetika", Beograd, 1986, etj. Në këtë libër ekziston një përpjekje mjaft e suksesshme për diferencimin e niveleve të tekstit narrativ, por edhe gati në të gjitha poetikat klasike në kuadër të analizës së veprës letrare ka përpjekje të analizohen shtrësat e strukturës së tekstit, para së gjithash kompozicioni i veprës etj.

11. Emil Benvenist, "Problemi opste lingvistike", Beograd, 1975.

12. Për modelin e hapur shih veprën: "Otvoreno delo" të Umberto Ekos.

13. Franc Shtancel, "Tiptene forme romana", Knjizevne zajednice Novog Sada, 1987; Vejn But, "Retorika proze", Beograd, 1976; Cvetan Todorov, "Poetika"; Milvoj Solar, "Moderna teorija romana", Beograd, 1979 etj.

14. Stanko Lasic, "Poetika kriminalistickog romana", Zagreb, 1973.

15. Kritika jonë zakonisht e thekson këtë referencë rrëfimore mbi historinë, traditën (A. Aliu, R. Qosja, S. Hamiti).

16. Jan Mukarзовski, kap. "Dve studije o dialogu", në lib. "Struktura pesnickog jezika", Beograd, 1986

17. Gyorgy Lukacs, "Roman i povijesna zbilja", Zagreb, 1986

18. Po aty

19. Mihail Bahtin, "Problemi poetike Dostojevskog", Beograd, 1967

20. Për ontologjinë, tipet e saj dhe kategoritë ontologjike (natyrisht edhe për ontologjinë e artit) shih shkrimin përmbledhës mbi shumë autor me tit. "Poezia i ontologjia" në lib. me të njëjtin titull të autorit Sutic Miloslav, Beograd, 1985.

21. B.A. Uspenski, "Poetika kompozicije-Semiotika ikone", Nolit, Beograd, 1979

22. J.M. Lotman, "Struktura umetnickog teksta", Beograd, 1976

23. Po aty.

24. Po aty.

25. Për intencën e autorit në tekst në një dritë tjetër, para së gjithash në raport me kuptimin, shih lib. "Nacela tumacenja" të E.D. Hirsh të bot. nga Nolit, Beograd, 1983.

26. Në këtë kufizim dhe determinim e ka bazën e ashtuquajtura ideja objektive e tekstit..

27. Formën këtu e kemi përdorur në kuptim më të gjerë që nga struktura e deri te njësitë më të vogla modeluese.

28. Për kohën mitike-historike, aktuale dhe të ardhme, shih teks. e kritikëve tanë Qosja, Ali, Hamiti etj.

29. Raporti midis syzheut dhe fabulës si dhe midis kohës dhe hapësirës si kategori romaneske do ta sqaronte më tutje këtë.

30. Ndërlkueshmëria zhanrore (e madje edhe vetë formacioni) del nga shkalla e aplikueshmërisë dhe e përshtatjes së saj prej një tipi të kulturës në tjetër; p.sh. përroi i ndërdisjes si tip zhanror i bartur në literaturën tonë ka zënë vend në shkallë relative, si i tillë, vetëm në prozat e Lutfi Lepajes; kurse si teknikë romaneske është modifikuar në tipin e prozës sonë metaforike (simbolike, alegorike-futuriste etj.) të Z. Rrahmani A. Pashkut etj. Dominimi i modelimit metaforik (simbolik, alegorik) në prozën tonë është para së gjithash rezultat i kllngit politik në të cilën ndodhet kultura me vite të tëra.

31. Për shqiptimin e idesë shih tekstet e S. Hamitit të përmendura më parë në këtë punim.

32. Pjesën e analizës mbi bashkësinë semiotike dhe sistemin simbolik e kemi hequr për shkak të natyrës së punimit, që mos të imponohet si digresion.

33. Etjen Surio, "Dvesta hiljada dramskih situacija", Beograd, 1982.

Rexhep Murtez Shala


The Premisees About Category Genre On The Novels "Oh" And "Zanoret e Humbura" (Lost Vowels)

This paper offers theoretical analyses of the application of some genre categories which are foreexample: modelling standpoint as a head category of the text and actancial mode-the comprehension as a category or relation which if first of all is logical to the text. Besides that it offers a validity for categories, in this paper is once more reactualised the proof for elaborating a grammar of text on the direction of narratological attempts. In fact, the modelling standpoint, presents the basic category which determines and transforms other categories through the levels of the structure of the text. With this he "re-

defines" the dynamic structure of the text as a model and at the same time as a transforming system. The modelling standpoint is in essence renewal of the instance of the author in the text, which is so easy rejected with the shout: "Who is narrating the novel?" in the name of some kind of misapprehended ontology of the text and the categories within it. Meanwhile, this return of author in the text has nothing in common with the comprehension and positivistic treatment of the author's presence as some kind of vulgar biographysm and psychologism and up to moralism which is often ideological one. It's presence must be seen as a immanency of the idea and selected form by itself or, consequently, as a modelling standpoint, as a position from where the text is built and the ideas, reflexes and generally the world which is appearing there are articulated.

THE TH M A

GJENDJA
POSTMODERNE



Kultura evropiane është e mbetet, që nga renesansa posaçërisht, një ndërtimore e zhurmshme pa rend, që s'i nënshtrohet kurrfarë planit as programit të menduar paraprakisht. Qysh edhe sot vetë shkenca s'po zhvillohet në pajtim me ndonjë rend të programuar, por sipas rrëmujës inventive e cila përmban sasinë e programeve konkrete dhe hulumtimeve antagonistë që kryqëzohen me shtytjet e rastësishme dhe interaksionet. Vlami i kulturës evropiane ka qenë dhe mbetet skicë.

Dialogjika vorbullore

Originaliteti i kulturës evropiane nuk qëndron vetëm mbi atë se ka qenë bija e judeokrishterimit, trashëgimtarja e të menduarit grek, prodhuesja e shkencës dhe e frymës (mendjes) moderne. Por edhe mbi atë se pënderprerë ishte prodhues/prodhim i një vorbulle të cilën e bëjnë ndërveprimet dhe kryqëzimet e dialogjikave të ndryshme që ndërliken e konfrontohen:

religjioni/fryma (mendja); be simi/dyshimi; të menduarit mitik/të menduarit kritik; empirizmi/racionalizmi; ekzistenca/idea; e përveçmja/e përgjithshmja; problematizimi/rivendosja; filozofia / shkenca; kultura hu- maniste/ kultura shkencore; e vjetra/ e reja; tradita /evoluimi; reaksioni/revolucion; individi/kolektiviteti; imanenca/transcedenca; hamletizmi/prometeizmi; kishotimi / sançopansaizmi; etj.

Ç'është e vërteta, dialogjika ekziston në secilën kulturë, por ajo në shumicën e kulturave ka mundur të jetë më shumë ose më pak e mbyllur në rreth dogmash e ndalesash dhe procesi i tyre ka mundur të jetë pak a shumë i reshtur, i frenuar ose i kontrolluar. Veçantia e kulturës evropiane konsiston para së gjithash në kontinuitet dhe forcë të dialogjikave të saj në të cilat asnjëra nga instancat konstituive nuk i shkatërron dhe shfarosë tjerat, dhe as që për më gjatë ushtron hegjemoni ca më të fuqishme. Në këtë mes vendoset vlami kulturor nga shekulli i XV deri XX. Vet an-

tagonizmi gjendet brenda secilit term të dialogjikës. Fryma (Mendja), ta zëmë, njëh antagonizmat e brendshëm midis tendencave kritike dhe sistematike, midis racionalitetit të hapur dhe racionalizimit të mbyllur dhe i duhet, e kërcënuar me vetë-shkatërrim, që vazhdimisht të bëjë vetëkritikë. Në të njëjtën mënyrë dhe njëherit humanizmi evropian pëson dhe prodhon antagonizmin e thellë midis besimit në universalitetin e vetë, që sikur fsheh një evropocentrizëm mbizotërues, dhe potencialitetit të vërtetë universalizues që është i hapur ndaj të gjithë individëve dhe secilës kulturë dhe e cila e demaskon dhe kritikon evropocentrizmin. Ky proces përmban fenomenet e afrimit të ndërsjellë ndërmjet fenomeneve antagoniste: në Fe futet shumë racionalitet kritik, ç'është e vërteta kundër vetë Frymës (Mendjes), por edhe kundër shkaqeve të Fesë; futet po ashtu Feja shumë e madhe (besimi) në Frymë dhe Shkencë. Ky proces, njashtu, përmban kthesa të parëndomta të situatës kur, ta zëmë, dyshimi i tepruar krijon ankthin që shpie drejt fesë dhe kur tepria racionalistike krijon atë farë thatësie që shpie drejt romantizmit dhe kur kundërmitet krijojnë mitet si Fryma dhe Shkenca. Ai (proces) ende përmban momentet themelore dialogjike në kundërshtitë ekzemplare sikur që janë Pascal/Montaigne, Hobbes/Locke, Newton/Descartes, Rousseau/Voltaire, iluminizëm/romantizëm Hegel/Kierkegaard. Ai, më në fund, përmban krizat në secilin term të dialektikës, por asnjëri nuk bie poshtë, madje edhe përfiton nga kriza për t'u pasuruar e përtëritur. Kështu gjithmon ka qenë dhe është puna e Fesë. Kultura evropiane jo që shtron vetëm kundërshti, konflikte dhe kriza; ajo jeton në to. Ato janë sa prodhuese të saj aq edhe prodhime.

Në kulturën evropiane nuk janë të rëndësishme vetëm idetë mbizotëruese (krishterimi, humanizmi, fryma dhe shkenca), por këto ide së bashku me kundërshtitë e tyre. Frymën evropiane nuk e bën vetëm pluraliteti në të ndërruar por dialogu i pluralitetit i cili prodhon ndërrimin. Ajo nuk konsiston në prodhimin e së resë si të tillë, por në antagonizmin e të vjetrës dhe të resë (e reja shkaku i së resë zvetënohet në modë, përciptësi, snobizëm e konfor-

mizëm). Me fjalë të tjera, në jetën dhe zanafillën e kulturës evropiane është i rëndësishëm takimi që mbarëson shumë-farësitë, antagonizmat, garat, plotësimet, me një fjalë, dialogjika e saj. Pikërisht ajo është prodhim/prodhuesi i ndërlidhjes "vorbullore" në të cilën secili element dhe moment është njëherit shkak dhe pasojë e ndërlidhjes së tërësishme, që zhvillohet si spirale e mjegulltë. *Dialogjika është në qendër të identitetit kulturor evropian*, e jo të këtij apo atij elementi a momenti.




Profanja dhe universalja

Kultura evropiane s'është vetëm ajo kulturë prodhimet më të rëndësishme të së cilës-humanizmi, fryma (mendja) dhe shkenca-janë profane. Kjo është kulturë që në tërësi është profanizuar në atë kuptim që, duke u nisur nga një moment i caktuar, asnjë ide s'mbetet mjaft e shenjtë ose mjaft e mallkuar për t'i ikur vorbullës së debateve, diskutimeve dhe polemikave. Fuqia e dialogut kulturor, në diskutim dhe kontestim, ka futur idetë religjioze e politike që konsiderohen si diçka Jodiskutabile dhe të Pamohueshme dhe, sado që mbesin të shenjta për besimtarët e tyre, ato hyjnë në debatin profan. Kjo, *ipso facto*, futi në de-

bat idetë e paprekshme që derisa sundojnë si të Pamohueshme, mbeten të Paprekura. Në këtë mënyrë ka mundur që e shenja të jetë e debatur dhe e kritikuar publikisht nga ana e laikes, e që të mos jetë e vërshuar dhe shkretëtuar me profanizim.

Sado që, nga fillimi i shënuar në logjikën e renesansës, profanizimi ishte rezultat i vonë dhe në disa vende i paplotë, ashtu që gjat atij shekulli u desh të prapambetet, me vendosjen e sakralitetit të një rendi



tjetër në gjysmën e Evropës. Por në asnjë tjetër kulturë, duke përfshirë edhe atë të Athinës, nuk pati profanizim kaq të gjerë. Prapë, nuk u profanizua e prozësua çdo gjë në kuadër të sferës laike. Përkundrazi, pamë që miti dhe religjioni depërtuan në vetë qendrën e ideve të demistifikuara antireligjioze. Por miti i Frymës dhe religjioni humanist janë neomite dhe neoreligjione që, përveç rastit të partisë marksiste-leniniste në pushtet, nuk disponojnë me fuqinë institucionale të kishës e të shtetit. Ato kamuflohen si mite e religjione dhe, atje ku janë bërë parazitike, racionaliteti kritik jeton në llogari të parazitëve.

Së këndejmi duhet t'ia njohim përparësinë

e veçantë, brenda kulturës evropiane, racionalitetit kritik i cili është problematizues në vetën e vetë dhe i cili brengoset për objektivitet, sikur që është i aftë për vetëkritikë dhe kritikë të kritikës së tij. Ky i njëjti racionalitet është vektori themelor i parimit të universalitetit të cilin e ushqen kultura evropiane, por të cilën e ushqen edhe ai. E saktë është se perëndia Abraham ishte Zot i universit dhe e saktë është se porosia krishtere është e drejtuar të gjitha qenieve njerëzore, por me shekuj vetëm besimtarët shfrytëzuan mëshirën e Krishtit. E saktë është se demokracia greke ka njohur dinjitetin e njeriut-qytetar; nga kjo, ndërkaq, përjashtoi skllevërit dhe barbarët. E saktë është që Germanët dhe Frankët kanë qenë njerëz të lirë, por kurrë nuk e kanë kuptuar lirinë për njerëzit tjerë.

Racionaliteti kritik ka detyruar humanizmin evropian, mbi të cilin përkufizohet dhe ende kufizohet mbështjellësi evropo-centrik, me konkretizim të universalitetit të tij, duke ia njohur plotninë njerëzore secilës qenije njerëzore, pa marrë parasysh racën, kontinentin e kulturën. Sidoqoftë, dashuria ndaj njerëzimit nuk rrjedh nga racionaliteti, por nga një mistikë të thuash religjioze që e ka animuar humanizmin. Universalizmi evropian nuk është vetëm racionalizëm, objektivitet dhe shkencëri, por njashtu edhe besim e gjakim, dhe, në këtë kuptim, është trashëgimtar i krishterimit. Universalja, si mundësi, ekziston në secilin mendim dhe në secilën kulturë. Por asnjëra nuk e ka vendosur si lëvizës të kulturës së vet të veçantë. Pikërisht pse kjo universalja ishte në kundërshtim me të gjitha egoizmat dhe egocentrizmat e individuumit, kombit e kulturës, kjo është shtrembëruar pandërprerë, i është mbrapshtuar kuptimi dhe është tradhtuar në atë kulturën evropiane në të cilën edhe ka zën fill.

Fryma që gjithnjë mohon

Përbrenda vorbullës dialogjike idetë përherë mohohen; pikërisht kjo vorbull e negativitetit tërheq kulturën moderne evropiane. Ajo është bija e përgënjeshtimeve të të vërtetave mesjetare dhe s'do të ndalet së përgënjeshtuari çfarëdo ideje, sistem dhe teorie. Dëshira faustiane për njohjen abso-

lute e lind "frymën që gjithnjë mohon": Me-fistofelin. Negacioni është diabolik vetëm për atë që mohohet; ai gjithashtu është-sikur që tha Hegeli për skepticizmin e sofistëve-energji e frymës, dhe pikërisht ai animoi vorbullën.

Negacioni ka mundur ta marrë pamjen e dyshimit, ironisë, mohimit dhe kryengritjes. Dyshimi evropian ngjallet për aq më shumë për sa bashkon skepticizmin me diçka që, nga ana e vet, e mohon. Në këtë kuptim, s'është dyshimi vetëm në qendrën e meditacionit të Montaigne-s. Ai është në qendër sikur të metodës së Descartes-it dhe fesë së Pascal-it sa edhe të empirizmit të Hume-it (Hjum). Kur vështrojmë trimat e mirëfilltë të literaturës evropiane, që janë antiheronjë madhësia e të cilëve është në dobësi, a s'është dyshimi në qendër të de-tyrës së shenjtë të Hamletit, të neveritjes permanente të Oblomovit, të tragjedisë së Ivan Karamazovit dhe të mjerimit të Stavroginit?

Sot Milan Kundera mundet, në mënyrë retrospektive, në Kishotin, Faustin dhe don Zhuanin t'i identifikojë trimat tragjik evropian, për shkak se janë trimat e mos-suksesit dhe qesëndisë në gjurmim të të madhërishtes dhe absolutit.¹ Secili në mënyrën e vetë, ata hedhin poshtë def-nitetin, besojnë në të pakufizuarën, nuk e përfillin parimin e realitetit pikërisht në çastin kur u imponohet. Kjo ndodh në ko-hën kur bota borgjeze, kapitaliste, shken-core mbërrin sukseset më produktive pse i nënshtron çdo gjë parimeve realistike. Por sot e dimë se kapitalizmi, shkenca dhe Evropa i nënshtrohen shtytjeve të thella që hedhin poshtë defnitetin, besojnë në të pakufizuarën dhe më në fund arrijnë deri te harrimi i parimit të realitetit. Literatura evropiane bart përherë në vete negativin e padukshëm të përbërë nga vuajtjet dhe humbjet, pamjes euforike të progresit të pafundtë dhe pushtimit të botës.

A s'ekziston më në fund ndonjë lidhje e fshetë dhe e përhershme midis negativitetit që i është i vetishëm kulturës evropiane dhe procesit defnitivisht vetëshkatërrues që Evropën e shpuri në rrënoja? Kjo nuk guxon të prehet. Kjo po ashtu duhet të problematizohet.

Problematizimi i përgjithshëm

Vetia e parë dhe e fundit e kulturës evropiane është problematizimi. Të rikujto-hemi: renesansa është lindja e problema-tizimit të përgjithshëm; ajo rishqyrton Zotin, Kosmosin, Natyrën dhe Nje riun. Mandej kultura evropiane i njohu disa çaste kur një mendim, një parim dhe një evidencë besonin se më në fund e themeluan siguri-në absolute. Humanizmi besonte se njeriu, masa e të gjitha gjërave, mund të jetë the-mel i të gjitha gjërave, Fryma besonte se në logjikën e vetë themelëson të vërtetën e diskursit të vetë, e Shkenca beson se siguria e teorive të saj është e themeluar në sigurshmërinë e përvojave të veta. Por këto parime, mendime, evidenca e themele çdo-herë i bënte çështje brezi tjetër, e proble-matizimi i pandërprerë ka përshkuar pronën e kulturës evropiane.

Shikuar nga ky kënd, përpjekja e pandër-prerë e kulturës evropiane nuk është asgjë tjetër veçse pasojë e problematizimit të për-hershëm i cili sot ka sjellur deri te proble-matizimi i përgjithshëm radikal. Evropa të gjitha gjërat, njeriun, jetën, dhe kosmosin i ka zhytur në zanafillë që çdo gjë problema-tizon. Ajo një kohë të gjatë besonte se Zanafilla, Historia, Përparimi i shmangen problematizimit pikërisht pse ato vetë çdo gjë problematizojnë. Por edhe ato kanë hyrë në të njëjtin proces, për më shumë, ai i kapërdiu. Sikur që tha Patocka: "Problemi i Historisë nuk mund të zgjidhet. Ai duhet të mbetet".²


Në Evropë u vendos problematika e për-gjithshme. Prej atëherë "Evropa vetëm mund të vendoset në problematikë, sepse ajo është trashëgimia e saj".³ Ne jemi trashëgimtarë të problematikës; tash na duhet të bëhemi barinje të saj.

përk. M. Llimani

1. Milan Kundera, "L'art du roman", Paris Gallimard, 1986

2. Jan Patocka, "Essais herétiques sur la philosophie de l'histoire", Paris, Verdier 1982

3. Robert Chenavier, "Sortir du XX siècle", 1987, fq. 1219.



Ajo që sot nuk kontestohet është kriza e projektit Moderna. Kontestet teorike, ndërkaq, sillen në emërtimin e situatës që del nga kriza e Modernës. A është fjala për një situatë "origjinale historike" apo vetëm për një stagnim të përkohshëm të perspektivave të Iluminizmit?

Moderna në një mënyrë merret si bashkëkohësi dhe ndërlidhet me të në suazat e *common sensit*; sipas kësaj logjike edhe njeriu neandertal ishte Modern në raport me kohërat që i paraprinin. Përdorimi i parashtesës *Post* (pas) në neologjizmin *Postmoderna*, në rrjedhën e logjikës së

mësipërme, krijon një paradoks i cili ka të bëjë me ngulitjen e këtij neologjizmi që sugjeron se ka diçka "më moderne se sa moderna", diçka që është *pas Modernës*. Pra, duhet lënë anash kuptimin e Modernës si qenësim aktual, në mënyrë që t'i hapet shtegu një definimi, përcaktimi sa më të përafërt, apo emërtimi të një situatë ku janë evidente ndërrimet në të gjitha diskurset dhe praktikatat.


Moderna nuk është Modernë vetëm krahasuar me kohërat e mëparshme dhe me përcaktimin kronologjik të saj, po është e tillë për nga identiteti i saj. Identitetin e

Modernës e thurrë vizioni i njeriut, që njehërit "orienton të gjitha realitetet" (Lyotard) e tij, kah konceptet e Progresit, Teknikës, Lirisë, thjesht gjithë emancipimit njerëzor. Ideja e emancipimit të përgjithshëm është Ideja e legjitimitimit të të gjitha vlerave, institucioneve, praktikave, njohjeve etj. Çdo gjë është në funksion të Programit dhe Emancipimit. Njeriun Modern e përshkon bindja mbi *progressus ad infinitum* si parim i pakontestueshëm historik. Bindja e tillë themelohet në shpresën subverzive dhe "ëndrrat aktive që transformohen në revolucione dhe reforma"¹. Andaj historia si medium i realizimit të këtij progresi linear prej fundit të shek. XVIII e deri në fillim të shek. XX ishte përplot lëvizje tendosëse, rrymime tensionuese dhe konflikte të panumërta. Rrethanat e përmendura shpiejnë kah një mobilizim militant i frymës njerëzore rreth këtyre koncepteve të mëdha, me çka mundësohet revolucionarizimi permanent i vlerave, botëkuptimeve, klerarkive që ofronin një pasqyrë stabile mbi botën. Në fakt Moderna fillon si kritikë. "Kritika është shenjë e mvehtësishme e saj, shenjë e lindjes"². Kritika si e tillë, do të çlirojë Modernën nga të gjitha format tradicionale të jetës. Së këndejmi, lindja e Modernës do të jetë njehërit shpërbërje e shoqërive tradicionale ku më nuk ka "dominin të një sistemi monolit vleror që parapërcakton dhe strukturon nënsistemet e ndryshme të saj"³. Ndërrerja, shkëputja totale nga tradita, diskontinuiteti absolut me të kaluarën krijon një humnerë në mes të tashmes-sotshmes dhe traditës. Kategoria e Novumit, zbulesë e Modernës, si kategori metafizike futet dhe shtrihet në histori me çka kësaj i përcaktohet fundi dhe qëllimi, si të ndodhur në "një rrjedhë unike" qëllimi i së cilës është i predeterminuar, nga kërkesa tipike Moderne për të Renë. Kategoria e Novumit do të vërshojë sferën e moralit, shkencës, artit etj., pra të gjitha sferat e manifestimit sublim të të qenmit njerëzor. Nuk do të vendoset tradita e re por "*tradita e së Resë*" (H. Rosenberg). Mu në këtë qëndron maradoksi apo edhe antinomia e Modernes e cila do të çojë në krizën e saj. Manifestimin e krizës së themeluar në paradokse, kundërthënie dhe apori mund ta kapim

vetëm nëse do t'i qasemi sferave konkrete në të cilat janë të artikuluar qartë këto kundërthënie të Modernës, si p.sh. në diskurset dhe veprimet e orientuara nga projekti Iluminist dhe perspektiva iluministe, në arkitekturë, art-avangardizmin modern. Mund të themi se të gjitha sferat e sipërpërmendura ishin të kontekstualizuara dhe të funksionalizuara në rrjedhën unike të historisë së teleologjizuar dhe eskatologjike nga projekti Modern.

Dështimi i projektit Iluminist

Njeriu i epokës Moderne investon të gjitha shpresat në zhvillimin Teknik dhe Shkençor parapa të cilit qëndron nocioni i Racionalitetit. E pritshmja është *Regnum hominis*, një mbretëri humane, e çliruar nga të gjitha prangat dhe pengesat e njëmendësimet të shoqërisë ideale dhe të njerëzimit të lirë. Rrjedha e zhvillimit, ndërkaq, e teknologjisë dhe e racionalizimit të botës mori kahje të padëshiruar. Procesi i zhvillimit të tyre u tjetërsua nga nevojat e njeriut dhe kontrolli i tij. Ajo që sot është evidente është fakti se "çlirimi i potencialeve teknologjike nuk ishte vetëm çlirim i shpirtërave të dëgjueshëm të cilët flenin nën tokë me miliarda vjet dhe ëndrronin mbi çastin kur do të zgjoheshin nën emrin e forcave prodhuese në shërbim të projekteve njerëzore"⁴. Përkundrazi, filloi një proces i zhvillimit të pakontrolluar të arsenalit destriktiv i cili rrezikon jo vetëm qëllimin që duhej realizuar por edhe mbarë njerëzimin. Racionaliteti zhvillon edhe potenciale vetëshkatërruese. Kjo dëshmon se racionaliteti si i tillë nuk është garancë e mjaftueshme e emancipimit dhe mirëqenies njerëzore. "Në racionalizëm gjithnjë është e përmbajtur tendenca edhe praktike, jo vetëm ideale, kah vetëshkatërrimi"⁵. Euforia mbi aftësinë dhe esencën emancipuese të mendjes-*ratios* po shuhet. Mendja manifestoi predispozitën instrumentalizuese të saj. Ajo tani mund të jetë instrument për arritjen e qëllimeve që janë jashtë saj, dhe mund të përdoret për robërimin, manipulimin e edhe shkatërrimin e njeriut. Mendja totalizuese, si bartëse, agjens i unitetit, totalitarizon-implicon dominimin ndaj çdo gjëje.



Në anën tjetër, ngjarjet e shumta ushqejnë dyshimin në koherencën e të ndodhurit historik. Si të spjegohet p.sh. Auschwitz-i ose Gulagu dhe, thjesht, si të kontekstualizohen këto në historinë moderne. Lyotardi (Liotar) jo pa arsye në këtë sheh një jokonsekuencë të historisë së perpetuuar nga projekti Moderna. "Cili lloj i mendimit është i aftë të "zbulojë" Auschwitzin në kupitimin e fjalës *aufheben*, duke e vendosur në proces të përgjithshëm empirik, e madje edhe spekulativ, të orientuar kah emancipimi universal"⁶. Realiteti historik është krejt tjetër krahasuar me interpretimin iluminist dhe racionalist të tij. Në të vërtetë realiteti i dy shekujve të fundit është i përplot me barbarizma, totalitarizma, lufta, varfëri. Totalitarizmi, shkatërrimi dhe dhuna nuk janë vetëm eventualitete të procesit të racionalizimit të botës por janë manifestime të një predispozite esenciale të përmbajtur në *ration*. Dukuritë e tilla janë vrragë, shenja, gjurmë që la njeriu si Homo rationalis, Gens rationalis në hapërimin e tij historik në drejtim të njëmendësimit "të mbretërisë së perfeksionit antropocentrik" (Sloterdijk).

Perspektivat ilumaniste janë universale dhe absolute. Liria absolute, Drejtësia absolute, e Vërteta absolute si vlera prijëse që presupozohen në çdo angazhim të të gjitha subjekteve, pashmangshëm shpëjnë në

terrorizimin normativ të përcjellë me atë fizik. Terrorizimi normativ është produkt i antinomive etike që lindin nga orientimi vleror universal i subjektit partikular⁷. Si mund të themelojë një subjekt partikular legjitimitetin e veprimit të motivuar nga normat universale në interes të të gjithë njerëzimit? Si mund të zgjidhen antinomitë e tilla pa ndërmjetësimin e dhunës? Në cilat kritere mbështetet universaliteti i tyre? Me çka përkon vetëmjaftueshmëria e universalitetit të normave dhe të vlerave si legjitimim i veprimit të subjektit? Prej nga thithte proletariati dhe *avangarda* e tij (Partia Komuniste) legjitimitetin për realizimin e intencave të tyre, pos prej ideve të tilla universale dhe absolute. "Për shkak të idealit të Lirisë Absolute, çdo realitet mund të akuzohet se është pengesë e Lirisë"⁸. Andaj, duhet flakur "realitetin me vdekjen e të dyshimtëve" ngase aty gjithmonë duhet të jetë "komploti kundër Idesë". Për kampet e përqendrimit mund të thuhet se ishin një lloj mediumi përmes të cilit synohej realizimi i vlerave universale dhe absolute. Terrori është i domosdoshëm dhe i pashmangshëm në procesimin e absolutit.

Këto jokonsekuenca historike vështirësojnë përpjekjet për të mbrojtur projektin Moderna si "projekt të pakryer" (Habermas) i cili duhet rishqyrtuar dhe rehabilituar, ndërkaq, mbështesin mendimin e Lyotardit

se projekti Moderna "nuk është lëshuar, harruar por është shkatërruar, likuiduar"⁹. Këto janë paradokset, kundërthëniet dhe antinomitë që shkaktuan "rënien metafizike" për të cilën flet Adorno, e ne do të thoshim edhe gjunjëzimin dhe dështimin e projektit iluminist.

Kriza e projektit Moderna në arkitekturë

Praktika arkitektonike, si të gjitha tjerat nuk u kursye nga përshkimi me idetë iluministe. Specifikat e krijimit arkitektonik bëjnë që në arkitekturë të artikulohej tendencat shoqërore shumë më shpejtë se sa në rrafshet tjera. Andaj, edhe arkitektura moderne është në funksion të realizimit të ideve dhe të bindjeve moderne që përmes rekonstruktimit të përgjithshëm të hapësirës të njëmendësohen idealet dhe vizionet e kohës. Shpërbërja e formave tradicionale të jetës përcillet edhe në arkitekturë, me çka shpërthejnë forma të reja të krijimit arkitektonik të kushtëzuara nga nevojat e kohës, të civilizimit teknologjik dhe të mënyrës së jetuarit të njeriut modern. Gjurmimi i formave të reja të konstruktimit të hapësirës është funksionalizimi i krijimit arkitektonik me idetë Moderne mbi të Renë-*Novumin*. Arkitektura Moderne është "pluralizëm i gjallë" i stileve, por redukcioni i qëllimëve imponohet nga përpjekjet për të prezentuar synimet dhe pretendimet e lëvizjeve të ndryshme në arkitekturën moderne (Bauhaus, De Stijl, Konstruktivizmi, Art Nuovo etj.) për ndryshim jo vetëm hapësinor por edhe shoqëror.

Shtyllat mbi të cilat ngritet arkitektura moderna janë univerzalizmi ekspresiv i formave dhe racionalizmi, që imponon funksionalizmin si metodë. Funksionalizmi është rrjedhë logjike, që rezulton pas rrënimit të formave tradicionale jo vetëm arkitektonike. Me funksionalizëm do të duhej tejkaluar ngurtësia kierarkike shoqërore, në mënyrë që në organizmin shoqëror "të aktivizohen bartjet e funksioneve"¹⁰. Racionalizimi i formave ishte "rebelues ndaj çdo dekorimi të tepërt, ndaj çdo luksi retorik, ndaj kufijve nacional dhe traditave lokale, shprehja arkitektonike fi-

ton karakter universal, domethënie internacionale"¹¹. Funksionalizmi dhe racionalizmi janë supstitute për format e shpërbëra tradicionale nga kërkesat moderne.

Lëvizjet e reja moderne në arkitekturë lindin në mes dy luftrave, në kohën e tensioneve dhe thyerjeve të mëdha, në kohën e shpërthimit të barbarizmit dhe të dhunës, në kohën kur revolucionet dhe lëvizjet teknike sociale dridhnin universin jetësor të njeriut. Krijimi i formave dhe i konstruksioneve të reja, sëkëndejmi, nuk ishin produkte arbitrare dhe tekanjoze të arkitektëve modern, por formësim apo materializëm i vizioneve të tyre për tejkalimin e gjendjes së imponuar nga "errësimi i mendjes". Ndërlidhja e arkitekturës me dimensionin social ishte shprehje e "vetëdijes së hidhur" (Argan) të arkitektëve modern nga sasi të dhunës dhe të keqes që dilnin në sipërfaqe me lufta dhe revolucione. Le Courbusier (Korbizje) kishte artikulluar këtë dimension përmes dilemës ose-ose (arkitektura ose revolucioni) ngase "problemi i ndërtimit qëndron në rrënjën e çrregullimeve sociale".¹² Refleksionet e tilla do të mbështesin synimet e arkitektëve modern për strukturim të atillë kuptimor të hapësirës, brenda së cilës do të duhet të përcaktoheshin dhe të krjoheshin marrëdhënie të përsosura shoqërore. Arkitektura i kishte vën vetes si qëllim zgjidhjen e krizës në të cilën gjendej shoqëria. Ristrukturimi hapësinor ofrohet si faktor i ndërrimit esencial të strukturave shoqërore. Domeni i saj nuk është revolucioni social, por i përditshmërisë, në hapësirën e së cilës shtrihen arteriet sociale përmes së cilave barten proceset shoqërore: shtëpia, shkolla, teatri, etj. Projeksionet arkitektonike depërtojnë në parktikën e përditshme. Ilustrimi më i mirë për këtë ndërlidhje është ndërtesa e Le Courbisierit *Unité d'habitation* (Bloku i Marsejit) i frymëzuar nga *Phalantère* e Furisë dhe idetë socialutopike për krijimin e komuniteteve të vogla ideale të vendosura nëpër "tërësi banesore të madhësisë adekuate". *Unité* ishte monument i ngurtësuar i "balansit të qëllimeve pozitive dhe të *pasojave negative*".¹³ E paramenduar që të krijojë vetëmjaftueshmërinë sociale në një ndërtesë (26 institucione të ndryshme komunale dhe ser-



visë, ndër të cilat është edhe çerdhja e fëmijëve dhe salla e fiskulturës), Le Courbisier bjen në paradoksin e pazgjidhshëm. Mënyra e organizimit të jetës në *Unité* izolon banorët e saj nga jeta publike, duke i vendosur në një hapësirë të ngushtuar të "makines së banimit" "ideal", të preokupuar me çështjet private dhe familjare në kuadër të një megastruktura tehnoidë, të një katrori të betonit. Në esencë, e këtui Jencksi (Xhenks) ka të drejtë, individët e tillë mund të jenë ekuivalent bashkëkohor të "idiotëve" grek, në kuptimin burimor etimologjik të atyre që nuk marrin pjesë në jetën politike-publike (*res publica*). Kjo nuk është e tëra që krijon paradoksin, kësaj mund t'i shtohet edhe fakti se kopshiti gjendet mbi ndërtesë, rrugët brenda ndërtesës, ndërsa qendra tregtare gjendet në katin e shtatë të ndërtesës. Përkundër të gjitha përparësive praktike-pragmatike të shpërndarjes së tillë funksionale të hapësirës së përditshme, shumë teoreticienë si Jane Jacobs, Lewis Mumford, etj., vëjnë në pah mangësitë antroposociale të *Unitës*. Shpërndarja e hapësirës në *Unité* si produkt i kreacionit të pasur imagjinar, çon kah çrrënjosja artificiale e funksioneve primare nga totaliteti hapësinor jo vetëm urban por edhe socio-politik.

E njëjta ngjan me ndërtesën *Prit-Ajgo* në

Saint Louis, të ndërtuar-konstruktuar nga CIAM (Kongresi Internacional i Arkitektëve Modern), ndërkaq i frymëzuar nga idetë e Le Courbisierit dhe që mishëron idealet e arkitekturës moderne dhe të arriturat e saj. "Duhej që forma e mirë të çojë tek përmbajtja e mirë, ose së paku, deri te sjellja e mirë; projektimi inteligjent i hapësirës abstrakte duhet të nxiste sjellje të shëndoshë"¹⁴. Pas lulëzimit të kriminalit dhe pas dështimit projektues të arritjes së virtyeteve të shëndosha tek popullata, kjo ndërtesë rrënohet me 15 korrik 1972 në ora 15 e 32. Çka edhe merret nga Jencksi si datë dhe kohë precize e vdekjes së arkitekturës Moderne.

Arkitektura Moderne e udhëhequr me ideologjinë e iluminizmit për progresin e paevitueshëm shoqëror çoftë edhe përmes definimit dhe përcaktimit të ri të hapësirës, formës dhe funksionit, u nëpërkëmb në kundërthëniet dhe paradokset që shpien në krizën e projektit të saj. Shkaku i krizës së projektit Moderna në arkitekturë nuk duhet kërkuar vetëm në pamundësinë e shërimit të shoqërisë përmes ridefinimit hapësinor dhe funksional, por edhe në qëllimin e ndërtimit të tyre dhe kontekstin shoqëror në të cilin dhe për të cilin është ndërtuar. "Këtu mund të gjejmë një devijim të çuditshëm por të pashënuar të arkitektit modern në rolin e utopistit social, ngase do

të shohim se si ai ka ndërtuar për forcat në pushtet të shoqërisë me baza komerciale, e kjo lidhje e fshehtë ka paguar llogarinë e saj si çdo aferë e paligjshme dashurie"¹⁵. Pastaj, racionalizimi radikal i formave ku ornamentet shpallet krim, shkëputja e konstruksionit dhe e formave të reja nga kontinuiteti tradicional i kontekstit ku ndërtohet, domethënia internacionale e stileve moderne, shfjtyron dhe i humb identitetin qyteteve si tërësi hapësinore dhe kohore, urbane dhe sociale. Shkaqet e krizës së arkitekturës moderne Jencksi i klasifikon në dy më të rëndësishmet, në atë të varfërimit të gjuhës arkitektonike dhe atë të përmbajtjes, respektivisht, të qëllimeve shoqërore për të cilat është ndërtuar.


Paradokset e ekskluzivitetit avangardist

Me shpalljen vetëthemeluese të Modernës, përmes destrukturimit të traditës dhe të formave tradicionale të shprehjes dhe përmes revolucionimit permanent të vlerave, paraqiten edhe lëvizjet avangardiste si bartëse dhe artikuluese të idealeve të kohës. Avangarda jo vetëm politike por edhe artistike identifikohet me misionin e madhërishëm të saj të udhërrëfyesit drejt formave të reja të ekzistimit, të qenësimit dhe të të përjetuarit. Andaj avangarda artistike dhe drejtimet e ndryshme të saj janë të fundamenteuara në logjikën e shkëputjes rrënjësore nga e kaluara. Avangarda është e pandashme nga programet historike që për qëllim e kanë transformimin e shoqërisë. Të gjitha opsionet dhe euforia e destruksionit janë të kuptimsuara nga vizioni për ardhmërinë e ndritshme të *Tokës së Premtuar*. Së këndejmi avangarda artistike ishte një lloj "politizimi i recepcionit" (Shtulhofer). Politizimi i recepcionit do duhej bartur revolucionin dhe veprimin revolucionar prej rrafshit politik dhe social në atë të rendit kulturor. Andaj avangarda është një lloj aktivizimi revolucionar, politik dhe kulturorë. Ajo është një "ekspeditë e kuptimit" (Sloterdijk), që hapë shtigjet për idetë e reja, kultin e së resë dhe të ndryshimit Modern. Avangarda lansonte lirinë absolute përmes *negacionit të pakufishëm* (Adorno) dhe përmes synimeve radikale

kah e reja-*Novumi*. Gogeni përpiquej të "vendosë të drejtën se guxon çdo gjë". Ekspresioni artistik tani duhet të jetë i ri, ai duhet t'i ikë "kodit të pasqyrimin" (Lipovesky) deskripcionit dhe prezentimit të realitetit. Aktivizimi avangardist shëndrrohet në opsion të ngurtë të shkuarjes përpara, të gjurmimit të së resë. "Nuk ka vepra të mirëfillta pa moment agresiv", thuhej në manifestimin e Futurizmit. Ajo kryen një lloj agresioni ndaj rregullave obliguese të krijimit artistik tradicional të formës dhe të harmonisë. Me realitetin, duke e abstrahuar dhe duke e hudhur Maleviçi dhe Supermatizmi zbulojnë asgjënë çliruese. E që është e logjishme edhe mimezisin, duke iu afruar në këtë mënyrë "botës së formave, toneve, kuptimeve të lira dhe sovranë, të panënshtuara rregullave të jashtme"¹⁶. Revolucionimi permanent, "kërcimi plotë rrezik" (Marinetti), hapë horizonte të reja të krijimit artistik, vendos një kod të ri për veprat e kësaj kohe, një sovranitet, autenticitet, autonomitet.

Aktivizimi avangardist ishte i drejtuar edhe kah tejkalimi i ndarjes së artit nga jeta e përditshme dhe praktika jetësore. Ndërlidhja e avangardës me idenë sekulare mbi "shpëtimin historik të njerëzimit" të gjitha shpresat e investonte në "çlirimin ekspresiv të individit" (Sloterdijk). Arti duhej të reintegrohej në domenin e jetës praktike. Programi ose programet që prinin aktivizimin avangardist, e kjo kishte logjikë të brendshme, "prodhonte më shumë *demonstrata* se sa vepra artistike"¹⁷. Politizimi i shqisave, i recepcionit dhe i përjetimit që qëndronte pas programeve avangardiste kishte qëllimin e caktuar: krijimin e skandalit dhe shokut si "strategji estetike të avangardës" (Sloterdijk).

Aktivizmi avangardist nuk ishte vetëm i pasqyruar në veprat e Futuristëve, që kapnin lëvizjen në pikturat e tyre dhe njëkohësisht në poezi, këndonin për shpejtësinë dhe Makinën. Ai ishte në esencë dinamik, dukuri e dinamizmit të kushtëzuar nga kërkesa për atë që është absolutisht e re. "Cilës hapësirë nuk i beson Cézanne? Asaj të impresionistëve. Cilin objekt e kontestojnë Picasso dhe Braque? Atë të Cézannesë"¹⁸. *Tejkalimi* dhe *Negacioni* janë absolut. Dinamizmi avangardist krijon



kundërthënie, apori. Skandali dhe shoku nuk mund të jenë konstanta të krijimit dhe përjetimit artistik, sepse krijimi i formave dhe perspektivave të reja artistike në pajtim me parimin mbi Novumin absolut implikon demodimin momental të veprës moderne artistike. Efekti i shokut dhe skandalit humbet menjëherë pas aktit të recepcionit. Inovacioni artistik i themeluar në provakacion, skandal dhe shok si kanon estetik rutinizohet dhe "normalizohet". Ekskluziviteti shokant dhe dinamizmi marramendës avangardist fillon të shterret nga përsëritja dhe insistimi stereotipik i vendosjes së veprave absolutësisht të reja artistike. *Dinamika vetëshkatërruese e negacionit krijues*-kjo është aporia e avangardës.

Konstatimi mbi fundin avangardist (refuzimi i artistëve të identifikohen me avangardën-*Transavangardizmi*), mbi fundin e estetikës së themeluar në shkëputje radikale e ekskluzivitet nuk ka të bëjë me fundin e artit. Ngase "ky nuk është fundi i artit, por fundi i *idesë së artit modern*" (O. Paz).

Gjendja e postmodernitetit

Kriza e Modernës është kriza e ideve të saj, të funksionalizuara në projektin e çlirimit eskatologjik si perspektivë absolute dhe ekskluzive. Në të gjitha diskurset dhe praktikën vërehet abstenimi nga identifikimi me ato ide. Prefiksi *Post* në përdorimin e shpeshtë të tij në diskurset e ndryshme dhe në përshkrimin e situatave të ndryshme, nuk ka vetëm funksion dekorativ retorik. *Postiluminizmi*, *Posthistoria*, *Postracionalizmi*, *Postukomunizmi*, shoqëritë *Postrevolucionare* dhe *Postindustriale* etj., janë shprehje që duhet të shënojnë një përpjekje për të artikuluar një ndërrim dhe zhvendosje të madhe që ka përshkuar botën bashkëkohore, pas rënies së një megaprojekti, çfarë ishte ai i Modernës. Sot flitet për fundin e radikalitetit Modern të motivuar nga shpresat futuriste, që përcillej me tendosje, përçarje, kundërthënie, thyerje e konflikte. Prefiksi *Post*, sëkëndejmi, shënon fundin e koncepteve të mëdha si Historia, Iluminizmi, Revolucioni, Komunizmi etj. Refleksioni mbi konceptet dhe

projektet Moderne si joabsolute manifestohet në dy mënyra. Në atë të kataklizmës, shkatërrimit, katastrofës dhe apoklipsës, artikullohet përmes utopive negative (Orwell, Huxley), literaturës *sciencefiction* si dhe filmimit të gjendjes postapokaliptike (Mad Max, Terminator, Universal Soldier). Refleksionet mbi katastrofizmin nuk janë pjellë e imagjinatës, prapa saj qëndron rreziku real dhe potencial nga asgjësimi. Mirëpo, sot mund të konstatohet rënija e koncepteve Moderne dhe një gjendje joapokaliptike, jokatastrofale. E sidomos jotragjike. "Aq më shumë, këtu edhe vetë mundësia e ekzistimit të katastrofës atomike (...) konsiderohet si element karakteristik për këtë mënyrë të "re" të përjetimit të asaj përvoje"¹⁸. Kjo gjendje, pas fundit të iluzioneve të mëdha është ajo e potmodernitetit.

Deziluzionimi qëndron prapa fundit të atyre narracioneve-metanarracioneve dhe koncepteve të mëdha mbi historinë dhe *telosin* si princip. Me këtë i vie fundi vizioneve dhe projeksioneve eskatologjike dhe strumbullarëve të saj, revolucionit, mobilizimit militant, skandalit etj. Fundi i historisë, në të vërtetë është fundi i historizimit, kuptimit të historisë dhe të rrjedhës së saj unike kah finaliteti kuptimësues-atij të çlirimit. Finaliteti metafizik, i imponuar nga subjekti poashtu metafizik, prej krishterimit dhe tokëzimit të tij nga Moderna, si "funksion narrativ i humb funksionit" (faktorët), heronjtë e mëdhenj, rreziqet e mëdha, peripetitë e mëdha dhe qëllimin e madh"¹⁹. Totaliteti i subjekto-centruar i "prodhimit unitar të kuptimit të historisë" është në shpërbërje e sipër. Ndërrimet e kushtëzuara nga zhvillimi teknoshkencor Modern, nuk dromcon e desupstancializon vetëm materien, por në themel ndërron të kuptuarit e njeriut të Genies. Totaliteti i subjektit sikurse atomizimi i molekularizimi i materies, shpërbëhet në libido, ego, superego, ndër dije. "Po them shpërbërje (unmaking), edhe pse në trend janë termime tjera p.sh. dekonstrukcioni, decentrimi, flakja, diseminimi, demistifikimi, diskontinuiteti, diferanncë, disperzioni etj. Këto terme shprehin hudhjen ontologjike të subjektit të mbyllur tradicional, *cogitos* së filozofisë perëndimore"²⁰.

Rrënim i rendit të deriatëhershëm epistemologjik kushtëzohet nga ai ontologjik. Ne po hymë në fazën e rendit të ri jo vetëm politik (New World Order) por edhe kulturor, në konstelacione të reja kompleksifikuese. Gjendja e postmodernitetit, në të subjekti i decentruar e *gjen* veten të situuar në vorbullin e diferencave kulturore dhe të pluralizmit dhe poliperspektivizmit vleror. Dispozicioni i postmodernitetit është vendosje në strukturat e disperzuara të qendrës. Heterogjeniteti i subjekteve të decentruar dhe të diferencave "të paredukueshme" të specifikave kulturore, etnike, politike regjionale etj. dëshmojnë për lëvizjet e mëdha historike dëshmitarë të së cilave jemi. "Dekori i ri" i postmodernitetit nuk është i privuar nga kundërshtitë, përçarjet, thyerjet, konfliktet, por artikulimi i tyre nuk përcjellë logjikën e zgjedhjes përfundimtare të tyre. A nuk krijohet identiteti kulturor evropian edhe përmes dhe në vorbullin e dialogjikave kulturore (Morini)? A nuk kemi të bëjmë me një koncepttjetër të "totalitetit", atij dialogjik (Velmer), me unitetin e padhunshëm të të shumtës (Adorno), që vendoset përmes "*relationship by way of differences*" (Jameson)?

Konstelacionet e krijuara të fragmentaritetit-politik e kulturor-duhet të pamundësojnë interpretimin manikeik të botës. Kjo duhet t'i shmanget "tiranisë së tërësive" (vendosjes së dhunshme të unitetit), përmes procesit të decentrimit, çka njëherit duhet të jetë pengesë e vendosjes së sistemit dhe të totalizimit.

Gjendja e Postmodernitetit nuk është përkundërsi dhe s'është tejkalim pozitiv i Modernitetit. Postmoderniteti është tjetër nga Moderniteti. Tjetërsia është largim, distancim nga identifikimi me ideologjinë e konsekracionit të Novumit në Modernë. Bindjet e postmodernistëve se ajo është *Tejkalim* i Modernës, janë mbase vlerësime sipërfaqësore, që mbesin në suazat e logjikës së Modernës, e cila vetëafirmohet përmes akteve negatorike dhe tejkaluese. Vlerat e hudhura nga Moderna, nga ekskluziviteti i saj si dhe nga gjurmimi i ekstatik i së resë, Postmoderna me mosinsistimin në inovacion (si kusht të krijimit) i rehabiliton. Insistimi radikal në inovacion i Modernës në Postmodernë shëndërrohet në

"eklekticism radikal", në kombinime eklektike të stileve në vepra, në heterogjenitet të stileve, ngase "eklekticismi është synim i natyrshëm i një kulture të lirë në zgjedhjen e saj" ²¹. Ripërtirja e stileve dhe kthimi në traditë nuk janë prirje të proceseve dhe diskurseve Postmoderne. E mvehtësisht për Postmodernën është koekzistenca e stileve, bashkëprania e kundërthënies, flakja e antinomive e opozitave të krijuara nga humnera e diskontinuitetit nga tradita të Modernës, është properspektivizmi i poliperspektivizmit në koekzistencë dhe ndërpershikime. Në Postmodernë mund të gjenden të gjitha vlerat e Modernës; ato tani nuk janë subverzive, bërthama e tyre revolucionare është pastruar dhe fleksibilizuar.

Postmoderna nuk është prerje absolute me Modernën, s'është as "situatë origjinale historike". Postmoderna është gjendje në të cilën shpie kriza e Modernës, rënia e projektit dhe programit të saj. Kjo është gjendje ku mundësohet ekzistimi i botërave paralele, gjendje e zhvendosjes infinitezimale të kufijve, të kombinimeve aleatorike të stileve, "laksizmit elektik", pranimit "të agonistikës gjuhësore" etj. Refleksioni dhe diskursi Postmodern (çoftë në arkitekturë, letërsi, art, film, teatër), përmes nocioneve të sinkretizmit, reminishencës, citatit, polivalencës, pastishit, heteronimisë, fragmentit, heteroklicitetit artikulojnë një sensibilitet të ri, të krijuar nga situata e humbjes së ardhmërisë-Idesë mbi qëllimin e historisë të presupozuar në Modernë. Me këtë duhet të artikullohet fundi i koncepteve të mëdha dhe esenca iluzore e vlerave të projektuara në ardhmëri. "Ne jemi pjesëmarrës të depërtimit të realitetit në një botë pa iluzione."²² Situimi në gjendjen e postmodernitetit ka hudhur barrën e ideologjisë së militarizuar dhe opsive në ardhmërinë e ndritshme (Metafizika e dritës-iluminatio). Tërë qenien ka përshkuar procesimi i amshueshëm i së njëjtës, sotshmes së pakufishme; çlirimi nga barra e qëllimit të madh është radikal; sensibilizmi për tolerancë dhe indiferencë radikale. Më nuk ka projekt që do të mund t'i mobilizonte masat, e sidomos me aspirata globale dhe historike (Lipovecki).

Asgjë tragjike!

1. Oktavio Paz, "Drukclje misljenje", fq.32 Svetovi, Novi Sad 1991.

2. Po aty, fq. 31.

3. Richard Wollin, "Modernizam protiv Postmodernizma", fq.179 në "Marksizam u svetu" Nr.45/1986. Lidhur me këtë çështje të shpërbërjes së totalitetit të lidhjes etike të jetës Habermasi thotë: "Forcat religjioze të integrimit social janë të paralizuar gjatë procesit iluminist i cili nuk mund të zhduket as të prodhohet arbitrarisht. (...) Për këtë Hegeli dhe nxënësit e tij fusin shpresat në dialektikën e iluminizmit, në të cilën madje i siguron vetes rëndësi si ekuivalent për forcën bashkuese të religjionit. Ata zhvilluan konceptet e mendjes që do të duhet të plotësonin atë program", J.Habermas, "Filozofski diskurs moderne", Globus, Zagreb, 1988, fq.83.

4. Peter Sloterdijk, "Kopernikanska mobilizacija i ptolomejsko razoruzavanje", Bratstvo-Jedinstvo, Novi sad, 1988 fq. 14.

5. Adorno-Horkhajmer, "Dijalektika prosvetiteljstva", Veselin Maslesa, Sarajevo 1974 fq. 12.

6. Joen Francalse Lyotard, "Postmoderna protumacena djeci", A.Cesarec, Zagreb, fq. 70.

7. Për këtë shih rev. "Nase teme" e Zagrebit nr. 9-1989; A. Loshonc, "Moderna na Koloni" fq.2255-6, Nr.tematik "Postmoderna od fascinacije do spektakla".

8. Jean Francoise Lyotard, "Postmoderna protumacena djeci", fq.79.

9. Po aty, fq 33, Loytard thotë se "Auschwitz-in mund ta kuptojmë si emër paradigmatic për "pakryershmërinë" tragjike të Modernës".

10.Rreth kësaj shih G.C. Argan, "Studije o modernoj umetnosti", Nolit, Beograd, 1986, fq.163.

11. Gina Pischel, "Opca povijest umjetnosti" (3), Mladost, Zagreb fq. 218.

12. Cituar sipas Charles Jencks, "Moderni pokreti u arhitekturi", Gradjevinska knjiga, Beograd, fq.47.

13. Po aty, fq.25.

14. Charles Jencks, "Jezik postmoderne arhitekture", Kultura, Beograd, fq.56.

15. Po aty, fq.61.

16. Zhil Lipovecki, "Doba praznine-ogledi o savremenom individualizmu", Knjizevna zajednica, Novi Sad, 1987,fq. 76.

17. Richard Wolin, "Modernizam protiv postmodernizma", në rev. "Marksizam u svetu" nr. 4-5/1986.

18. Gianni Vattimo, "Kraj Moderne", Bratstvo-Jedinstvo, Novi sad, 1991, fq.9.

19. J.F. Lyotard, "Postmoderno stanje", Bratstvo-Jedinstvo Novi Sad, fq.6.

20. I. Hassan, cit. sipas Albreht Velmer "Prilog dijalektici moderne i postmoderne", Bratstvo-Jedinstvo, Novi sad, fq.49.

21. Charles Jencks, "Jezik postmoderne arhitekture".

22. Jean Baudrillard, "Fatalne strategije", Knjizevna zajednica, Novi sad 1991, fq.61.



ARKITEKTURA POSTMODERNE




Michel Graves është sot arkitekti më i shquar amerikan. Në këtë bisedë, që u zhvillua në Vjenë që më 1987, ai flet për lëvizjet më të reja në arkitekturën amerikane dhe bashkëkohore, për fundin e modernizmit dhe pluralizmin e drejtimeve në arkitekturën e ashtuquajtur postmoderniste, si dhe për një varg çështjesh tjera të arkitekturës aplikative (urbanizmi, disenjimi i orendive shtëpiake etj.)

Në vitet e shtatëdhjeta, së bashku me Robert Venturin dhe Filip Xhonsnin (Philip Johnson), kenit qenë ndër mohuesit e parë të qëndrimit ortodoks modernist në arkitekturë. Sot kritikët dhe arkitektët e rinj janë duke kundërshtuar teprimet në stilin e vonshëm postmodernist. Ç'mendonit ju për këtë? A kanë të drejtë këta kritikë dhe a mund të sjellë kritika e tyre ndërrime qenësore në arkitekturë?


Mendoj se, me gjasë, kanë të drejtë. Nocioni *stil i vonshëm postmodernist* posa ka hyrë në përdorim, por unë po kuptoj se ç'mendonit. Ç'është postmodernizmi? Ju jeni postmodernist, unë poashtu, të gjithë jemi postmodernistë. Askush sot nuk mund të jetë modernist, bile as arkitektët që janë duke i shfrytëzuar versionet e reja të arkitekturës modernë nuk ndërtojnë më njësoj sikur që kanë ndërtuar Gropiusi (Gropius), Korbizheu (Le Corbusier) dhe Mis vand der Rou (Mis van der Rohe). Këto janë gjëra krejtësisht të ndryshme. Mendoj se është i frytshëm ekzistimi i hulumtimeve të ndërsjella në mes të njerëzve të



cilët merren me vlerat tradicionale, të cilëve u takoj unë vetë, dhe të atyre që vetën e konsiderojnë për avangardë. Një gjë e tillë vetëm sa i ndihmon arkitekturës që të ecën rrugëve që kurrë nuk kanë qenë të shfrytëzuara. Si shembull të hulumtimeve të tilla do ta kisha përmendur arkitektin Moshe Safdi nga Bostoni.

Disa kritikë thonë se thirrja në historinë është bërë si një



BISEDË ME
MAJKËL GREJVSIN





lloj shoubiznisi (show busines) dhe se nën firmën e formës historike është hapur mun-dësia për depërtimin e çdo marrëzie. A mendoni edhe ju se postmodernizmi si një stil i ri internacional do t'i bëjë po ato gabime që i ka bërë modernizmi, duke u aplikuar në mënyrë uniforme në hapësirat urbane të mbarë botës?



E gjithë kjo varet nga mënyra se si e përkufizoni postmodernizmin. Siç thash më parë, disa versione më të reja të modernizmit janë postmodernizëm. Atë që quhet modernizëm unë do ta përkufizoj si një pako ku gjenden Van der Rou, Gropiusi dhe Korbizjeu, por këtu jo rrallëherë janë përfshirë edhe Altoja (Aalto), Mekintosh (Macintosh) dhe Rajti (F.L.Wright), si dhe një mori e arkitektëve modern, të cilët nuk kanë qenë gjithaq ortodoks dhe të prezentuar nga CIAM-i (Kongresi Ndërkom-

bëtar i Arkitektëve Modern). Postmodernizmi assesi nuk është kthim nga e kalura, siç pandehet zakonisht. Në disa versione ai mund të jetë i këtille, por jo edhe në ato të cilat i shfrytëzoj unë vetë. Modernizmi i ka shfrytëzuar vlerat tradicionale, po këtë e bëja edhe unë në mënyrën time, dhe këtë e bënë në një mënyrë tjetër, p.sh. Hans Hollejni (Hollein). Këto nuk duhet konsideruar si shikime të kthyera prapa nga e kaluara, por si vazhdimësi dhe kontinuitet me të kaluarën. Edhe ju edhe unë kemi memorjen, por kjo megjithatë nuk do të thotë se unë do ta huazoj kapitullin nga njëra periudhë historike, ndërsa shtyllën nga periudha tjetër, duke bërë kështu një kollazh. Natyrisht, ka njerëz që do ta bëjnë edhe një gjë të tillë.

Ju i shfrytëzoni format klasike evropiane të Paladios, të Klod Leduese (Ledoux) e të tjerëve, por do të ishte interesante të

na shpjegoni se sa ka ndikuar në punën tuaj ambientit urban amerikan në të cilin jeni rritur?

Amerika moderne është ndërtuar vertikalisht, drejt ashen-sorëve. Dallimi në mes Parisit, Romës, Londrës nga njëra anë, dhe Nju-Jorkut, nga ana tjetër, qëndron në atë se qytetet evropiane janë ndërtuar në gjerësi, ndërsa Nju-Jorku dhe disa qytete të tjera amerikane, në lartësi. Megji-thatë, pjesa dërmuese e qyte-teve amerikane poashtu shtrihet në gjerësi, dhe në dukje janë si ata të Evropës, por kjo nuk do të thotë se qendrat e këtyre qyteteve janë po aq të bukura si në Evropë, sepse janë ndërtuar në kua-dër të një tradite ndërtimore të shkurtër dyqind-vjeçare. Rrënjët e ndërtimtarisë amerikane janë neoklasiciste, dhe ato do të mund t'i quajmë edhe evropiane, por unë atë do t'i quaja, duke u mbështetur në orientimet e



mia, thjesht *arkitekturë*, sepse kjo për mua nuk është as arkitekturë evropiane e as orientale, por arkitekturë e perëndimit, pjesë e kontinuitetit të cilës jemi edhe ne, ndonëse në të jemi inkuadruar shumë vonë. Neoklasicismi i shekujve XVIII dhe XIX në Amerikë ka qenë i pabesueshëm, mahnitës. Javën e kaluar kam udhëtuar nëpër shtetin federal Mejn. Shtëpitë neoklasike, objektet komunale dhe kishat janë të mrekullueshme, të punura nga druri, dhe janë versionet të arkitekturës së njëjtë që rrjedhë nga Austria dhe Italia, e që është zbatuar nga format klasike. Unë besoj në forma të përkthyer dhe të transformuara klasike.

Ndërtesat e juaja duken shumë komunikative. A keni ndonjë feedback (informate këthyese) nga njerëzit që ato i shfrytëzojnë? A keni njohuri se çfarë janë përvojat e tyre?

Shumica e klientëve të mi janë personat privatë, me të cilët shoqërohem. Edhe kur kam punuar adaptimet e disa ndërtesave, jam shoqëruar me pronarët për ta kuptuar se çfarë ndjenja kanë ndaj zgjidhjeve të caktuara arkitektonike. Në një rast pata punuar në zgjerimin e një bodrumi të verës, dhe propozuam një spektër ngjyrash për brendinë e ndërtesës. Gruaja e prositësit dëshironte interierin krejtësisht të bardhë, ndërsa ai dëshironte nijansën e bakërt, dhe më në fund u grindën. Kam telefonuar çdo orë, tërë ditën, për të kuptuar se çka kanë vendosur. Ka praraste kur jeni të detyruar të merrni pjesë në të gjitha problemet familjare, por ka edhe njerëz të cilët farë nuk bisedojnë me ju, dhe megjithatë ju duhet të futeni në lëkurën e atyre që do ta shfrytëzojnë hapësirën. Për shembull, interieri i *Public Service Building*

në Portland nuk është realizuar mirë sepse ka qenë shpallur konkursi i veçantë për rregullimin e brendshëm të kësaj ndërtese, me më pak mjete për metër katror, se sa ka pasur për projektin e ndërtesës. Për interierin ishte caktuar shuma prej pesëdhjetë dollarësh për një kaudër, ndërsa për ndërtesën tetëdhjetë dollarë. Më kanë kritikuar pse i kam projektuar dritaret shumë të vogla, por unë kam qenë i detyruar të mendoj se sa të holla do të shpenzohen për të mbetur brenda kufijve të buxhetit, e pastaj është dashur të mendoj edhe për shpenzimet e energjisë, gjë e cila në vitin 1982 ishte shumë moderne, duke e adaptuar projektin e ndërtesës sipas kodit energjetik të cilin e kishte parapërcaktuar qyteti. Po të mos e kisha bërë këtë, kisha humbur poenat shumë të rëndësishme të konkursit. Nëse do ta punoja përsëri këtë


ndërtesë, dritaret do t'i bëja më të mëdha. Përndryshe, mendoj se objektet administrative janë shumë të vrazhda. Te projekti *Humana* në vend të kubit e kemi bërë kuadratin, në mënyrë që nëpunësit të janë sa më afër dritareve, burimit të dritës dhe me shikim jashtë. Me projekt kam paraparë që të gjithë t'i kenë dyert pas shpine, ndërsa me fytyrë të shikojnë kah dritaret. Këtë kam mundur ta bëj sepse buxheti ka qenë dyfish më i madh se për ndërtesën në Portland. E kam paramenduar që nëpunësit të vendosen në dhomat e jashtme më të ndriçuara, ndërsa udhëheqësit i kam vendosur në pjesën e brendshme. Por, me që unë nuk e kam punuar interiorin, administrata e qytetit ka marrë vendim të kundërt, duke i vendosur nëpunësit në pjesën e brendshme, e "të mëdhenjtë" nëpër zyrat përreth me më shumë dritë. Për shumicën ky projekt i imi ka qenë kontraverz, por unë mendoj se ka qenë shumë i thjeshtë. Shumë arkitektë u shqetësuan për këtë, dhe këto janë gjëra me të cilat vazhdimisht ndeshem në punën time.

Na shpjegoni diç për rolin simbolik të ngjyrës dhe të formave të caktuara në projektet e juaja.

Ngjyrat janë të atilla çfarë do t'i zgjedhnin fëmijët.

Ngjyra primare?

Ato janë primare, por jo në kuptimin që e kanë të De Stijli, Van Doesburgu (Van Doesburg), Ritveldi (Rietvelde) dhe të tjerët, të cilët e kanë përdorur ngjyrën e kaltërt, të verdhën, të kuqen, të bardhën dhe të zezën, por jo edhe të gjelbërtën, sepse ajo për ta nuk ishte ngjyrë primare. E gjelbërtë për ju, sikurse për mua, e paraqet ambientin, rrethinën. E ata nuk donin që ngjyra të paraqesë diç dhe të simbolizojë diç, por e kon-



sideronin si një element të mëvetësishëm. Për mua, përkundrazi, ngjyra e kuqe e transponuar në terrakotë, e simbolizon tokën, dheun. Simbolikisht, kur nga dheu piqet tulla, dheu pastaj edhe bartet në muret e shtëpisë. Dhe, kur i shfrytëzoj ngjyrën e kuqe ose terrakotën, ato gjithnjë i vendos në pjesën e poshtme të mureve me qëllim që të theksohet pesha dhe të krijohet mundësia për paraqitjen e bazës së re diku tjetër në ndërtesë. Gjithashtu, edhe ngjyrat tjera, të kaltërtën, të gjelbërtën o të verdhën, i përdor në mënyrë shumë të lirë dhe pa ndonjë fshehtësi të veçantë. Ndonjëherë kur dëshiroj të bëjë transpozicione dhe

të theksoj se, p.sh., brenda ndërtese jeni duke lëvizur në drejtim të *piano nobile* (katit fisnik), muret i ngjyrosi në të gjelbërt, që e simbolizon peizazhin. Pra, kjo nuk është asgjë misterioze. Ngjyra blu, apo azure shënon qiellin, majën, lehtësinë dhe maturinë, ndërsa e bardha ose e përhimta - gurin.

Keni pasur probleme rreth zgjerimit të Muzeut Vitni në Nju-Jork. A keni arritur t'i zgjidhni?

Problemet janë ende të njëjta. Problemi i Muzeut Vitni pjesërisht është problem i arkitekturës sime, e pjesërisht problem i ndërtimit në Nju-Jork. Nju-Jorku tashmë është i lodhur nga ndërtimet, nga konfuzioni i trafikut dhe nga zhurma. Këto janë bërë gjëra mizore, sepse të gjithë kanë dëshirë për të ndërtuar në këtë qytet, e me këtë vetëm thellohet përçarja në jetën e njerëzve, në transport etj. Të gjithë janë të lodhur nga kjo. Problemi i tretë ka qenë se ndërtimin është dashur ta bëjmë në pjesën historike të Nju-Jorkut, në pjesën lindore të Menhetnit, dhe përgjatë Medison Avenyse. Çdo ndryshim në atë kuart duhet të kalojë nëpër pesë komisione të ndryshme, e kjo krijon vështirësi të mëdha për çdo arkitekt.

Marsel Brojeri (Marcel Breuer) gjithashtu ka pasur probleme të mëdha në vitin 1960 kur ndërtonte Muzeun Vitni?

Ky nuk ka qenë problem i natyrës së njëjtë, por ishte shumë domethënëse dhe profetike. Është interesante se Brojeri, pasi që e kreu Muzeun Vitni, propozoi që të rrethohej Grand Central

Station (Stacioni Qendror) dhe në vend të tij të ndërtohet një rrokaqiell i madh administrativ. Kur është dashur të fillojë rrënim i Stacionit, para bulldozerëve dolën Xhon Kenedi, Filip Xhonsoni dhe disa atë

tjerë. Dëshira e Brojerit që të rrënohet stacioni u bë shkak për nxjerrjen e ligjit të ri i cili sot më detyron të punoj mu në kufijtë e tij. Kjo është frymë e Brojerit, por negative. Objekti im ishte i projektuar ngjitas me ndërtesën e Brojerit, por modernistët, sot pothuajse të gjithë në moshën shtatëdhjetëvjeçare e më tepër, nënshkruan një petition ku kërkohej që ndërtesa e tij të qëndrojë e veçuar.

Modernistët e parë, sikur Misi, Ritvaldi, Altoja dhe të tjerët janë të njohur me arkitekturën e tyre dhe po kështu me mobiljarët. Ju poashtu merreni me mobiljar?

Për shkaqe të ndryshme disenjimi i mobiljarit më është bërë kënaqësi sepse, shikoni, kjo me Muzeun Vitni është duke zgjatur shumë vjetë e asgjë nuk kemi ndërtuar. Ndërsa, kur e bëni disenjimin e një ulëse, apo gote, kjo realizohet brenda një viti ose edhe më parë. Është një punë e mrekullueshme, procesi është tjetërfare, punoni drejtpërsëdrejti me blerësin dhe menjëherë është e qartë se çka është e mundur ose çka do të jetë e stërshtrentjë. Pastaj, menjëherë i bëni ndryshimet për shkak të zbatimit teknik. Kjo më është tërheqëse. Përndryshe, i dua gjësendet që më rrethojnë, dua t'i shikoj me vëmendje dhe të krijoj të reja. Kjo është një pjesë e jetës së disenjatorit, e cila nuk duhet mohuar dhe e cila është një prirje personale. Mis van de Roe, p.sh., ka projektuar mobilje por jo edhe sendet që përdoren. Mekintoshi ka disenjuar mobiljet dhe sendet, por nuk ka mundur të ndërtojë. Unë punoj të dyjat në kontinuitet, por nuk dua të them se interijerët e mi patjetër duhet t'i kenë mobiljet e mia.

Si ka filluar bashkëpunimi i juaj me grupin "Memfis"?

Më ftoi Sotasi (Sottas). Për "Memfis" kam disenjuar, përveç disa projekteve që kanë mbetur në letër, edhe dy gjëra që janë zbatuar: me 1981 tavolinën kozmetike "Plaza" dhe me 1982 shtratin të quajtur "Stejnhoup" (Stanhope). Ndërsa, me Alesin (Alessi), për të cilin më 1981 e kam disenjuar një ibrik çaji, edhe më tutje po bashkëpunoj.

Duke punuar për "Memfis" dhe me Alesin keni formuar një stil të veçantë. Çka nënkuptoni ju me fjalën stil?

Ka dallime në përdorimin e sotëm të kësaj fjale. Ne në Amerikë themi *styling* - në harmoni me moden që dominon, dhe kjo është ajo që në Detroit bejnë me automjetet. Ua vejnë "petkat" e reja makinave të vjetra dhe i prezantojnë çdo vjet si modele të reja. Në sferën e modës ndodh e njëjta gjë me veshmbathjen. Kurse stili në kuptimin tradicional shpreh dëshirën dhe interesin e saj. Kjo fushë e gjerë është një lloj i marrëveshjes shoqërore se çka është stili, pa marrë parasysh se a ndodh kjo në ekonomi, matematikë apo kulturë. Kjo është një strukturë e cila e përcakton se për çka janë sendet e caktuara dhe si duhet kënaqur me to, dhe kujdeset që këto gjëra të jenë në harmoni me kohën. Kjo është ajo që shpesh pëson ndryshime, sjell mosbesime.

Mobiljet që i keni projektuar janë qartë të inspiruara nga art decoja.

Po, ky është stili im më i dashur. Sot më duket se nuk jam inkuadruar në mënyrë më të mirë në "Memfis".

Pse?

"Memfisi" ishte më shumë i orientuar nga poparti, derisa unë jam më klasik në qëndrimin ndaj disenjit, ndonëse kjo tingëllon pak kontradiktore.

Përgjigja e juaj e ngjashme pas një kumtese ka zgjuar

reaksione të tilla. Mua më duket se këtu ka pasur edhe keqkuptime?

Pajtohem me këtë. Një arkitekt modernist që u paraqit para meje ka thënë se nuk projektoj shtëpi të cilat do jenë *Home, sweet home* (Shtëpi, e ëmbela shtëpi), ndërsa unë mund të them se ndërtoj mu shtëpi të këtilla.

Modernistët kanë pasur ide utopistike mbi shoqërinë dhe besim të madh ndaj epokës industriale. Çfarë janë idetë e juaja dhe të kolegëve arkitektë mbi shoqërinë sot? A besoni në epokën informatike?

Kemi biseduar më parë për stilin dhe periudhat dhe mund t'ju them se jam i sigurt që sot nuk është koha e utopisë. Pyetni edhe të tjerët rreth kësaj tryeze, ose kudo tjetër, dhe jam i bindur se përgjegjja do të jetë: "Jo, gjithnjë ekzistojnë mundësitë reale". Para tridhjetë apo dyzet vjetësh, nga arkitektët kishit marrë përgjigje pohuese mbi utopinë, por sot jo, sepse gjithnjë ekziston, mundësia më e mirë, më e përsosur dhe e ndryshme për të bërë diçka. Gjenerata ime e arkitektëve besonte se shkenca do të mund të ndikojë të prijësit e popujve të bëjnë diç. Mendoj se kjo nuk është e vërtetë, sepe gjithnjë ka shumë mënyra të mira ose të keqija se si mund të shfrytëzohen projektet. Për neve, si shoqëri, do të ishte interesante të kemi një konsensus më të madh për atë se çfarë do të jetë rruga cilës do të ecim. Nuk është e thënë që kjo të jetë një rrugë, sepse tashmë shoqëria është bërë tejet pluralistike dhe pothuajse çdo ide është bërë e pranueshme.

Çfarë ka rëndësi për zhvillimin në arkitekturë?

Talenti. Dhe mundësia për të ndërtuar.


Bisedën e zhvilloi: N.Roban
përktheu: Alisa Mallqi

E
TH M
A


KATALOGU I
THEMËS

THEMA • THEMA
ESSEITIKES
TEATER
ART





ARBEN XHAVERI
ARBEN XHAVERI
ARBEN XHAVERI
ARBEN XHAVERI
ARBEN XHAVERI



NË DIMENSIONIN E SKULPTORIT

Çdo situatë historike e ka sensin e vet për kohën, për ritmin, që imponohet nga intensiteti i ngjarjeve. Të ndërtohet një dimension subjektiv për kohën, kundruall rrjedhës së përgjithshme lipset të keshë botën, universin, sistemin tend të vlerave që nuk shkundullohet nga lëkundjet e jashtme. Njeri nga këta "tuafët" që në sajë të punës dhe krijimtarisë fanatike arrin të je-tojë në dimensionin e vet është skulptori kosovar, Agim Çavdarbasha. Oaza e tij, ku ai jeton, punon, krijon dhe arrin ta ruajë vertikalen e jetës gjendet në fshatin pranë Prishtinës, Çagllavicë, në studion e vendosur në parcelën prej 700 m².

Me të hyrë në këtë hapësirë hetohet shkarrja nga ambienti: në ritëm, në formë, në ngjyrë, në tone. Studioja e Agim Çavdarbashës me oborrin përreth ka diçka nga tempulli.

Gjithçka është në funksion të një ideje: plastikës. E vendosur mirë, me proporcione të thuash antike ku çdo gjë është vënë nën urdhërin e syrit, e stilizuar aq sa të mos vërehet stili. Skulptura të vogla e të mëdha, nga mermeri, druri, hekuri, poliesteri, gjipsi, laçi të ekspozuara përreth ndjellin respekt jo vetëm për bukurinë e kultivuar, por edhe për punën këmbëngulëse që të ruhet kontinuiteti krijues përkundër pengesave të panumërta që e rënojnë motivimin.

Agim Çavdarbasha është nga skulptorët e rrallë që punon drejtpërdrejtë në material pasi që ka një respekt religjioz për të. Shpeshherë struktura, forma e materialit ia ndërron idenë fillestare të hedhur në formë të krokut në letër. Skicat që janë vlera të mëvehtësisht figurative ngaqë Çavdarbasha është njeri ndër vizatuesit më të dalluar kosovarë, dëshmojnë për shtëzimet, për luftën e madhe të skulptorit, të idesë së

tij me substancën, me *eldosin* e fjetur të materialit. Ndodhë që ai të jetë në funksion të magjistarit që i ringjall format e ndrydhura në material. Në njërin nga skulpturat më të dalluara, e realizuar kohë më parë, "Pieta" paraqitet një nënë që i vajton frytet, pjellën e vetë. Edhe pse fillimisht autori që i shmanget patosit tragjik ka dashur të paraqesë një imazh tjetër, megjithatë i dorëzohet mesazhit inherent të materialit. Kompromisi është arritur në formë që e karakterizon krijimtarinë e Çavdarbashës: nëna dhe frytet e saj nuk janë të konkretizuar, nuk ka as narracion. Në vend të gjestit të sforcuar, skulptori paraqet një habi nga fatumi që me ndjesi e sugjeron ndjenjen e absurdit. Nëna është e përgjithshme ashtu si edhe pësimi, vuajtja e saj. Ai shikim i papërqëndruar, i padefinuar, ajo lëvizje aritmike e syve, e gojës, e hundës mund të paraqitet lehtë me vizatim ose akuarel, mirëpo



shumë vështirë në materiale të forta si është mermeri. Çavdarbasha përdor daltën ashtu si penën dhe brushën. Këtë e ka arritur jo vetëm në saje të mjeshtërisë, por të botëkuptimeve që përkufizohen si filozofike: materiali e ka imancën e vet. Aty ku refuzohet ky parim ndodhë çarja. Në skulpturën "Dervishët", Çavdarbasha nga një bllok mermeri ka skalitur portretet e tre dervishëve. Me të përfunduar punën njera nga kokat çahet, përgjysmohet, dhe bie

poshtë në vendin e ekspozuar. Skulptori e pranon këtë sugjerim, këtë bashkëveprim mistik të natyrës në krijimin e një forme të re. "Dervishët" me një kokë të përgjysmuar i duket vepër më e ardhur. Reagimi i natyrës që e prish atë përsosmëri artificiale, tipike për njeriun, i jep veprës një bukuri paradoksale: shkarja, e papërsosura, diskontinuiteti, e papërfunduara shndërrohet në vlerë imanente. Nga skulpturat e thyera të antikës, nga ajo hakmarrje e ma-

terialit ndaj formës së imponuar, ndaj bukurisë së përsosur, zë fill adhurimi i torzos, simbolit të bukurisë së dëmtuar.

Kur njeriu i vështron skulpturat e Çavdarbashës ashtu të ekspozuara bashkë s'ka si të mos hetojë atë disponim të brendshëm, mbase atavist të autorit për të paraqitur në variacione të nduarnduarta intimën e jetës së përbashkët, qofshin temë njerëzit, shpezët apo format tjera. Çdo gjë është bashkë madje edhe portretet, kokat. Sikur autori e ndjen thellë peshën e vetmisë kundruall hapësirës gllabëruese të kosmosit dhe e ndërton manifestin e afrisë së njerëzve, gjallesave. *Gens una summus*, është porosia e ndrojtur e këtyre veprave.

Te këto vepra hetohet një tendencë për afirmimin, për reinkarnimin e sigurisë së dikurshme në bashkësi. Motivet e veta Çavdarbasha i titullon në mënyrë sinjifikative: Sofra, Familja, Intima, Çifti, Përqaftimi, Bashkësia, Lokja, Nëna, Halla, Trio, Kokat (Malësori, Baca, Rrafshjani), Turma, Dyzimi. Madje edhe zogjt (variacionet e ndryshme) janë materializime artistike të një ndjesie për nevojën imenente të njeriut për bashkjetë. Pa një vizion, botëkuptim për jetën artisti shndërrohet në mjeshtër e arti në mjeshtri, zanat. Çavdarbasha gjithsesi e ka vizionin të ngritur në nivel të postulatit prej nga buron edhe ajo energji e pashtershme për punë, për të krijuar. Skulpturat e tij paraqesin një manifest të ngurtësuar të bashkësisë. Këtë vlerë skulptori e zbulon në përditshmërinë kosovare, në familje, në frytat e njerëzve që kanë një hije mirësie. Ai është në hulumtim permanent të bukurisë së fshehur të ambientit të tij. Përmes syve të tij edhe ne fillojmë të zbulojmë një vlerë të re. Kodet janë gjithkund në studio: portreti i plakut fotografuar fshehurazi në treg, vizatimet, detajet e ndryshme nga e përditshmja



jonë, veglat etj. Çavdarbasha nuk është folklorist, por krijues që ua kthen vlerën sendeve, fenomeneve, duke i transponuar në produkte artistike. Përmes vizionit të tij, mjeshtresë tashmë të përsosur, të potencimit të një detajit, të shamisë së nanës, shallit të rugovasis, të mustaqeve të derishëve, të hapësirave të lëmuara në raport me ato qëllimisht të papërpunuara, figurat marrin një domethënie të

re duke nxitur te recipienti emocione nga më të ndryshmet.

Edhe në skulpturat të një gradacioni apstrakt vërehet tendenca e afirmimit të gjallërisë. Në mes të dy sferave të lëmuara, ekspozohet gjallëria e formave, vetë jeta. Ata që kanë prirje për persiatje këto skulptura do t'i përjetojnë si simbole të raportit të amshuar në mes jojetës (sfera) dhe jetës, në mes të apstraktes dhe konkrete.

tes. Këto realizime paraqiten në të gjitha fazat e krijimtarisë së Agim Çavdarbashës që mund të shpjegohet ose si ikje nga përmbajtjet konkrete ose si motiv i ngulitur thellë në qenien e skulptorit.


Sferat dhe gjallëria e formave në mes të tyre, sido që të jetë janë lajtmotif i krijimtarisë së Agim Çavdarbashës. Çdo krijues që mbetet besnik vokacionit të vet me kohë krijon dorëshkrimin që veprat e tij i shquan nga të tjerat. Nga këto dorëshkrime në vendet e organizuara kanë lindur shkollat, pastaj stilet për të përfunduar shpesh me manire.

Agim Çavdarbasha në çdo skulpturë e le vulën e vet, dorëshkrimin në formë të kafazit, shiritave apo grilave ose kryqit që simbolizojnë kufizimin. Zogjtë në kafaz, të pështjellë me shirita, portrete të mbërthyer në grila ose në kryq që ta sugjerojnë idenë se çdo formë kufizohet nga ideja, ashtu si çdo njeri e bartë kryqin e fatumit në kalvarin e vet. Në skulpturën më të re, në kompozicionin ku paraqiten trajta të zogjeve, çdo figurë e ka shiritin, nishanin e vet. Ato nuk janë skalitur vetëm për shkak të vlerave plastike, të krijimit të një raporti interesant në mes të hapësirave të lëmuara dhe atyre të papërpunuara, por sugjerojnë edhe përjetime të tjera që mund të postohen në sferën e ideve.

Çavdarbasha është krijues që tërë qenien e vet e ka fokusuar për punë. Në këtë mënyrë ai e ka ndërtuar botën e vet ku mund të hynë vetëm ata që kanë ndjesi dhe respekt për krijimtari. Për të tjerët Agimi dhe tempulli i tij është i mbyllur.

Dolëm nga studioja e tij të ngarkuar me emocione për t'iu kthyer sërish hirtësisë së përditshmës kosovare ku jeta është ndrydhur nga ide, kryqe e shirite të tjerë.

Në studion e Çavdarbashës hasëm në kujtime të mira kosovare.



ALI PODRIMJA
ALI PODRIMJA
ALI PODRIMJA
ALI PODRIMJA
ALI PODRIMJA

PËR KË 'SHKRUAJMË?



Në një qytet të Bavarisë, rastësisht më ra në dorë një gazetë e Zagrebit. Duke e shfletuar, hasa një tekst të mikut tim Mirko Kovaç. Me kënaqësi fillova ta lexoj. Vazhdimi ishte dramatik, me plot gërçe. Ajo që e thoshte shkrimtari i nderuar serb, nuk dëshiroja të ishte e vërtetë. Ishte diçka monstruoze. Diku në Bosnjë, në qytetin Foça, kryesisht i banuar me myslimanë, jeta kishte marrë tatëpjetën. Iracionalja mbisundonte arsyen. E kuptoja revoltën e mikut tim, por nuk mund ta merrja me mend se njeriu ishte shndërruar në një gjësend pa vlerë; se në mbarim të shekullit XX urrejtja ndërnacionale ishte bërë instinkt dhe Evropa ishte shndërruar në një teatër të absurdit.

Sipas shkrimtarit të nderuar, njëfarë Vojislavi, profesor serb i Universitetit të Sarajevës, rrugëve të përgjakura të Foçës ishte parë duke luajtur futboll me kokat të myslimanëve të

masakruar. Nga ato viktime disa, ndoshta, kanë mundur të jenë edhe studentë të tij, të cilët atje buzë Milackës pitoreske, kanë përcjellë ligjeratat e tij mbi të bukurën në art. Por Vojislavi kishte harruar se ishte profesor i Universitetit, që merrej herë pas here edhe me mjeshturinë e shkrimit. Ai ishte shndërruar në një fantom dhe me gradën e majorit ushtarak kishte marrë pjesë në vrasje të shumta dhe pastrime etnike. Rrënimi i Vukovarit, i Mostarit, i Dubrovnikut, i Sarajevës dhe i shumë fshatrave e qyteteve të tjera më pak të njohur flitnin bindshëm se nuk ishte fjala vetëm për psikotikën e individit.

Paranoja, pra, nga dita në ditë zbulonte fytyrën e vet të shëmtuar jo vetëm në shkrime bulevardeske, por edhe në etnosin, idelogjin dhe filozofinë e një populli që i afrohej katastrofës. Në krye të asaj të keqeje, qendronin shkrimtarë, gjysmë-shkrimtarë, intelektu-

alë, kuazi-intelektualë, politikanë të dyshi-mtë e kriminelë në zë që i gjurmonte policia ndërkombëtare. Me programe nacionaliste dhe elaborate fashiste mbusheshin bibliotekat ose krijoheshin të reja - sipas skenarëve. E kë nuk e shqetson kjo? Në vetëdijen e krijuesit kishte ndodhur një eklips i tmerrshëm, humaniteti as dinjiteti nuk ekzistonin më. Sipas kokave nacionaliste një "popull qiellor" nuk mund të gabojë. Atij i lejohej çdo gjë edhe krimi. Toka serbe shpallëshin brenda nate edhe ato vende ku një qorr apo topall i sojit të tyre kishte kaluar ndonjëherë. Ose, ekspeditat ndëshkuese shpejtonin të shlyenin çdo gjurmë nga trashëgimia kulturore e identiteti i të tjerëve në trojet e pushtuara me dhunë. Nga një filozofi primitive s'mund të lindte diçka njerëzore, pos një krijesë kiç, pikëlluese, pa vlerë - me një mjerim të thellë

shpirtëror. Sepse, dihet, nacionalizmi është një qiç. Kështu thoshte edhe Danilo Kishi. Por mu nacionalizmi na u bë ushqim kryesor për mediokër që shtoheshin rreth tryezës nacionale. Ata krijues të paktë, të cilët kishin guxim intelektual t'i kundërvihen kësaj paranoje kolektive, shpallëshin tradhëtarë të interesave kombëtare, botuesit ua mbyllnin dyert, ose detyroheshin ta marrin udhën e ekzilit. Guximi i Mirko Kovaçit ma kujtonte fatin edhe të një poeti serb i cili, duke parë në ekranin TV se ç'po ndodhte me fëmijet shqiptarë, në demonstrata paqësore dhe masakra e policisë serbe, kishte qarë për shkak të turpit dhe mjerimit të popullit të vet. Dorë pas dore, pas sa ditësh, më kishte rënë në dorë një poezi e tij për fëmijët që kishin rënë nga breshëri i plumbave dumdum, e të cilën e kishte shkruar atë natë të kobshme. "Ti mund ta botosh. Unë do të të jem mirënjohës tërë jetën se më ndihmon ta pështyj në fytyrë nacionalizmin e popullit tim", në telefon kaq më kishte thënë, por edhe në një letër që më kishte arritur pas një gjysmë viti udhe. Poeti që e thoshte këtë, e kishte kundërshtuar regjimin totalitar një gjysmë jete dhe poezia për fëmijët, as milëfi i tij nuk ishte një gjest. Ai besonte në vlerën dhe lirinë e njeriut. Para së gjithash, ai mbronte etikën e shkrimtarit në një kohë të ligë kur euforia nacionaliste, metaforë e së keqës, është një ekstazë dhe më e fortë se fjala e tij prej humanisti.

Devalvimin shpirtëror të krijuesit, që e mundonte jo vetëm Mirko Kovaçin, e theksonte edhe më rëndë disidenti dhe bardi malazias, Jevrem Berković, në një tubim ndërkombehtar të shkrimtarëve mbajtur në Bled. Por ai tmerr e agresiviteti i një diktature nacionaliste-staliniste ishte diçka

e rëndomtë për ne shqiptarët. Vrasjet e ekzodet, ndjekjet dhe tmerrin e bardhë ne e kishim përjetuar me dhjetra herë gjatë historisë sonë mijëvjeçare. Nëse Evropës nuk i kujtohet tragjedia e Çamërisë, pastaj ajo e Toplicës; nëse Evropa u mbyll në hipokrizinë e vet edhe pas vrasjeve e ekzodeve të mëdha të viteve '50, '60, '80 dhe '90 duke konstatuar *vetëm* se atje në Ballkan po ndodh diçka e tmerrshme, kujtesa jonë nuk mundi t'i shlyejë vajet e britmat mbi të vranët e fëmijët e masakruar. Mjafton ta lexoni librin "Luftërat e Toplicës" të Dimitrije Petroviqit e të bindeni nëpër çfarë golgotë kaloi populli shqiptar, të shikoni deri ku ishin trojet e tij, apo të shfletoni dokumentet e fshehta të ortodoksizmit ekstrem në relacion Beograd-Athinë...

T'i kthehemi më mirë të tashmes, që na është bërë shqetësimi ynë i përbashkët. Para katër vjetësh në Beograd u mbajt takimi i parë dhe i fundit ndërmjet shkrimtarëve serbë dhe shqiptarë. Midis fqinjëve shekullorë kërkoheshin shtigje për një mirë-kuptim e dinjitet. Por, ç'ndodhi! Shkrimtarët serbë, në vend që të përkrahnin kërkesat e arsyeshme të shqiptarëve rreth thellimit të bashkëjetesës në këtë pjesë të Ballkanit të shqetësuar, ata i shpallën luftë shqiptarëve, dhe për çudi, këtë nxitonin ta bënin para Sheshelit, Arkanit, policisë dhe ushtrisë serbe. Gjeniu krijues të popullit serb nuk dua ta fyej, por atë nuk mund ta shoh si kreator të një ideologjie nacionaliste e antihumane.

Emrat që i përmendte Berković në tekstin e vet fatkeqësisht i njihja. Ata ishin shkrimtarë të cilët zjarri i brendshëm demonian i kishte mundur. Tashti ata gjendeshin në krye të ekspeditave të vdekjes, në krye të pastrimeve etnike. Udhë e krimeve është përgatitur me vite, në kontinuitet: nga poetika e viktimës si popull i shtypur, i persekutuar, i

keqtrajtuar dhe i vranë nga të tjerët deri të mistifikimi i një patosi e folklorike të çoroditur. Nëse një nobelist, siç ishte Ivo Andriq, ose një akademik serb, siç ishte Vasa Çubriloqi, njëri nga atentatorët e Sarajevës të vitit 1914, pas të cilit shpërtheu Lufta e Parë Botërore, patën guxim që, sy e faqe Evropës, të shkruanin elaboratet e famshme të viteve 1937, '39 në stilin e Gebelsit, për zhdukjen e qenies kombëtare të popullit dhe të shtetit shqiptar nga faqja e dheut, pse të mos vepronin kështu pasardhësit e tyre mediokër që për virtutet e pranojnë rrenën dhe filozofinë e tyre nacionale e ngrisin mbi të. Apo, siç thotë kryearkitekti i ideologjisë nacionaliste serbe, Dobrica Ćosić: "rrejmë në mënyrë kreative... të paramenduar". E, kjo nuk bëhet për shkak të ekzistencës, siç mendon Ćosić, por për të fshehur dhunën, krimet dhe frikën e fajësisë. Ndërkaq, për një popull dinjitoz e civilizues - vrasjet, rrënimet e plaçkitjet nuk janë cilësi krenuese. Shkaktar për një rënie kaq të madhe, para së gjithash, është euforia nacionaliste e cila ka krah të fortë pseudoshkencën dhe propagandën e saj shoveniste e cila, brenda e jashtë trevës gjuhësore sllave, bën çmos ta mohojë autoktoninë e të tjerëve, pra edhe të shqiptarëve. E, kjo të shtynë të besosh se popullin serb ka zënë ta kaplojë ndjenja e inferioritetit ndaj vlerave e të vërtetave të të tjerëve. Bota e ka të qartë se kush nga ka ardhur, poashtu për popull autokton askund në botë nuk mund të shpallën ardhacakët. E vërteta për shqiptarët si pasardhës të ilirëve dhe popull autokton në etninë e tyre, nga dita në ditë vjen e forcohet me dëshmi e vepra jo vetëm të shkencës shqiptare.

Pjesëmarrjen e shkrimtarëve në euforinë nacionaliste, e kuptoj edhe si një fatkeqësi për artin e lirinë e njeriut. Nëpër veprat e shkrimtarëve,

që i përmendte Bërković me një shqetësim të thellë, nëpër fjalët e simbolet e tyre bridhte e keqja, e akumuluar me vjet dhe e mbështjellur me një gjak të zi. Ishin ato imazhe të errëta e përmbajtje të vdekura. Në të dorë e artistit më së pakti hetohej. Theksimi i tepërt e arrogant i krenarisë dhe i ndjenjës nacionale kishte arritur të zhdukë çdo dallim të mundshëm në mes nacionalizmit dhe kombëtares.

Ishte fillimi i verës në Bavari

ende frymonte rreth meje. Por bota vazhdonte të sillej rreth meje sipas ligjit të dhunës apo si e quaja në shaka me miqtë e mi: *pendrek demokracia* serbe ishte në lulëzim të plotë. Njeriu nuk vlente më as për pesë para.

Kthehesha në shtëpi dhe në një vitrinë gazetash, aty ku para dy vitesh, në demonstrata të mëdha paqësore të shqiptarëve ishte qëlluar për vdekje një fëmijë, ma tërhoq vëmendjen një fotografi karakteristike

e kishte paralajmëruar nga studioja e vet krijuese zoti Orwell.

Ditët më shkonin ters. Gishtërinjtë e njerëzve rreth qafe dhe ajo pozë karakteristike e luftëtarit serb më rrinin parasysh e posaçërisht më tmerronte qetësia e akullt e Evropës që nuk i lëvizte as qerpiku i syrit edhe kur ia dërgonin peshqesh kokat e prera të njerëzve. Një ditë, kur edhe nëpër gjësendet e mia kishte filluar të shtrihet hija e



kur i mblodha copat e verdha të gazetave që më vinin nga Jugosllavia e mbeturinave, dhe në fund të kopshtit ua vura zjarrin. Njëherë e përgjithmonë dëshiroja të lirohem nga ankthi i tmerrshëm që njeriun e kishte poshtëruar atje në Ballkanin tragjik. Nga leximi i shtypit të verdhë hoqa dorë dhe më rrallë ndizja TV. Në bibliotekën familjare fillova ta kaloj kohën më shumë duke lexuar vepra nga autorët antikë. Më mundonin fjalët: gjak, ekzod, vaj, bukë. Fundshekullin e shihja si hynte në oborrin tim mjaft i lodhur dhe i leckosur. Përpiqesha të vë dialog me njerëzoren, me të bukurën dhe me të gjallën që

që kishte zënë të zbehet më tepër nga turpi. Ishte një luftëtar serb i cili kthehej "triumfalisht" nga një fushëbetejë në Kroaci, duke i "falur" botës një buzëqeshje karakteristike me një varg plot gishtërinj njerëzish, që e kishte varur rreth qafës së shkurtur e të trashë. Fotografia fliste më shumë se çdo libër i tmerrit. Ai luftëtar serb, me atë pozën karakteristike të ngadhënjësit, i cili mendonte, ndoshta, se ata gishtërinj njerëzish rreth qafës së shtypur ishin specia të vjelur në ndonjë kopsht të Shumadisë apo të Vojvodinës, dëshmonte për një shthurje të madhe në hapësirën tonë. Ai ishte me siguri një prototip që

vdekjes, i shkrova një mikut të pendës: "Të lutem, më thuaj për kë shkruajmë?" Përgjegjja e tij ishte e shpejtë dhe ektivoke: Për Ballkanin e di ku bie, por Serbia me siguri nuk gjendet në Evropë..." Ai ishte intelektual i një metropole.

Duke lexuar librin "*Mbretëria e Osmanlinjve*" të turkologut të mirënjohur austriak Joseph von Hamerit, nga kapitulli në kapitull, zbuloja mistifikime të mëdha në shumë vepra që i kisha lexuar më parë, në vërtetësinë dhe vlerat e të cilave kisha dyshuar. Koha e humbur më dhimbëse dhe më mundonte mjerimi shpirtëror e krijues i autorëve që kishin helmuar breza lexuesish e

përçarë popuj. Me këtë rast duhet zënë ngoje, para së gjithash, Mitin për Kosovën (Dardaninë), shfaqjen e tij e që ishte ngritur mbi gërmadhat shpirtërore, e për të cilin bëhet fjalë aq shumë në historiografinë dhe letërsinë e dy fqinjve shekullorë - serbëve dhe shqiptarëve. Përderisa serbët Betejën e Kosovës e shpallin vetëm si luftë të drejtë të tyre, shqiptarët e konsiderojnë si luftë të koalicionit ku ballkaniasit për herë të parë i kishte bashkuar një e keqe e madhe. Derisa serbët Mitin e Kosovës e ngritin si çështje ekzistenciale të serbizmit dhe me zjarmi duan të dëshmojnë autoktoninë në një tokë të huaj, shqiptarët nuk vuajnë nga ky kompleks; përmes Mitit të Kosovës ata përkujtojnë se sa herë i kanosej Ballkanit ndonjë fatkeqësi, popujt e këtij rajoni i kanë harruar hasmëritë. Pra, Miti i Kosovës të shqiptarët shpie nga mirëkuptimi, bashkëjetesa e paqja. Për qëllime hegjemoniste këtë nuk e pranon pala serbe.

"Mbretëria e Osmanlijve", një çelës i artë, me hapte derën e rëndë të vilajetit të errët dhe më nxiste të rilexojë shumë vepra që i kisha hedhur në një qoshk të bibliotekës familjare. Mallkoja shumëçka se krijuesit ballkanas kishin lëshuar një shansë jetike. Përmes Mitit të Kosovës ta madhëronin dhe ta forconin bashkëjetesën në rajon. Këtë, si duket, bëri përpjekje ta korrigjojë shkrimtari me famë botërore, Ismail Kadare; të kaluarës duke iu qasur me një senzibilitet të ri e vërtetësi historike dhe duke respektuar e çmuar edhe përpjekjet e të tjerëve në shtegtimin nga drita e largët e vilajetit të errët. Kështu kishte vepruar edhe historiani i nderuar austriak Joseph von Hamer, i cili njëzet vjet kishte kaluar nëpër arkivat e osmanlijve, për të kërkuar të vërtetën për atë se ç'kishte ndodhur në Ballkan në kohë të shkuara. Sepse nuk ka gjë më të tmerrshme se kur krijuesi e



rrën lexuesin. Mistifikimi është shkalla e parë e nacionalizmit, ndoshta edhe më e pasigurta.

Përkundër përpjekjeve të krijuesve dhe intelektualëve shqiptarë për të vënë një dialog paqësor me palën serbe, gjenocidi kulturor e fizik në etninë shqiptare në Jugosllavinë e mbeturinave vazhdon të marrë përmasa katastrofike edhe për


vetë rajonin. Se deri ku ka arritur paranoja dhe radikalizmi i një politike mesjetare serbe e ilustron mjaft mirë një barcelotë e cila ka kohë që qarkullon: Ç'bën serbi kur nuk ka para? Shkon në Kosovë, vret ndonjë shqiptar dhe pret Sheshelin t'ia dërgoj 50 markat gjermane të marra nga shqiptari i vrarë! Kjo e vërtetë e hidhur, më tepër tragjike për vetë politikën shtetërore serbe, ta kujton edhe një këshillë bizare të kohës së Pashiqit: *Të lindni femijë sa vritni shqiptarë!* Unë nuk kam kurrëfarë komenti për këtë marrëzi njerëzore. Dhuna e krimi u zhvilluan në kontinuitet, në mënyrë të paramenduar.

Shkaktarë të një gjendjeje të tensionuar, jo vetëm në hapësirën shqiptare, para së gjithash janë pjesa dërrmuese e shkrimtarëve serbë, të cilët me energjinë e tyre krijuese ushqyen dhunën. Kjo është e tmerrshme, posaçërisht në momentin e pikërisht kur qetësia e Evropës është një qetësi false. Ta duash popullin dhe kulturën tënde është gjë e shenjtë, nuk jam as kundër atyre që bëjnë programe nacionale dhe merren me historizëm. Jam kundër atyre që rrenojnë qetësinë e njeriut. Populli im nuk e pranon dhunën si mjet për zgjidhjen e konflikteve jo vetëm në rajonin tonë të shqetësuar. Fqinj të e mi shekullor, po qe se do t'i urreja, do të turpërohesha para etikës së popullit tim; vetëm më brengos fati i popullit serb, nëse vazhdon të identifikohet me një ideologji neofashiste. E ardhmja e tij mund të jetë edhe më e zymtë.

Shtrohet pyetja: A mund t'i ikim një katastrofe të mundshme dhe të na kthehet paqja në trojet tona? Besoj se po, vetëm kokat e fjalët tona t'i shkundim nga demonët. Atdheu ynë i vetëm e më i sigurt është Njeriu.

(Janar, 1993)

(Kumtesë e lexuar në Simpoziumin ndërkombëtar "Shkrimtarët dhe nacionalizmi", mbajtur në Vjenë më 30 dhe 31 janar '93)





SHPËRNGULJET E SHQIPTAREVE.

Me lejoni së pari t'i përgëzoj organizuesit e këtij tubimi në të cilin janë mbledhur intelektualët e Ballkanit, për të ngritur zërin kundër luftës, çështje kjo shumë aktuale në këtë moment, ngase derisa ne po diskutojmë këtu, lufta po vazhdon në territoret e ishJugosllavisë, veçanërisht në Bosnje, duke paraqitur njëherësh kërcënim për paqen në vendet e tjera të Ballkanit, si edhe të Evropës. Dëshiroj gjithashtu të shpreh mirënjohjen time të sinqertë për ftesën që m'u dërgua dhe m'u bë e mundshme të marr pjesë në këtë tubim i cili na bën të mundshme të kemi mendimet mbi rolin dhe funksionin e intelektualëve gjatë kërkimit të një shtegdaljeje nga kjo gjendje, për rivendosjen e paqes dhe të mirëqenies. Duhet të vihet në pah se tubimi ynë po bëhet në një vend që është djepi i qytetërimit dhe i demokracisë evropiane, prandaj shpresoj se jehona e zërave tonë do të dëgjohet larg.

Unë po vij nga një pjesë e Ballkanit, nga Kosova, ku rreziqet e përhapjes së luftës po trokasnin në dyert tona. Në rast të shpërthimit të luftës në Kosovë, me të drejtë druhet se rrjedhimet e saj do të jenë shumë më të rënda sesa ato të Bosnjes. Dëshiroj të theksoj këtu se po bëhen më shumë se dhjetë vjet që kur regjimi serb po shkel në mënyrë shumë të vrazhdë të drejtat e njeriut dhe të drejtat kombëtare popullit shqiptar të Kosovës. Represioni është intensifikuar veçanërisht pas heqjes së autonomisë së

Kosovës më 1989 nga ana e Sërbisë, duke shkelur Kushtetutën në fuqi në atë kohë, të nxjerrë më 1974, sipas së cilës Kosova ishte element konstitutiv i ishfederatës jugosllave.

Mirëpo, megjë nuk i kemi shtruar vetes për detyrë të trajtojmë një çështje aq të gjerë siç është ajo e shkeljeve të të drejtave të shqiptarëve në ishJugosllavi, ne do të përqëndrohemi në një çështje të vetme të të drejtave të njeriut, por e cila është ndër çështjet themelore të kësaj fushe, në atë të dëbimit të popujve nga vatrat e veta. Deri tani lufta në ishJugosllavi ka detyruar më shumë se dy milionë banorë të saj të braktisin vatrat e tyre dhe të ballafaqohen me një të ardhme shumë të pasigurt, me fjalë të tjera me shpresa shumë të vogla që të kthehen në vatrat e braktisura.

Një pjesë e këtyre refugjatëve, ndërkaq, janë viktimat të spastrimeve etnike. Grupe të mëdha njerëzish, veçanërisht grash, fëmijësh dhe pleqësh, posaçërisht myslimanësh të Bosnjes, kanë qenë të shtrënguar të braktisin vatrat e tyre me kërcënimin e armëve. Këto spastrime etnike, me plot arsye e kanë shqetësuar opinionin publik ndërkombëtar. Ndërkaq, në Kosovë, pa u bërë shumë zhurmë, po zhvillohet një proces tjetër i spastrimit etnik. Ky proces është në funksion të politikës së shpallur haptas nga regjimi serb, që synon ndryshimin e strukturës etnike të Kosovës, 90% të popullsisë së të cilës janë shqiptarë.

Vendosa ta shtroj këtë problem meqë mendoj se ai është shumë aktual dhe me rrjedhime të rënda. Duke ngritur këtë çështje në një tubim ku temë diskutimi është roli i intelektualëve për ruajtjen e paqes, shpresoj se do të mund t'u japim një ndihmesë rivendosjes së rrjedhave normale të jetës në një trevë të rrezikshme nga përhapja e luftës, siç është Kosova. Në fund të mijëvjeçarit të dytë, në një kohë kur kufijtë po zhduken në Evropë, kur po krijohet një hapësirë e qarkullimit të lirë të njerëzve, të ideve dhe të mallrave, orvatjet për ndryshimin me dhunë të strukturës etnike të një vendi janë një absurd i njëmendët.

Regjimi serb jo vetëm që ka nisur zbatimin praktik të politikës së spastrimeve etnike në Kosovë, të sanksionuar me ligjet e nxjerra nga Parlamenti i Sërbisë, por madje ai edhe orvatet ta arsyetojë këtë politikë, me argumente qesharake.

Në të vërtetë, çështja e spastrimeve etnike të trojeve shqiptare të ishJugosllavisë i ka rrënjët të thella. Këto veprime kanë nisur të zbatohen që nga koha e Kongresit të Berlinit, të vitit 1878, kur Serbia pushtoi territoret e Leskovcit, të Vranjes dhe të Toplicës, me popullsi kryesisht shqiptare. Shqiptarët e këtyre viseve, për të shpëtuar kokën nga terrori i egër i ushtrisë serbe, u shtrënguan të braktisnin vatrat e veta.

Në fillim të shekullit XX, pas luftërave ballkanike, Serbia i shtyri kufijtë e vet drejt jugut, dhe pushtoi territore të mëdha shqiptare. Në këtë mënyrë, pas Konferencës së Londrës të vitit 1913, gjysma e popullit shqiptar ngeli jashtë kufijve të Shqipërisë, e cila u shpall shtet i pavarur, siç dihet, më 1912. Menjëherë pas Luftës së Parë Botërore, Serbia, e cila u bë pjesë e shtetit të ri të sllavëve të jugut, që u krijua në Konferencën e Versajës, më 1918, vazhdoi politikën e spastrimeve etnike të territoreve të reja të pushtuara shqiptare, të cilën e kishte nisur në trevat e

Leskovcit, të Vranjës dhe të Toplicës. Mirëpo këtë herë u përdorën metoda të tjera. U bë kolonizimi i Kosovës me serbë e malazias.

Ndonëse një pjesë e konsiderueshme e popullsisë shqiptare të trevave shqiptare që ngelën në Jugosllavi u shtrëngua të braktiste vatrat e veta, meqë as kolonizimi, veçanërisht i Kosovës, nuk ia doli ta ndryshonte strukturën etnike në atë masë sa kishte synuar Serbia në Klubin Kulturor Serb të Beogradit, u paraqit një projekt sipas të cilit do të ndryshonte rrënjësisht struktura e trojeve etnike shqiptare në Jugosllavi. Ky projekt, autori i të cilit ishte Vasa Çubriloqi, parashihte të gjitha format e trysnive që do t'i detyronin shqiptarët të braktisnin trojet e veta dhe të emigronin në Turqi. Pas këtij projekti, më 1938, u bë një konventë midis Jugosllavisë dhe Turqisë, me të cilën parashihej vendosja e disa qindra mijëra shqiptarëve në Turqi. Kjo konventë u sendërtua vetëm pjesërisht, ngase pëlciti Lufta e Dytë Botërore, mirëpo ajo u riaktualizua shumë shpejtë, madje para përfundimit të kësaj Lufte, në nëntor të vitit 1944. I njëjti profesor i Universitetit të Beogradit, anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, Vasa Çubriloqi, i cili pak më vonë u emërua ministër i republikës së re jugosllave, hartoi një projekt të ri për shpërnguljen e shqiptarëve nga trojet e tyre, i cili nuk u sendërtua, mirëpo ky dështim i ri i spastrimit etnik nuk e dekurajoi politikën serbe. Pas më pak se një dekenie, më 1953, një marrëveshje e re u bë midis Jugosllavisë dhe Turqisë, me të cilën parashihej vendosja e disa qindra mijëra shqiptarëve në Turqi. Pas sendërtimit të kësaj marrëveshjeje, në Kosovë u ndërmor një fushatë e tërbuar kundër shqiptarëve. Mirëpo, megjithëse rreth 250.000 shq-

iptarë u shpërngulën në këtë kohë në Turqi, kthesa politike që u bë më 1966 në Jugosllavi, kur u largua nga skena politike nënkryetari i atëhershëm i Republikës jugosllave, Aleksandër Rankoviqi, i cili qëndronte në krye të aksionit për dëbimin e shqiptarëve nga trojet e tyre, e la në gjysmë të rrugës planin për spastrimin etnik të Kosovës.

Megjithatë, Serbia nuk hoqi dorë kurrë nga këto plane. Pas vdekjes së Titos, një fushatë e re u ndërmor kundër shqiptarëve të Kosovës, e intensifikuar veçanërisht këto vitet e fundit, posaçërisht pas suprimimit të autonomisë së Kosovës. Shkeljet e vrazhda të të drejtave njerëzore dhe kombëtare të shqiptarëve, largimi nga puna i dy të tretave të shqiptarëve të punësuar, mbyllja e shkollave në gjuhën shqipe dhe e Universitetit të Prishtinës, përjashtimi i shqiptarëve të Kosovës nga jeta politike, ekonomike, shoqërore dhe kulturore dhe shkelje të tjera të panumërta, kanë si qëllim të fundit spastrimin etnik të Kosovës. Derisa në Bosnje spastrimi etnik bëhet me dhunë, po ky proces në Kosovë zbatohet me mjete të tjera. Një pjesë e shqiptarëve të Kosovës, duke u gjendur pa mjete materiale për jetesë, pa mundësi të shkollimit të fëmijëve, pa sigurim social dhe mbrojtje shëndetësore, është shtrënguar të zgjedhë rrugën e shpërnguljes, duke u vendosur në vende të ndryshme të Evropës Perëndimore dhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Nuk kemi në dorë statistikë zyrtare për numrin e shqiptarëve të shpërngulur nga trojet e tyre të ishJugosllavisë, mirëpo vlerësohet se numri i atyre që kanë zgjedhur rrugën e mërgimit e tejkalon shifrën e 200.000 frymëve. Ky proces po vazhdon edhe sot e gjithë ditën dhe ai është intensifikuar në kohët e fundit nëpërmjet një fushate e cila ka gjetur si vjeggë çarmatosjen e shqiptarëve. E vërteta, e njo-

hur nga e gjithë bota, është se regjimi serb vetë e ka armatosur popullatën serbe të Kosovës, ndërsa shqiptarët janë të shtrënguar t'ia dorëzojnë policisë serbe edhe pushkët e gjahut. Njerëzit e ftuar në polici për të dorëzuar një armë, po që se nuk e kanë, janë të shtrënguar ta blejnë për t'iu shmangur torturave të cilat i presin në policinë serbe.

Spastrimet etnike që janë bërë në Bosnje me kërcënimin e armëve kanë shkaktuar zemërim, me plot arsye, tek opinionin publik i mbarë botës. Spastrimet etnike në Kosovë, të bëra me mjete të tjera, pa ngritur shumë zhurmë, pra spastrimet e qeta etnike, rrjedhimet e të cilave nuk janë më pak të rënda, i janë më pak të njohura opinionit publik ndërkombëtar. Për këtë arsye zgjodha ta trajtojë këtë çështje në këtë tubim.

Duhet të vihet në pah se nis-mëtarët e planeve të spastrimeve etnike janë mjerisht, intelektualët, siç janë profesori i universitetit dhe anëtar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Serbisë, Vasa Çubriloqi, shkrimtari i shquar, laureat i çmimit Nobel, Ivo Andriqi, ose Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Serbisë me Memorandumin e vet të njohur, të hartuar më 1986.

Mendoj se struktura etnike heterogjene e Ballkanit, kjo përzierje popujsh, kulturash dhe qytetërimesh, në territoret relativisht të ngushta, paraqet një fenomen interesant të kulturës dhe të qytetërimit evropian dhe, përkundër asaj që po ndodh në këtë kohë në Bosnje dhe në Kosovë, duhet të mbështetet. Mjerisht, jemi dëshmitarë të një procesi të kundërt dhe është për keqardhje që nuk dëgjohet aq sa duhet zëri i intelektualëve i cili duhet të ngrihet botërisht kundër spastrimeve etnike në Bosnje dhe në Kosovë.

Duke e ngritur këtë çështje në këtë tubim, shpresojmë se ajo do të zërë vendin që i përket

gjatë kërkimit të zgjidhjeve të krizës së tanishme të ishJugosllavisë. Intelektualëve u bie një barrë e rëndësishme në përpjekjet për rivendosjen e paqes në këtë pjesë të Evropës, e cila që më shumë se një shekull është bërë skenë e përleshjeve të përgjakura. Duhet bërë çmos që të përfundojnë një herë e përgjithmonë këto konflikte dhe të bëhen përpjekje për integrimin e Ballkanit në Evropën e bashkuar, të cilën rrugë e ka hapur Greqia, ku ne u mbledhëm për të biseduar për çështje të rëndësishme të ardhmërisë sonë. Do të ishte më vend, më thotë mendja, që tubimet e këtilla të bëhen më shpesh. Duke punuar së bashku, do të mund të kryejmë shumë detyra të rëndësishme dhe të zgjidhim shumë çështje të cilat na i la trashëgim historia.

Në kumtesën time unë preka një çështje shumë shqetësuese të kohës në të cilën po jetojmë, me të vetmin synim që t'i hapet rruga një ardhmërie më të mirë, një mirëkuptimi më të madh dhe një bashkëpunimi të çiltër e të domosdoshëm të të gjithë popujve të Ballkanit.

Një revistë e përjavshme gjermane, *Der Spiegel*, në një artikull të botuar në këto kohët e fundit, duke gjurmuar gjenezën e konflikteve të tanishme në ishJugosllavinë, përgjegjësinë për to ua hidhte në radhë të parë intelektualëve, duke i pagëzuar penat e tyre si të përgjakura. Është një kënaqësi për mua kur po shoh se në këtë tubim synimet e penave tona shkojnë në drejtim të kundërt, në rivendosjen e paqes dhe të mirëqenies. Shpresoj se rezultatet e bisedimeve tona, këtu në Delfi, do të jenë një ndihmesë e përpjekjeve për ndalimin e konflikteve në Ballkan.

* Kumtesë e lexuar në tubimin "Intelektualët e Ballkanit kundër luftës", të mbajtur në qytetin antik Delfi të Greqisë, prej 5 deri më 7 mars 1993.



THOMAS PAINE

Doktrinar i të drejtave të njeriut

Në një rast, në Paris, filozofi freng Condorcet¹ i kishte thënë Thomas Paineit (Tomas Pejñ): "Mund t'ju them, qytetar Paine, se fjala e shkruar nuk vdes kurrë. Para disa netësh e kam kaluar kohën me "Common sense" dhe jam kënaqur, jam kënaqur, miku im Paine".

Veprat madhore të Thomas Paineit "Common sense", "The Rights of Man" dhe "Disertation on the First Principles of Government"² edhe sot, dy shekuj më pas, janë aktuale, dhe bashkëkohore. Njeriu edhe sot, sidomos ai që ende jeton nën tmerrin e "Bastilleve të reja, ndien kënaqësi duke lexuar. Penda e tij ka shkruar:

"Nga shkëndia e vogël që undez në Amerikë, shpërtheu zjarri që nuk mund të shuhet më. Sikurse ultima ratio regum, ai po përhapet nga populli në popull dhe qetë i pushton. Njeriu sakaq ndryshon, as vet duke mos e ditur se si. Ai mëson për të drejtat e veta duke u kujdesur për interesat që ka edhe më në fund zbulon se forca dhe fuqia e despotizmit në të vërtetë fshehen në frikën e tij që t'i kundërshtojë, se për të qenë të lirë, mjafton të dëshirojë"³.

Ai i dhuroi njerëzimit idetë dhe parimet që edhe sot nxisin luftën për demokraci të vërtetë politike dhe pavarësi kombëtare.

Th. Paine gjatë tërë jetës luftoi për të drejtat e njeriut. Ai besonte se "në një të ardhme të afërt, njerëzit do të jenë të lirë, të barabartë dhe të lumtur".

Në moshën tridhjetë e shtatë vjeçare, kah fundi i vitit 1774,

atëherë kur në trembëdhjetë kolonitë amerikane kishte filluar të rritet revolta kundër politikës merkantiliste koloniale angleze, Painei shkoi në Amerikë. Revolucionit të porsafilluar i dha flakë me esetë dhe artikujt që i botoi ato ditë, sidomos me veprën "Common sense" që shumë shpejtë u bë e famshme⁴. Duke i bërë vështrim të shkurtër kushtetutës angleze dhe duke u kritikuar rreptë monarkinë, ai e nxiti popullin amerikan që të deklarohej për pavarësi:

"Gjaku i të vrarëve dhe zëri i përmortshëm i natyrës thonë: koha është që të ndahemi"⁵.

Ideja e ndarjes dhe e pavarësisë, që në tërësi e përshkon këtë veprë, i bindi amerikanët se pavarësia është në interes të tyre.

Dhe atyre që e kundërshtonin pavarësinë u tha:

"Ju që e kundërshtoni pavarësinë, e dini ç'po bëni po ia hapni dyert tiranisë së përjetshme, sepse po ia lironi vendin tiranit"⁶.

Paine e kuptonte frikën e njerëzve nga pavarësia dhe atë e shihte në faktin se ende nuk ishte përcaktuar asnjë plan. Në pjesën e tretë të veprës: "Thoughts on the Present State of American Affairs" ai i paraqet drejtimet e përgjithshme të zhvillimit të shtetit të ardhshëm amerikan ku "liria dhe e drejta në pronësi do të duhet t'u sigurohet të gjithëve, e mbi të gjitha liria e religjionit"⁷.

Pjesa e katërt (Of the Present Ability of America, with some

Miscellaneous Reflections) është përplot argumente në dobi të pavarësisë. Aty Paine konstaton:

"Kjo është ajo periudhë që çdo komb e përjeton vetëm një herë dhe që është e përshtatshme për formimin e qeverisë. Shumë kombe e kanë humbur atë rast dhe u detyruan t'i pranojnë ligjet e pushtuesve të tyre, në vend që t'i krijojnë të vetat⁸".

I sigurtë në fitoren e pavarësisë "Common sensein" e përfundon:

"Le të dëgjohet për ne vetëm si për qytetarë të mirë, miq të sinqertë dhe të vendosur, mbrojtës besnik të të drejtave të njeriut dhe banorë të shteteve të lira dhe të pavarura të Amerikës⁹".

Paine ishte pjesëmarrës aktiv edhe i Revolucionit freng (1789) i cili për të ishte një etapë e re e luftës për demokraci. Ai mori pjesë në përplimin e Deklaratës mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit. Në shenjë mirënjohjeje për kontributin që i kishte dhënë revolucionit, markezi La Fayette simbolikisht ia dorëzoi çelsat e Bastilles, me ç'rast, Paine i shkruan G.Washingtonit: "Parimet amerikane e pushtuan Bastillen".

Pas miratimit të Deklaratës mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit (Paris 6. gusht 1789), E. Burke¹⁰ në Parlamentin britanik e sulmon Revolucionin freng (1789) dhe në nëntor të të njëjtit vit del vepra e njohur e tij Reflections on the French Revolution.

I revoltuar me veprën e Burkesë, në dhjetor të të njëjtit vit, në Londër, Paine filloi t'a shkruaj veprën e vet më të rëndësishme, aplogjinë e Revolucionit freng "The Rights of Man" (Pjesa Iër). Vepra del nga shtypi në mars të vitit 1791 dhe së shpejti anglezët fillojnë t'i citojnë pjesët e saj madje më me entuziazëm se sa amerikanët "Common sensein" (posaqërisht ato ku Painei e sulmon parlamentin anglez për shkak të vendimit të tij të vitit

1688, me të cilin W.Orkanski shpallet mbret i Anglisë) si: "Asnjëherë, në asnjë vend, nuk ka ekzistuar, nuk do të ekzistojë dhe nuk mund të ekzistojë ndonjë parlament, grup njerëzish apo gjeneratë që do të posedonte të drejtën apo fuqinë për të sunduar me pasardhës, si dhe të përcaktjë se si do të qeveriset dhe kush do të qeverisë (...) që vet të vendosë për të gjitha çështjet, njësoj siq kanë bërë edhe gjeneratat para saj.

(...) Njerëzit nuk janë pronësi e një njeriu. Asnjë gjeneratë nuk e ka pronësinë mbi gjeneratat që pasojnë¹¹.

Pushteti i përjetshëm nuk është e drejtë e njeriut, prandaj nuk mund të jetë as e drejtë e parlamentit¹².

Burkesë, që i kundërshton të drejtat e njeriut, Painei i përgjigjet:

"Të drejtat e njeriut janë ato që njeriut i takojnë nga e drejta për të ekzistuar. Këtu hyjnë të gjitha të drejtat intelektuale, si dhe e drejta e njeriut që të punojë për rehatinë dhe lumturinë e vet duke mos i cënuar me atë rast të drejtat natyrore të të tjerëve. Të drejta civile janë ato që mbështetën në të drejtën themelore që njeriu të jetë anëtar i shoqërisë. Çdo e drejtë civile mbështetet në ndonjë të drejtë natyrore e cila ekziston në individin, por për shfrytëzimin e të cilëve nuk mjafton gjithmonë forca e tij vetjake¹³".

Duke e sulmuar Burkenë i cili me përbuzje flet për Deklaratën mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit, Painei kalon në ekstremitet. Ai nuk sheh asgjë pozitive në asnjë akt mbi të drejtat që është miratuar ndonjëherë në Angli. Për të Magna Carta është "pushtim i ri", ndërsa Bill of Rights¹⁴ "Ligj mbi padrejtësitë dhe fyerjet".

Megjithatë Deklarata mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit nuk është akt i parë¹⁵ ku si të drejta të patjetërsueshme të njeriut theksohen l

iria, pronësia, siguria dhe rezistenca ndaj shtypjes dhe në këtë frymë parimet: se të gjithë njerëzit janë të barabartë para ligjit; se për të gjithë janë të arritshme të gjitha pozitat në të gjitha shërbimet dhe punët publike, sipas zotësive; se çdo njeri është i pafajshëm derisa të mos vërtetohet fajësia; se askush nuk guxon të shqetësohet për shkak të ideve dhe besimit që ka dhe në pajtim me këtë, çdokush ka lirinë e fjalës, të shkrimit dhe të publikimit; që tatimet për shërbime publike të përcaktohen sipas pasurisë së qyte-tarëve; që shfrytëzimi i tyre të bëhet nën mbikqyrje publike, njësoj sik-urse edhe administrata në të-rësi; e edhe të ekzistojë ndarja e pushtetit vetëm në Deklaratën mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit këto të drejta janë të drejta natyrore¹⁶.

Paini, sikurse edhe shumë bashkëkohës të tij, ashtu si edhe shumëkush tani, dy shekuj më pas, në Deklaratën mbi të drejtat e njeriut dhe të qytetarit shohin vetëm njërën anë të saj të drejtat e njeriut. Por, nëse Deklaratën e shohim me një sy tjetër, do të vërejmë edhe të kundërtën autorizimet e pushtetit. Fatkeqësisht, në atë Deklaratë njësoj mund të thirren edhe kundërshtarët e demokracisë. Për terror të jakobinëve, Deklarata nuk paraqiste pengesë. Pra, Deklarata mbi mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe të qytetarit nuk është vetëm akti i mbrojtjes së lirive dhe "të drejtave natyrore" të njeriut dhe mbrojtëse e njeriut si subjekt politik, por, ndryshe nga ç'm-endonte Painei, mund të ofrojë edhe arsytim për pushtet arbitrar të sundimtarit.

Megjithatë, edhe sot, dy shekuj më pas duhet të pajtohemi me Painein se me ideologjinë e të drejtave natyrore të njeriut Revolucionin freng u bë lajmëtar i rendit të ri, subjekt i të cilit është njeriu i lirëqytetari.

1. Antonie Nicolas Caritat de Condorcet (1743-1794) bashkëpunëtor i Enciklopedisë, sekretar i Akademisë, dhe anëtar i Konventit, autor i esesë së famshme *Esquisse d'un tableau historique des progres de l'esprit humain*.

2. *Common sense addressed to the Inhabitants of America* për herë të parë është botuar më 10. Janar 1776 në Philadelphia.

The Rights of Man : being an answer to Mr. Burke's attack on the French Revolution, pjesa I për herë të parë është botuar më 1791 dhe pjesa II më 1796.

Dissertation on the First Principles of Government është botuar më 1795

3. Th. Paine: *Prava covjeka i drugi spisi*, Zagreb, 1987, f. 161

4. Ndër artikujt më të njohur të Paineit që u botuan ato ditë ishte "*African Slavery in America*" (1795), ndërsa "*Common sense*" ishte shpërndarë për tre muaj në 120.000 ekzemplare.

5. Th. Paine: *Njësoj*, faqe 17.

6. Th. Paine: *Njësoj*, faqe 25

7. *Njësoj*, faqe 24

8. *Njësoj*, faqe 30

9. *Njësoj*, faqe 39

10. Burke, I. Edmund (1729-1797) politikan dhe teoricien i konservativizmit anglez, përfaqësues i klasës borgjeze që doli nga revolucioni i vitit 1688-1689 dhe që u zhvillua së bashku me revolucionin industrial. Burke ishte kundërshtar i teorive racionaliste të kohës së vet, veçanërisht i kundërshtonte të drejtat natyrore, kontratën shoqërore, parlamentin e shumicës dhe të drejtën në revolucion. Negativisht e vlerësoi Revolucionin freng duke qenë i bindur se me të janë çrregulluar të gjitha raportet në shoqëri që domosdo do të sjellin deri të diktatura e një njeriu. Ishte mbrojtës i revolucionit amerikan i sulmonte keqpërdorimet e administratës në Irlandë. Ishte i pari që theksoi se është obligim i Anglisë që të kujdeset për rendin ekzistues në botë.

11. Th. Paine. *Njësoj*, faqe 48

12. *Njësoj*, faqe 50.

13. *Njësoj*, faqe 66

14. *Magna Carta Libertatum* konsiderohet akti i parë kushtetues që paraqet gur themel të demokracisë anglosaksone.

E miratuar pa dëshurë nga mbreti anglez John Lackland, në qershor 1215, nën presion të baronëve anglez, kjo Kartë u bë simbol i kufizimit të pushtetit dhe pushtetit arbitrar të sundimitarit me anë të normës juridike, personifikim i garancisë së lirive dhe të drejtave të njeriut, parimit të ligjëshmërisë dhe sigurisë juridike.

Bill of Rights (1689) paraqet fillimin e historisë moderne shtetërore juridike të Anglisë. Me të përfundimisht edhe në pikëpamje formale juridike janë rrum-

bullakësuar fitoret e revolucionit borgjez.

Ky dokument, për herë të parë i ka vënë themelet e pozitës së re të mbretit si monark kushtetutur. Njëkohësisht, *Bill of Rights* i ka forcuar themelet e lirive dhe të drejtave të njeriut.

15. Në *Bill of Rights* theksohet se njerëzit nuk mund të gjykojnë pa ligj, se ligjet i nxjerrin organet e zgjedhura në mënyrë legale

16. Në të gjitha aktet e mëhershme mbi të drejtat e njeriut, ato të drejta janë "dhunti e Perëndisë".

HAQIF MULLIQI

Sado që për ndokënd, mbase, edhe mund të tingëllojë ca si absurde, natyrisht për shkak të rrethanave të jashtëzakonshme në të cilat po jetojmë, është e padyshimtë se mund të konstatojmë që sezoni i fundit teatror në skenat e Prishtinës ishte më i begatshëm me premiera se kurdoherë më parë. Arsyt kryesore për këtë lloj "paradoksi" mund të përkufizohen në dy pika: e para, fillimi nga puna i Teatrit "Dodona" dhe e dyta, vistri i shfaqjeve të përgatitura nga studentët e Akademisë së Arteve, Dega e Aktrimit, me të cilat edhe diplomuan pothuajse të gjithë studentët e vitit të IV, klase e profesor Faruk Begolli.

Fillimi nga puna i Teatrit "Dodona" në Prishtinë, qoftë si skenë për të shfaqur pjesë për fëmijë, si teatër i kukullave, apo edhe pjesë për të rritur, qoftë si një skenë alternative qoftë si institucion ishte një ngjarje e njëmendtë në jetën kulturore të Kosovës. Mbase, fillimisht, askujt prej nesh as që i kishte shkuar mendja se në një skenë e cila më tepër i gjason atyre të shtëpive të kul-



SEZONI TEATRORE 1992-1993 NË SKENAT E PRISHTINËS

turës në provincë sesa një teatri, mund të ndodhë një sezon i vërtetë teatror i cili begatol jetën kulturore jo vetëm në Prishtinë.

Profesor, jam talent se jo mahi...

Sezoni në skenën e këtij teatri u hap me riaktivizimin e shfaqjes tashmë të njohur në publikë, "Profesor, jam talent se jo mahi...". Është fjala për shfaqjen karakteret e personazheve për të cilën i kishin zgjedhur vetë studentët, për ta përmbledhur si tërësi, dorën në zemër mjaft heterogjene, nga profesori F. Begolli, studentët e klasës së të cilit edhe aktruan. Shfaqja analoge me këtë publiku ynë kishte rastin të shikonte të paktën përmes ekranit televiziv, të përgatitur nga studentët e Akademisë së Arteve të Sarajevës, mirëpo ky fakt, mendojmë se në asnjë mënyrë nuk e devalvon punën e studentëve prishtinas, por, përkundrazi vetëm dëshmon se shfaqjet e tilla janë mjaft praktike, joshëse për publikun, e nga ana tjetër u japin mundësi aktoreve të rinj që të

realizojnë kreacione të suksesshme. Së fundit, nuk ka dyshim se publiku ynë këtë shfaqje e mirëpriti në mënyrë të jashtëzakonshme, kështu që, edhe sot e kësaj dite, pas njëqind e sa reprizave, para portës së këtij tempulli të Talias, mund të dëgjohet ai refreni aq i rrallë, por shumë i çmueshëm: "A keni biletë tjetër". Mendojmë se prishtinasve një kohë të gjatë do t'u mbeten në kujtes kreacionet e Veton Osmanit, Abdinaser Bekës, Mentor Ejupit, Ilire Vincës, Sunaj Racës etj., sado që në shfaqjet e mëvonshme në momente këto karaktere nga kjo shfaqje edhe i "munduan", meqë plotësisht nuk arritën të zhveshen nga to.

"Oda në Hamburg" e Teki Dervishit

Kur kishim shkruar para ca kohësh diku nëpër gazetatat tona lidhur me komedinë "Oda në Hamburg" të Teki Dervishit me regji të Afrim Kasapolliit, shkrimin e filluam me komparacionin ndërmjet nevojës që kishin në antikë për tragjedinë,


Hamburg" në një mënyrë nga të dy autorët, edhe ai i tekstit, edhe ai i projeksionit skenik, kishin këtë qëllim. Ç'është e vërteta, ishte ta quajmë simpaktik fakti se kësaj radhe qesheshim me vetën tonë, duke u identifikuar situata analoge nga përditshmëria jonë. Edhe pse me tekstin e Dervishit komunikuam vetëm përmes shfaqjes (meqë nuk kishim rastin ta lexojmë) megjithatë krijohet bindja se pretendimet e tija nuk ishin aq të mëdha. Definimisht, duke shikuar këtë shfaqje, e cila padyshim u ofron mundësi interpretative 23 aktorëve, e vërejmë që strukturalisht kjo pjesë "kërkon vetën" diku ndërmjet vodvilit dhe burleskës. Kur përmendëm aktorët dhe kreativitetin e tyre, para së gjithash duhet theksuar lojën e mirë të Luan Dakës, atë të Afrim Kasapolliit dhe të balerines Nexhmie Selca, e cila na befasoni këndshëm. Nga ana tjetër, duket se Karli i Veton Osmanit dhe Baba i Shani Pallaskës dramaturgjikisht në skenë mbetën të pakryer (mbase edhe në tekst

tij i cili dukej se ishte aty sa për të mundësuar një epilog mjaft alogjik të pjesës.

Sidiqoftë duhet thënë se publiku në formim e sipër i Teatrit "Dodona" me interesim përcolli reprizat e kësaj komedie e cila, mendojmë se mund të jetojë edhe më në këtë skenë.

"Idioti" i Dostojevskit / Vajdës

S'do mend se premiera e dramës "Idioti" të F.M.Dostojevskit, përkatësisht të dramatizimit të këtij romani me namë të njërës ndër shkrimtarët më të luajtur nëpër skenat botërore, nga ana e regjisorit të njohur polak, Andzhej Vajda, mbase mund të quhet edhe shprehja e parë dhe tendenca e udhëheqësve të Teatrit "Dodona" që t'i japin një fizionomi kësaj skene me një vepër kaq të njohur, e cila deri më tashti përjetojë një sërë premierash nëpër skenat më të njohura botërore. Meqë Vajda dramatizimin e tij konceptualisht e ndërton vetëm mbi një segment të këtij romani, duke marrë për trajtim ngjarjen që ndodhi në shtëpinë e Rogozhinit dhe raportin e tij me Mishkinin, vetëm tri ditë pasi është vrarë po aty e dashura e tyre e përbashkët, "femra fatale" Nastasja Filipovna, kihet përshtypja se veti e tekstit nuk është thurja e veprimit, nga këndvështrimi global. Mirëpo, edhe si i këtillë, duket se i mundësoi regjisorit Selami Taraku që të zhvillojë konceptin e tij i cili për shumë kë mbase edhe nuk korrespondonte me atë stilin dostojevskian, por që megjithatë i jepte një sharm të posaçëm shfaqjes. Ç'është e vërteta, shfaqjen e bëjnë shumë joshëse edhe thyerjet e shpeshta dramatike, edhe konflikti permanent ndërmjet personazheve e para së gjithash vistri i situatave tragjikomike të cilat me një sens të stërholluar për skenën dhe profesionalizëm



në shekullin e kaluar për atë që njihet me emrin roman qytetar dhe me nevojën aktuale të njerëzve që të qeshen në këto kohëra të vështira. Dhe vërtetë u kuptua sa kishim pasur të drejtë. Kështu që mendoj se komedia "Oda në

), madje edhe pse për çdo dalje në skenë të doajenit Shani Pallaska, publiku e përshëndette me duartrokitje frenetike, megjithatë mendojmë se kjo kryekëput kishte të bënte me personalitetin e tij prej aktori të shquar se sa për "Babën" e

maksimal i realizoi aktori, vërtetë aktori, Enver Petrovci. Zoti Petrovci edhe njëherë, pas roleve kryesore në "Confiteorin" e Shnajderit dhe "Procesin" e Kafkës, që më parë i realizoi në skenën e Teatrit Popullor të Kosovës, dëshmoi vlerat e tija artistike. Duhet thënë se ishte përjetim i posaçëm për dashamirët e teatrit dhe të dramës të shikonin këtë lojë brilante të E. Petrovcit, të cilin shpresojmë se do të kemi rastin ta shohim edhe herave tjera mbi dërrasa, qoftë të kësaj skene, apo edhe të TPKSë. Transformimet e Rogozhinit të tij, tonet e zërit, gjestikulacioni, shprehja e fytyrës në sitata të caktuara, qëndrimi i tij, reaksionet dhe raportet në situatat përkatëse ishin të studjuara deri në atë masë kështu që vërtetë na befasoj ajo që quhet sasi e erudicionit që investoi zoti Petrovci në realizimin e rolit të tij. Ne, përmes tij, mbase depërtuam thellë në shpirtin morbid të Rogozhinit që t'na bëjë ta duam dhe ta urëjmë në të njëjtën kohë, që kështu të familjarizohemi me tragjedinë e tij shpirtërore e cila nga dashuria e marrë e shpie në krim, në errësisë psikike dhe vetëshkatërrim të plotë. Me një fjalë, loja e Enver Petrovcit ishte artistike, e komponuar mirë, e nuancuar dhe i gjasonte një rituali të njëmendtë skenik.

Mirëpo, s'do mend se edhe kjo shfaqje kishte ca të meta. Mbase atë pikërisht e sforcon, ta zëmë dimensionin ideologjik që i jep regjisorin në fund, apo edhe përsëritjet e disa skenave në mënyrë gati të njëtrajtshme. Për mendimin tonë, lëshimi më i madh në këtë pjesë ka karakterin logjik dhe ai ndodh në momentet kur në skenë, në pjesët fiktive të shfaqjes hyn Nastasja Filipovna (Jovanka Mandiq) thjesht si një brofitje, ndërsa vizuelisht skena shtrohet në atë mënyrë sa kihet përshtypja se edhe Rogozhini (E.

Petrovci) e edhe Mishkini (Dibran Tahiri) në të njëjtën kohë kanë një përfytyrim, apo ëndërrojnë diç të njëjtë. Kur e përmendëm Dibran Tahirin, të themi se ky ishte një profesionist i njëmendtë dhe patjetër i kontribuoi edhe shfaqjes, por edhe kolegut të tij Petrovci që të bëjë një kreacion të shkëlqyeshëm. Ky, me disa lëvizje të thjeshta ishte i tëri ç'duhet të ishte. Ky, s'do mend se e ka kuptuar fare mirë se rolin e tij duhet të ndërtojë jo me mjetet e emocioneve të vrullshme me të cilat e ndërtoi Petrovci Rogozhinin, kështu që në këtë shfaqje kishim rastin që të kënaqemi me forma të kundërta, por gjithësesi të realizuara të lojës.


Kur jemi tek kjo pjesë të themi se na u kujtua seç pat thënë në një rast Eduard Olbi: "Absurdi në teatër lind atëherë kur një shfaqje konsiderohet e mirë nëse ka shumë publikë, ndërsa e keqe ajo e cila nuk ka shumë publikë". Dhe kjo jo rastësisht zgjoi asociacione për absurdet rreth interesimit të publikut për këtë shfaqje. Së fundit mendojmë se është e padyshimtë që puna e publikut humbi kjo shfaqje, por sigurisht më tepër humbën ata që nuk erdhën të shohin këtë vepër.

"Kufiri me atdheun" i Teki Dervishit

Kur e shënuam diku më lartë se Teatri "Dodona" u shpalos në jetën tonë kulturore si një institucion për hulumtimin e formave të reja alternative dhe të një vizioni të ri të teatrit, para së gjithash e kishim fjalën te drama "Kufiri me atdheun" e Teki Dervishit, i cili njëherit bëri edhe regjinë e saj.

Kihet përshtypja se shkrimtari Teki Dervishi pranoi të futet në këtë projekt edhe si regjisor (kjo është hera e dytë, meqë së pari në Teatrin Shqiptar të Shkupit bëri poashtu regjinë e tekstit të tij "Atentati në tav-

ernë"), jo për të krijuar namë, apo për të na bindur se sa afër teatrit qëndron dhe vepron, por, besojmë para së gjithash pse kishte përshtypjen që këtë



tekst në këtë formë dhe në këtë ndërtim konceptual, pak kush do ta realizonte nga regjisorët. Së fundit, personazhet e tija gjysmë të burgosur e gjysmë të lirë nuk janë plotësisht pjellë e imagjinatës së tij. Mbase vetëm hapësira ku ndërton ngjarjen e dramës "Kufiri me atdheun" është zgjedhur nga relievi i imagjinatës së tij artistike, sepse z. Dervishi edhe vetë përjetoi prangat e totalitarizmit bolshevik nëpër kazamatat antinjerëzore. Mirëpo, dramën "Kufiri me atdheun" mund ta quajmë si një protestë artistike kundër deziluzionimit tonë mbi botën e panjohur "magjike" diku në mëmëdhe. Dhe është e padyshimtë se Dervishi kësaj ia arrinë dhe se dramën e tij me të drejtë mund ta quajmë një mirakel skenik. Është vështirë të themi se cilit nga regjisorët Dervishi do të kishte mundur t'ia besojë në realizim këtë tekst, për të cilin besojmë se ushqen një emocion më të madh se sa atë të zakonshmin artistik si secili krijues tjetër!? Është pra evidente se autori ka simpati të posaçme për këtë tekst, kështu që në skenë nuk

ngurron t'i lëshojë edhe ca nga ato pamje të cilat mbase edhe kërkuar ndonjë redakturë. Këtu mund të përmendim, ta zëmë pamjen kur Lloçani bisedon apo improvizon bisedën me t'et përmes telefonit, pastaj dialogun e Lirit dhe Ajanit etj.

Mirëpo, shikuar globalisht, përpos ca rënieve të shkurtëra, mezi të vërejtëshme, shfaqja në tërësi ka një dinamikë dhe ritëm jo të rëndomtë. Madje, disa pamje u gjasojnë sekuençave filmike dhe gjithëherë asociacionet, qoftë vizuele, apo edhe auditive krijojnë metafora të shumta që na shtyejnë të mendojmë gjatë. Thënë të drejtën, do të kishim dëshirë të madhe që këtë shfaqje ta shikonim me dikë cili nuk e di gjuhën tonë dhe të kuptojmë se si e përjeton ai pjesën, sidomos ritualin fizik të saj. Meqë ekziston një paradoks me të cilin avangarda duhet të ballafaqohet sepse, jo rrallë pandehet se ajo e cila ndërtohet në skenë bëhet më shumë për ata që luajnë në skenë se sa për ata që shikojnë, ndërsa mendojmë se me shfaqjen e tij Dervishi iu shmang këtij paradoksi duke dëshiruar që ajo shfaqje të ndodhë dhe të merret pjesë aty në skenë. Kështu, duke iu përmbytur thënies së Aristotelit që të mos shkatërrohet esenca e fabulës, Dervishi arrin ta përmbyllë këtë projektion të guximshëm skenik.

Kur e themi "të guximshëm", s'do mend e kemi parasysh se ky këtë pjesë e realizoi me studentët e vitit të tretë të Akademisë, klasa e profesor Enver Petrovcit, të cilët kryesisht justifikuan besimin e dhënë. Por, edhe pse kishim të bënim me aktorë fare të papërvojë, megjithatë na u imponua pyetja: a thua kjo shfaqje në këtë formë të teatrit fizik, pra që kërkonte përgatitje të madhe fizike, ka mundur të realizohet edhe me aktorët më të vjetër. Mendoj se përgjigja për këtë mund të jetë negative. Kur

jemi tek studentët aktorë, do të përmendim kreacionet simpatike të Arben Kastratit, Xhejlane Godancit, Ismet Azemit, Esat Gjocajt, por edhe të tjerëve.

Tri shfaqje diplomante

Shfaqjet e dikurshme të studentëve të Shkollës së Lartë, Dega e Artit Dramatik, të cilat i inskenuan si punime diplome aktorët tashmë të afirmuar të teatrove tona, ishin shfaqje për të cilat u fol gjatë madje edhe shumë kohë pasi, fatkeqësisht, u mbyll ai institucion për kualifikimin e aktorëve të rinj e të shkolluar për të cilët skena jonë viteve të fundit "lëngoi" shumë. Shi për këtë, sigurisht se ishim kureshtarë që të shohim shfaqjet e diplomantëve nga klasa e parë e Akademisë të cilët për shkak të rrethanave të njohura, s'do mend se të paktën në dy vjetët e fundit, mësuan dhe vepruan në rrethana të jashtëzakonshme dhe shumë të vështira.

"Tregimi zoologjik" i Eduard Olbit

Shfaqja e parë e studentëve para komisionit dhe para publikut ishte inskenimi i tekstit të njohur të dramaturgut amerikan Eduard Olbi "Tregimi zoologjik", regjinë e së cilës e bëri Faruk Begolli, ndërsa interpretuan Sunaj Raça dhe Abdinaser Beka.

"Tregimi zoologjik", bashkë me dramën "Kush e vrau Virginia Vullfin" dhe "Nata Amerikane" janë vepra të cilat e bënë të njohur E.Olbin nëpër skenat e shumta të botës. Edhe në "Tregimin zoologjik", ashtu sikur edhe në veprat e tija të tjera, Olbi tragjedinë e fatit njerëzor e nxjerrë si një shprehje të marrëdhënies të jashtme, lidhjen e patjetërsueshme reciproke të çdo gjëje me gjithçka, duke eksplikuar ideoartistikisht ndarjen e pamundësisë të dëshirave ndaj tyre. Kjo, mbase në një mënyrë i gjason edhe botëkuptimit

hegelian mbi tragjedinë ku individualitetet, në të njëjtën kohë janë edhe faktore edhe të pafajshme, derisa në "tragjedinë e vërtetë" e drejta e të dy drejtave në konflikt është njëjtë e madhe, respektivisht njëjtë relative. Dhe, duket se regjisori Begolli idenë e tij mbi ndërtimin e shfaqjes e bën mbi parimet e "tragjedisë së dytë" duke ngritur dhe relativizuar tragjizmin e dy personazheve të Olbit në "Tregimin zoologjik". Dorën në zemër, strukturalisht, shfaqja e Begollit kishte një konceptim të thjeshtë dhe të bazuar në të lexuarit e njëtrajtshëm të tekstit. Kështu që vizuelisht kjo shfaqje është ndërtuar thjeshtë por në mënyrë mjaftë precize, pa ndonjë shprehje ekzotike apo të ashtuquajturit konfeksionizëm evropian. Dhe, doemos arrin të na futë në një ambient klaustrofobik me plot e përplot kërcënime të ndërsjella ndërmjet dy protagonistëve. Aktorët me sens të madh mishëruan personazhet e dramës të Olbit, kështu që sa rrjedhte drama nuk humbaste në ritëm dhe nuk sillej në të zbraztë.

Vetia më karakteristike e kësaj shfaqjeje është disonanca ndërmjet qëllimit dhe realizimit në të cilin realizimi në të shpeshtën e rasteve nuk mund të tolerojë barren e rëndë të interpretimeve mendore largpamëse (vizionare) të cilat në të mishërohen. D.m.th. Sunaj Raça dhe Abdinaser Beka arrijnë që para nesh me një lehtësi dhe sens të stërholluar t'na sjellin një skelet të idesë e cila rëndom është e përgjithësuar dhe abstrakte, që çdo tentim të konkretizimit të saj e shndërron në një ilustrim të thjeshtë. Mund të themi se në këtë shfaqje mbi të gjitha duhet veqar pikërisht kreacionet e aktorëve të rinj Sunaj Raça dhe Abdinaser Beka. Ata personazhet e Olbit i shpurën nëpër të gjitha situatat absurde të dramës, duke hulumtuar arsyet për jetë dhe vdekje, dhe që të dy në mënyrë të mëvetësishme.

Të përkujtojmë poashtu se kjo pjesë u vlerësua si njëra ndër më të mirat në takimet ballkanike të studentëve të dramës të mbajtur sivjet në Shkup. Veçanërisht u pëlqye interpretimi i dy aktorëve të rinj.

"Ditë vere" e Mrozhekut

Deri më tashti në skenat e Prishtinës u inskenuan dy drama të shkrimtarit polak Sllavomir Mrozhek: "Emigrantët" dhe "Tango", të cilat në skenën e TPK-së i realizoi regjisorin nga Polonia Mjeçesllav Gorkijeviq, me gjysmë suksesi. Derisa shfaqja "Emigrantët", atëbotë në interpretim të Dibran Tahirit dhe Hazir Myftarit, u realizua me sukses të lakmueshëm, "Tangoja" megjithatë nuk kënaqi. Pra, vënja e serishme e një veprë të Mrozhekut në skenën tonë nuk ishte kurrëfarë befasië për teatërdashësit, aq më tepër kur vepra e tij jep mundësi të mëdha të realizimit.

Drama "Ditë vere" është një nga tekstet "filozofike" të Mrozhekut dhe në të vërehet prirja e autorit për teatrin avangard. Shi për këtë vënja e kësaj pjese në skenë s'ishte befasi aq e madhe duke pasur parasysh se shfaqjet e studentëve zakonisht edhe mëtonjnë hulumtimin e dimensioneve të caktuara të avangardës. Regjisore e shfaqjes ishte Melihate Qena, ndërkaq aktuan me sukses Adem Zhitopotoku, Avni Dalipi dhe Ilire Vinca. Këtyre personazheve të Mrozhekut që janë më shumë tipe "filozofike" sesa reale, në hulumtimin e një mundësie ideore të shtruarjes fabulative të kësaj pjeseide, M.Qena sikur u falë pak më shumë emocion se sa ato mund të durojnë në kornizat e atij abstrakcioni filozofik dhe konceptit struktural të dramës së Mrozhekut. Mirëpo, kjo në asnjë mënyrë nuk na bën t'mos e kuptojmë se para nesh në tri personazhe është i zërthyer një njeri i cili përjeton një metamorfozë të thellë dhe i cili zbërthehet në tri pjesë të tija: të mirëm (si



fatmirë), të keqën (si fatkeq) dhe idealin e tij që materializohet me të bukurën. Dhe pikërisht ky "fetus" filozofik i botës së brendshme të njeriut të ndarë në dy pjesë, apo thënë ndryshe homodupleksiteti dhe (i)realiteti i tij, me gjithë ato antagonizma të brendshëm në mendjen dhe opsionet të dyzimit, ishte temë e kësaj loje skenike.

Megjithse loja e aktorëve A.Zhitopotoku, I.Vinca dhe A. Dalipi ishte e efektshme, regjisorja Qena, me apo pa qëllim, nuk arriti të zhvillojë figurshmërinë dhe mizanskenin e duhur, duke mbajtur aktorët nën një regjim i cili patjetër kufizon. Madje sa për ilustrim mund të themi se gati e tërë shfaqja luhet në gjendje të ulur, gjë që apriori dobëson ritmin e një teksti të këtille, i cili është i tëri me teza por megjithatë jep mundësi të mëdha lëvizjeje.

Sidoqoftë, publiku duartrokiti nga zemra duke u uruar diplomimin aktorëve në fjalë. Nga kjo shfaqje patjetër duhet përmendur edhe skenografinë tejet të realizuar, inventive dhe vizuelisht precise të debutuesit, piktorit Mehmet Behluli.

Adaptim i "Borxhezi fisnik" të Molierit

Shfaqja e tretë e studentëve diplomantë ishte "Borgjezi fis-

nik", komedi e Molierit regjinë e së cilës bëri Luan Daka ndërsa interpretuan Mentor Zymberi, Refki Bytyqi, Ilire Vinca, Abdinaser Beka dhe Avni Dalipi. Regjisorin Daka kur iu fut këtij projekti para vetës kishte studentët afinitetët e të cilëve për komedinë i njihte nga "Profesor, jam talent..." në të cilin edhe vetë interpreton. Madje kihet përshtypja se edhe konceptin e tij regjisorial, përkatësisht kërkesat e tij para aktorëve të rinj i kufizon duke mos tejkaluar atë nivel dhe mënyrë të interpretuarit. Kjo më së miri vërehet tek rasti i Mentor Zymberit, i cili në masë të madhe me Zhurdenin e tij në "Borxhezin fisnik" shumë i gjason atij Labinot Kondrollit nga "Profesor, jam talent...", por të një moshe më të madhe.

Nga ana tjetër, zoti Daka në mungesë të kuadrit aktoreesk detyrohet që të kapë vetëm një vijë të tekstit të Molierit, për të krijuar një shfaqje të pastër skenikisht, por e cila ka mjaft alogjizma tek shkrirja e personazheve (zonja Zhurden me Nikoletën etj.). Rol i cili padyshim jepte mundësi të mira interpretimi ishte patjetër ai i zotit Zhurden, i cili u ndërtua mjaft bindshëm nga M.Zymberi me suptilitet dhe sinqeritet, por i cili duke gërmuar në momente më shumë se sa duhet disa herë kishte elemente të groteskës. Po ashtu ishin të realizuar edhe rolet e Refki Bytyqit (i mishëroi disa personazhe) e në veçanti imponoi interpretimi i Ilire Vincës dhe Abdinaser Bekës, të cilët pamëdyshje dhanë kontribut të çmueshëm në ndërtimin e përshtypjes së mirë që la ky projekt skenik, sado që nuk ishin gjithnjë në plan të parë.

"Nata e fundit në Goli Otok" e M.Kajtazi / Xh. Qorrrjat

Teatri popullor në dy tre vjetët e fundit, padyshim, kaloi nëpër krizën më të madhe që mund të kalojë një tempull i kulturës kudoqoftë dhe në çfarëdo rrethanash lufte e paqeje. Rreth këtij institucioni



me traditë gati gjysmëshekullore frynë erëra të stuhishme dhe të egra, të cilat deshen ta zhbijjnë qenien nacionale shqiptare. Obstrukcionet e shumta dhe deri te pamundësimit teknik për të realizuar shfaqje (për shkak të riadaptimit të objektit) sikur ndikuan që veprimtaria në këtë teatër, në të cilin u shua një ansambël baleti, të dëgjohet në mënyrë të zbehtë, vetëm sa për t'u vërejtur. Kështu, pas gati një viti heshtjeje në skenë (tekstualisht atë ku zuri vend edhe publiku) tingëlloi zëri i aktorit dhe buzëqeshi Muza e Talias. Tre aktore të këtij teatri, më shumë me vetënisjativë (Xhevat Gorraj, Selman Lokaj, Asllan Hasaj) përgatitën dramën "Nata e fundit në Goli Otok", sipas motiveve të shkrimtarit Mehmet Kajtazi.

Dramatizimin dhe regjinë e kësaj pjese e bëri Xhevat Gorraj. Gorraj në dramatizimin e vetë, si një aktor me përvojë shumëvjeçare, nisët nga mundësitë e skenës dhe nga teksti i M. Kajtazit, në të cilin ka shumë faqe, merr vetëm atë ekstrakt të nevojshëm, atë lëndë nga e cila mund të bëhet një dramë joshëse. Por, padyshim se edhe vetë tema, siç ishte ajo mbi ferrin e Goli Otokut, pra një temë e tabuizuar deri vonë, ishte një provokim artistik për një krijues të teatrit. Kështu, shfaqja e Gorrrjat ka rrjedhën e vetë, ndërsa dramaticiteti fiton në tension veçanërisht në momnte kur aktorët evokojnë episoda tragjike nga e kaluara e popullit tonë. Sado që në momente të këtyre evokimeve vërehej një dozë e shtuar e patosit, megjithatë vetë ambienti në të

cilin zhvillohet ngjarja (qelia e burgut) sikur e toleronte këtë, ndërsa prezenca e shikuesve në scenë sikur simbolikisht paraqiste një burg për të gjithë ne, edhe për aktorët edhe për shikuesit.

Ishte joshës interpretimi i Xhevat Gorrajt i cili duket se maksimalisht realizoi njërin nga personazhet. Poashtu në nivbel ishte edhe loja dhe interpretimi i Asllan Hasajt dhe Selman Lokajt.

"Lkeni i Hasit" i Edi Shukriut

Pas një serie të shfaqjeve për klerikët patriotë shqiptarë Pjetër Budin ("Teatri i Vogël i Deli Ukës" i Ymer Shkrelit në regji të Agim Sopit) Pjetër Bogdanin ("Zhvarrimi i Pjetër Bogdanit" i Teki Dervishit në regji të Fadil Hysajt) etj. sikur me padurim prisnim premierën e dramës "Lkeni i Hasit" të Edi Shukriut në regji të Muharrem Genës, e cila ka për trajtim ca episoda nga jeta e të çmuarit At Shtjefën Gjeçovi, intelektualit dhe atdhetarit të shquar



shqiptarë të vrarë nga shovinistët serb në dekadën e dytë të këtij shekulli. Arsyet për këtë "pritje" tonën lidhur me këtë shfaqje, padyshim ishin dy: dëshira që një autore të ketë shkruar një dramë të mirë, aq më tepër kur kryeprotagonisti i veprës së sajë kishte për afinitet një profesion të njejtë me

autoren arkeologjinë, dhe e dyta se regjisori i kësaj shfaqjeje iste doajeni i skenës sonë dhe njëri ndër regjisorët e suksesshëm, zoti Muharrem Qena, opusi krijues i të cilit patjetër flet më së miri për punën e tij. Por, vërtetë ajo që pamë ishte një surprizë e njëmendtë për të gjithë ne. Faktikisht teksti i E. Shukriut ishte fare i dobët dhe thjeshtë edhe sot nuk e kemi të qartë se përse zoti Qena iu rrek punës ta inskenojë duke venë kështu në lojë reputacionin e tij. Edhe pse, dorën në zemër, vërehet tendenca që ky regjisor u orvatë të investojë në këtë veper më shumë se sa ajo ishte në gjendje të pranojë. Dhe në vend të dramës, e vetmja që pamë dhe dëguam në këtë pjesë ishte monologu mbi jetën dhe veprën e atë Gjeçovi si dhe të folurit e bukur skenik të Bislim Muçajt dhe Dibran Tahirit, të cilët fatkeqësisht nuk kishin hapësirë që të jenë më kreativ.

"Venedikasja" e anonimit

"Venedikasja" e autorit të panjohur italian të shekullit XV / XVI (ka supozime se mund të jetë edhe veper e Makiavelit), mendojmë se në skenën e TPKsë u inskenua në momentin e duhur, atëherë kur këtij teatri i nevojitej një shfaqje e cila do t'ia kthente publikun. Dhe, vërtetë ashtu sikur është besuar kjo pjesë, në regji të Faruk Begollit dhe në një sintetizim të kuadrit aktorsk (luajnë ca aktorë të vjetër e ca të rinj) sikur e përgënjeshtroi një bindje jo drejtë të krijuar se publiku ynë për arsye të masave të dhunshme të instaluar këtu nuk po i viziton shfaqjet në teatër. Kjo është paradoksale aq më tepër kur i njëjti publik e ka edhe Kosovën nën masë të dhunshme dhe s'ka si të apstenojë, respektivisht të heqë dorë nga kjo. Mendojmë se publiku nuk e ka bojkotuar teatrin, por nuk ka pasur interesim që të shkojë për të shikuar shfaqjet siç ishte të zëmë "Alo 1991",

"Antigona" apo "Lkeni i Hasit", të cilat assesi nuk do e plotësonin kërkesën e tyre artistike.

Sa i përket "Venedikases", vërehet se zoti Begolli i bëri një lexim linear tekstit dhe të thuash për asnjë çast nuk u shmang nga ai. Ai thjeshtë e dinte se çfarëdo shmangie apo edhe eksperimentim do t'i sillte kokëçarje të mëdha duke i "ikur" edhe nga zhanri, e sigurisht edhe mundësitë që ofron për realizim kjo komedi erotike. Mirëpo, mu kjo komedi, mu kjo pjesë ishte dëshmi tipike për atë se sa ka pasë nevojë kjo skenë për kuadër të ri aktorsk. Për këtë më së miri na binden me lojën e tyre plot elan dhe vrull, por edhe sens dhe kreativeitet artistik aktorët Veton Osmani dhe Ilire Vinca. Përndryshe, besoj se fat i tyre i madh ishte se në këtë pjesë luajtën pranë aktoreve numër një të kësaj shtëpie, Drita Krasniqit dhe Çun Lajçit, të cilët absolutisht në duart e tyre mbanin gjithë penjtë e kësaj shfaqjeje. Pra, "Venedikasja" është një shfaqje e cila josh publikun, krijon atmosferë e para së gjithash mendoj se ka arritur t'i thyej edhe disa "parime" të pashkrutara mbi puritanizmin e rrëzshëm të njeriut tonë.

Në fund të themi se ekzistojnë shumë faktorë që ndikojnë në krijimin e repertoarit teatror, por para së gjithash, në çfarë pajtohen të gjithë njohësit e dramës dhe skenës: zgjedhja letrare e pjesëve dramatike në bazë të përmbajtjes së tyre, kualiteteve të tyre artistike, në bazë të asaj që ato i flasin publikut bashkëkohor të teatrit, afiniteteve të tyre me kohën në të cilën teatri krijon dhe vepron. Mendojmë se edhe në këtë kohë të pakohë duhet punuar teatri, por edhe të kihet kujdes në zgjedhjen e teksteve. Është evidente se drama ynë nacionale megjithatë po çalon, ose krijuesit tanë veprat e tyre dramatike po i ruajnë për kohërat tjera.

MUFAIL LIMANI

TRI NOVELA TË KASËM TREBESHINËS

Kasëm Trebeshina, Stina e stinëve, Ndërmarrja botuese "Gjon Buzuku", 1991, Prishtinë

Rrëfimi i Kasëm Trebeshinës ka shumëçka të gojëdhënës, të narracionit popullor, është i shlrshëm, shtrrues, me shumë finesa oratorike, ku fantastikja dhe faktikja kanë simbiozën e vetë joautoriale, të trashëguar, me shumë kthesa, kapërcime, rikthime, digresione, dhe me një patetikë rurale në "Stina e stinëve" dhe "Fshati mbi shtatë kodrina", të cilat, po ashtu vihen në përdorim edhe në novelën tjetër, "Odin Mondvalsen". Ky rrëfim pretendon ta ketë fuqinë për të rrëfyer çdo gjë. Gogoli, Çehovi dhe rusët tjerë janë një shembull i mirë prej të cilëve, bashk edhe me Servantesin, duket se ka marrë zanatin Trebeshina. Është një rrëfim "dashamirës" nga perspektiva e fëmijërores, ku "çrëndomtësimi" jep jetë. Po, prapë, s'është fjala për atë se s'ka ferr në këto novela, por për atë se, si duket, objek-

tivisht s'ka mundur të jetë ndryshe pos kështu, mbasi rrëfimi e bën të veten, një rrëfim i një shpirti të irituar me "ndotjen e ambientit jetësor", ku s'mund të gjendet më dhe shtegëdaljen e kërkon tjetërkund... në fëmijëri... deri në çmendi. Antikomunizmi i Trebeshinës është rural kthimi në fshat, dhe atë në fshatin e fëmijërisë, kur çdo gjë ka qenë në rregull. E prapë, s'ka qenë deri në fund, por "isha fëmijë...". Zhdërvjelltësi është evidente. Ajo që është autoriale te rrëfimi i Trebeshinës është pikërisht kjo zhdërvjelltësi. Dhe fascinimi me fëmijëroren si qëndrim i artit kundrejt rrethinës së tij "madhore", sado që ky qëndrim është më parë i vetëdijshëm, spontan, sesa i "programuar", si kreacion që do të prodhonte rrëfimin...

Novela "*Stina e stinëve*" është përshkrim i një fëmijërie në fund e sipër. Prekja me "madhoren" është gjithkund. Rrëfëhet për Kristinën flok-verdhë, të bijën e një dyqanxhiu. Ajo është, në esencë, protagoniste e metamorfozës. Ajo është e bukur njëherë. Lahet në lumë me çupat tjera, e zhveshur, e bërë gati femër. Pastaj, djaloshi rrëfimtari i bërë gati mashkull, e zë atë duke "lozur" aktin seksual me një tamam-fëmijë. Kristina nuk mendon të rritej, pra. Djaloshi gati mashkull i bën shantazh dhe ajo i jepet, duke mbuluar fytyrën me përparësen e ngritur... Më vonë vijnë tjerët midis këmbëve të saj... Qehajai i pashallarëve me kobure... Pastaj edhe një gjysmëorgjie me djemtë e fshatit. Kristina, në fund të rrëfimit për të, rri e qan e palëvizshme, e shtirë, e përdorur, e lënë, e panevojshme, e harxhuar... E ky është, siç shkruan në kopertinat e librit ku gjendet kjo novelë, një alegorizim i mirë për fatin e autorit, fëmijë të ngrënë nga nënarevolucion. Aty është edhe Erveheja, vajza tjetër fati tjetër, femra tjetër që erdh e skolë, e panjohur, e pastër, e dëlirë, e huaj dhe e

pashembulltë... Edhe Sofa, e veja që luante bisht me një kapter e xhandarë tjerë. Ajo, po ashtu, flen me "fëmiun e rrëfimit", të cilin e bën tamam një burrë me zanatë burrash. Ajo është larg fëmijërisë, e mbetur e vetme, ndërsa vetmia edhe seksi si terren i vrazhdtë i pjekurisë me të hyjnë në jetë dhe jeta mbetet pa fëmijëroren, e cila tash e tutje, edhe ashtu edhe kështu (në jetë dhe në këtë rrëfim) është e shtirur, njëfarë vajtimi infantil, i mësuar gabimisht nga leximi i gabuar i të mëdhenjëve... Prindërit, vërfëria, miqtë, legjendat, thashethëmat, heroizmat lokal, pune e fshatit, kur nuk janë të sforcuar deri në plan të parë, janë "perspektivë" e mirë, sfond i përshtatshëm për idenë e fëmiutnatyrë, natyrës së fëmijëzuar që "zhvillohet" prej spontanitetit të pakushtëzuar, biologjik, e deri te "vetëvetëdijësimi" i dhembshëm shkëputja identiteti fati personal zgjedhjet ballafaqimet....

"*Fshatit mbi shtatë kodrina*" është novela tjetër e kësaj përmbledhjeje, ku shumëçka është i njëjti rrëfim. Është, megjithatë, më e realizuar, në kuptim që tani fëmijëror është vetëm perceptimi, ndërsa rrëfimi është një histori alternative e shqiptarëve. Nëse "Njëqind vjet vetmie" e Markesit ka mund të lexohet si një histori e botës, atëherë kjo novelë s'është pos një histori, që thamë, tjetër gojore, folklorike, popullore shqiptare. Rapo Hardhia rrëfen. Gjithnjë ndryshe të njëjtat ngjarje. Problematizohet gënjeshtra që rrëfyesiautori me zhdërvjelltësi oratorike e bën irelevante. Thuajse nuk e di se ku flitet për mite, legjenda, përralla, ngjarje... Dhe ku arti flet, gënjeshtra s'ka ç'kërkon aty: ajo është kategori politike, eknomike, juridike më parë sesa që do të mund të ndërlihdje me rrëfimin artistik. Nejse... Trebeshina vetëm që nuk e ka shkruar, kudoqoftë, parullën "Unë jam realist", e cila mbase i duhej një të ndjekuri i cili

ishte më realist në politikë dhe për atë shkak edhe pësonte... Në këtë novelë gjejmë një Shqipëri përplot male, kodra, përroje, yje në qiell, bagëti e bujqësi dhe përplot kujtime... çdo gjë që vlen më nuk është! Rapo Hardhia është një Homer lokal, të cilin fshati e mbanë për të rrëfyer e për t'i dëfryer. Dasmat, nusët e shëmtuara, bukuroshet fatale, kapëdanët e patrembur, të huajt e egër shkatërrues, komitet kryengritës, tregimet me raki e meze, dredhitë e vogla, mashtrimi me "dhi të bojatisura me ngjyrën e vjedhur të kuqe"... vështirë që mund të flasin për diçka tjetër, vështirë që mund të universalizohen, vështirë se kapin diçka më esenciale, duket se mbesin aventura të një populli të mirë që jeton në një fshat të bukur, të cilin nuk e lënë rehat të huajt... një syzhe i stëpërdorur patriotik në letërsinë tonë, në një milion variacione... Por në këtë novelë është edhe komunizmi, rusët e kuq, çiltëria e konfirmimit të fajit, lufta, edukimi komunist i popullit prej kohës "kur njerëzit hanin bar" e deri më tash... Më shumë humorit sesa ironisë i takon këtu roli i këndvështrimit. Historia që përfundon me një urti të cilën, në të vërtetë, duhej ta shqiptonin tjerët, "... a ka gjë më të mirë sesa të dalësh nga skena fill pas mbarimit të rolit tënd?!".

"*Odin Mondvalsen*" është, ndërkaq, diçka tjetër...

"Shënimet e një të çmenduri" të Gogolit janë, apo mund të ishin, një mostër e mirë për shkrimin e novelës së "Odin Mondvalsenit". Fjala është për rrëfimin, për stilin, për fjalitë ku mungesa e logjikës, sikur edhe te pasazhet e tëra, është efekt i mëvetëishëm, material me të cilin ndërtohet, strukturohet bota dhe shpirti ku logjika nuk përket, por ku ruhet kuptimi. "*Odin Mondvalsen*" është novelë me përplot alegori, ajo mund të quhej ndoshta edhe tamam një alegori e tërë. Alegoria sugjeron

shtetin e bërë Çmendi, ku të gjithë janë pacientë në shërim. Shqipërinë që burgos shkrimtarin Kasëm Trebeshina. Realizimi i idesë më racionale në histori të shtetit krijoi shtetin "jonormal". Paradoksi është edhe komik. Andaj humori edhe në këtë novelë. Por ajo që e shtyu ta shkruante këtë autor këtë novelë nuk ishte ndonjë vizion i "utopisë negative", një rishkrim i "1984" të Oruellit, ose "1985" të Barxhisit, ose të "Botës së re të mrekullushme..." të Haksilit, apo ngjashëm..("Nëpunësi i pallatit të ëndërrave", të Kadarese, ta zëmë...)...Jo! Në Shqipëri të atillë, çfarë kishte qenë deri tash për të cilën tani të gjithë dimë diçka nuk kishte nevojë për imagjinatë, për realizim autorial të një ferri modern. Ferri ishte aty, i realizuar, kudo përreth. Paraonet shëtisnin nëpër autmjete luksoze, Putifari xhelozonte aty Jusufin e bukur, për shkak të dorës dhe gishtit të prerë të gruas të tij, shkaku i bukurisë... Ne që kemi jetuar komunizmin, veprat e tilla, me gjasë mund t'i lexojmë si kronika të literarizuara të një përditshmërie tani, shyqyr!, të shkruar.

Te "Odin Mondvalseni" flitet për historinë e Partisë e cila që bërë historia e botës, sepse ajo e pushtoi botën e njerëzve nën pushtetin e saj. Milladin Popoviçi, Dushan Mugosha... Sekretari i Parë i Partisë... ishin vetëm emra tjerë për protagonistet e njohur nga historia e civilizimit njerëzor. Mirëpo krejt kjo është plani i dytë, sfondi, prapavija. Konflikti është i vendosur tek bukuria...Infermierja dashurohet në pacientin dhe ata vendosen në gravitacionin e bukurisë. Asaj ia dëgjin shtëpinë. Ata që janë, në esencë, kundër bukurisë. Bukuria, e bukura, supozohet mbase si kategori estetike, bile një vend të tillë doemos që zë në krijimet e autorit të frymëzuar nga rrëfimi i realizmit të shekullit të shkruar, siç thotë edhe Adrian Klosi. Paradokset, mungesa e logjikës, coinciden-

cat e njëpasnjëshme..., ngjarjet zhvillohen sikur në njëfarë ëndrre, edhe fundi është vetëm një fund i një ëndrre. Por zgjim nuk ka! Dhe s'mund të kishte. Çka është logjike, çka është normale, çka është e kapshme për mendjen e shëndoshë, çka është jetësore, çka është kuptimplote në sistemin dhe institucionalizimin e çmendisë në formë dhe në fuqi të Shtetit? Kjo novelë është e tillë që meriton vend në çdo antologji të prozës shqiptare. "Thuaj se je shqiptar" i preferohet Mondvalsenit i cili kurrësesi të ndihet shqiptar në atë Shqipëri. Sepse ishte i huaj aty, i pasëmurë nga realizmi socialist. Madje dr. Klosi i parathënijes thotë kështu: "si është e mundur që ato (këto vepravër. e jonë) nuk u infektuan...". Një pyetje paradoksale që flet për atë se komunizmi si ka qenë i importuar në Shqipëri, i ushtruar me gjitha dhunë ndaj popullatës, aq sa ka qenë njëfarë "sëmundje" kombëtare (nëse nuk llogariten shumica e kosovarëve, natyrisht...).

Në një Shqipëri të tillë Kasëm Trebeshina guxonte të vazhonte të ndihej shqiptar dhe të ishte shkrimtar, që është mjaft për një jetë. Në një Shqipëri të tillë u shkruan këto novela: kjo duhet të mjaftojë për art, për lavdinë e artit dhe të të gjithë artistëve me kombësi shqiptare.

Nuk e di çka ka shkruar tjetër Kasëm Trebeshina, sepse ato janë ende të pabotuara, mirëpo qysh në këto tri novelat e këtij libri hetohet se fjala është për një shkrimtar profesionist, me identitet të themeluar në rrëfimin e tij të posaçëm dhe mjeshtëror, për kordinatat e stilit të cilit i përket në përgjithësi dhe, sidomos me novelën "Odin Mondvalsen", se fjala është për një autor pa të cilin më letërsia shqipe nuk do të mund të ishte e kompletuar në çfarëdo rekapitulimi të asaj kohor në periudhën e ferrit komunist.

Lexojeni!



Victor Hell, *L'idée culture, Press universitaires de France, Paris, 1991*

Libri *Idea e kulturës*, i autorit Viktor Hell, është një vështrim i përgjithësuar mbi historinë e kulturës dhe të civilizimit. Ç'është kultura? A është e mundur që një sjellje të trajtohet si kulturë e një tjetër jo? A është dashuria kulturë? Cili është raporti mes kulturës dhe politikës? Janë këto vetëm disa nga çështjetë parashtruara në këtë vepër, me tendencë për tu përgjigjur në to. Viktor Hell bën një gjë të tillë duke rradhitur, sipas kapitujve, një histori të tërë të mendimit intelektual, politik e shkencor, që nga shekulli XVII e deri në ditët e stome. Një historicizëm të tillë në qasje ai tenton që ta arsyetojë në përmbylljen e veprës me fjalët se një mendim mbi idenë e kulturës, veçanërisht kur duhet përshkruar në kufij mjaftë të ngushtë, as që mund të ndahet nga një dituri më e gjerë enciklopedike.

Njëri ndër problemet e para me të cilat do të preokupohet

autori është ai i përkufizimit të nocionit kulturë. Në libër janë dhënë një numër i madh shprehjesh në të cilat nocioni kulturë përdoret në kuptime të ndryshme, si p.sh. "revolucion i kulturor" i famshëm kinez, i shprehur bile edhe në shtratin revolucionar të Mao Ce Dunit dhe gruasburrë të tij, në "shtëpi të kulturës" të cilat, aktualisht, për shkak të statusit ende të paqartë në ekonominë e tregut, më shumë shesin akullore se sa kulturë, "ministritë e kulturës" për buxhetin e të cilave gjithnjë thuhet e nuk ka mjete, për dallim nga ai i ministrisë së mbrojtjes nga armiqet e jashtëm dhe të brendshëm, për të vazhduar mandej me "industritë kulturore", "funksionarët e kulturës" dhe "identitetet kulturore". Autori shprehjet e përmendura vetëm i emron kalimthi, meqë më shumë është i interesuar për definimin e kuptimit kulturor. Një gjë të tillë ai nuk e bën vetë. I tërë kapitulli i parë është një antologji, e vërtetë e definicioneve mbi kulturën. Fillon nga sqarimi për kuptimin e parë të kulturës nga "Fjalori universal" (*Dictionnaire universel*, 1690) i Antoan Furetiyeut, në të cilin kultura definohet si një "aktivitet i cili ndërmirret për të bërë pjellore një tokë me anë të punës ose për t'u kujdesur për rritjen dhe përparimin e ndonjë bime". Më tej në "Fjalorin e gjuhës frënge" (*Dictionnaire de la langue française*, 1878), të Litreut ky kuptim i parë i kulturës shndërrohet në një kuptim të bartur metaforik. Ndërmjet numrit të madh të enciklopedive të përmendura, gjenet edhe Enciklopedia amerikane nga e cila është marrë definicioni i sociologut anglez, ser Eduard Tejlor, vepra e të cilit "Kultura primitive" (*Primitive culture*, London 1871), llogaritet si vepra e parë e cila shkencërisht i qaset kulturës; Tejlor mes tjerash për kulturën thotë se ka të bëjë me gjithë tërësinë komplekse që është prodhura nga njerëzit gjatë eksperiencës historike. Kështu,

Viktor Hell, me definicionet e përmendura, do të arrijë deri në vitin 1979, me saktësisht në "Fjalorin e gjuhës së folur frënge" (*Dictionnaire du français vivant*, Paris, Bordas, 1979), në të cilin bëhet edhe ndarja mes kulturës fizike dhe asaj shpirtërore mbi të cilën ndarje bazohet edhe analiza e problemeve të ndryshme të kulturës dhe elementeve kulturore. Helli pastaj parashtrohet edhe aspekte të institucionalizimit të kulturës, duke cituar ekstraktet na aktet shtetërore, që kanë të bëjnë me probleme kulturore, si p.sh. çështjet mbi kulturën të përfshirë në ligjin për arsim të Francës nga viti 1968

Mbi të gjitha nëpërmjet një panorame të tillë mund të ndiqet evoluimi në kuptimin dhe përkufizimin e kulturës. Se me të vërtetë bëhet fjalë për evoluim mjafton vetëm krahasim ndërmjet definicionit të parë të vitit 1690 të akteve normative nga viti 1968 dhe i fjalorit të vitit 1979.

Faktin që subjektiviteti i autorit shumë pak është i dukshëm në këtë vepër, Hell e arsyeton me mendimin se ai tenton që të ofrojë ide nga më të ndryshmet, të cilat janë të lidhura me kulturën në adhe të parë, kurse kultur nuk mund të vërehet dhe analizohet pavarësisht nga evoluimi i mendimit politik modern, duke filluar që nga Dekarti për të vazhduar më tej.

Idea mbi kulturën as që mund të vërehet jasht kontekstit evropian, brend të cilit është e definuar vetë gjeneza, principet themelrore dhe implikimet praktike të saj. Për të evituar tendencën e konceptioneve gjenerale dhe apstrakte, dhe duke i zgjedhur dis amomente sinjifikative dhe shembuj të qartë që konkretizojnë gjenezën e idesë mbi kulturën autori pastaj merret me të menduarit mbi kulturën në disa periudha të ndryshme historike, letrare e filozofike, duke filluar po ashtu nga shekulli i XVII i racionalizimit

dhe iluminizmit, për të kaluar mandej në romanizimin si ndërlihdje me shprehjet kulturore të psikoanalizës së Frojdit. Karakteristikë për Hellen është se për të ilustruar mendimet e tij në të shumtën e rasteve nuk zgjedh përfaqësuesit më eminentë të orientimeve të ndryshem teorik, p.sh. nga shekulli i XVII të Hell ka zgjedhur Semjuel Pufedorfin, i cili është mjaft i njohur si veprimtar i Revolucionit Francez dhe nuk çmohet shumë si mendimtar në krahasim me emrat e njohur të kohës, sipas tij, megjithatë më mirë e prezenton mendimin e kohës kur është fjala për idenë e kulturës. Juristi dhe dipolomati Pufedorf është njëri ndër mendimtarët e parë i cili përdor nocionin kulturë pa një përcaktues përcjellës, i vendos raportet mes kulturës dhe politikës dhe i parashtrohet pyetjet më esenciale të cilat i sjell zhvillimi kulturor.

Në këtë rast Hell del nga prapavija për të shprehur mendimin e tij se ai nuk bën ndarje në mes kulturës dhe politikës, sepse, siaps tij, politika në finalizimin e saj megjithatë është një vepër kulturore. Autori, si duket për të vërtetuar mendimet e tij, gjithnjë sjell radhazi autorë të ndryshëm me veprat e tyre dhe autoriteti është fjala e fundit, gjë që me gjithë njohuritë e reja që sjell, edhe e ngarkon librin. Kështu, sa i përke konceptimeve mbi kulturën dhe politikën do të japë dis autorë siç janë Grotiusi, Pufedorfi, Hobsi dhe Rusoi.

Njëri ndër aspektet kryesore të idesë së kulturës është bashkëveprimi i idesë për të drejtën natyrore dhe i konceptit mbi qenien morale (entia moralia) nëpërmjet të cilit bashkëveprim manifestohet sociabiliteti origjinal njerëzor. Këtë shprehje të njerëzores, Hell tenton që ta shpjegojë nëpërmjet të *Enciklopedisë* dukeçmuar lart përparësinë dhe rolin të cilin mësimi i enciklopedistëve ia jep njeriut si

qenie. Njeriut, i cili për bazë të eksitencës së tij ka qëndrueshmërinë mbi ndryshimet e pandërprera. Nga ana tjetër, kultura nuk është diç më shumë se ndryshimi kolektiv që krijon njeriun dhe në të njëjtën kohë, krijohet edhe vetë. Mu për arsyen se njeriu është në qendër të *Enciklopedisë*, jo si një qenie statike, por si një princip vital i tërësisë, Hell këtë mënyrë të trajtimit të njeriut e ndërlihd me zhvillimet kulturore.

Mendimit të enciklopedistëve, i kushtohet aq shumë rëndësi edhe për shkak të një problematike tjetër, asaj të përcaktimit të raporteve mes kulturës dhe politikës, më qartë të afirmimit të prioritetit të kulturës ndaj politikës. Shembull i *Enciklopedisë*, forma e radhitjes së ssaj, temat e përshira në të ilustrojnë funksionin praktik dhe shprehjen filozofike të kulturës.

Një problem tjetër i cili preket gjatë kësaj periudhe, dhe i cili fitoi aktualitet më të madh në studimet moderne interkulturore, është fenomeni i quajtur *kosmopolitizëm*. Hell edhe nuk mundet t'i largohet një problemi të tillë si profesor i letërsisë komparative në Strasburg, ku edhe është vendosur qendra për realizimin praktik-politik të një ideje evropiane-multikulturale. Kjo ide gjendet në *Enciklopedi*, më qartë, në definimin e njeriut si banor i botës, kosmopolit, Nacionet kozmopolit, *veltbürger*, qytet i njerëzve përdoren që nga kohë kur as që mundet të bëhet fjalë për tregje të përbashkëta, por, universaliteti si moment kulturor, nevoja e njeriut për komunikim, arti i cili nuk njihet kufij, ishin faktorët kryesorë për të inicuar dhe ndihmuar në realizimin e një ideje të mënjanimi të kufijve, ide e cila mbi të gjithë është një ide e kulturës.

Viktor Hell pastaj anlaizon edhe idenë mbi kulturën të idelizmi gjerman. Si nocion alternativ për kulturën ai madje përdor nocionin gjerman

Bildung, e cila simbolizon gërshtimin original të mendimit (Hegeli dhe Fichte) dhe të poezisë (Gete dhe Shiler) gjermane, që kanë dhënë ndihmesë për zhvillimin e idesë së kulturës dhe për aktualizimin e saj. Hell merret me drejtimet e ndryshme rismitare letrare e filozofik gjermane që kanë ndikuar në frymën e kohës dhe rrjedhat e kulturës së kontinentit. Kështu ai ndalet në shprehjen kulturore të romantizmit evropian, të kësaj lëvizjeje filozofike, estetike dhe shpirtërore, e cila luajti një rol mjaft të rëndësishëm në zhvillimin e mendimit dhe kulturës evropiane. Katër janë fushat në të cilat manifestohet shprehja kulturore e romantizmit: 1) arti dhe jeta (nromalja dhe pafundësia) 2) eksperiencia e dashurisë dhe unit poetik; 3) miti dhe historia dhe 4) poezia popullore dhe nacionale. Helli ripërkujton funksionin e romantizmit për krijimin identitetin kulturor të popujve.

Hell në përfundim flet për idenë mbi kulturën me një terminologji politike, duke përdorur kuptimet e lirisë si një mënyrë e novjshme e të ndierit, konceptimin e qytetarit me obligime të ndryshme ndaj organizatave shoqërore, por idea e kulturës megjithë detyrat politike, sipas tij, implikon një supermacion të njeriut ndaj qytetarit. Si tendencë për institucionalizimin e kësaj ideje Hell sjell shembullin e Këshillit Evropian, i cili synon përparimin dhe bashkëveprimin e kulturave të ndryshme me ë siç thotë autori, ky këshill merr vendimet në emër të 380 milionë banorëve dhe 24 shteteve.

Vlera më e madhe e veprës "Ideja e kulturës" qëndron në përshkrimin evolutiv të idesë mbi kulturën nga një kohë në tjetrën. Një çështje tjetër mjaft me rëndësi është aspekti politik i veprës në fjalë. Së bashku me zhvillimin kulturor, krahas është shprehur edhe zhvillimi politik deri në tendencën bashkëkohore të trajtimit të

problemit të multikulturës si problem politik në zhvillimet moderne të Evropës së regjioneve. Kur multikultura nuk do të promovohet vetë m deklarativisht por pluraliteti kulturor do të bëhet program obligativ politik e kulturor do të mund të bëhet fjalë për realizim të idesë kulturore dhe zhvillim të identiteteve të ndryshme kulturore. Rrugat me të cilën mendimi evropian arriti në këtë shkallë ishte mjaft e dhembshme gjë që gjerësisht tregohet në librin në fjalë. E si do të jetë për ata që jetojnë në hapësirat që nuk e njohin tolerancën dhe bashkëjetesën, do të shohim po që se mbetemi gjallë.

YLBER HYSA

SHQIPTARËT DHE
MAGALI IDEJA GREKE

Shkëlzen Raça, Marrëdhëniet shqiptaro-greke, Instituti Albanologjik Prishtinë, 1990

Raportet e komuniteteve etnike ndër shekuj dhe gjeneza e tyre ka përbërë gjithnjë një nga detyrat më të vështira dhe më të pafalënderueshme të historianëve. Përveç memories kolektive tashmë të standardizuar në klishe që paraqitet

përpara studiuesit si barriërë, afërsia e dy komuniteteve fqinje, shqiptarëve e grekëve. Si dy popujve më të vjetër të Ballkanit, me marrëdhënie mijëvjeçare, me batica e zbatica historike, këtë problem e rëndon edhe korniza kohore (1829/1881) e zbërthimit të raporteve të këtyre popujve në fjalë. Në të vërtetë, shekulli XIX në historinë e popujve të Ballkanit paraqet kthesat vendimtare kur fillojnë të paraqiten shtetet nacionale. Dhe kjo adoleshencë e shteteve kombëtare e përjetuar në mënyrë të paevitueshme me nacionalromantizëm dhe poashtu me involvimin e paevitueshëm të Fuqive të Mëdha dhe interesave si logjikë e këtyre raporteve, maksimalisht do t'i tensionojë raportet dhe fatet ndërbalkanike në pezhorativitetin tekstual të shprejës "ballkanike". Kufiri i poshtëm kronologjik, viti 1829 i veprës shënon ngadhënjimin e revolucionit grek dhe formimin e shtetit grek, gjegjësisht monarkinë me në krye monarkun Otonin nga Gjermania, siç ishte modë e kohës, që në krye të shteteve të reja të vihej ndonjë monark nga familja mbretërore evropiane si shenjë apo garancë e stabilitetit të shteteve të posakrijuara. Në të vërtetë autori u bën një retrospektivë raporteve shqiptarogreke në mesjetë dhe vjen deri te revolucioni grek 1821/1829 për të filluar fabulën. Dhe këtu gjithsesi duhet potencuar pjesëmarrjen masive të shqiptarëve, arbëreshve të Greqisë, pa rolin e të cilëve vështirë mund të kuptohet formimi i shtetit grek, madje madje edhe me ndonjë emër legjendar shqiptar në revolucionin grek, si Marko Boçari.

Prej këtij viti, koncepti i "Megali Idesë", si program radikal i neohelenizmit që vetes i shtron detyrën e restaurimit të Perandorisë Bizantine dhe "kthimin e fronit të Konstandinit", do të jenë prore skelet i politikës së jashtme greke dhe objektiv i parashtuar nacional. Në këtë frymë do të përkufizohen edhe

kontaktet me shqiptarët, si veprim taktik për realizimin e qëllimeve "megaliideane" që do të njohin batica dhe zbatica, varësisht nga kontekstet ballkanike. Në të vërtetë, koncepte të "Megali Idesë" i priu edhe një koncept epizodik i patriotit grek Riga Fereos nga shoqata e njohur "Filiqi Eterua" mbi *federatën ballkanike*. Një ide të tillë për një kohë të gjatë e përqafonin edhe personalitetet me rëndësi të Rilindjes shqiptare si Thimi Mitko, Jani Vreto e ndonjë tjetër, por kjo ide e falimentuar që prej kohës së Ali Pashë Tepelenës kurrë nuk ishte kuptuar seriozisht nga pala greke, përveç rasteve kur këtë duhej përdorur si karrem për afrimin grekshqiptar në rrethana të reja. Një rrethanë e tillë alarmante për politikën greke ishte rasti i Konferencës së ShënStefanit kur Rusia haptazi u bë mentor i pansllavizmit në Ballkan duke tentuar krijimin e "Bullgarisë së Madhe" që depëronte thellë në tokat etnike greke dhe të një pjese shqiptare. Kjo fazë e politikës greke do të shoqërohet me kthimin e politikës pasive ndaj Perandorisë Osmane, të cilën me të madhe e preferon Anglia tashmë protektor i hapur i Greqisë. Kjo do të sjell mbretin e ri "europian" në fronin helen Gjergjin I nga Anglia. Apatitet e hapura pansllaviste në Ballkan do të bëjnë të mundur edhe një herë përpjekjen për afrimin grekshqiptar dhe kështu do të lindin takimet SkuludhiAbdyl Frashëri në Stamboll e Korfuz që sillëshin brenda objektivave të dualizmit shtetëror grekshqiptar nën ombrellën e monarkut të Greqisë. Por, këto takime ishin të dënuara me dështim për shkak të mossinqeritetit dhe taktizimit grek, i cili do të shkojë aq larg sa të sjell invadimin në krahinën shqiptare të Lëkurësit, ku andartët grek do të masakrojnë fshatarët shqiptarë duke përsëritur kështu një dezhavy greke të v. 1854. Këto ngjarje do ta sjellin marrëveshjen shqiptarogreke në nivelin "zero".

Çështje e vërteta problemi konkret gjatë gjithë kohës do të jetë çështja e përkufizimit të këtyre popujve, gjegjësisht pretendimi i çdokusht i qeverisë greke që të posedojë Epirin në tërësi dhe një pjesë të konsiderushme të tokave shqiptare në Jug të Shqipërisë, duke mos respektuar fare situatën demografike. Ky problem do të bëhet qenësor në kohën e mbajtjes së Konferencës së Berlinit duke u bërë një problem i nivelit ndërkombëtar, në kohën kur Lëvizja Kombëtare Shqiptare do të arrinte pjekurinë e saj më të madhe. Por, kësaj rruge i parapriu një historik gjysëmshkullor që do t'i determinojë marrëdhëniet shqiptarogreke.

Periodha pas formimit të shtetit grek e gjer më Kongresin e Berlinit tek shqiptarët gradualisht do të lind Rilindjen Kombëtare që kualitativisht do të ndryshojë konceptet politike nacionale. Kësaj do t'i paraprinë një varg ngjarjesh kulturore ndër shqiptarë që do të profilizojnë qëndrimin shqiptar karshi pozicioneve megaliideane dhe ultraortodokse greke. Kështu, "Alvafitari shqip" i v. 1871 i Kristoforidhit, vepërmartaria e Jani Vretos, Thimi Mitkos, Veqilharxhit, që do të kulminojnë me Shoqërinë e Stambollit dhe sistemin e ri ortografik të Sami Frashërit mbi bazat e *shkrimit latin*, definitivisht do të shënojnë fundin e inferioritetit kulturor para helenizmit shumë agresiv të udhëhequr nga fanariatët që një kohë do të arrijë shkallën e vërtetë të një inkuizicioni ortodoks. Rolin e tillë që e luajti Lëvizja kulturore shqiptare e kupton autori i librit, duke i vënë asaj vendin e posaçëm të një kapitulli. Në të vërtetë, ajo që potencon autori, pas një shfletimi dhe prezantimi të lakmueshëm të publikimeve dhe revistave të kohës, është fakt se neohelenizmi megaliidean prodhoi një kohë të gjatë një inferioritet kulturor nacional tek një shtresë shqiptarësh, duke u mbështetur maksimalisht në situatën e push-

timit osman të tokave shqiptare, të dallimeve fetare tek ta si dhe te pozicioni shumë komod i kishës ortodokse, që përmes klerit grek të imponojë skemën e njohur të ndarjes në "turq dhe helenë" brenda shqiptarëve. Vetëm në këtë mënyrë mund të kuptohen tipat si himarioti Milos me detyra të posaçme nga qeveria greke, apo shqiptari Byku me gazetën e tij "Pellazgos" me propagandim të hatashëm, e mos të flasim për bankerin Zhapa apo Arsaqin, që me të madhe po e ndihmonin greqizimin e shqiptarëve. Në anën tjetër, historianët dhe publicistët helen, prej pozitës së institucionalizuar shtetërore si Pashidhis, Papadopollos, Paparigopollos etj., shkonin aq larg me propagandën ultrahelene sa që Skenderbeun e paraqitën si grek dhe luftëtar për të mirën e Greqisë!

Përveç kësaj, Greqia e shekullit XIX kishte një pozicion vërtetë të privilegjuar në arenën diplomatike, "djep i civilizimit antik". Përaq më tepër ku një pjesë e territorit të saj ishte e okupuar nga "turqit myslimanë". Ky skematizim i problemeve e reduktonte në një mënyrë problemin e pozicionit shqiptar në "qytetar të perandorisë osmane" dhe problemin e Epirit dhe tokave shqiptare në kontekstin e "përkufizimeve grekoosmane", siç do të ndodhë më vonë në Kongresin e Berlinit. Kështu, gjatë periudhës që do të 't'i paraprijë "Krizës Lindore", Greqia do të bëjë përpjekje për një afrim të matur edhe me popujt tjerë ballkanik dhe si rezultat i kësaj do të bëhen marrëveshjet serbograhe me 1861 dhe 1867 që nënkuptonte ndarjen e sferave të interesit Jugun e Shqipërisë për Grekët dhe Veriun shqiptar për serbët. Mirëpo, marrëveshjet e tilla përveç se nuk mund të realizoheshin për shkak të plogështisë së armatës greke, pengoheshin edhe nga udhëzimet e diplomacisë anglo-franceze për mos ndërrmarjen e ndonjë aventure ballkanike ndaj Turqisë të cilën

hapësirë do ta shfrytëzonte definitivisht Rusia cariste.

Siç përmendëm më parë, një rast i afritit grekoshqiptar u krijua me të ashtuquajturën "Paqë të ShënStefanit" që dëshironte t'i legalizonte pozitat e fuqishme pansllaviste në Ballkan e çka e brengosi Gre-qinë dhe aleatët e saj perendimorë që ndërrmorën si kundëro-fenzive një konferencë të re ndërkombëtare, atë të Berlinit. Mirëpo, afrimi shqiptarogrek do të jetë taktik dhe i përkohshëm siç potencon autori Shkëlzen Raça, ngase së shpejti do të kuptohet se diplomacia evropiane do të përkrahë interesat greke në Epir, Thesali e Maqedoni. Kështu, prej v. 1879-1881 marrëdhëniet shqiptarogreke jo vetëm që do të ndërpriten por, do të acarohen maksimalisht.

Pikërisht kjo periudhë do ta shënojë zenitin e raporteve kontestuese shqiptarogreke dhe gjithë asaj që fshihej prapa perdeve që tanimë kishte marrë karakterin e një çështjeje ndërkombëtare, ku secili e tërhiqte ujin në mullirin e vet. Kështu, rreth simpative evropiane ndaj djepit të civilizimit, Vaso Pashë Shkodrani, në vepërën e tij "E vërteta mbi Shqipërinë dhe shqiptarët", të botuar në Paris në vitin e krizës 1879 thoshte: *"Ne ia njohim meritat Greqisë dhe askush nuk mund të injorojë atë që njerëzimi, shkencat dhe artet i detyrojnë racës greke. Por, ky nderim i sinqertë që ua bëjmë grekëve nuk duhet ta mbysë dashurinë tonë për Shqipërinë."*

Kështu, marrëdhëniet greko-shqiptare do të hyjnë në vorrbullën karakteristike që për grekët do të thotë shansi ndërkombëtarë për të arritur objektivat megaloidane e për shqiptarët mbrojtjen e hapsirës së tyre etike. Por, e gjithë kjo ishte diç më tepër në konstelacionin e politikës evropiane, që nënkuptonte me një anë Turqinë përgjegjëse në problem, Fuqitë e Mëdha, si garantuese të zgjidhjes së

problemit, dhe palët reale në konflikt grekët në një anë, që duhej shpërblyer dhe shqiptarët, që duhej humbur bashk me "firmën zyrtare" turke. Dhe normalisht, Turqia maksimalisht do t'i eksponojë shqiptarët si pagues kryesor të realizimit të marrëveshjes së Berlinit për t'i tkurrur kërkesat maksimale territoriale të Greqisë por, megjithatë, për të kryer pazarin në vijën e lumit Salavaria, që i mundësonte Greqisë të fitonte mjaft tokë për shtetin e saj. Kjo do të thoshte edhe kthimin definitiv të Portës kah Lidhja e Prizrenit, gjegjësisht shuarjen e saj dhe likuidimin e krerëve, para së gjithash të Abdyl Frashërit. Me këtë do të marrë fund një epizodë me rëndësi jo vetëm e raporteve shqiptaregreke por edhe të historisë së Ballkanit në shekullin e kaluar. "Vonë dikur, si do të përfundojë autori, duke theksuar një impresion të peshkopit grek të Korçës Filotheos më 1886, se Abdyl Frashëri megjithatë punoi me përkushtim "për unjimin e shqiptarëve të krishterë e musliman, duke i sakrifikuar postet oficiele". Ai peshkop më në fund pranonte se truri i Lidhjes Shqiptare të Prizrenit ishte i vetëdijshëm se kishte pak gjasa për të arritur qëllimin e caktuar dhe me të drejtë vënte në pah se luftën e tij dhe të shqiptarëve përgjithësisht e gëzuan të tjerët.

Libri i Raçës mbi marrëdhëniet shqiptaregreke të periudhës 1829-1881, nuk shënon vetëm një punë pioniere të pahlumtuar ndër ne, por, për aq më tepër është përpjekje e suksesshme e ndriçimit të problemit në fjalë. Përveç asaj që autori ka arritur të shfrytëzojë nga fondi i burimeve të panjohura dhe të papublikuara gjer më tani, ai në mënyrë të shkëlqyeshme arriti të prezentojë problematikën e ndieshme në të gjitha aspektet.

Në këtë mënyrë, autori arriti të formësoj nga shumë segmente një çështje shumë të ndieshme dhe me notë aktuale që po mungonte prorre në letrat tona.

PLANI BOTUES PËR VITIN 1993

Për numrat e ardhshëm redaksia ka planifikuar nga dy tema boshte.

Nr.12:

IDEJA E EVROPËS
SUBKULTURA

Shkrimet pranohen deri më 31 korrik 1993.

Nr.13:

PROBLEME TË TRANZICIONIT
FILOZOFIA DHE SOCIOLOGJIA NDER SHQIPTARËT

Shkrimet pranohen deri më 30 shtator 1993.

Nr.14:

FILOZOFIA E RE FRANCEZE
MODELET E ZHVILLIMI TË SHPEJTUAR EKONOMIK

Shkrimet pranohen deri më 15 nëntor 1993.

Në revistë do t'i kemi edhe këto blloqe tematike të përhershme:

GJENDJA POSTMODERNE
VËSHTRIME
RRJEDHA KULTURORE
KATALOGU.



THEMA • THEMA
ESSEITIKES • ARCHITECTURE
TEATER
ART

